


XOVASAR ÇAKMAKXHIAN

# GATITJA E REAKTIVEVE

BIBLIOTEKA

542  
217

## kimikë



KN

NITRAT

M = 101,

Prova n,  
pH = 7-8,5



542  
C 17

XOVASAR ÇAKMAKXHIAN

*Satitja  
e reaktivëve kimikë*



SHTËPIA BOTUËSE E LIBRIT SHKOLLOR

# Parathënje

Zhvillimi i industrisë në vendin tonë, në mënyrë të veçantë i industrisë kimike, ka krijuar një bazë të shëndoshë për prodhimin e një numri gjithnjë e më të madh kimikatesh (reaktivë kimikë), që gjijnë përdorim në prodhim, në shkollë, në institucionet shkencore dhe për eksport. Kështu është arritur që një pjesë e kimikateve të hiqen nga lista e importit madje edhe të eksportohen. Por duke u nisur nga mundësitet e pasfundme të prodhimit në vend të kimikateve të reja, veçanërisht i atyre me pakicë, por që nevojiten shumë dhe që zakonishi kushtojnë shtrenjtë, i hymë një pune eksperimentuese (mbi dhjetë vjet), për përfitimin e kimikateve me shkallë të ndryshme pastërtie, duke u nisur nga lënda e parë që ndodhet në vend ose që mund të përfshohen me leverdi nga produkte kimike teknike të importit. Kushtet që kërkon kjo punë, janë krahasimisht të thjeshta, të arritshme në shumicën e rasteve edhe në një laborator shkolle ose prodhimi.

U pa e arsyeshme që përvoja e punës sonë të përhapet, t'u vihet në dorë ndërmarrjeve të prodhimit, veçanërisht të prodhimit kimik, laboratorëve e institucioneve shkencore, mësuesve të kimisë në shkolla, nxënësve të zellshëm e të talentuar në kimi. Libri që i jepet në dorë lexuesit synon që:

a) nga lëndë të para të vendit dhe të importit të përgatiten sasi të vogla kimikatesh, që blihen me çmim të lartë nga tregu i jashtëm;

b) nga «mbeturina» të industrisë, të përgatiten produkte me vlerë ekonomike, për t'u përdorur në vend dhe për eksport;

c) të hiqen nga lista e importit dhe të prodhohen në vend të gjitha kimikatet që mund të prodhohen në kushte të zakonshme, pa investime të ndjeshme;

ç) produktet teknike që prodhon sot industria jonë kimike, të pastrohen e të përpunohen, duke ia rritur vlerën e përdorimit dhe të eksportit.

Në libër përshkuhen rreth 300 dorëpunime për substancat, kryesisht inorganike. Sot për sot këto na u dukën më me leverdi dhe që arrihen më lehtë në kushtet e laboratorit të prodhimit dhe të shkollës. Por rruga mbetet e hapur për libra të tjerë të këtij lloji.

Pjesën dërrmuese të substancave që përshkuhen në libër, i kemi përfshuar në kushtet e një laboratori të thjeshtë; u jemi shmangur disa recepturave që përshkuhen në literaturë, por që kërkojnë kushte speciale.

Kur kërkesat teknike të dorëpunimit dhe pastërtia e substancave nistore zbatohen

*me rreptësi, pastërtia e produktave të përfshira arrin një shkallë të lartë, jo rrallë të klasifikimit i pastër për analizë ose kimikisht i pastër<sup>1</sup>.*

*Por shpesh, veçanërisht për kushtet e laboratorit shkollor, kërkesat janë për substanca të klasifikimit të pastër. Në këtë rast dorëpunimi thjeshtohet, p.sh., duke pakësuar numrin e larjeve, rikristalizimin, riprecipitimin, kohën e tharjes etj. Nuk lejohet në asnje rast që për thjeshtësi të shkelen rregullat e veçanta të teknikës së sigurimit.*

*Në libër, për t'u orientuar lehtë, substancat janë paraqitur sipas rendit alfabetik. Gjithashtu janë përdorur disa shkurttime:*

*d = dendësia ( $\text{kg}/\text{m}^3$ )*

*(k.p.) = reaktiv kimikisht i pastër*

*(p.) = reaktiv i pastër*

*(p.p.a.) = reaktiv i pastër për analizë*

*M = masa molare ( $\text{g}/\text{mol}$ )*

*(t.p.) = reaktiv kimik special, me pastërti të veçantë ose i tejpastër.*

*t.shk. = temperatura e shkrirjes ( $^\circ\text{C}$ )*

*t.vl. = temperatura e valimit ( $^\circ\text{C}$ )*

*tretshmëria (% në masë), d.m.th. gramë substancë në 100 g tretësirë të ngopur. Autori do t'u jetë mirënjohës përdoruesve të librit që do ta ndihmojnë me vërejtjet e sugjerimet e tyre.*

**Autori**

---

<sup>1)</sup> Për hollësira në teknikën e dorëpunimit shih tekstin Kimia analitike (për shkollën teknologjike). .

# Hyrje

Kimikatet janë substanca që shërbejnë përi nevojat e ekonomisë.

Kimikatet që prodhohen në uzina e fabrika kimike ose edhe në ndërmarrje të ndryshme përi nevojat e ekonomisë, quhen kimikate teknike ose produkte kimike, kurse kimikatet që shërbejnë përi nevojat e laboratorëve të ndryshëm, si të kimisë, fizikës, biologjisë etj. quhen kimikate përi laboratorë ose reaktivë kimikë.

Kimikatet teknikë nuk janë të pastra. Ato, zakonisht, përbajnjë si papastërti substanca të tjera. Lloji e sasia e këtyre papastërtive varen nga lëndët e para ose lëndët ndërmjetëse, që përdoren përi prodhimin e kimikateve, si dhe nga metodat e proceset teknologjike që zbatohen gjatë prodhimit të tyre. Përi nevojat e ekonomisë e përi qëllime praktike kimikatet teknike i nënshtrohen pastrimit teknik. Kimikatet të cilave u është bërë pastrimi teknik, quhen kimikate teknikisht të pastra<sup>1)</sup>.

Kimikatet përi laboratorët ose reaktivët kimikë, sipas përdorimit të tyre, ndahen në dy grupe kryesore:

reaktivë kimikë përi përdorim të përgjithshëm dhe

reaktivë kimikë përi përdorim të veçantë.

Reaktivët kimikë përi përdorim të përgjithshëm, zakonisht, ndodhen në çdo laborator kimik. Të tillë janë një grup krahasimisht i vogël reaktivësh, si p.sh., disa acide (acidi sulfurik  $H_2SO_4$ , acidi klorhidrik  $HCl$ , acidi nitrik  $HNO_3$ ), disa alkale (hidroksidi i natriumit  $NaOH$ , hidroksidi i kaliumit  $KOH$ , hidroksidi i kaliumit  $Ca(OH)_2$ , uji amoniakor  $NH_3 \cdot H_2O$  ose hidroksidi i amonit  $NH_4OH$ ), disa kripëra inorganike (sulfate, klorure dhe nitrate të natriumit, të kaliumit, të bakrit, të kalciumit, të hekurit), dhe disa dëftues (fenolftaleina, laksuni, metiloranzi). Reaktivët kimikë përi përdorim të përgjithshëm, zakonisht, harxhohen në sasi krahasimisht të madhe në laboratorët kimikë të ndërmarrjeve, të shkollave (të larta, të mesme, 8-vjeçare) ose edhe të institucioneve kërkimore e shkencore. Zakonisht, ambalazhohen në pako letre ose në thasë polieteni, shishe, damixhanë ose bidonë (qelqi ose polieteni) që përbajnjë ngandonjëherë disa kilogramë reaktivë.

1) Në etiketat e ambalazhit të këtyre kimikateve vihet shënim: depuratum (lat. i pastruar) kurse në etiketat e ambalazhit të kimikateve teknike të papastrave vihet shënim: crudum (lat. i papastër, i papërpunuar).

Reaktivët kimikë për përdorim të veçantë, harxhohen në sasi të vogla për punime të caktuara, veçanërisht për analiza të ndryshme. Ambalazhohen në shëshe qelqi ose polieni, që përbajnjë deri në 1 kg reaktiv, madje edhe më pak.

Reaktivët kimikë kanë shkallë pastërtie të ndryshme, sipas shkallës së pastërtisë klasifikohen në:

- Reaktivë kimikë të pastër (p.)
  - Reaktivë kimikë të pastër për analiza (p.p.a)
  - Reaktivë kimikë kimikisht të pastër (k.p.)
  - Reaktivë kimikë specialë, me pastërti të veçantë ose të tejpastër (p.p.).
- a) Reaktivët kimikë të pastër mund të përdoren kryesisht për qëllime laboratorike mësimore: për kryerjen e eksperimenteve demonstruese dhe eksperimenteve laboratorike, që parashikohen në programet e kimisë shkolllore. Këta reaktivë mund të përdoren edhe për laboratorët kimikë të shkollave të larta, si edhe për laboratorët e prodhimit, në përshtatje me kërkesat e tyre.

Në etiketat e ambalazhimit të këtyre reaktivëve, zakonisht, përdoret shkronja p, që do të thotë purum (lat. i pastër).

b) Reaktivët kimikë të pastër për analiza, siç e tregon edhe vetë emërtimi, përdoren për punime analitike. Përbajtja e përzierjeve të substancave të tjera në këta reaktivë është aq e vogël, saqë zakonisht nuk sjell gabime në rezultatet e analizave kimike. Këta reaktivë mund të përdoren edhe për punime shkencore.

Në etiketat e ambalazhimit të këtyre reaktivëve, zakonisht, përdoren shkronjat AR, që do të thotë reaktiv për analiza, ose shkronjat: p.a., që do të thotë pro analysi (lat. për analiza).

c) Reaktivët kimikë kimikisht të pastër përdoren për studime të rëndësishme shkencore. Ata nevojiten për punime laboratorike që kërkojnë saktësi të madhe, si p.sh., në laboratorët e kimisë analitike për titullim etj.

Në etiketat e ambalazhit të këtyre reaktivëve, zakonisht, shënohen shkronjat CP, që do të thotë kimikisht i pastër ose shkronjat GR, që do të thotë reaktiv i garantuar.

ç) Reaktivët kimikë me pastërti të veçantë ose tej të pastër përdoren vetëm për qëllime shkencore të caktuara. Në këta reaktivë përbajtja e papastërtive të substancave të veçanta nuk i kalon të milionëtat pjesë të përqindjes ( $1.10^{-8} \div 1 \cdot 10^{-10}\%$ ).

Gjatë punës me reaktivët kimikë duhet të kihet gjithnjë parasysh se rritja e shkallës së pastërtisë së një reaktivë (d.m.th. ulja e përbajtjes së përzierjes me substancë të tjera), nga njëri rend klasifikimi në atë pasardhësin, shpie në një rritje të theksuar të çmimit të reaktivit (nganjëherë ky çmim rritet në progresion gjeometrik). Për këtë shkak reaktivët me pastërti të lartë nuk lejohet të përdoren përfshirë punë.

Gjithashtu, duhet pasur parasysh se për prodhimin e substancave të pastra, si rregull, nuk është vështirë të ulet përbajtja e papastërtive nga  $0,1 \div 1\%$ . Pasrimi i mëtejshëm i tyre është një detyrë shumë më e ndërlidhur. Kështu, ulja e përbajtjes së ndonjë papastërtie, duke filluar nga rendi  $10^{-3}\%$ , kërkon përdorimin e metodave speciale të pastrimit. Përfthimi i një produkti të tillë, kërkon mjetës me ajër të filtruar, me mungesë të plotë të sendeve metalike, përdorimin jo vetëm të ujit dy-tri herë të distiluar, por që ka kaluar edhe një pastrim tjetër me anë të joniteve, masa të repta për mënjanimin e mundësive të rënies së papastërtive nga duart ose veshjet e punonjësve etj.

Llojet, recepturat e gatitjes dhe recepturat e pastrimit të substancave që përfshihen në këtë libër, janë parashikuar për t'u kryer në një laborator kimie të za-

konshëm dhe janë bazuar në metoda të thjeshta, si: kristalizim, precipitim, distilim, ekstraktim etj.


Rikristalizimi. Nga të gjitha metodat e pastrimit të kripërave sipas shkallës së përdorimit, në vend të parë qendron rikristalizimi. Një gjë e tillë lidhet si me thjeshtësinë e procesit, ashtu edhe me efektivitetin e tij (të paktën për një pastrim pa pretendime).

Duke shfrytëzuar rritjen e tretshmërisë së kripërave gjatë nxehjes, mund të përgatitet një tretësirë e ngopur në temperaturën e valimit, të filtrohet ajo duke e ndarë nga papastërtitë dhe të ftohet. Në këtë rast, shpesh arrihet të përfshohen kristale të një kripe mjaft të pastër. Kjo lidhet me atë që, gjatë ftohjes, tretësira është e mbingopur vetëm në lidhje me substancën kryesore; kurse kripërat e tjera (papastërtitë), që ndodhen në pjesë të përqindjes, mbeten në tretësirën mëmë. E tillë është skema elementare e procesit të rikristalizimit.

Në të vërtetë rikristalizimi zhvillohet në mënyrë shumë më të ndërlikuar, pasi atë mund ta shoqërojnë një sërë procesesh që e ulin shumë efektivitetin e pastrimit gjatë rikristalizimit. Kështu, jone ose molekulat e papastërtive mund të kapen mekanikisht nga kristalet (që formohen) e substancës kryesore (okluzione). Është e pashmangshme edhe ndajthihja e joneve të papastërtive në sipërsfaqen e kristaleve. Këtu ndikon edhe dukuria e izomorfizmit (formimi i tretësirave të ngurta). Kjo dukuri është më e theksuar kur përmasat e joneve të kripës kryesore dhe përmasat e përzierjes ndryshojnë jo më shumë se  $10 \div 15\%$  dhe kur substancat kristalizojnë në të njëjtin sistem.

Efektiviteti i pastrimit të substancave me rikristalizim varet edhe nga tretshmëria e tyre. Kur tretshmëria e substancave është 5-30%, pastrimi bëhet shumë më i plotë sesa 75-85%. Që këtë rrjedh se rikristalizimi është me vend të bëhet për pastrimin e substancave që janë shumë të tretshme.

Pastrimi kimik. Një nga metodat e thjeshta të ndarjes së substancave, në veçanti për pastrimin e reaktivëve, është kalimi i papastërtisë (ose i substancave kryesore) në precipitat. Kjo mund të arrihet, në qoftë se gjatë veprimit të një reaktivi të patretshëm, komponenti i larguar i papastërtisë formon një përbërje pak të tretshme, për shembull, veçimi i përzierjes së  $\text{Fe}^{3+}$  te kloruri i amonit  $\text{NH}_4\text{Cl}$  gjatë veprimit të tretësirës amoniakore  $\text{NH}_4\text{OH}$ :



Shumë më shpesh kemi punë me kombinime të tilla të joneve, çdonjëri prej të cilave mund të reagojë me reaktivin precipitates, duke dhënë substancë pak të tretshme. Në këtë rast, duhet të përdoren dallimet në produktet e tretshmërive, duke krijuar kushte në të cilat elektrolitet që kanë tretshmërinë më të madhe (vlerë më të madhe të PT), të mbeten në tretësirë. Kështu, për ndarjen (veçimin e përzierjes së  $\text{Ba}^{2+}$  dhe kripërave të  $\text{Sr}^{2+}$  është e mjaftueshme të shtohet në tretësirën e kripës që pastrohet një sasi e vogël acidi sulfurik. Në qoftë se merret parasysh  $\text{PT}_{\text{BaSO}_4} = 0,37 \cdot 10^{-14}$  dhe  $\text{PT}_{\text{SrSO}_4} = 2,8 \cdot 10^{-7}$ , atëherë është e qartë që  $\text{BaSO}_4$ , që është më pak e tretshme, do të precipitojë në radhë të parë dhe vetëm pas precipitimit gati të plotë të saj, acidi sulfurik i mbetur do të precipitojë një sasi mjaft të vogël  $\text{Sr}^{2+}$  në formë  $\text{SrSO}_4$ .

Distilimi. Pastrimi i substancave me distilim ka si bazë avullimin e përzierjes së lëngjeve. Avulli, zakonisht, përfshohet me një përzierje tjetër. Ndodh pasurimi i tij me komponentë të lehtë të avullueshëm të përzierjes. Prandaj, nga shumë përzierje mund të largohen përzierjet që avullojnë lehtë ose, përkundrazi, të distilo-

het substanca kryesore duke mbetur papastërtitë që avullohen me vështirësi në aparatin e distilimit. Me distilim nuk mund të ndahen ato komponentë që formojnë përzierje azeotropike.

Metodat që përmendëm, janë më te zakonshmet që përshkruhen në këtë libër. Gjatë punës mund të përdoren edhe metoda më speciale, si rektifikimi, ndajthja, ekstraktimi etj.

*Pajisjet.* Në pjesën më të madhe të dorëpunimeve mund të përdoren mjete të thjeshta, që i përban pajimi tip i lëndës së kimisë të shkollave të mesme. Për raste të veçanta nevojitet dollapi tharës (termostati), në mungesë të tij aerosterili i qendrës shëndetësore (me temperaturë 0-250°C), furra elektriqe (mufla); në vend të saj mund të përdoren gypa zjarrdurues porcelani të veshur me rezistencë, nikel-kromi. Në ndodnjë rast duhet zëvendësuar ndonjë aparat special me aparate të mund të zëvendësohet me këmishën e ftohësit etj.

# I. Alumini dhe përbërjet e tij

## 1.1. Alumini

Al	M = 26,98 g/mol	d = 2700 kg/m <sup>3</sup>
	t.shk. = 660°C	t.vl. = 2500°C

Alumini është metal i bardhë shumë i lehtë, telëzohet dhe petëzohet dhe është përcjellës i mirë i rrymës elektrike dhe i nxehtësisë. Ka afri të madhe për oksigjenin. Në ajër mbulohet me një cipë okside të përhime, që e mbron metalin nga oksidimi i mëtejshëm. Në formë pluhuri digjet në ajër me një drithë të fortë. Alumini, në kushte të zakonshme, nuk vepron me ujin, acidin nitrik dhe acidin etanoik, kurse me alkalet, acidin klorhidrik dhe acidin sulfurik vepron.

Në eksperimentet laboratorike mund të përdoren telat ose ashklat e aluminit, të cilat mund të merren nga mbeturinat e ndërmarrjeve elektromekanike.

## 1.2. Përbërjet e aluminit



### 1.2.1. Hidroksidi i aluminit

Al(OH) <sub>3</sub>	M = 78,00 g/mol	d = 2423 kg/m <sup>3</sup>
---------------------	-----------------	----------------------------

Hidroksidi i aluminit Al(OH)<sub>3</sub> është pluhur i bardhë kristalor, pothuajse i patretshëm në ujë (tretësira e ngopur, në temperaturën 20°C përmban  $1,5 \cdot 10^{-4}\%$  Al(OH)<sub>3</sub>; PT =  $1 \cdot 10^{-32}$ ). Në qoftë se qëndron për një kohë të gjatë nën ujë ose thahet në temperaturë mbi 130°C, humbet aftësinë për t'u tretur si në acide, ashtu dhe në alkale. Hidroksidi i aluminit ka karakter amfoter dhe mund të sillet si acid shumë i dobët  $\text{HAIO}_2$ , me konstante shpërbashkimi  $4,1 \cdot 10^{-13}$  (në temperaturën 25°C).

### 1.2.1.1. Gatitja e hidroksidit të aluminit

a) Precipitati i hidroksidit të aluminit mund të përfshohet nga bashkëveprimi një alkali me aluminin, sipas barazimeve të reaksioneve të mëposhtme:





Kujdes! Veprimet duhen bërë në kapë, larg flakës dhe me syza mbrojtëse.

Në një kupshore porcelani përgatitet tretësira që përmban 6,5 g NaOH në 50 ml ujë. Shtohen në të, pak e nga pak dhe pjesë-pjesë, 5 g ashkla (ose tallash alumini). Përzierja nxehet shumë dhe valon vrullshëm duke shkumëzuar. Shkumëzimi ndodh si pasojë e çlirimt të hidrogjenit.

Pasi imbaron reaksiuni, lëngu filtrohet<sup>1)</sup>. Filtrati hollohet me ujë deri në vëllimin 200 ml. Pastaj, duke e përzier vazhdimisht, hidhet në të, pak e nga pak, acid nitrik (me dendësi 1180-1190 kg/m<sup>3</sup>) deri në reaksiun asnjancë (provat me tregues universal ose metil të kuq). Sasia e harxhuar e acidit është rreth 27,5 ml. Precipitati i hidroksidit të aluminit, pasi ndahet me anë të filtrimit<sup>2)</sup>, lahet 8-10 herë me ujë të ngrohtë, derisa ujërat larëse të mos përbajnë më jone nitrat NO<sub>3</sub><sup>-</sup>. Precipitati del në formë paste. Për të përfshuar hidroksid alumini të thatë, pasta thahet në temperaturë jo më të lartë se 110°.

b) Preparati i pastër mund të përfshohet edhe nga sulfati i aluminit Al<sub>2</sub>(SO<sub>4</sub>)<sub>3</sub> · 18 H<sub>2</sub>O teknik, sipas barazimeve të reaksioneve:



Në 75 ml ujë trefen 50 g Al<sub>2</sub>(SO<sub>4</sub>)<sub>3</sub> · 18 H<sub>2</sub>O dhe tretësira filtrohet. Filtrati ngrohet deri në temperaturën 75-80°C dhe hidhet në formë currili të hollë, duke e trazuar në tretësirën e nxehët që përmban 32 g NaOH në 75 ml ujë<sup>3)</sup>. Përzierja e përfshuar mbahet në temperaturën 70-80°C, 20-30 min dhe filtrohet në një letër filtruese, të palosur dy herë<sup>4)</sup> (del filtrat krejtësisht i tejdukshëm). Precipitati që mbetet në filter, njomet me 15-25 ml ujë të nxehët, në mënyrë që ujërat larëse të bashkohen me filtratin.

Filtrati nxehet në temperaturën 80-85°C dhe pastaj shtohet në të tretësira e 15-17 g karbonat amoni (NH<sub>4</sub>)<sub>2</sub>CO<sub>3</sub> (i pastër) në 60 ml ujë (i ngopur paraprakisht 1 h me dioksid karboni). Për të kryer precipitim sa më të plotë të hidroksidit të

1) Literatura këshillon hinkën për filtrim në zbrazëti (Buhner).

2) Literatura këshillon filtrimin në zbrazëti, por provat tregojnë se ky veprim mund të kryhet edhe me hinkë qelqi të zakonshme, në një kohë më të gjatë dhe më shumë se 12 larje me ujë të ngrohtë.

3) Gjatë punës përdoret tretësirë hidroksidi natriumi me përqendrim 40% (produkt i Uzinës së Sodë-PVC-së Vlorë), duke marrë 50 ml tretësirë NaOH dhe 27 ml ujë.

4) Letra filtruese e palosur dy herë ose dy herë e palosur përgatitet në këtë mënyrë: dy letra filtruese të veçanta vendosen në hinkën filtruese në mënyrë të tillë që tri fletët e letrës filtruese të dytë të përkijnë më njëren fletë të letrës filtruese të parë.

aluminit, tretësira e karbonatit të amonit (në fillim) duhet të hidhet në formën e një currili të hollë, duke e përzier në mënyrë të njëtrajtshme, dhe në fund me sasi të vogla, pak e nga pak, Pastaj, përzierja nxehet përsëri 20 min, në temperaturën 80-85°C, dhe pas lënies në qetësi 1 h, pjesa e sipërme e lëngut derdhet.

Precipitati, pasi lahet 2-3 herë me dekantim, hidhet në letëri filtruese të palosur dy herë, ku lahet 8-10 herë me ujë të nxeh të distiluar, derisa në ujërat larëse të mos ketë më jone sulfat (prova me klorur bariumi  $\text{BaCl}_2$ ). Nga 50 g sulfat alumin teknik (produkt i N Kimike, Durrës) përftohen 8 g precipitat.

### 1.2.2. Kloruri i aluminit

#### a) Kloruri i aluminit anhidër

$$\text{AlCl}_3 \quad M = 133,34 \text{ g/mol} \quad d = 2440 \text{ kg/m}^3 \\ t. shk = 192,6^\circ\text{C}$$

#### b) Kloruri i aluminit kristalhidrat

$$\text{AlCl}_3 \cdot 6\text{H}_2\text{O} \quad M = 241,43 \text{ g/mol} \quad d = 2398 - 2440 \text{ kg/m}^3$$

Kloruri i aluminit anhidër  $\text{AlCl}_3$  është substancë kristalore e tejdukshme, pa ngjyrë. Tretet në ujë (formon  $\text{AlCl}_3 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$ ), në alkool etilik dhe në eter dietilik, duke çliruar nxehësi.

Kloruri i aluminit  $\text{AlCl}_3$  thith lagështirën e ajrit, hidrolizohet pjesërisht dhe çliron klorur hidrogjeni.

Kloruri i aluminit kristalhidrat  $\text{AlCl}_3 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$  është pluhur i bardhë kristalor, shumë higroskopik. Tretet mirë në ujë. Me ngrohje shpërbëhet, çliron ujë dhe klorur hidrogjeni.

#### 1.2.2.1 Gatitja e klorurit të aluminit kristalhidrat

Kloruri i aluminit mund të përftohet nga veprimi i acidit klorhidrik mbi hidroksidin e aluminit sipas barazimit:



Në një kupshore porcelani, përgatitet tretësira e 75 ml acidi klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ) në 20 ml ujë të ngrohur në temperaturën 70°C; hidhen në të, duke i përzier, 26 g  $\text{Al(OH)}_3$  i thatë. Temperatura dalëngadalë ngrihet në 110 deri në 115°C. Në këtë rast, ndodh një reaksion i vrullshëm dhe pjesa më e madhe e hidroksidit të aluminit tretet.

Ngrohja në këtë temperaturë vazhdon derisa tretësira të bëhet asnjanëse (prova me kongo të kuqe<sup>1)</sup>). Në tretësirën e përfstuar shtohen 40 ml ujë. Lëngu

<sup>1)</sup> Provat mund të bëhen edhe me dëftues universali.


lihet në qetësi dhe filtrohet. Filtrati avullohet në banjë uji ose vaji, deri në formimin e një qulli kristalor. Pas ftohjes, kristalet filtrohen, lahen 2-3 herë me ujë të ftohtë dhe së fundi, thahen me anë të letrave filtruese.

Përftohen rrëth 50 g  $\text{AlCl}_3 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$ <sup>1)</sup>.

Kloruri i aluminit kristalhidrat mund të përfshohet edhe me anë të pastrimit të produktit teknik. Pastrimi kryhet në këtë mënyrë:

Treten 55 g produkt teknik në 45-50 ml ujë. Tretësira avullohet në temperaturën 90-100°C (në banjë uji) dhe pastaj ftohet. Kristalet që bien, filtrohen, lahen disa herë me acid klorhidrik dhe hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti. Pas kësaj kristalet thahen në temperaturën 70-80°C.

### 1.2.3. Nitrati i aluminit



$$M = 375,13 \text{ g/mol}$$


Nitrati i aluminit  $\text{Al}(\text{NO}_3)_3 \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  formon kristale të sistemit rombik ose monoklin. Tretet mirë në ujë (43% kripë anhidër, në 30°C) dhe në alkool etilik.

Në ajër me lagështirë, kristalet qullen. Në temperaturën 70°C nitrati i aluminit  $\text{Al}(\text{NO}_3)_3 \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  shkrin dhe kalon në  $\text{Al}(\text{NO}_3)_3 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$ .

Nga nxehja e nitratit të aluminit në temperaturën 150-180°C, në prani të avujve të ujit, formohet kripa bazike  $\text{Al}(\text{NO}_3)(\text{OH})_2 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$ , e cila në 350°C shndërrohet në  $\text{Al}_2\text{O}_3 \cdot 3\text{H}_2\text{O}$ , kurse në 500-550°C në  $\text{Al}_2\text{O}_3$  dhe  $\text{NO}_2$ .

#### 1.2.3.1 Gatitja e nitratit të aluminit kristalhidrat

a) Nitrati i aluminit kristalhidrat mund të përfshohet nga veprimi i acidiit nitrik me hidroksid alumini sipas barazimit:




Në një kupshore porcelani hidhen 87,5 g pastë e lagët  $\text{Al}(\text{OH})_3$ . Shtohen në të, pak e nga pak dhe duke e përzier, 37 ml  $\text{HNO}_3$  me dendësi 1340 kg/m<sup>3</sup> (ose C = 55%). Lëngu i turbullt avullohet në banjë uji në 50°C, derisa dendësia e tretësirës të arrijë vlerën 1520 kg/m<sup>3</sup><sup>3)</sup>. Tretësira gjatë ftohjes kristallizon. Pasj të kristalizojë plotësisht, shtohen në të 50 ml ujë, përzihet deri në tretjen, deri në formimin e cipës kristalore dhe lihet të ftohet. Me ftohje të ngadaltë formohen kristale të mëdha, të cilat veçohen nëpërmjet filtrimit. Kristalet lahen 2-3 banjë uji në 50°C. Të dy sasitë e kristaleve të përfshura bashkohen dhe mbahen

- 1) Në qoftë se si substanca nistore përdoren reaktivë të pastër, nëpërmjet metodikës që thamë, përfshohet reaktiv-kimikisht i pastër (k. p.).
- 2) Për përgatitjen e  $\text{Al}(\text{OH})_3$  shih paragrafin 1.2.1.
- 3) Për të arritur kristalizimin e dëshiruar, mund të bazohemi në formimin në sipërsaqe të lëngut të një cipe kristalore.

24 h në eksikator me hidroksid natriumi të ngurtë, e pastaj ruhen në shishe me tapë të smeriluar.


Përftohen rreth 40 g kripë.

b) Nitrati i aluminit  $\text{Al}(\text{NO}_3)_3 \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  mund të përftohet edhe nga bashkë-veprimi i sulfatit të aluminit me nitrat bariumi sipas barazimit:



Në një gotë kimike (me nxënësi 500 ml) hidhen njëkohësisht, duke i trazuar, tretësirat e nxehta të parapërgatitura të 32,5 g  $\text{Al}_2(\text{SO}_4)_3 \cdot 18\text{H}_2\text{O}$  në 150 ml ujë dhe të 35 g  $\text{Ba}(\text{NO}_3)_2$  në 150 ml ujë. Përzierja e përftuar filtrohet<sup>1)</sup> dhe filtrati provohet për praninë e joneve  $\text{Ba}^{2+}$  dhe  $\text{SO}_4^{2-}$ . Për këtë, në dy provëza (1,2) hidhen disa pika tretësirë nga filtrati. Në provëzen (1), për të hetuar praninë e joneve  $\text{SO}_4^{2-}$ , hidhet tretësirë  $\text{BaCl}_2$ ; kurse në provëzen (2), për të hetuar praninë e joneve  $\text{Ba}^{2+}$ , hidhet tretësirë  $\text{H}_2\text{SO}_4$ . Sipas pranisë së joneve  $\text{Ba}^{2+}$  ose  $\text{SO}_4^{2-}$ , në tretësirë shtohen përkatësisht me pika tretësirat e  $\text{Ba}(\text{NO}_3)_2$  ose të  $\text{Al}_2(\text{SO}_4)_3$ . Pas filtrimit, filtrati avullohet si në rastin e përfstimit të kësaj kripe nga veprimi i hidroksidit të aluminit me acid nitrik.

#### 1.2.4. Oksidi i aluminit




Oksidi i aluminit  $\text{Al}_2\text{O}_3$  është pluhur i bardhë, që nuk tretet në ujë.

Trethmëria e oksidit të aluminit në acide varet nga temperatura në të cilën është gëlqerizuar. Preparati i gëlqerizuar fort, praktikisht nuk tretet në acide inorganike dhe mund të kalohet në tretësirë vetëm duke e tretur, në gjendje të thërruar imët, në hidroksid kaliumi ose hidrogjensulfat kaliumi.

##### 1.2.4.1. Gatitja e oksidit të aluminit

Oksidi i aluminit mund të përftohet nga shpërbërja e shapeve të aluminit, në temperaturë të lartë, sipas barazimit:



Për të larguar ujin e kristalizimit, shapi amoniakor i aluminit nxehet në një kupshore porcelani në temperaturën  $100-200^\circ\text{C}$ , deri në formimin e një mase porozë të shkrifët. Kjo masë poroze, pasi të thahet, futet në furrën elektrike, ku gëlqerizohet, në fillim në  $800^\circ\text{C}$  e pastaj 4 h në  $1250-1300^\circ\text{C}$ .

Sipas literaturës, me këtë metodikë mund të përftohet reaktiv kimikisht i pastër.


Oksidimi i aluminit mund të përftohet edhe nga gëlqerizimi i hidroksidit të

1) Është mirë që filtrimi të bëhet nëpërmjet hinkës filtruese në zbrazëti.

aluminit, në temperaturë 850-900°C, 3h ose gëlqerizimi i nitratit të aluminit  $\text{Al}(\text{NO}_3)_3 \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  në temperaturë 825°C.

Provat tegojnë se gëlqerizimi mund të kryhet fare mirë edhe me furnelë elektrike.

### 1.2.5. Sulfati i aluminit



Sulfati i aluminit  $\text{Al}_2(\text{SO}_4)_3 \cdot 18\text{H}_2\text{O}$  formon kristale me ngjyrë të bardhë, të sistemit hekzagonal. Tretet mirë në ujë dhe fare pak në alkool etilik. Me ngrohje fryhet shumë dhe shndërrohet në një masë të sfungjertë. Në temperaturë të lartë shpërbëhet në trioksid sulfuri dhe oksid alumini.

Sulfati i aluminit që prodhohet në ndërmarrjen Kimike në Durrës, është në gjendje kristalore, me ngjyrë të gjelbër në të hirtë me veçoritë fiziko-kimike, që jepen në tabelën 1.1.

Tabela 1.1.


Treguesit	Norma në përqindje		
Oksid alumini $\text{Al}_2\text{O}_3$	jo më pak se	13,5	
Oksid hekuri $\text{Fe}_2\text{O}_3$	jo më shumë se	1	
Substanca të pattetshme		0,1	

Produkti teknik nuk mund të përdoret si reaktiv kimik, prandaj duhet të pastrohet.

Për pastrimin e tij ndiqet e njëjta ecuri pune që u përdor për gatitjen e hidroksidit të aluminit nga sulfati i aluminit.

#### 1.2.5.1. Gatitja e sulfatit të aluminit kristalhidrat

Sulfati i aluminit  $\text{Al}_2(\text{SO}_4)_3 \cdot 18\text{H}_2\text{O}$  mund të përfshohet nga bashkëveprimi i hidroksidit të aluminit me acidin sulfurik sipas barazimit:



Në tretësirën e acidit sulfurik të përfstuar nga tretja e 26 ml  $\text{H}_2\text{SO}_4$  98% (densia 1840 kg/m<sup>3</sup>) në 35 ml ujë, hidhen pak e nga pak dhe duke e përzier 25 g hidroksid alumini i thatë. Nga reaksioni qëlohet një sasi e madhe nxehësie. Pas mbarimit të reaksiot dhe ftohjes përfshohet një masë poroze e bardhë.

Me anë të kësaj metodike përfshohen rreth 25 g  $\text{Al}_2(\text{SO}_4)_3 \cdot 18\text{H}_2\text{O}$ .

## 1.2.6. Sulfuri i aluminit

$\text{Al}_2\text{S}_3$      $M = 150,15 \text{ g/mol}$      $d = 2020 \text{ kg/m}^3$   
t.shk. =  $1100^\circ\text{C}$

Sulfuri i aluminit është substancë me ngjyrë të verdhë në të hirtë dhe me erë të sulfurit të hidrogjenit. Preparati i pastruar me anë të sublimimit është në formë gjilpërash të bardha. Sulfuri i aluminit vepron me ujin e ngrontë dhe shndërrohet në hidroksid alumini dhe sulfur hidrogjeni (ndodh një çlirim i vrullshëm i  $\text{H}_2\text{S}$ ).

### 1.2.6.1. Gatitja e sulfurit të aluminit

Përzierja e një pjese në masë pluhuri të trashë alumini<sup>1)</sup> me 2 pjesë në masë «ule» squfuri hidhet në një pote porcelani me nxënësi të mjaftueshme dhe ndizet me anë të një shiriti magnezi. Kur fillon reaksiuni i vrullshëm, që shoqërohet me çlirim nxehësie, potja mbulohet me kapak dhe lihet disa minuta. Masa ende e shkrirë hidhet në një fletë hekuri; pas ftohjes thyhet në copa dhe futet në një shishe të myllur fort.

Preparati përmban përzierje alumini dhe squfuri por, provat tregojnë se ai është i përshtatshëm që të përdoret në laborator për përfshimin e sulfurit të hidrogjenit ose si agjent sulfurimi.

---

1) Puna duhet kryer me syza dhc doreza.

## 2. Argjendi dhe përbërjet e tij

### 2.1. Argjendi

Ag       $M = 107,87 \text{ g/mol}$        $d = 1050 \text{ kg/m}^3$   
t.shk. =  $960,8^\circ\text{C}$       t.vl. =  $2184^\circ\text{C}$

Argjendi është metal i butë me ngjyrë të bardhë karakteristike; formon kristale në formë kubi dhe oktaedri. Është i qëndrueshëm ndaj ujit, kurse në ajet mbulohet ngadalë me një shtresë sulfuri argjendi  $\text{Ag}_2\text{S}$ .

Në temperaturë të zakonshme acidi fluorhidrik, klorhidrik e sulfurik nuk veprojnë me argjendin, kurse acidi nitrik vepron dhe e shndërron në nitrat argjendi. Gjithashtu, acidi sulfurik i përqendruar dhe i nxeh të vepron me të (formohet sulfatargjendi), kurse bazat e shkrira nuk veprojnë.

#### 2.1.1. Gatitja e argjendit

a) Nga lidhjet metalike të argjendit që përbajnë Cu, Pb, Sn, Zn, As etj.

Metoda bazohet në tretjen e lidhjes metalike në  $\text{HNO}_3$ , precipitin e argjendit në formën e  $\text{AgCl}$  dhe reduktimin e  $\text{AgCl}$ .

Lidhja tretet në tretësirë 13-16% acidi nitrik. Tretësira e përfstuar hollohet me uje dhe lihet në qetësi; precipitojnë  $\text{SnO}_2$ ,  $\text{Sb}_2\text{O}_3$  etj.


Pas precipitimit, përzierja filtrohet me letra filtruese 2-3 herë të palosura. Filtrati mblidhet në një gotë të madhe, ku shtohet (me pak tepricë) acidi klorhidrik<sup>1)</sup>, me  $d = 1120 \text{ kg/m}^3$ . Tretësira bashkë me precipitatin ngrohen. Gjatë ngrohjes papastërtitë (metalet e tjera) treten në ujin mbretëror, që formohet. Precipitati ( $\text{AgCl}$ ) filtrohet dhe valohet përsëri me acid klorhidrik 10%; pastaj, lahet me uje të nxeh të dhe dekantohet.

Kloruri i argjendit i formuar reduktohet si më poshtë (shih pikën b).

<sup>1)</sup> Nuk duhet të shtohet klorur natriumi.

### b) Gatitja e argjendit nga halogjenuret e argjendit

Argjendi mund të gatitet nga halogjenuret e tij duke i reduktuar këto me zink;




Kloruri i argjendit përpunohet me tretësirë 13-16% acidi nitrik. Pas 24 h filtrohet dhe lahet me ujë. Precipitati përzihet me ujë dhe pezullia (suspensioni) acidifikohet me acid sulfurik; deri në reaksjon acid të dobët (ndaj kongos së kuqe). Pas acidifikimit hidhet në të zink i kokërruar: (23,5 g Zn për 100 g AgCl; 17,5 g Zn për 100 g AgBr; 14 g Zn për 100 g AgI). Gjatë reaksionit kimik çlirohet nxehësi dhe përzierja ngrohet; pjesa më e madhe e zinkut tretet (shndërrohet në  $\text{ZnCl}_2$ ), kurse precipitati i  $\text{AgCl}$  reduktohet në argjend (bie në formë pluhuri). Procesi quhet i përfunduar kur prova e marrë nga pluhuri, pas larjes së kujdeshme me ujë, tretet plotësisht në acid nitrik. Në rast të kundërt, në përzierjen e reaksionit shtohen edhe 10% zink dhe ngrohet disa orë në banjë uji.

Pasi mbaron reaksiuni, pluhuri i argjendit hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe lahet me kujdes, deri në largimin e plotë të joneve  $\text{Cl}^-$ ,  $\text{Br}^-$  dhe  $\text{I}^-$ . Pastaj, përpunohet me  $\text{H}_2\text{SO}_4$  10% (për të tretur tepricën e Zn), lahet me ujë deri në largimin e plotë të joneve  $\text{SO}_4^{2-}$  dhe thahet në 80-100°C.

Rendimenti arrin deri në 100%.

Argjendi mund të përfshohet edhe me anë të reduktimit të klorurit të argjendit me metanal:



Përzihen 50 g klorur argjendi (i lagësht) me 50 ml ujë të nxehë. Lëngu i përfshuar hidhet në një gotë porcelani të pajisur, me përzierës mekanik. Hidhet në të (në kapë) tretësira e 30 g hidroksid natriumi në 75 ml ujë (në 35-40°C) dhe me përzierje të pandërrerë, shtohet tretësirë metanali 40%. Pasi të trazohet 2-3 h, shtohen edhe 20 ml metanal. Gjatë 2 h temperatura gradualisht ngrihet deri në 55-70°C. Precipitati i argjendit hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti; lahet me 100 ml ujë të nxehë, pastaj me 50 ml  $\text{H}_2\text{SO}_4$  2%, 50 ml  $\text{NH}_4\text{OH}$  2% dhe më në fund me ujë të nxehë deri në largimin e joneve klorur  $\text{Cl}^-$ . Argjendi i larë thahet në temperaturën 40-50°C.

Rendimenti arrin deri 100%.

### c) Gatitja e argjendit nga mbeturinat e laboratorëve fotografikë

Mbeturinat valohen (1 h) me zink të kokërruar, në prani të acidit klorhidrik (500 ml tretësirë fiksuesi të përdorur i shtohen 20 g zink i kokërruar dhe 10 ml acid klorhidrik i përqendruar). Kokrrizat e patetshme të zinkut hiqen me shpatull porcelani. Precipitati i argjendit të reduktuar, lahet me dekantim, tretet (duke e ngrohur) në acid nitrik dhe i shtohet acid klorhidrik. Kloruri i argjendit që formohet (precipitat), reduktohet sipas rastit (b).

## 2.2. Përbërjet e argjendit

### 2.2.1. Bromuri i argjendit


$\text{AgBr}$        $M = 187,78 \text{ g/mol}$        $d = 6453 \text{ kg/m}^3$  (në  $25^\circ\text{C}$ )  
t.shk. =  $430^\circ\text{C}$

Bromuri i argjendit është pluhur me ngjyrë të bardhë në të verdhë, që me nxeh-tësi shkrin dhe kthehet në një lëng të kuqërrëmtë. Në ujë dhe në acide të holluara është pothuajse i patretshëm, kurse në hidroksid amoni tretet pak.

Bromuri i argjendit është i ndjeshëm ndaj dritës.

#### 2.2.1.1. Gatijtja e bromurit të argjendit

Bromuri i argjendit mund të përfshohet sipas reaksiionit kimik:



Në tretësirën<sup>1)</sup> e 54 g nitrat argjendi në 520 ml ujë të ngrohur në  $50^\circ\text{C}$  hidhet tretësira e ngrohtë e 40 g bromur kaliumi në 160 ml ujë. Precipitati i bromurit të argjendit hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti, lahet me ujë, thahet në banje uji dhe ruhet në shishe të errët.

Përfshohen rreth 60 g bromur argjendi.

### 2.2.2. Joduri i argjendit


$\text{AgI}$        $M = 234,77 \text{ g/mol}$        $d = 5670 \text{ kg/m}^3$   
t.shk. =  $556,8^\circ\text{C}$       t.vl. =  $1506^\circ\text{C}$

Joduri i argjendit është pluhur amoif me ngjyrë të verdhë të zbehtë. Me nxeh-tësi shkrin dhe kthehet në një lëng të verdhë, i cili po të nxehet në temperaturë më të lartë, me rrugën e murime në të kuqe. Në ujë, në hidroksid amoni dhe në acide të holluara pothuajse nuk tretet, kurse në tretësirat e përqendruara të jodurit të kalumit e të sulftit të natriumit tretet. Joduri i argjendit është i ndjeshëm ndaj dritës.

1) Puna duhet të kryhet me ndriçim artificial.

### 2.2.2.1. Gatitja e jodurit të argjendit


Joduri i argjendit mund të përftohet<sup>1)</sup> sipas raksionit kimik:



Në tretësirën e ngrohtë (në 50°C) të 50 g nitrat argjendi në 50 ml ujë hidhet tretësirë e ngrohur deri në 50°C e 47,5 g jodur kaliumi në 95 ml ujë. Precipitati hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti, lahet me kujdes me ujë, thahet në banjë uji dhe ruhet në shishe të errët.

Përftohen rrëth 68 g jodur argjendi.

### 2.2.3. Nitrati i argjendit



$$M = 169,87 \text{ g/mol}$$

$$\begin{aligned} d &= 4352 \text{ kg/m}^3 \\ \text{t.shk.} &= 212^\circ\text{C} \end{aligned}$$

Nitrati i argjendit formon kristale pa ngjyrë, të sistemit rombik. Nën veprimin e drithës, në qoftë se nuk ndodhen në të substanca organike, nuk pëson ndonjë ndryshim, në rast të kundërt, nxihet (për këtë shkak lë njollë të zezë në duar, në rroba etj.). Tretet shumë mirë në ujë (68,3%, në 20°C) dhe në glicerinë; tretet në alkool etilik dhe në alkool metilik, kurse në aceton e në benzen tretet me vështirësi. Në acid nitrik të përqendruar është pothuaj i patretshëm. Nitrati i argjendit është substancë helmuase.

Tretësira e nitratit të argjendit ruhet në shishe me ngjyrë të errët dhe me tapë të smeriluar; për rritjen e qëndrueshmërisë i shtohen disa pika acidi nitrik.

#### 2.2.3.1. Gatitja e nitratit të argjendit

Nitrati i argjendit mund të gatitet në këtë mënyrë:


Në tretësirën e ngrohtë (në 50°C) të 43 ml acid nitrik ( $d = 1400 \text{ kg/m}^3$ ) në 45 ml ujë, hidhen (në kapë) pak e nga pak 60 g tallash argjendi (mund të merret nga monedha argjendi). Pas tretjes së plotë, lëngu filtrohet. Filtrati avullohet deri në formimin e një cipe kristalore dhe stohet duke e përzier. Kristalet që bien, hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe lahen 2 herë me ujë në temperaturën 0°C. Tretësira mëmë bashkë me ujërat larëse avullohet dhe kristalizohet si më sipër. Të dy sasitë e përfstuara pas kristalizimit përzihen, thahen në 110°C dhe ruhen në shishe me ngjyrë të errët.

Përftohen rrëth 95 g nitrat argjendi.

Sipas kësaj metodike përftohet reaktiv i klasifikimit (p.p.a.).

1) Puna duhet të kryhet në drithë të kuqe.

## 2.2.4. Sulfati i argjendit



M = 311,80 g/mol

d = 5450 kg/m<sup>3</sup>  
t.shk. = 660°C

Sulfati i argjendit formon kristale të imëta të sistemit rombik. Në 1085°C reaktivi shpërbehet. Tretet mirë në hidroksid amoni, pak në ujë dhe është i patrëshëm në alkool etilik.

Ruhet në vende të errëta, në shishe të mbyllura mirë.

### 2.2.4.1. Gatitja e sulfatit të argjendit

Në tretësirën e 30 g nitrati argjendi në 20 ml ujë të ngrohtë, hidhet tretësira e ngrohtë dhe e filtruar e 13,2 g sulfat amoni në 20 ml ujë. Precipitati i sulfatit të argjendit, hidhet në hinkën përfiltrim në zbrazëti, lahet me ujë të ftohtë dhe tha-het.

Përftohen rreth 28 g reaktiv i pastër.

### 3. Azoti dhe përbërjet e tij

#### 3.1. Azoti

N<sub>2</sub>

M = 28,01 g/mol

t. shk. = - 210,52°C

t. vl. = - 195,67°C

Azoti është gaz pa ngjyrë, pa erë dhe pa shije, pak i tretshëm në ujë. Në kushte normale 1 l peshon 1,2505 g.

Azoti, në temperaturën e mjedisit, është i plogët kimikisht, kurse në temperaturë më të lartë se 560°C vepron me Mg, Ca, Li e me disa metale të tjera dhe formon nitrur e.


##### 3.1.1. Gatitja e azotit

Azoti mund të përftohet nga ajri atmosferik në këtë mënyrë:

Në një gyp qelqi zjarrdurues vendoset oksid bakri (II) kokrrizor (mund të përdoret edhe një rrjetë bakri e palosur në mënyrë të dendur).

Nga gypi, në fillim, duhet të nxirret ajri me anë të hidrogjenit. Pastaj oksidi i bakrit ngrohet me rrymë hidrogjeni, në temperaturën rreth 200°C dhe reduktohet deri në bakër metalik. Pas ftohjes së gypit (me rrymë hidrogjeni), për të larguar hidrogjenin, futet azot teknik ose ajër. Gypi me bakër<sup>1)</sup> nxehet deri në skuqje, dhe «gurgullohet» në të ngadalë, përsëri azot teknik ose ajër. Gazi që del nga gyp (pothuaj nuk ka fare oksigjen), kalohet në një tretësirë hidroksidi kaliumi për t'u pastruar nga CO<sub>2</sub>. Pastaj, thahet në një shtyllë me CaCl<sub>2</sub> dhe në shishen larëse me acid sulfurik të përqendruar. Azoti i përfstuar është i pastër nga oksigjeni.

Azoti, i pastër nga gazet e plogëta, mund të përftohet me anë të reaksionit:



1) Bakri u përfstuua nga reduktimi i oksidit të bakrit (II) me hidrogjen.

Në një poç me fund të rrumbullt hidhen 50 ml tretësirë e ngopur e sulfatit të amonit dhe poçi mbylljet me një tapë me dy vrima; në njérën vrimë kalon një hinkë ndarëse dhe në vrimën tjetër një gyp zhvillimi. Tretësira ngrohet në banjë uji dhe nga hinka ndarëse hidhet me pika 50 ml tretësirë e ngopur e nitritit të natriumit. Shpejtësia e çlirimt të azotit mund të rregullohet duke ndryshuar shpejtësinë e hedhjes së tretësirës së nitritit të natriumit. Gazi në gazometër duhet të mblidhet vetëm pasi të nxirret plotësisht ajri i aparatit.

## 3.2. Përbërjet e azotit

### 3.2.1. Acidi nitrik



$$\begin{aligned} M &= 63,01 \text{ g/mol} \\ \text{t.shk.} &= -42^\circ\text{C} \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} d &= 1526 \text{ kg/m}^3 \\ \text{t.vl.} &= 83,8^\circ\text{C} \end{aligned}$$

Acidi nitrik është lëng pa ngjyrë, me erë karakteristike mbytëse. Tymon në ajër dhe me kalimin e kohës merr ngjyrë të verdhë. Me ftohje të fortë shndërrohet në kristale pa ngjyrë. Tretet në ujë dhe në eter, kurse alkoolin etilik e shpërbën. Është oksidues i fuqishëm, ka veti të forta gjerryese. Shkakton djegie të lëkurës në formë flluskash të verdha, plagë që dhembin dhe shërohen me vështirësi. Avujt e tij janë mbytës. Acidi nitrik mund të shkaktojë ndezjen e substancave të ngrohta dhe plasje me substancat reduktuese. Ambalazhohet në shishe qelqi të errëta, me tapë të smeriluar ose në bidonë plastmase (tapat prej gome ose prej tape i shkatërron). Ruhet në vende të veçanta, në mjeshtë të freskët, larg lëndëve të djegshme.

Acidi nitrik tymues është lëng me ngjyrë të kuqe të murrme; në ajër tymon shumë dhe thith lagështirën. Në temperaturën  $40^\circ\text{C}$  shndërrohet në një masë qelqore. Me ujin jep një tretësirë me ngjyrë të gjelbër në të kaltër; tretësira po të hollohet, bëhet pa ngjyrë.

Në uzinën «Gogo Nushi» Fier prodhohet acid nitrik me përqendrim 65% dhe acid nitrik me përqendrim 52,8% me veçoritë fiziko-kimike që jepen në tabelën 3.1.

Tabela 3.1

Treguesit	Norma në përqindje			
	HNO <sub>3</sub>	65 %	HNO <sub>3</sub>	52,8 %
HNO <sub>3</sub>	më pak se 65		52,8	
SO <sub>4</sub> <sup>2-</sup>	jo më shumë se 0,005		0,005	
Cl <sup>-</sup>	jo më shumë se 0,001		0,001	
Fe <sup>3+</sup>	jo më shumë se 0,03		0,03	

Në Kombinatin Kimiko-Metalurgjik në Laç prodhohet acidi nitrik i përqendruar me këta tregues kimikë:

HNO <sub>3</sub>	98-99%
HNO <sub>2</sub>	jo më shumë se 0,2%
Klorure (Cl <sup>-</sup> )	0,01%
Fe	0,01%
Pb e metale të rënda	0,01%
Mbeturina të djegies	0,02%

### 3.2.1.1. Pastrimi i acidit nitrik

Acid nitrik i klasifikimit (k.p.) mund të përfshohet nga acidi nitrik teknik në këtë mënyrë:

Në acid nitrik teknik shtohet tretësirë nitrati argjendi, derisa të ndërpritet, formimi i precipitatit të klorurit të argjendit. Përzierja tundet fort dhe lihet në qetësi, në një vend të ngrohtë (në 30-40°C). Lëngu i tejdukshëm (në kapë); me anë të sifonimit, hidhet në një poç distilimi. Poçi i distilimit, lidhet me ftohtësin me tapë të smeriluar (tapat prej gome ose prej lëvoreje nuk duhet të përdoren asnjë herë). Përbajtja e poçit, pasi t'i shtohet pak nitrat kaliumi (për të lidhur acidin sulfurik), ngrohet me kujdes në banjë rëre. Distilati mblidhet në një prites me tapë të smeriluar.

Në fillim distilohet lëngu që përmban sasi të mëdha dioksid azoti. Periodikisht merret prova e distilatit, hollohet me ujë dhe provohet për praninë e joneve klorur Cl<sup>-</sup>. Kur në distilat nuk zbulohen jone klorur, pritesi ndërrohet dhe acidi avullohet, derisa në poç të mos mbetet sasi e madhe lëngu.

Acidi i distiluar, si pasojë e shpërbërjes së pjesshme të tij, del i ngjyrosur (nga oksidet e azotit) me ngjyrë të verdhë. Për t'i larguar këto të fundit, në acid gurgullohet një rrymë e fortë ajri (e pastruar nga pluhuri), deri në çngjyrosjen e plotë të acidit.

Acidi i përfshuar në këtë mënyrë ka dendësinë 1400-1450 kg/m<sup>3</sup>. Për të përfshuar acid nitrik 99% të pastër, merret përzierja e 145 ml acid nitrik i pastër ( $d = 1400 \text{ kg/m}^3$ ) me 40 g anhidrid fosforik dhe distilohet në aparatin e përdorur më sipër. Distilati i ngjyrosur në ngjyrë kafe të kuqe (nga oksidet e azotit) çngjyrositet duke gurgulluar në të ajër të thatë e të pastër.

### 3.2.2. Amoniaku

$$\begin{array}{lll} \text{NH}_3 & M = 17,03 \text{ g/mol} & d = 638 \text{ kg/m}^3 \\ & \text{t.shk.} = -77,8^\circ\text{C} & \text{t.vl.} = -33,4^\circ\text{C} \end{array}$$

Amoniaku është gaz pa ngjyrë me erë të fortë, që ngacmon sytë dhe rrugët e frysimeve. Në kushte normale, 1 l peshon 0,7708 g.

Në atmosferë oksigjeni, amoniaku digjet me flakë të gjelbër. Përzierja e 4 vëllimeve amoniak me 3 vëllime oksigjen, po të ndizet pëlcet fort. Amoniaku tretet shumë mirë në ujë, duke çliruar shumë nxehësi; tretet mirë në alkool etilik dhe në alkool të tjera.

### 3.2.2.1. Gatitja e amoniakut


Amoniaku i gaztë mund të përfstohet në këtë mënyrë:

Përzihen në një poç 5 pjesë në masë kloruri amoni i thërrmuar me 7 pjesë në masë gëlqere teknike, të porsapeshuar. Shtohen në të 10 pjesë në masë ujë dhe përzihet mirë. Gjatë ngrohjes së poçit, në banjë rëre, përfstohet një rrymë e ndërprerë gazi, e cila gurgullohet në një shishe larëse (me një sasi të vogël uji) dhe thahet në hidroksid kalumi të ngurtë.

Në vend të  $\text{NH}_4\text{Cl}$  mund të përdoret  $(\text{NH}_4)_2\text{SO}_4$ ; kurse në vend të  $\text{Ca}(\text{OH})_2$  mund të përdoret KOH ose NaOH.

Amoniaku i gaztë mund të përfstohet edhe nga tretësira amoniakore. Në poçin me fund të rrumbull hidhen rrith 100 ml tretësirë amoniakore dhe disa copëza porcelani (të thyera). Poçi mbyllët me një tapë, nëpër të cilën kalon një gyp qelqi dhe vendoset në rrjetë azbesti (në rrithin e një mbajtëseje metalike). Tretësira amoniakore ngrohet në fillim me kujdes, e pastaj më fort. Amoniaku i porsapërtuar thahet duke e kaluar në hidroksid natriumi të ngurtë ose hidroksid kalumi të ngurtë.


### 3.2.3. Dihidrogjenfosfati i amonit



Dihidrogjenfosfati i amonit formon kristale të tejdukshme, të sistemit tetragonal (në formë prizmash). Është kripë e tretshme në ujë (27,3%, në 20°C) dhe e qëndrueshme në ajër.

#### 3.2.3.1. Gatitja e dihidrogjenfosfatit të amonit

Reaktivi kimik mund të përfstohet nga bashkëveprimi i acidit fosforik me tretësirë amoniakore:




Në 100 ml tretësirë amoniakore ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ) shtohet me porcione të vogla acid fosforik ( $d = 1700 \text{ kg/m}^3$ ), derisa prova e tretësirës të mos jepë më precipitat me tretësirë kloruri bariumi. Zakonisht, harxhohen deri në 90 ml acid fosforik dhe tretësira fiton reaksiون acid.


Pastaj, tretësira avullohet në banjë uji, deri në shfaqjen e cipës kristalore dhe lihet të ftohet. Kristalet që bien, hidhen në hinkën përfiltrim në zbrazëti dhe thahen me anë të letrave filtruese.

Sipas kësaj metodike, në rast se substancat nistore janë të klasifikimit (p.p.a.), edhe reaktivi i përfstuar i përgjigjet klasifikimit (p.p.a.).

### 3.2.4. Dikromati i amonit




Dikromati i amonit formon kristale të sistemit monoklin me ngjyrë portokalli në të kuqe. Tretet mirë në ujë (26%, në 20°C) dhe në alkool etilik. Në temperaturën 168°C shpërbehet (reaksioni shoqërohet me flakë) duke formuar oksid kromi (III) në formën e një pluhuri të shkrifët:



#### 3.2.4.1. Gatitja e dikromatit të amonit

Dikromati i amonit përfshohet nga veprimi i oksidit të kromit (VI) me ujin amoniakor:



Në 200 ml ujë, në temperaturën 45°C, treten 156 g oksid kromi (VI). Tretësira ndahet me kujdes nga precipitati dhe hidhet (120 ml) në një gotë ose kupshore porcelani të ftohur me akull. Pas ftohjes deri në temperaturën 8-10°C shtohet në të, me porcione të vogla dhe duke e përzier vazhdimisht, hidroksid amoni (rreth 60 ml me d = 910 kg/m³) deri në reaksiun asnjancës (ndaj kongos së kuqe). Gjatë reaksiunit, temperatura nuk duhet të ngrihet mbi 15°C. Pas ftohjes së tretësirës deri në 10°C, kristalet që bien, hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti, lahlen me 10-15 ml ujë në temperaturën 0°C dhe thahen në 50°C.

Përfshohen rreth 50 g reaktivë që i përgjigjet klasifikimit (p. p. a.). Tretësira mëmë avullohet në temperaturën 70°C dhe ftohet deri në 10°C; përfshohen edhe 30 g preparat më pak i pastër. Ky produkt mund të rikristalizohet. Për këtë, 30 g kripë, treten në 45 ml ujë, në temperaturën 70-75°C dhe filtrohen.

Filtrati avullohet në temperaturën 70°C, deri në formimin e cipës kristalore dhe ftohet (në 10°C).

Përfshohen rreth 12 g kripë.

### 3.2.5. Fosfati i amonit



Fosfati i amonit formon kristale pa ngjyrë.


Eshtë i tretshëm në ujë (19%, në 25°C), kurse në alkool etilik dhe eter dietilik është i patretshëm. Në ajër humbet pjesërisht amoniakun dhe shndërrohet në hidrogjenfosfat amoni.

### 3.2.5.1. Gatitja e fosfatit të amonit

Fosfati i amonit mund të gatitet në këtë mënyrë:

Në tretësirën e 30 g  $(\text{NH}_4)_2\text{HPO}_4$  në 300 ml ujë, hidhet tretësira e 37,5 g  $\text{NH}_4\text{Cl}$  në 300 ml ujë. Përzierja ngrohet deri në temperaturën  $60^\circ\text{C}$  dhe shtohen në të 300 ml tretësirë amoniakore ( $d = 930 \text{ kg/m}^3$ ). Tretësira e përfshuar ftohet nga-dalë në një shishe të myllur. Kristalet që bien, hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe lahen me tretësirë amoniakore ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ). Reaktivi i përfshuar (kristalet) ruhet në shishe të myllura mirë me tapë.

### 3.2.6. Hidroksidi i amonit (uji amoniakor)



$$M = 35,05 \text{ g/mol}$$

$$d = 924 \text{ kg/m}^3 (C = 25\%)$$

Hidroksidi i amonit është lëng pa ngjyrë, me erë të fortë therëse; ka reaksion alkalin. Konstantja e shpërbashkimit të hidroksidit të amonit, në temperaturën  $25^\circ\text{C}$ , është  $1,76 \cdot 10^{-5}$ .

Studimet e viteve të fundit kanë treguar se amoniaku në ujë nuk ndodhet në formën e hidroksidit të amonit,  $\text{NH}_4\text{OH}$ , por në formën e hidratit  $\text{NH}_3 \cdot \text{H}_2\text{O}$ . Hidroksidi i amonit është helmues, ngacmon rrugët e frysëmarrjes dhe lëkurën; shkakton të vjella dhe dhembje koke. Rënia në sy e tretësirave të përqendruara është shumë e rrezikshme. Kur ngrohet deri në temperaturën  $70-80^\circ\text{C}$ , largohet gjithë amoniaku.

Reaktivi kimik që prodhohet në Ndërmarrjen Kimike Durrës (nga tretja e amoniakut të gaztë në ujë), ka veçoritë fiziko-kimike, që jepen në tabelën 3.2

Tabela 3.2

Treguesit	Norma në përqindje
pamja e jashtme, ngjyra, era hidroksid amoni	lëng pa ngjyrë dhe me erë shpuese jo më pak se 25
lëndë joflurore	jo më shumë se 0,002
karbonate	jo më shumë se 0,002
klorure ( $\text{Cl}^-$ )	jo më shumë se 0,00005
metale të rënda ( $\text{Pb}$ )	jo më shumë se 0,00005
sulfure	jo më shumë se 0,00002
$\text{FeCl}_3$	jo më shumë se 0,00002
fosphate ( $\text{PO}_4^{3-}$ )	jo më shumë se 0,00002
Piridinë	jo më shumë se 0,00002. (gjurmë)
substanca që reduktojnë $\text{KMnO}_4$	gjurmë


Ambalazhohet dhe ruhet në enë hermetike (në bidonë prej polieteni, me nxë-vësi 0,5 l ose në shishe me tapë të smeriluar).

### 3.2.6.1. Gatitja e ujit amoniakor

Për të gatitur ujin amoniakor, amoniaku i gaztë gurgullohet në ujë të distiluar, të ftohur me akull. Që tretësira ujore e amoniakut të mos përbajë  $\text{CO}_2$ , këshillohet që uji i distiluar (i porsavaluar) të ftohet paraprakisht duke gurgulluar në të ajër të pastruar nga  $\text{CO}_2^1$ .

Sasi të vogla tretësire amoniakore, me pastërti të lartë, mund të përfshohen në këtë mënyrë: Në fundin e një eksikatori, vendosen disa copa KOH ose NaOH dhe 500 ml  $\text{NH}_4\text{OH}$  ( $d = 880 \text{ kg/m}^3$ ), kurse në diskun e tij të porcelanit me vrima vendoset një pjatë e madhe polieteni me 250 ml ujë të distiluar. Eksikatori myllitet me kapak dhe lihet 4-5 ditë. Në pjatë përfshohet ujë amoniakor me  $d = 940 \text{ kg/m}^3$  (afro 14,5%  $\text{NH}_3$ ).


### 3.2.7. Hidrogjenfosfati i amonit



Hidrogjenofosfati i amonit formon kristale të tejdukshme, pa ngjyrë. Tretet mirë në ujë; në ajër dalengadalë humbet amoniakun dhe shndërrrohet në dihidrogjenofosfat amoni.

#### 3.2.7.1. Gatitja e hidrogjenofosfatit të amonit

Për të përfshuar hidrogjenofosfat amoni mund të asnjani është acidi fosforik me hidroksid amoni:



Në 180 g  $\text{H}_3\text{PO}_4$  ( $d = 1120 \text{ kg/m}^3$ ) shtohet  $\text{NH}_4\text{OH}$  ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ), deri në reaksion bazik të theksuar ndaj fenolftaleinës. Tretësira e përfshuar valohet 30-40 min dhe avullohet. Kur dendësia e tretësirës arrin vlerën  $1410 \text{ kg/m}^3$ <sup>2</sup>, shtohet në të përsëri  $\text{NH}_4\text{OH}$  deri në reaksion bazik ndaj fenolftaleinës. Pastaj, avullohet përsëri dhe lihet të ftohet. Kristalet që bien, hidhen në hinkën përfiltrim në zbrzëti dhe thahen me letra filtruese.

Përfshohen rreth 35 g kripë.

### 3.2.8. Karbonati i amonit



Karbonati i amonit është substancë kristalore pa ngjyrë, me erë të fortë amoniaku. Në ajër shndërrrohet (gradualisht) në kripë acide.



1) Ajri pastrohet nga  $\text{CO}_2$ , duke e gurgulluar në tretësirë të përqendruar KOH.

2) Sipas provave deri në 2/3 e vëllimit.

Në temperaturë rrëth  $58^{\circ}\text{C}$ , shpërbëhet në  $\text{NH}_3$ ,  $\text{CO}_2$  dhe  $\text{H}_2\text{O}$ . Reaktivi tretet mirë në ujë. Tretësira ujore e  $(\text{NH}_4)_2\text{CO}_3$ , në temperaturën  $70^{\circ}\text{C}$ , shpërbëhet në  $\text{NH}_3$  dhe në  $\text{CO}_2$ .

### 3.2.8.1. Pastrimi i karbonatit të amonit

Pastrimi i karbonatit të amonit mund të bëhet në këtë mënyrë:

Në një poç me fund të sheshtë përzihet 1 pjesë në masë  $(\text{NH}_4)_2\text{CO}_3$  me 4 pjesë në masë  $\text{NH}_4\text{OH}$  të përqendruar. Poçi mbylljet me tapë dhe lihet dy ditë, në temperaturën e mjedisit. Pastaj, tretësira dekantohet dhe ftohet; kristalet që bien, hidhen shpejt në hinkën përfiltrim në zbrazëti dhe thahen 2h, në ajër në temperaturën e mjedisit.

Sipas literaturës preparati i përfstuar, zakonisht, i përgjigjet klasifikimit (p.p.a.). Një sasi tjeter preparati mund të veçohet edhe nga tretësira mëmë. Për këtë, tretësira mëmë ngopet paraprakisht me amoniak të gaztë dhe shtohet në të alkool etilik ( $50 \text{ ml}$  alkool në  $100 \text{ ml}$  tretësirë).

### 3.2.9. Kloruri i amonit



$M = 53,49 \text{ g/mol}$        $d = 1527 \text{ kg/m}^3$   
 $t.\text{shk.} = 400^{\circ}\text{C}$  (në gyp të mbyllur)

Kloruri i amonit formon kristale të sistemit kubik pa ngjyrë, pa erë, me shije të kripur. Tretet mirë në ujë ( $27.3\%$ , në  $20^{\circ}\text{C}$ ) dhe më pak në alkool etilik. Në  $337.8^{\circ}\text{C}$  kripa shpërbëhet në  $\text{NH}_3$  dhe  $\text{HCl}$ , që bashkëveprojnë midis tyre dhe formojnë një tym të bardhë të dendur të përbërë nga kristale shumë-të imëta të  $\text{NH}_4\text{Cl}$ . Ruhet në enë të mbyllura mirë dhe në vende të freskëta.

Në ndërmarrjen kimike në Durrës nga kloruri i amonit teknik (importi) prodhohet reaktiv i pastër për analizë (p.p.a.) me treguesit fiziko-kimikë që jepen në tabelën 3.3.

Tabela 3.3

Treguesit	Përbajtja në përqindje
Përbajtja e $\text{NH}_4\text{Cl}$	98,5-99
Mbetja pas kalcinimit	më pak se 0,01-0,005
Sulfate ( $\text{SO}_4^{2-}$ )	më pak se 0,001-0,005
Metale të rënda (Pb)	më pak se 0,0005
Fosfate ( $\text{PO}_4^{3-}$ )	më pak se 0,0005
Hekur (Fe)	më pak se 0,0002-0,0005
Nitrate ( $\text{NO}_3^-$ )	më pak se 0,0005
Kalcium dhe magnez	më pak se 0,0005
Arsenik	më pak se 0,005
Acid i lirë	0,0001

### 3.2.9.1. Pastrimi i klorurit të amonit teknik

Kloruri i amonit shumë i pastër mund të përfshohet nga produkti teknik (nishađer) me anë të kristalizimit.

Në tretësirën e ngrohur deri në valim të 150 g nishađer në 225 ml ujë, shtohet hidroksid amoni deri në reaksiun bazik. Tretësira valohet disa minuta dhe precipitati i hidroksidit të hekurit (III). filtrohet në letër filtruese me pala. Filtrati lihet një natë, në temperaturë të ulët; precipitati i imët kristalor i klorurit të amonit kalohet në hinkën përfiltrim në zbrazëti, lahet me një sasi të vogël uji (në temperaturën 0°C) dhe thahet në një xham sahati (në temperaturën e menjësuar).

Përfshohen rrëth 50 g kripë.

Sipas kësaj metodike përfshohet reaktiv i klasifikimit (p.p.a).


### 3.2.9.2. Gatitja e klorurit të amonit

Për të përfshuar klorurin e amonit të pastër, asnjanësohet amoniaku me aci drhidrik:

klo Në një gotë të ftohur me akull, asnjanësohet me kujdes 150 ml hidroksid amoni (i pastër, me  $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ) me 300 ml acid klorhidrik (i pastër, me  $d = 1120 \text{ kg/m}^3$ ). Në qoftë se pas hedhjes së acidit tretësira do të ketë reaksiun  $\text{NH}_3 + \text{H}_2\text{O} \rightarrow \text{NH}_4^+$  (pasojë e çlirimtë të një sasie amoniaku), shtohet në të hidroksid amoni deri në (seaksiun bazik të dobët. Pasi të ngrohet deri në valim, filtrohet dhe filtrati ravalullohet deri në shfaqjen e cipës kristalore.

Kristalet veçohen si në rastin e pastrimit të klorurit të amonit teknik.


### 3.2.10. Kromati i amonit



$$M = 152,07 \text{ g/mol}$$

$$d = 1910 \text{ kg/m}^3$$


Kromati i amonit formon kristale në formë gjilpërash, me ngjyrë të verdhë. Tretejt mirë në ujë (23,7%, në 0°C). Po të ruhet në ajër ose gjatë tharjes, humbet një pjesë të amoniakut dhe shndërrohet në dikromat amoni. Me ngrohje të shpejtë, kripa shpërbëhet (duke flakëruar) sipas barazimit:



Kromati i amonit është substancë helmuese dhe shkakton iritim të lëkurës.

### 3.2.10.1. Gatitja e kromatit të amonit

Kromati i amonit mund të përfshohet nga bashkëveprimi i dikromatit të amonit me tretësirë amoniakore:



Tretësira e 60 g  $(\text{NH}_4)_2\text{Cr}_2\text{O}_7$  në 100 ml ujë asnjanësohet me  $\text{NH}_4\text{OH}$  (15-20%), deri në kthimin e ngjyrës portokalli në ngjyrë të verdhë. Pastaj ftohet deri në temperaturën 5°C. Kristalet që bien, hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti, lahen dhe thahen (duke i përzier) në temperaturën e mjedisit. Përftohen rreth 55 g kripë.

### 3.2.11. Nitrati i amonit

$$\text{NH}_4\text{NO}_3 \quad M = 80,04 \text{ g/mol} \quad d = 1725 \text{ kg/m}^3 \\ t.\text{shk.} = 169,6^\circ\text{C}$$

Nitrati i amonit formon kristale pa ngjyrë ose me ngjyrë të bardhë, të sishemit rombik që qullen në ajër. Me ngrohje të kujdeshme, në temperaturë më të lartë se 190°C, shpërbëhet në  $\text{H}_2\text{O}$  dhe  $\text{N}_2\text{O}$  (me ngrohje të shpejtë mund të shpërthejë). Tretet mirë në ujë duke thithur nxehësi (nga tretja e 1 pjesës në masë kripë në 1 pjesë në masë ujë me temperaturë 15°C, temperatura e ujit ulet në -10°C). Tretet në alkool etilik dhe në aceton.

Ruhet në vende të thata, në shishe të mbyllura në mënyrë hermetike.

Nitrati i amonit që prodhohet për bujqësinë, në uzinën «Gogo Nushi» në Fier (i veshur me një shtresë  $\text{CaCO}_3$ ), ka këto veçori fiziko-kimike:

azot ( $\text{N}_2$ ) — jo më pak se 33%  
ujë ( $\text{H}_2\text{O}$ ) — 0,7%  
karbonat kalciumi ( $\text{CaCO}_3$ ) 2-4%

Kurse nitrati që prodhohet si kimikat teknik, ka këto veçori:

azot ( $\text{N}_2$ ) — jo më pak se 34,37%  
ujë ( $\text{H}_2\text{O}$ ) — jo më shumë se 0,5%  
mjedisi — acid

Reaktivi kimik që prodhohet në Ndërmarrjen Kimike në Durrës, nga pastrimi i nitratit të amonit teknik, ka këto veçori fiziko-kimike:

Përbajtja e $\text{NH}_4\text{NO}_3$ jo më pak se	99%
Përbajtja e acidit të lirë jo më shumë se	0,005%
Përbajtja e mbetjeve të patretshme, jo më shumë se	0,01%
Përbajtja e klorureve ( $\text{Cl}^-$ ) jo më shumë se	0,002%
Përbajtja e fosfateve ( $\text{PO}_4^{3-}$ ) jo më shumë se	0,0005%
Përbajtja e sulfateve ( $\text{SO}_4^{2-}$ ) jo më shumë se	0,002%
Përbajtja e hekurit jo më shumë se	0,0002%
Reaktivi kimik ambalazhohet në shishe qelqi ose plastmase, me nxënësi 500 deri 1000 g. (Mund të shpërthejë në prekje me substancat organike dhe vajore.)	

#### 3.2.11.1. Pastrimi i nitratit të amonit teknik


Nitrati i amonit i klasifikimit (p.) mund të përftohet duke pastruar produktin teknik.

Në 100 ml ujë, në temperaturën 80-90°C, treten 200 g produkt teknik. Shtohen në të 10 g karbonat bariumi dhe përzierja ngrohet afër vlimit (2h), në mënyrë

që të precipitojnë plotësisht metalet (e në veçanti hekuri). Tretësira filtrohet në letër filtruese me pala (të valëzuar); filtrati avullohet në banjë uji, deri në formimin e një cipe të hollë kristalore, dhe stohet me akull. Kristalet që bien, hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe thahen në temperaturën  $40\text{--}50^{\circ}\text{C}$ .

### 3.2.11.2. Gatitja e nitratit të amonit

Për të gatitur nitrat amoni, asnjanësohet acidi nitrik me ujë amoniakor:




Në tretësirën e 45 ml  $\text{HNO}_3$  ( $d = 1400 \text{ kg/m}^3$ ) në 60 ml ujë shtohet dalëngadalë ujë amoniakor ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ), derisa të ndihet mirë era e amoniakut (rreth 58 ml). Pastaj tretësira ngrohet dhe filtrohet e ngrohtë. Filtrati avullohet në banjë uji, deri në formimin e një cipe të hollë kristalore dhe stohet me akull. Kristalet që bien, hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe thahen në temperaturën  $40\text{--}50^{\circ}\text{C}$ .

Përfstohen rreth 30 g kripë.

Sipas kësaj metodike, në rast se substancat nistore janë të klasifikimit (p.p.a.), edhe reaktivi i përfstuar i përgjigjet klasifikimit (p.p.a.).

Me avullim-dhe kristalizim të tretësirës mëmë mund të përfstohet edhe një sasi tjeter reaktivi i pastër.

### 3.2.12. Oksalati i amonit



Oksalati i amonit formon kristale pa ngjyrë të sistemit rombik. Është i tretshëm në ujë (5%), në  $20^{\circ}\text{C}$ ), kurse në alkoholi i tretet pak.

### 3.2.12.1. Gatitja e oksalatit të amonit


Oksalati i amonit mund të gatitet në këtë mënyrë:

Në 160 ml ujë, në temperaturën  $60^{\circ}\text{C}$ , treten 104 g acid oksalik  $\text{H}_2\text{C}_2\text{O}_4 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$ . Tretësira filtrohet (pa u stohur) në letër filtruese me pala; filtrati hidhet në një kupshore porcelani, që përmban 142 ml  $\text{NH}_4\text{OH}$  ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ) dhe stohet shpejt deri në  $25^{\circ}\text{C}$ , duke e përzier pa ndërpërje. Kristalet që bien, filtrohen (shpejt) në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe thahen në temperaturën e mjedisit.

Përfstohen rreth 85 g kripë.

Sipas kësaj metodike, në rast se substancat nistore janë të klasifikimit kimikisht të pastra (k.p.) ose të pastra për analizë (p.p.a.), reaktivi i përfstuar i përgjigjet klasifikimit (k.p.) ose (p.p.a.).


### 3.2.13. Oksidi i azotit (II)



Oksidi i azotit (II) është gaz pa ngjyrë. Në kushte normale, 1 l oksid azoti (II) peshon 1,3402 g. Tretet pak në ujë, tretet më mirë në alkool etilik. Në prani të oksigjenit formon avuj të murrmë të dioksudit të azotit.


#### 3.2.13.1. Gatitja e oksidit të azotit (II)

Oksidi i azotit (II) mund të përfshohet nga veprimi i bakrit me acid nitrik të holluar:



Copat e bakrit metalik (tel ose tallash) vihen në një poç me fund të rrumbullt. Poçi mbylljet me një tapë me dy vrima; në njëren vrimë kalon një hinkë ndarëse dhe në vrimën tjetër një gyp zhvillimi. Nga hinka ndarëse hidhet ngadalë acidi nitrik ( $d = 1100 - 1150 \text{ kg/m}^3$ ). Për të shmangur formimin e oksideve të tjera të azotit, përzierja nuk duhet të ngrohet fort. Për këtë, këshillohet që poçi të ftohet me ujë të rrjedhshëm. Në fillim në poç shfaqen avuj të murrmë të dioksudit të azotit, që formohen gjatë oksidimit të oksidit të azotit (II) nga oksigjeni i ajrit. Përsa pastruar nga oksidet e larta të azotit dhe nga spërkat e acidit nitrik oksidi i azotit (II) gurgullohet në shishe larëse me tretësirë hidroksidi natriumi 5% dhe mblidhet mbi ujë. Në qoftë se gazi duhet të thahet, kalohet në një gyp me hidroksid kaliumi të ngurtë.

Një mënyrë më praktike për përfshimin e oksidit të azotit (II) është ngrohja e përzierjes së nitritit të kalumit me nitrat kalumi dhe oksid kromi (III):



Përzihen 32 g  $\text{KNO}_2$ , 12,5 g  $\text{KNO}_3$  dhe 38 g  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ . Shtohen në të 60 g  $\text{Fe}_2\text{O}_3$  ( $\text{Fe}_2\text{O}_3$  shtohet për të shmangur shkumëzimin dhe spërkatjen) dhe një sasi e vogël uji, deri në formimin e një paste të dendur. Pasta e përfshuar tryset në tableta me diametër 25 mm dhe thahet.

Në një provëz qelqi zjarrdurues, po të ngrohen 10 g tableta, përfshohen 860-870 ml gaz, që përban 99,78% NO.

Oksidi i azotit (II) mund të përfshohet në formën e një rryme të njëtrajtshme, në këtë mënyrë:

Në tretësirën e klorurit të hekurit (II) me përqendrim 30%, (ose të  $\text{FeSO}_4$  20%), të përzier me 1 vëllim të njëjtë acidi klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ), hidhet me anë të hinkës ndarëse tretësirë 40% nitriti natriumi:



Oksidi i azotit (II) që përfshohet pastrohet duke e gurgulluar në tretësirë 10%  $\text{NaOH}$ . Reaksioni mund të kryhet me aparatin që u përshkrua më sipër. (Ftohja e poçit me fund të rrumbullt, nuk është e nevojshme).

### 3.2.14. Oksidi i azotit (IV) dhe tetraoksidi i diazotit


$\text{NO}_2$	$M = 46,01 \text{ g/mol}$	$d = 1491 \text{ kg/m}^3$ (në $0^\circ\text{C}$ )
$\text{N}_2\text{O}_4$	$M = 92,01 \text{ g/mol}$	$t.\text{shk.} = -9,3^\circ\text{C}$
		$t.\text{vl.} = 20,7^\circ\text{C}$

Dioksidi i azotit  $\text{NO}_2$ , si përbërje kimike e pavarur (gaz i murrmë) ekziston vetëm në temperaturë mbi  $290^\circ\text{C}$ . Në temperaturën e mjedisit mund të ndodhet në një përzierje të  $\text{NO}_2$  dhe  $\text{N}_2\text{O}_4$  (tetraoksid diazoti);  $\text{N}_2\text{O}_4$  është një gaz i kuq në të murrmë me erë të mprehtë.

Ekuilibri  $\text{N}_2\text{O}_4 \rightleftharpoons 2\text{NO}_2$  varet nga temperatura. Nën  $0^\circ\text{C}$  ekziston pothuajt vetëm  $\text{N}_2\text{O}_4$ , prandaj, po të ftohet përzierja  $\text{NO}_2$  dhe  $\text{N}_2\text{O}_4$ , ngjyra çelat.

Tetraoksid i diazotit formon kristale pa ngjyrë. Me pak ujë jep një tretësirë me ngjyrë të gjelbër të hapët që përban  $\text{HNO}_3$ ,  $\text{HNO}_2$  dhe  $\text{N}_2\text{O}_4$ .

Tretësira, po të hollohet, çngjyroset si pasojë e hidrolizës së  $\text{N}_2\text{O}_4$ :




Tetraoksid i diazotit është oksidues shumë i fortë; me shumë përbërje organike vepron me vrull dhe nganjëherë me plasje.

Dioksidi i azotit dhe tetraoksid i diazotit janë substanca jashtëzakonisht helmuese. Avujt e  $\text{N}_2\text{O}_4$  (e rrjedhimisht të  $\text{NO}_2$ ) kanë veprim mytës dhe shkaktojnë kollë.

#### 3.2.14.1. Gatitja e oksidit të azotit (IV)

Oksidi i azotit (IV) mund të përftohet<sup>1)</sup> duke shpërbërë me nxehësi nitratin e plumbit:



Në një kupshore porcelani hidhet  $\text{Pb}(\text{NO}_3)_2$  i thërrmuar imët dhe ngrohet (thahet) duke e përzier, derisa të ndërpritet kërcitja dhe të fillojë çlirim i gazit të murrmë. Nitrati i plumbit i thatë ftohet në eksikator dhe përzihet me një sa si të njëjtë rëre kuarci, të gëlqerizuar paraprakisht. Përzierja e përfstuar hidhet në një lëfytje (stortë). Gryka e stortës<sup>2)</sup> lidhet me një shtyllë tharëse të mbushui me klorur kalciumi të gëlqerizuar. Gypi i daljes i shtyllës tharëse përfundon në pritësin, që ftohet me një përzierje të akullit me kripë gjelle.

Lëfytja ngrohet me kujdes. Dioksid i azotit i kuq, në të murrmë, që çlirohet gjatë shpërbërjes së nitratit të plumbit, lëngëzohet në pritës në formën e një lëngu me ngjyrë të gjelbër (ngjyra shkaktohet nga formimi i sasive të vogla të  $\text{N}_2\text{O}_3$ ). Pas një farë kohe lëngu bëhet i verdhë në të murrmë, pastaj i verdhë dhe në fund pa ngjyrë. Po të ftohet shumë, formon një masë kristalore të bardhë ( $\text{N}_2\text{O}_4$  i ngurtë).

1) Puna duhet të kryhet në kapë.

2) Pjesët e aparatit duhet të lidhen midis tyre me pjesë të smeriluara ose me ngjitje. Nuk këshillohet përdorimi i tapave të gomës.

### 3.2.15. Sulfati i amonit

$$(\text{NH}_4)_2\text{SO}_4 \quad M = 132,14 \text{ g/mol} \quad d = 1769 \text{ kg/m}^3 \\ t. shk. = 140^\circ\text{C}$$

Sulfati i amonit formon kristale pa ngjyrë të sistemit rombik. Tretet mirë në ujë (43 %, në 20°C), kurse në alkool etilik nuk tretet. Në temperaturën 335°C shpërbehet në NH<sub>3</sub> dhe NH<sub>4</sub>HSO<sub>4</sub>.

Sulfati i amonit që përfshohet (si nënprodukt gjatë pastritimit të gazeve të kokuat nga amoniaku) në kombinatin metalurgjik «Çeliku i Partisë» në Elbasan, ka veçoritë fiziko-kimike që jepen në tabelën 3.4.

Tabela 3.4

Treguesit	Përbajtja në përqindje
azot	më shumë se 20,8
sulfat amoni	më shumë se 98
acid sulfurik të lirë	më pak se 0,2
lagështirë	më pak se 1

#### 3.2.15.1. Pastrimi i sulfatit të amonit teknik

Sulfati i amonit i pastër mund të përfshohet me anë të të pastrimit të produktit teknik.

Në 260 ml ujë tretet 150 g (NH<sub>4</sub>)<sub>2</sub>SO<sub>4</sub> (teknik). Tretësira e përfshuar ngrohet deri në valim; shtohet H<sub>2</sub>O<sub>2</sub> 30% (1-2 ml) dhe valohet disa minuta, deri në oksidimin e plotë të papastërtive të Fe<sup>2+</sup>. Për të provuar shkallën e oksidimit, në provën e marrë nga tretësira e reaksionit, shtohet tretësirë K<sub>3</sub>[Fe(CN)<sub>6</sub>]. Mungesa e ngjyrës së kaltër ose e precipitatit tregon për një oksidim të plotë. Në rast të kundërt, përsëritet përpunimi me H<sub>2</sub>O<sub>2</sub>.

Me mbarimin e oksidimit, në tretësirë shtohet NH<sub>4</sub>OH deri në reaksiون të dobët bazik (pH≈8). Pastaj, tretësira valohet dhe filtrohet.

Filtrati (pa ngjyrë) avullohet në një kupshtore porcelani, deri në formimin e një qulli të lëngët dhe shtohet në temperaturën e mijedisit. Kristalet hidhen në hinkën përfiltrim në zbrazëti, lahen disa herë me ujë të ftohtë dhe thahen në 30-50°C.

#### 3.2.15.2. Gatija e sulfatit të amonit

Sulfati i amonit mund të përfshohet nga asnjanësimi i ujit amoniakor me acid sulfurik:



Në 270 ml hidroksid amoni teknik ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ) shtohet duke e përzier dhe ftohur me ujë ose akull, 850 ml tretësirë 20% H<sub>2</sub>SO<sub>4</sub>. Tretësira e përfshuar duhet të ketë erën e amoniakut, në rast të kundërt shtohet edhe pak hidroksid amoni.

Tretësira ngrohet deri në valim, filtrohet, avullohet në një kupshore porcelani dhe veçohen kristalet si në pastrimin e produktit teknik.

### 3.2.16. Sulfuri i amonit





Sulfuri i amonit në gjendje të lirë nuk është arritur të përfshohet. Nga tretësira edhe me ftohje të fortë, nuk veçohen krisale. Tretësira ujore e  $(\text{NH}_4)_2\text{S}$  është lëng pa ngjyrë, me erë amoniaku dhe sulfuri hidrogjeni. Reaksiioni i tretësirës është bazik. Në ajër, si pasojë e formimit të polisulfureve, tretësira merr (shpejt) ngjyrë të verdhë.

Tretësira e  $(\text{NH}_4)_2\text{S}$  ruhet në shishe të mbyllura mirë, të mbushura plotësisht (deri tek tapa) ose në atmosferë azoti.

#### 3.2.16.1. Gafitja e tretësirës së sulfurit të amonit

Për të përfshuar tretësirën e sulfurit të amonit, uji amoniakor ngopet me sulfur hidrogjeni:



Një vëllim i përcaktuar i hidroksidit të amonit të holluar (por jo më shumë se 8%) ndahet në dy pjesë të barabarta. Njëra pjesë ngopet me tepricë sulfuri hidrogjeni dhe pjesa tjeter e hidroksidit të amonit shtohet në të.

## 4. Bakri dhe përbërjet e tij

### 4.1. Bakri

Cu

M = 63,54 g/mol  
t.shk. = 1023°C

d = 8940 kg/m<sup>3</sup>  
t.vl. = 2850°C

Bakri është metal me ngjyrë të kuqërrreme, i butë dhe i punueshëm. Në acid klorhidrik dhe në acid sulfurik të holluar nuk tretet; në acid nitrik tretet mirë, kurse në acid sulfurik të përqendruar tretet me ngrohje. Në prani të ajrit, bakri tretet ngadalë edhe në tretësirën amoniakore. Me lagështirën dhe dioksidin e karbonit (të ajrit) formon një shtresë sipërfaqësore (një cipë) të gjelbër karbonat bazik të bakrit (II)  $\text{Cu}_2(\text{OH})_2\text{CO}_3$  (substancë helmuese).

Bakri elektrolitik i prodhuar në Uzinën Metalurgjike të Rubikut është i cilësisë shumë të mirë, ai përmban mbi 99,98% Cu.

#### 4.1.1. Gatitja e bakrit

Në eksperimentet laboratorike mund të përdoren copa telash bakri, pa shtresë sulfurik të përqendruar, me temperaturë 70-80°C. Ky veprim bëhet në kapë, në shpëlahen me ujë të ftohtë të rrjedhshëm.

Bakri në trajtë pluhuri të imët mund të përftohet me anë të reduktimit të joneve bakër  $\text{Cu}^{2+}$ :

a) Nga reduktimi i oksidit të bakrit (II)  $\text{CuO}$  me hidrogjen, sipas barazimit:



Në një gyp qelqi zjarrdurues (horizontal) dhe me zgjerim në mes, hidhen rreth 25 g oksid bakrit (II) CuO pluhur. Në fillim, nëpërmjet aparatit të Kippit, në gyp dërgohet hidrogjen deri në largimin e plotë të ajrit.

Duke vazhduar dërgimin e hidrogjenit, oksidi i bakrit (II) CuO nxehet me kujdes në temperaturën 135-150°C, me anë të flakës së llambës me alkool, derisa ngjyra e zezë e tij të shndërrohet në ngjyrë të kuqërrremë. Në këtë çast, nxehja ndërpritet dhe pluhuri i bakrit ftohet me rrymë hidrogjeni.

Shënim. Provat tregojnë se për gatitjen e bakrit pluhur me metodën që përmendëm, është më mirë që gypi të ngrohet nëpërmjet një teli rezistence nikel-kromi në formë spiraleje. Për të arritur temperaturën e kërkuar, gjatësia e telit duhet të jetë rreth 15 m (për tel me diametër 0,4 mm).

b) Nga reduktimi i joneve bakër  $\text{Cu}^{2+}$  me metale, sipas barazimit të reaksiionit:




Në një gotë kimike, me nxënësi 500 ml, përgatitet tretësira e nxeh të (70-80°C) e 100 g  $\text{CuSO}_4 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$  në 250 ml ujë. Shtohen në të 6 ml acidi sulfurik 10% (me dendësi 1070 kg/m³) dhe 32 g kokrra zinku ose copa hekuri. Përzierja trazohet herë pas here dhe mbahet e nxeh të, derisa i tërë lëngu të çngjyroset (provë që tregon reduktimin e plotë të joneve bakër  $\text{Cu}^{2+}$ ).

Pas lënies në qetësi (dekanimit), lëngu derdhet, kurse precipitati i bakrit lahet 2-3 herë (derisa të ndërpritet shkumëzimi) me tretësirë të nxeh të acidi sulfurik 10% (për të tretur tepricën e zinkut ose të hekurit). Pas larjes, precipitati i bakrit hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti<sup>1)</sup>, ku lahet me ujë të nxeh të (në fletën filtruuese). Larja e precipitatit vazhdon, derisa në ujërat e larjes të mos ketë më jone sulfat  $\text{SO}_4^{2-}$  (prova me tretësirë kloruri bariumi  $\text{BaCl}_2$ ).

## 4.2. Përbërjet e bakrit

### 4.2.1. Etanoati i bakrit (acetati i bakrit)





Etanoati i bakrit  $\text{Cu}(\text{CH}_3\text{COO})_2 \cdot \text{H}_2\text{O}$  formon kristale me ngjyrë të gjelbër të errët (të sistemit monoklin) ose pluhur të imët kristalor. Është i tretshëm në ujë dhe në alkool etilik. Në temperaturën 100°C humbet ujin e kristalizimit.

#### 4.2.1.1. Gatitja e etanoatit të bakrit

Për të gatitur etanoatin e bakrit  $\text{Cu}(\text{CH}_3\text{COO})_2 \cdot \text{H}_2\text{O}$ , gatitet paraprakisht karbonati i bakrit (II)  $\text{CuCO}_3$  i precipituar dhe tretet në acid etanoik  $\text{CH}_3\text{COOH}$ :

<sup>1)</sup> Provat tregojnë se filtrimi mund të kryhet edhe me hinkë të zakonshme. Në këtë rast, duhet kujdes që precipitati në letrën filtruuese të jetë gjithnjë i mbuluar me ujë.



Karbonati i bakrit  $\text{CuCO}_3$  (i precipituar) gatitet në këtë mënyrë:

Në tretësirën e nxehë të filtruar të 50 g- $\text{CuSO}_4 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$  në 500 ml ujë hidhet, duke e përzier me vrull, tretësira e nxehë (në 60°C) e 57 g  $\text{Na}_2\text{CO}_3 \cdot 10\text{H}_2\text{O}$  në 240 ml ujë. Precipitati i  $\text{CuCO}_3$ , pasi lihet në qetësi, lahet me dekantim 10-15 herë me ujë të nxehë (çdo herë nga 200 ml), derisa të largohen plotësisht ionet  $\text{SO}_4^{2-}$  (prova me tretësirë  $\text{BaCl}_2$ ).


Precipitati kthehet në pezulli me 300 ml ujë; shtohen në të 2 ml tretësirë amoniakore (me dendësi 910 kg/m³) dhe dekantohet. Ky veprim përsëritet edhe dy herë dhe më pas lahet tri herë me ujë. Precipitati i  $\text{CuCO}_3$  hidhet pak e nga pak (glacial), të nxehur deri në temperaturën 60°C. Përzierja e përstuar hidhet në hinkën filtruuese, filtrati avullohet (në kapë) deri në 1/3 e vëllimit dhe ftoshet. Kri-stalet kalohen në hinkën filtruuese (më mirë në hinkën Buhner), shpëlahen me 2 ml ujë dhe thahen me anë të letrave filtruuese, në temperaturën e mjedisit.

Tretësira mëmë mund të avullohet duke i shtuar para kristalizimit 5 ml tretësirë  $\text{CH}_3\text{COOH}$  25%. Në këtë mënyrë mund të përfshohet edhe një sasi tjetër preparati.

Përfstohen rrëth 30 g kripë.

Në qoftë se si lëndë nistore përdoren reaktivë të klasifikimit (p. p. a.), edhe preparati i përstuar i përgjigjet klasifikimit (p. p. a.).

#### 4.2.2. Hidroksidi i bakrit




$$M = 97,55 \text{ g/mol} \quad d = 3368 \text{ kg/m}^3$$

Hidroksidi i bakrit (II) kristalor formon peta ose gjilpëra me ngjyrë blu të hapët.

Hidroksidi i bakrit i precipituar është pluhur amorf me ngjyrë blu. Në temperaturën 70-90°C errësohet, duke u shpërbërë në oksid bakri (II)  $\text{CuO}$  dhe në ujë  $\text{H}_2\text{O}$ . Hidroksidi i bakrit është bazë e dobët ( $K = 7,9 \cdot 10^{-14}$ , në 25°C), pothuaj-se e patretshme në ujë ( $PT = 5 \cdot 10^{-20}$ ).

##### 4.2.2.1. Gatitja e hidroksidit të bakrit

Hidroksidi i bakrit (në formë paste) mund të përfshohet nga bashkëveprimi i një alkali me tretësirën e një kripe të bakrit  $\text{Cu}^{2+}$ , sipas barazimit:




Në 750 ml ujë treten 50 g  $\text{CuSO}_4 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$  dhe tretësira filtrohet. Në filtrat hidhet 1 ml glicerinë dhe shtohet në të tretësira e filtruar e 17-18 g hidroksid na-triumi në 1 l ujë. Precipitati i formuar merr ngjyrë blu të hapët. Pas lënies në qetësi, precipitati lahet disa herë me ujë me anë të dekantimit (mundësisht shpejt)

dhe hidhet në ujë të ftohtë, që përmban 5-8 pika glicerinë. Ky veprim kryhet 2-3 herë, derisa në ujërat e larjes të mos ketë më jone sulfat  $\text{SO}_4^{2-}$  (prova me tretësirë  $\text{BaCl}_2$ ). Përzierja hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe lahet më ujë që përmban pak glicerinë, derisa në ujërat e larjes të mos ketë më jone  $\text{SO}_4^{2-}$  (prova me tretësirë  $\text{BaCl}_2$ ). Pasta e dendur trajtohet me 1 ml glicerini<sup>1)</sup> dhe në këtë gjendje ruhet.

Me këtë metodikë mund të përfshohet rreth 60 g  $\text{Cu}(\text{OH})_2$ .

#### 4.2.3. Karbonati bazik i bakrit



$$M = 221,10 \text{ g/mol}$$


$$d = 4000 \text{ kg/m}^3$$

Karbonati bazik i bakrit është pluhur amorf, i gjelbër, i shndritshëm, më kokrriza të imëta.

Në ujë nuk tretet, kurse në acide tretet dhe formon kripërat përkatëse të bakrit. Me ngrohje deri në temperaturën  $150^\circ\text{C}$  nuk ndryshon ngjyrën; me ngrohje në  $200^\circ\text{C}$  shpërbëhet dhe nxihet (formohet  $\text{CuO}$ ).

##### 4.2.3.1. Gatiqë e karbonatit bazik të bakrit

Karbonati bazik i bakrit mund të përfshohet nga bashkëveprimi i sulfatit të bakrit me hidrogenkarbonat natriumi sipas barazimit:



Në një havan porcelani përzihen njëherësh 12,5 g  $\text{CuSO}_4 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$  me 9,5 g  $\text{NaHCO}_3$ <sup>2)</sup>.

Përzierja e përstuar hidhet pjesë-pjesë (pak e nga pak) dhe me përzierje të shpejtë, në 100 ml ujë të valuar, që ndodhet në një gotë kimike me nxënësi 250 ml. Si pasojë e çlirimt të dioksidit të karbonit, tretësira shkumon. Pjesa tjetër e përzierjes hidhet vetëm pasi sipërsaqja e ujit çlirohet nga shkuma. Në fund, pas mbarimit të reaksiionit, përzierja valohet 10-15 min.

Pas precipitimit, precipitati lahet më dekantim më ujë, derisa në ujërat e larjes të mos ketë më jone sulfat  $\text{SO}_4^{2-}$  (prova bëhet më tretësirë kloruri bariumi). Precipitati hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti<sup>3)</sup> e më pas thahet. Tharja bëhet në fillim me anë të letrave filtruese, e pastaj në temperaturë  $70-80^\circ\text{C}$ .

1) Glicerina përdoret për të penguar çhidratimin e hidrokosit të bakrit (II). Në rast so kërkohet preparat pa praninë e glicerinës, ajo largohet lehtë duke e shpëlarë pastën me ujë.

2) Të dy kripërat duhet të janë të thata dhe të imtësuara (të shtypura).

3) Mund të përdoret hinkë e zakonshme.


#### 4.2.4. Kloruri i bakrit (I)

CuCl	$M = 98,99 \text{ g/mol}$	$d = 3530 \text{ kg/m}^3$
	t.shk. = $430^\circ\text{C}$	t.vl. = $1490^\circ\text{C}$

Kloruri i bakrit (I) CuCl formon kristale (tetraedrike) me ngjyrë të bardhë. Në ajër, si pasojë e formimit të kripës bazike, ngjyra e bardhë kthehet në ngjyrë të gjelbër. Kloruri i bakrit është pothuajse i patretshëm në ujë (0,0062 % CuCl, në  $20^\circ\text{C}$ ). Tretet në tretësirë amoniakore, në acid klorhidrik të përqendruar e të nxehtë, si dhe në tretësirat e klorureve alkaline.

##### 4.2.4.1. Gatiqë e klorurit të bakrit (I)

Kloruri i bakrit (I) CuCl mund të përfshohet duke reduktuar kripërat e  $\text{Cu}^{2+}$  me bakër metalik, në pranit të klorureve të mataleve alkaline, sipas barazimit:



Merren 60 g bakër i porsaprecipituar<sup>1)</sup> dhe hidhen në një qesë garze. Qeska varet në një gotë kimike me nxënësi 500 ml, ku ndodhet përzierja e përfshuar nga tretja e 60 g  $\text{CuSO}_4 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$  dhe 120 g NaCl në 500 ml ujë. Pas 10 min lëngu çngjyrosjet. Tretësira filtrohet në hinkën filtriuese. Filtrati mblidhet në një shishe që ka 1 l ujë dhe 5 ml acid klorhidrik 37% ( $d = 1119 \text{ kg/m}^3$ ). Menjëherë fundërron precipitati i bardhë i CuCl. Pas dy orësh, lëngu dekantohet dhe precipitati hidhet në hinkën filtriuese (me filtër bezeje). Precipitati i përfshuar lahet me 20 ml tretësirë 2% acidi klorhidrik. Larja përsëritet, derisa në ujërat e larjes të mos ketë më jone  $\text{SO}_4^{2-}$  (prova me tretësirë  $\text{BaCl}_2$ ).

Precipitati shpëlahet me alkool etilik dhe thahet në  $100^\circ\text{C}$ , duke e trazuar shpesh.

Në këtë rast, sasia është 20-25 g. Precipitati i CuCl, që është i ngjyrosur në të gjelbër (për shkak të përbajtjes së kriçërave bazike të  $\text{Cu}^{2+}$ ), po të lahet me acid klorhidrik 0,1 N, mund të bëhet i bardhë.

#### 4.2.5. Kloruri i bakrit (II)

##### a) Kloruri i bakrit(II) anhidër

$\text{CuCl}_2$	$M = 134,44 \text{ g/mol}$	$d = 3054 \text{ kg/m}^3$
		t.shk. = $630^\circ\text{C}$

##### b) Kloruri i bakrit (II) kristalhidrat


$\text{CuCl}_2 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$	$M = 170,48 \text{ g/mol}$	$d = 2380 \text{ kg/m}^3$
---	----------------------------	---------------------------

1) Sihi paragrafin 5.1.

Kloruri i bakrit (II) anhidër ka pamjen e një mase të qullët, me ngjyrë të verdhë të murime. Në temperaturën  $993^{\circ}\text{C}$  shpërbëhet duke qiruar klor. Kurse kloruri i bakrit (II) i hidratuar ka formë kristalesh prizmatike me ngjyrë të gjelbër, që qullen në ajër. Kloruri i bakrit tretet mirë në ujë (32,1% kripë anhidër, në  $17^{\circ}\text{C}$ ), në alkool metilik, në alkool etilik, si dhe në eter dietilik.

#### 4.2.5.1. Gativja e klorurit të bakrit (II)


Kristalhidrati  $\text{CuCl}_2 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$  mund të përfshohet nga tretja e bakrit në ujin mbretëror sipas barazimit:



Në një kupshore porcelani hidhen me radhë: 135 ml ujë, 140 ml acid klor hidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ) dhe 43 ml acid nitrik ( $d = 1400 \text{ kg/m}^3$ ). Në përzierjen e përfstuar shtohen 50 g tela bakri (të prera në copa të imëta). Reaksiioni në fillim zhvillohet vrullshëm<sup>1)</sup> dhe më pas ai dobësohet. Në fund të reaksiionit, përzierja ngrohet pak dhe tretësira filtrohet. Filtrati avullohet deri në shfaqjen e cipës kristalore (deri në  $1/3$  e vëllimit) dhe stohet. Kristalet që fundërojnë, kalohen në hinkën filtruese (mundësish në hinkën Buhnei). Pastaj, hidhen në një pjatë petri ose në një xham sahati, njomen me alkool etilik dhe thahen në temperaturën  $30^{\circ}\text{C}$ , duke i përzier riallë me shufër qelqi. Kur ngjyra e gjelbër e kristaleve shndërohet në të verdhë të kaltër, temperatura rritet deri në  $50^{\circ}\text{C}$ . Tharja<sup>2)</sup> e kristaleve vazhdon, derisa ato të mos ngjiten më në shufrën e qelqit.

Për të përfstuar kripën pa ujë (anhidër), dihidrati  $\text{CuCl}_2 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$  ngrohet në temperaturën  $140\text{--}150^{\circ}\text{C}$ , në prani të një rryme kloruri hidrogjeni HCl të thatë. Masa e përfstuar vendoset në eksikator me acid sulfurik të përqendruar dhe mbahe deri në largimin e plotë të ujit.

#### 4.2.6. Nitrati i bakrit (II)



$M = 241,60 \text{ g/mol}$

$d = 2040 \text{ kg/m}^3$

t.shk. =  $114,5^{\circ}\text{C}$


Nitrati i bakrit  $\text{Cu}(\text{NO}_3)_2 \cdot 3\text{H}_2\text{O}$  formon kristale me ngjyrë të kaltër të errët, që qullen në prani të ajrit. Tretet shumë mirë në ujë (55,6% kripë anhidër në  $20^{\circ}\text{C}$ ) dhe në alkool etilik. Një letër e njomur me tretësirë alkoolike nitrati baki gjatë tharjes, vetëndizet (merr flakë).

1) Në rast se reaksiioni nuk zhvillohet, atëherë përzierja duhet të ngrohet pak. Kjo dukuri ndodh në temperaturë të ulët të mijedisit.

2) Provat tregojnë se kur tharja vazhdon për një kohë të gjatë dhe jo me kujdesin e duhur, preparati errësohet dhe tjetërsohet.

#### 4.2.6.1. Gatitja e nitratit të bakrit


Nitrati i bakrit përfshohet nga bashkëveprimi i bakrit metalik me acid nitrik të holluar  $\text{HNO}_3$ , sipas barazimit:



Puna duhet të kryhet në kapë, në mungesë të saj në mjedis të hapur. Në një kouphore porcelani, që përmban 110 ml acid nitrik ( $d = 1400 \text{ kg/m}^3$ ) dhe 110 ml ujë, hidhen pak e nga pak (çdo herë nga 10 g) 25 g tela bakri (të prerë e të pastruar nga llaku<sup>1)</sup>). Pas mbarimit të reaksionit të vrullshëm, përzierja ngrohet deri në temperaturën  $60^\circ\text{C}$ . Sapo të ndërpritet çlirimi i oksidit të azotit, në përzierje shtohen, duke e trazuar, 50 ml ujë. Përzierja filtrohet dhe filrat avullohet në  $60-70^\circ\text{C}$ , derisa dendësia <sup>2)</sup> e tij të arrijë  $1790-1800 \text{ kg/m}^3$  (në  $60-70^\circ\text{C}$  Kristalet që fundërrojnë gjatë ftohjes, filtrohen<sup>3)</sup> dhe pasi shpëlahen (në filtri) me fare pak ujë të ftohtë, thahen me anë të letrave filtruese. Nitrati i bakrit  $\text{Cu}(\text{NO}_3)_2 \cdot 3\text{H}_2\text{O}$  i përfshuar hidhet shpejt në shishe të myllur me tapë të smerluar.

Tretësira mëmë, gjatë avullimit (në  $60-70^\circ\text{C}$ ) jep edhe një sasi tjetër preparati. Përfshohen rrëth 80 g nitrat bakri. Sipas literaturës, preparati i përfshuar me këtë metodikë, pas rikristalizimit, i përgjigjet klasifikimit i pastër për analizë (p. p. a.).


#### 4.2.7. Oksidi i bakrit (I)



Oksidi i bakrit (I) është pluhur kristalor me ngjyrë të kuqe-tulle. Preparati amorf që përfshohet, ndonjëherë ka ngjyrë të verdhë në portokalli. Është i patetshëm në ujë dhe në tretësirë amoniakore. Acidi klorhidrik, në mungesë të ajrit, e shndërron atë në pluhur të baïdhë, në klorurin e bakrit (I)  $\text{CuCl}$ .

#### 4.2.7.1. Gatitja e oksidit të bakrit (I)

Oksidi i bakrit (I) mund të përfshohet duke reduktuar ionet  $\text{Cu}^{2+}$  me glukozë, në prani të një alkali, sipas barazimit:



Në 240 ml ujë të nxeh të treten 60 g hidroksid natriumi. Tretësira dekantohet nhe pastaj filtrohet në një letër filtruese të dyfishtë. Filtrati lihet në qetësi 24 h; dë rast se tretësira tuftullohet, atëherë duhet të filtrohet përsëri.

Në tretësirën e ngrohtë të 80 g sulfat bakri  $\text{CuSO}_4 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$  në 550 ml ujë shto-

1) Shih paragrafin 5.1.

2) Provat tregojnë se për një kristalizim të mirë filtrati duhet të ayullohet, derisa sasia e tij të përgjysmohet.

3) Literatura këshillon hinkën përfiltrim në zbrazëti.

het tretësira e 24 g glukozë në 16 ml ujë dhe lëngu filtrohet. Në filtratin e ngrohur në temperaturën 32-35°C<sup>1)</sup> hidhet (duke e përzier shpejt) tretësira e hidrokosit të natriumit, që ka temperaturën e mijedisit. Pas 1 h, precipitimi i oksidit të bakrit (I) Cu<sub>2</sub>O merr fund; lëngu ç'ngjyrosht.

Precipitati i përfstuar lahet me dekantim me ujë dhe hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti<sup>2)</sup>, ku lahet me ujë të nxehëtë deri në largimin e joneve sulfat SO<sub>4</sub><sup>2-</sup> (prova bëhet me tretësirë të klorurit të bariumit). Precipitati i oksidit të bakrit (I) thahet në temperaturën 45-75°C.


#### 4.2.8. Oksidi i bakrit (II)

$$\text{CuO} \quad M = 79,54 \text{ g/mol} \quad d = 6400 \text{ kg/m}^3$$

Oksidi i bakrit (II) CuO është pluhur me ngjyrë kafe të errët ose në formë copash të ngurta me ngjyrë të zezë. Në temperaturën 1026°C shpërbëhet në oksid bakri (I) dhe oksigjen. Oksidi i bakrit (II) është pak i tretshëm në tretësirë amoniakore dhe, pothuajse, i patrëshëm në ujë. Preparati i përfstuar në temperaturë të ulët tretet në acide të holluara, kurse preparati i gëlqerizuar fort tretet ngadalë, madje edhe në acide të përqendruara të ngrohura.

##### 4.2.8.1. Gatitja e oksidit të bakrit (II)

Oksidi i bakrit (II) mund të gatitet me anë të precipitimit të joneve bakë: Cu<sup>2+</sup> me tretësirë të një alkali, sipas barazimit:



Në tretësirën e filtruar dhe të nxehëtë (në 80-90°C) të 17,2 g NaOH në 300 ml ujë, hidhet tretësira e nxehëtë e 50 g CuSO<sub>4</sub> · 5H<sub>2</sub>O në 200 ml ujë<sup>3)</sup>. Përzierja ngrohet 10-15 min. në temperaturë 90°C. Precipitati i oksidit të bakrit CuO, pasi lahet dy herë me ujë (me dekantim), hidhet në hinkën filtruese me filter bezeje (ose me letër filtruese të shpejtë). Në filter precipitati lahet me ujë, derisa në ujërat e larjes të mos ketë më jone sulfat SO<sub>4</sub><sup>2-</sup> (prova bëhet me tretësirë kloruri bariumi). Pastaj, precipitati hidhet në një poç konik, shtohet në tretësirë amoniakore NH<sub>3</sub> · H<sub>2</sub>O (NH<sub>4</sub>OH) dhe lihet rrëth 24 h, duke e tundur herë pas here. Pasi hollohet me ujë, përzierja lihet në qetësi të dekantojë. Precipitati lahet me dekantim (4-5 herë) me ujë, pastaj hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti ku lahet me ujë, derisa në ujërat e larjes të mos ketë më jone, sulfat SO<sub>4</sub><sup>2-</sup> (prova bëhet me tretësirë kloruri bariumi). Precipitati thahet në temperaturën 200-300°C dhe grimcohet në havan.

Sasia e përfstuar është rrëth 14 g.  
Sipas literaturës, kur si lëndë nistore përdoren reaktivë të klasifikimit të pas-

1) Provat tregojnë se mosrespektimi i kësaj temperaturë ndikon keq në zhvillimin e reaksionit.

2) Provat tregojnë se ky veprim mund të kryhet edhe me hinkë të zakonshme.

3) Nuk duhet bërë veprimi i kundërt.

tër (p.), preparati i përgjigjet klasifikimit: i pastër për analizë (p. p. a.).  
 Oksidi i bakrit (II) mund të gatitet edhe nga sulfati i bakrit (II)  $\text{CuSO}_4 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$  (teknik).

Në një gotë me nxënësi 1500 ml përgatitet tretësira e 250 g sulfat bakri  $\text{CuSO}_4 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$  në 1 l ujë. Hidhen në të 1,2 ml tretësirë 30% peroksidi hidrogjeni  $\text{H}_2\text{O}_2$  dhe ngrohet. Pasi të shtohen 2,5 g oksidi bakri (II), përzierja valohet (papastëritë e hekurit bien në formën e  $\text{Fe(OH)}_3$  dhe filtrohet. Në filtratin e nxehëtë hidhet tretësira e hidroksidit të natriumit (90 g hidroksid natriumi në 450 ml ujë) dhe ngrohet 20-25 min në temperaturën 80-90°C.

Përzierja e përfshuar lahet me dekantim, derisa të largohen jonet sulfat  $\text{SO}_4^{2-}$ . Precipitati hidhet në hinkën filtruese dhe pastaj gëlqerizohet në 300°C.

Përfshohen rrith 100 g  $\text{CuO}$ .


Në Uzinën e Telave Elektrike në Shkodër, gjatë procesit të telëzimit të bakrit (në temperaturatë larta), formohet (si mbeturinë) një sasi e madhe oksidi bakri (II) në formë lusplash. Ky oksid përban edhe cifla bakri pjesërisht të oksiduara, madje edhe të paoksiduara. Provat tregojnë se, pas një përpunimi me metodikën e mëposhtme, nga këto mbeturina mund të përfshohet preparati i përdorshëm për eksperimentet laboratorike.

Për këtë, përzierja e oksidit të bakrit (II) teknik me ciflat e bakrit të packisiduar (mbeturinat) lahet paraprakisht me tretësirë amoniakore  $\text{NH}_3 \cdot \text{H}_2\text{O}$  ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$  ose 24%). Më pas lahet me dekantim 2-3 herë me ujë të nxehëtë dëhe 3-4 herë me ujë të ftohtë. Pluhuri i lagësht, hidhet në një kupshore (ose pja°ë) porcelani dhe gëlqerizohet 2-3 h në furë elektrike në temperaturën 700-800°C (deri në oksidimin e plotë të ciflave të bakrit), duke e përzier herë pas here. Pas ftohjes, kokrrizat ose luspat e oksidit të bakrit (II) grimcohen në havan porcelani dhe siten në sitë me vrima me diametër jo më të madh se 1 mm. Oksidi i bakrit  $\text{CuO}$  i situr gëlqerizohet përsëri.


Sipas provave, rendimenti është 85%.

#### 4.2.9. Sulfati i bakrit (II)

##### a) Sulfati i bakrit anhidër



##### b) Sulfati i bakrit kristalhidrat



Kristalet e  $\text{CuSO}_4 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$  (gurkali) kanë njyrë të kaltër të errët dhe janë të sistemit triklin. Në temperaturën mbi 100°C kristalhidrati fillon të humbasë ujin e kristalizimit, në 220°C shndërrohet në një pluhur të bardhë ( $\text{CuSO}_4$  anhidër), dhe në 653°C fillon të shpërbëhet në  $\text{CuO}$  dhe  $\text{SO}_3$ . Sulfati i bakrit tretet në ujë (18,7%  $\text{CuSO}_4$ , në 25°C) dhe në alkool etilik të holluar, është i patretshëm në alkool etilik absolut.

Sulfati i bakrit  $\text{CuSO}_4 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$  i prodhuar në Uzinën Telave Elektrike në Shkodër, sipas kushteve teknike të prodhimit, ndahet në dy kategori me karakteristikat e mëposhtme:

## kategoria II

## kategoria III

Përbajtja e CuSO <sub>4</sub>	96,2%	93%
Përbajtja e hekurit	0,4%	1%
Përbajtja e H <sub>2</sub> SO <sub>4</sub> të lirë	0,25%	0,25%
Papastërti të patretshme në ujë	0,45%	0,45%

Sulfati i bakrit që prodhohet në Kombinatin Kimiko-Metalurgjik në Laç, formon kristale me madhësi deri në 3 mm, me ngjyrë të kaltër dhe me këto karakteristika fiziko-kimike:

- Përbajtja e CuSO<sub>4</sub> · 5H<sub>2</sub>O jo më pak se 96%.
- Përbajtja e H<sub>2</sub>SO<sub>4</sub> të lirë jo më shumë se 0,25%.
- Përbajtja e ujit jo më shumë se 4%.
- Papastërti jo më shumë se 0,1%.

Në ndërmarrjen Kimike në Durrës prodhohet CuSO<sub>4</sub> · 5H<sub>2</sub>O reaktiv kimik me karakteristikat fiziko-kimike që jepen në tabelën 4.1.

Tabela 4.1

Treguesit	Norma në përqindje
Pamja e jashtme, ngjyra	substancë kristalore me ngjyrë të kaltër
Përbajtja e CuSO <sub>4</sub> · 5H <sub>2</sub> O	jo më pak se 99%
Mbetja e patretshme	jo më shumë se 0,002%
Përbajtja e klorureve	jo më shumë se 0,001%
Përbajtja e nitrateve	jo më shumë se 0,001%
Përbajtja e metaleve alkaline (Na)	jo më shumë se 0,1%
Përbajtja e hekurit (Fe)	jo më shumë se 0,005%
Përbajtja e metaleve të rënda (Pb)	jo më shumë se 0,005%

Preparati ruhet në shishe qelqi ose në shishe plastike me nxënësi 500-1000 g, me tapë të jashtme dhe të brendshme.

#### 4.2.9.1. Pastrimi i sulfatit të bakrit CuSO<sub>4</sub> · 5H<sub>2</sub>O (teknik)

Sulfati i bakrit CuSO<sub>4</sub> · 5H<sub>2</sub>O teknik nuk mund të pastrohet nëpërmjet rikristalizimit, sepse rikristalizimi, qoftë edhe shumë herë, nuk e çliron preparatin nga papastërtitë e hekurit.

Sulfati i bakrit mund të pastrohet me rrugë kimike; jonet Fe<sup>2+</sup> dhe Fe<sup>3+</sup> precipitoohen në formën e Fe(OH)<sub>3</sub> me anë të hidroksidit të natriumit dhe ujit të oksigenuar (H<sub>2</sub>O<sub>2</sub>).

Në tretësirën e nxehjtë të 200 g CuSO<sub>4</sub> · 5H<sub>2</sub>O hidhen 5 ml H<sub>2</sub>O<sub>2</sub> (3%) dhe 10 ml tretësirë hidroksidi natriumi 20%. Lëngu valohet 5-10 min dhe filtrohet. Filtrati avullohet deri në shfaqjen e cipës kristalore dhe ftohet. Kristalet e CuSO<sub>4</sub> · 5H<sub>2</sub>O që fundërojnë, rikristalizohen edhe dy herë të tjera, pastaj ftohen nëpërmjet letrash filtruese.

Për të përftuar preparat të klasifikimit (p. p. a.), këshillohet kjo metodikë: Kripa e përftuar ngrohet 24 h në temperaturën 105°C, formohet mononhidrati  $\text{CuSO}_4 \cdot \text{H}_2\text{O}$ . Më pas ajo mbahet 1-2 ditë në eksikator me  $\text{H}_2\text{SO}_4$  13 %, deri në një masë konstante. Reaktivi i përftuar i përgjigjet me përpikëri formulës  $\text{CuSO}_4 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$ . Provat tregojnë se ky është shumë i qëndrueshëm, tretësira u jore e tij është krejtësisht e kthjellët dhe shumë e përshtatshme për titullim.

Për të përftuar preparat anhidër  $\text{CuSO}_4$ , kristalhidrati  $\text{CuSO}_4 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$  ngrohet në një kupshore porcelani, në banjë rëre, në temperaturë jo më të lartë se 220°C duke përzier vazhdimisht. Pluhuri i bardhë i përftuar shtypet në havan të nxehëtë dhe hidhet në shishe të thatë, të mbyllur mirë.

## 5. Bariumi dhe përbërjet e tij

### 5.1. Bariumi

Ba	M = 137,34 g/mol t.shk. = 847°C	d = 3600 kg/m <sup>3</sup> t.vl. = 1640°C
----	------------------------------------	--


Bariumi është metal i butë, me ngjyrë të bardhë të argjendtë, me pak shkëltim. Ka afri të madhe kimike; oksidohet shpejt në ajër dhe formon oksidin e bariumit e peroksidin e bariumit. Me ujin vepron me vrull dhe formon hidroksid bariumi e hidrogen (që çlirohet në gjendje të lirë). Bariumi e ngjyros flakën në ngjyrë të gjelbër.

### 5.2. Përbërjet e bariumit

#### 5.2.1. Etanoati i bariumit (acetati i bariumit)

Ba(CH <sub>3</sub> COO) <sub>2</sub> · 3H <sub>2</sub> O	M = 309,48 g/mol d = 2020 kg/m <sup>3</sup>
--	--

Etanoati i bariumit i hidratuar formon kristale të sistemit monoklin, që pluhurosen në ajër. Në temperaturën 25-44°C kristalizon me një molekulë ujë, kurse mbi 44°C kthehet në kripë anhidër. Reaktivi tretet mirë në ujë. Me ngrohje, mbi temperaturën 150°C, shpërbëhet në karbonat bariumi dhe propanon:



### 5.2.1.1. Gatinja e etanoatit të bariumit të hidratuar


Reaktivi mund të përfshohet nga asnjanësimi i hidroksidit të bariumit me acid etanoik.

Në 125 ml tretësirë 16% acidi etanoik të ngrohtë hidhet hidroksid bariumi<sup>1)</sup>, deri në reaksiun asnjani<sup>2)</sup> (ndaj bromtimolit blu). Pastaj, shtohen në të 2-3 g qymyr aktiv dhe tretësira valohet disa minuta. Përzierja e ngrohtë filtronet; filtrati, pasi shtohen 2-3 pika  $\text{CH}_3\text{COOH}$ , avullohet deri në shfaqjen e cipës kristale ( $d = 1390 \text{ kg/m}^3$ , në temperaturën e valimit. Pastaj, stohet në temperaturën 20°C, shtohen në të 100 ml alkool etilik, përzihet mirë dhe lihet 10.-12 h. Kristalet që bien, hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe thahen në temperaturën e mjedisit 24 h (derisa të mos ndihet më era e alkoolit).

Përfshohen 27-30 g reaktiv.

Sipas kësaj metodike, në rast se substancat nistore janë të klasifikimit (p.) ose (p. p. a.), edhe reaktivi i përfshuar i përgjigjet po këtij klasifikimi.

### 5.2.2. Hidroksidi i bariumit




Hidroksidi i bariumit anhidër  $\text{Ba(OH)}_2$  formon një masë kristalore të bardhë. Po të nxehet mbi temperaturën 780°C, shndërrohet në oksid bariumi. Hidroksidi i bariumit i hidratuar  $\text{Ba(OH)}_2 \cdot 8\text{H}_2\text{O}$  është substancë e bardhë kristalore. Tretet në ujë (3,75 % hidroksid bariumi anhidër, në 20°C), kurse në alkool etilik tretet pak. Ka veprim brejtës ndaj lëkurës. Në eksikator, mbi acid sulfurik shndërrohet në  $\text{Ba(OH)}_2 \cdot \text{H}_2\text{O}$ . Molekula e fundit e ujut shkëputet me nxehje deri në skuqje (në 180-540°C).

Hidroksidi i bariumit  $\text{Ba(OH)}_2 \cdot 8\text{H}_2\text{O}$  ruhet në shishe me tapë të parafinuar, sepse në ajër bashkohet me dioksidin e karbonit dhe shndërrohet në karbonat bariumi.

### 5.2.2.1. Gatinja e hidroksidit të bariumit të hidratuar

Hidroksidi i bariumit i hidratuar mund të përfshohet nga bashkëveprimi i klorurit të bariumit me hidroksid natriumi:



Në tretësirën e 90 g  $\text{BaCl}_2 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$  në 150 ml ujë, hidhen 75-80 ml tretësirë  $\text{NaOH}$  ( $d = 1200 \text{ kg/m}^3$ ). Përzierja ngrohet deri në valim, lihet të precipitojë rreth 30 min dhe filtronet në të nxehëtë në një kupshore porcelani që përmban 25 ml ujë të stohët. Kristalet e  $\text{Ba(OH)}_2 \cdot 8\text{H}_2\text{O}$  që bien, hidhen në hinkën për filtrim

1) Hidroksidi i bariumit  $\text{Ba(OH)}_2 \cdot 8\text{H}_2\text{O}$  mund të zëvealësitet me karbonat bariumi  $\text{BaCO}_3$  (rreth 38 g).

2) Nevojiten 55-58 g  $\text{Ba(OH)}_2 \cdot 8\text{H}_2\text{O}$ .


në zbrazëti dhe lahen 2 herë me ujë, me porcione nga 4-5 ml.

Për të pastruar preparatin e lagësht të përfshuar, 60 g të tij tretën në 75 ml ujë në temperaturën 60-90°C. Shtohet në të rrëth 1 ml  $H_2O_2$  3% dhe pas 10 min filtrohet. Të nesërmen kristalet e  $Ba(OH)_2 \cdot 8H_2O$ , që bien, hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti, lahen me 1-2 ml ujë dhe thahen në rrymë ajri pa dioksid karboni (ajri kalohet paraprakisht nëpër KOH ose NaOH të ngurtë).

Reaktivi ruhet në shishe hermetike me tapë gome ose lëvoreje.

Përfshohen rrëth 50 g hidroksid bariumi.


### 5.2.3. Karbonati i bariumit



Karbonati i bariumit formon kristale të sistemit hekzagonal. Në temperaturën 1450°C reaktivi shpërbëhet dhe çliron dioksid karboni. Në ujë, madje edhe të valuar, tretet fare pak.

#### 5.2.3.1. Gatitja e karbonatit të bariumit

a) Karbonati i bariumit mund të përfshohet duke ngopur tretësirën e hidroksidit të bariumit me dioksid karboni



Në tretësirën e ngrohtë të 160 g  $Ba(OH)_2 \cdot 8H_2O$  në 1 l ujë, gurgullohet dioksid karboni, derisa prova e filtratit të mos japë më precipitat kur shtohet në të tretësirë karbonati natriumi. Precipitati ( $BaCO_3$ ) hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti, lahet dhe thahet në 100°C.

Përfshohen 100 g karbonat bariumi.

Sipas kësaj metodike, në qoftë se  $Ba(OH)_2 \cdot 8H_2O$  është i klasifikimit (p. p. a.), reaktivi i përfshuar i përgjigjet klasifikimit (p. p. a.).

b) Reaktivi pak më i pastër mund të përfshohet nga veprimi i karbonatit të natriumit me nitrat bariumi:




Në tretësirën e ngrohtë të 70 g  $Na_2CO_3 \cdot 10H_2O$  në 250 ml ujë hidhet, duke përzier, tretësira e ngrohtë e 90 g  $Ba(NO_3)_2$  në 800 ml ujë. Pas hedhjes së gjithë sasisë së nitratit të bariumit, në tretësirë duhet të mbetet një sasi e përfillshme karbonati natriumi.<sup>1)</sup> Përzierja trazohet, lihet të precipitojë dhe precipitati lahet me ujë të ngrohtë (në 70°C), deri në largimin e joneve nitrat  $NO_3^-$  (prova me difenilaminë). Precipitati hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe thahet në 100°C.

Përfshohen rrëth 50 g karbonat bariumi.

1) Prova e tretësirës së filtruar duhet të japë turbullirë të lehtë kur shtohet në të tretësirë  $Ba(NO_3)_2$

## 5.2.4. Kloruri i bariumit



Kloruri i bariumit i hidratuar formon pllaka të shndritshme pa ngjyrë. Në temperaturë më të lartë se  $100^\circ\text{C}$  humbet ujin e kristalizimit (që e meir përsëri gjatë ftohjes, në prani të lagështirës së ajrit), thahet plotësisht në temperaturën  $160^\circ\text{C}$ . Tretet mirë në ujë ( $26,3\%$ , në  $20^\circ\text{C}$ ), kurse në acid klorhidrik dhe në eter dietilik është pothuajse e patretshme.

Në alkoll absolut humbet ujin e kristalizimit, por (pothuaj) nuk tretet. Kloruri i bariumit është substancë helmuese.

### 5.2.4.1. Gatitja e klorurit të bariumit të hidratuar


Preparati i klasifikimit (p. p. a.) mund të përfshohet nga produkti teknik.

Treten  $332 \text{ g BaCl}_2 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$  (teknik) në  $750 \text{ ml}$  ujë të ngrohtë. Shtohen në të  $15-20 \text{ ml}$  tretësirë e ngopur hidroksidi bariumi dhe  $12 \text{ ml}$  tretësirë të ngopur sulfuri amoni. Përzierja e përfshuar ngrohet  $20-30 \text{ min}$ , deri në  $80-90^\circ\text{C}$ , lihet të precipitojë dhe filtrohet. Filtrati avullohet deri në formimin e një lëngu në trajtë shurupi ( $d = 1330 \text{ kg/m}^3$ , në  $30^\circ\text{C}$ ) dhe ftohet. Kristalet që bien, hidhen në hinkën përfiltrim në zbrazëti dhe thahen në temperaturë të zakonshme.

Përfshohen  $50-60 \text{ g}$  klorur bariumi i hidratuar.

Nga tretësira mëmë, duke e avulluar dhe ftohur, mund të përfshohen edhe rreth  $40 \text{ g}$  reaktiv i pastër.

## 5.2.5. Nitrati i bariumit



Nitrat i bariumit formon kristale të tejdi kshme, pak higrokopike. Tretet në ujë ( $8,3\%$ , në  $20^\circ\text{C}$ ), kurse në alkoll etilik është i patretshëm. Preparati duhet tharë në temperaturë jo më të lartë se  $375^\circ\text{C}$ ; mbi këtë temperaturë, fillon të shpërbehet.

### 5.2.5.1. Gatitja e nitratit të bariumit

a) Reaktiv i klasifikimit (k. p.) mund të përfshitet me anë të pastrimit të kujdeseshëm të reaktivit të klasifikimit (p. p. a.).

Në  $200 \text{ ml}$  ujë tretet me ngrohje  $50 \text{ g Ba}(\text{NO}_3)_2$  dhe shtohen në të  $0,3 \text{ g}$  qymyr aktiv. Përzierja valohet për një kohë të shkurtër, filtrohet dhe thahet. Kristalet e nitratit të bariumit që bien, hidhen në hinkën përfiltrim në zbrazëti dhe thahen në  $100^\circ\text{C}$ .

Përfshohen rreth  $28 \text{ g}$  nitrat bariumi.

Nga tretësira mëmë, me anë të avullimit mund të përfshohet edhe një sasi tjetër reaktivë më pak i pastër.


b) Reaktivi i pastër mund të përfshohet nga veprimi i karbonatit të bariumit teknik me acid nitrik.

Në tretësirën e 100 ml  $\text{HNO}_3$  teknik ( $d = 1360 - 1400 \text{ kg/m}^3$ ) në 450 ml ujë, hidhet me porcione të vogla  $\text{BaCO}_3$  (teknik) deri në ndërpërjen e plotë të dioksidit të karbonit (rreth 150 g). Pastaj shtohen në të edhe 3-5 g  $\text{BaCO}_3$  dhe 10 ml tretësirë e ngopur e  $\text{Ba(OH)}_2$  për precipitin e papastërtive. Përzierja valohet 10 min dhe filtrohet. Në filtrat shtohet acid nitrik (p.), deri në reaksion acid të dobët dhe tretësira shohet me akull. Kristalet që bien, hidhen në hinkën për filtrim të zbrazëti dhe lahlen me një sasi të vogël uji, në temperaturën  $0^\circ\text{C}$ .


Përfshohen rreth 150 g reaktiv i cili mund të pastrohet me rikristalizim si në rastin e parë (a).

### 5.2.6. Peroksidi i bariumit

#### a) Preoksidi i bariumit anhidër



#### b) Peroksidi i bariumit kristalhidrat




Peroksidi i bariumit anhidër është pluhur me ngjyrë të bardhë. Në temperaturën rreth  $800^\circ\text{C}$  reaktivi humbet rreth  $1/2$  e oksigjenit dhe shndërrohet në oksid barumi. Nga veprimi me acide formon kripën përkatëse të bariumit dhe peroksid hidrogjeni.

Hidrati  $\text{BaO}_2 \cdot 8\text{H}_2\text{O}$  formon kokrriza hekzagonale me shkëlqim si qelibari. Në ujë të ftotë tretet pak (0.168 %, në  $20^\circ\text{C}$ ). Në  $130^\circ\text{C}$  humbet 7,5 molëkula ujë, kurse çhidiatimi i plotë arrihet në temperaturën mbi  $200^\circ\text{C}$  (duke çliruar pjesërisht oksigjen).

#### 5.2.6.1. Gatiqë e peroksidit të bariumit

a) Peroksidi i bariumit mund të përfshohet nga bashkëveprimi i klorurit të bariumit me peroksid hidrogjeni:




Në tretësirën e 100 g  $\text{BaCl}_2 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$  në 250 ml ujë<sup>1)</sup> hidhen 250 ml  $\text{H}_2\text{O}_2$  30 %. Fastaj, duke e përzier, shtohen 200 ml  $\text{NH}_4\text{OH}$  ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ). Përzierja lihet të dekantojë dhe pas dekantimit, lëngu derdhet. Precipitati i  $\text{BaO}_2 \cdot 8\text{H}_2\text{O}$  dekantohet 2-3 herë me ujë të ftotë; hidhet në hinkën për filtrim të zbrazëti dhe lphet me kujdes (këshillohet që të ndërthuret larja me filtrin, me larjen me dekantim). Precipitati i larë thahet në kupshore porcelani, në temperaturën  $50-70^\circ\text{C}$ , duke e

<sup>1)</sup> Në vend të tretësirës së  $\text{BaCl}_2$  mund të merret 100 g tretësirë e ngopur e  $\text{Ba(NO}_3)_2$ .

thërmuar me anë të shpatullës. Kur përbajtja e kupshores shndërrohet në një masë pluhuri, temperatura duhet të ngrihet deri në 75-80°C. Preparati i tharë therr mohet në havan dhe ruhet në një shishe me tapë të smeriluar.

Përftohen rreth 55 g reaktiv. Pastërtia e reaktivit varet nga cilësia e produktave fillestare dhe shkalla e larjes.

b) Peroksid bariumi  $\text{BaO}_2 \cdot 8\text{H}_2\text{O}$  më i pastër mund të përftohet nga bashkëveprimi i hidroksidit të bariumit me peroksid hidrogjeni:



Trefen 8 g  $\text{Ba(OH)}_2 \cdot 8\text{H}_2\text{O}$  në 340 ml ujë pa dioksid karboni<sup>1)</sup>. Tretësira e përfstuar ftohet deri në 0°C dhe përpunohet me 10 ml  $\text{H}_2\text{O}_2$  30 %. Pluhuri koktrizor (me ngjyrë të bardhë, të ndritshme) i  $\text{BaO}_2 \cdot 8\text{H}_2\text{O}$  lahet mbi 30 herë me porcione të vogla uji të cliruar nga dioksid i karbonit.

Përftohen rreth 1,5 g peroksid bariumi.

### 5.2.7. Sulfati i bariumit

$$\text{BaSO}_4 \quad M = 233,40 \text{ g/mol} \quad d = 4500 \text{ kg/m}^3$$


Sulfati i bariumit është pluhur i bardhë, praktikisht i patretshëm në ujë ( $PT = 0,87 \cdot 10^{-1}$ , në 18°C) dhe në acide. Në temperaturën 1580°C shkrin dhe pastaj fluron plotësisht.

#### 5.2.7.1. Gatitja e sulfatit të bariumit

a) Në tretësirën e nxehë të 55 g  $\text{BaCl}_2 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$  në 250 ml ujë, hidhet ngadalë tretësira e 23 ml acid sulfurik ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ) në 120 ml ujë. Pas lënies në qetësi për një kohë të shkurtër, bëhet prova e precipitimit të plotë me disa pikë acid sulfurik.

Përftohen rreth 100 g sulfat bariumi.

b) Reaktivi më pak i pastër mund të përftohet nga veprimi i sulfatit të natriumit me nitrat bariumi:



Në tretësirën e ngrohtë të 70 g  $\text{Na}_2\text{SO}_4 \cdot 10\text{H}_2\text{O}$  (p.) në 250 ml ujë hidhet, duke e përzier, tretësira e ngrohtë e 90 g  $\text{Ba}(\text{NO}_3)_2$  në 800 ml ujë. Përzierja, pasi të trazohet, lihet të precipitojë në qetësi dhe precipitati lahet me ujë të ngrohtë (në 70°C) deri në largimin e<sup>2)</sup> joneve nitrat  $\text{NO}_3^-$  (provë me difenilaminë). Precipitati hidhet në hinkën përfiltrim në zbrazëti (ose filtrohet në hinkë të zakonshme) dhe thahet në 100°C.




1) Përkëtë, uji i distiluar valohet një kohë të gjatë dhe ftohet në një rrymë e ajri pa dioksid karboni.

2) Për praninë e joneve nitrat  $\text{NO}_3^-$  duhet të provohen jo vetëm ujërat larese, por edhe precipitati duke e tretur në acid klorhidrik.

## 5.2.8. Sulfuri i bariumit

BaS      M = 169,40 g/mol      d = 4250 kg/m<sup>3</sup> (në 150°C)  
t.shk. = 2000°C

Sulfuri i bariumit është pluhuri kristalor i bardhë, nganjëherë i hirtë i shndritshëm ose në trëndafili, me kristale të sistemit kubik. Në ajër me lagështirë reaktivi dalëngadalë shpërbëhet, duke çliruar H<sub>2</sub>S dhe shndërrohet në një përzirje të përbërë nga BaCO<sub>3</sub>, Ba(OH)<sub>2</sub> dhe BaSO<sub>4</sub> sipas barazimeve të reaksioneve:



Në ujë hidrolizohet dhe formon hidrogjensulfur bariumi, dhe hidroksid bariumi.

### 5.2.8.1. Gatitja e sulfurit të bariumit


Sulfuri i bariumit mund të përfshohet nga asnjanësimi i hidroksidit të bariumit me sulfur hidrogjeni.

Merret 50 g Ba(OH)<sub>2</sub> · H<sub>2</sub>O i thërrmuar në formë pluhuri (përfshohet nga çhidratimi i Ba(OH)<sub>2</sub> · 8H<sub>2</sub>O, në 180°C) dhe futet në një gyp qelqi të gjërë në formë shtrese të shkrifët të vendosur horizontalisht. Gypi duhet të ketë përmasa të tillë, që shtresa e reaktivit të zërë jo më tepër se gjysmën e gypit. Nëpër gyp dërgohet sulfur hidrogjeni (në kapë). Në këtë rast, masa nxehet shumë dhe lagështira largohet me anë të rrymës së sulfurit të hidrogjenit; pa e ndërprerë këtë gypi ftohet (mund të ftohet, gjithashtu, me rrymë hidrogjeni).

Përfshohen rrëth 45 g produkt, që përmban rrëth 70-80 % BaS.

## 6. Bromi dhe përbërjet e tij

### 6.1. Bromi




Bromi është lëng i rëndë, që formon avuj me ngjyrë të kuqe të murrme. Ngjyra e lëngut, në dritën e reflektuar, është vjollcë në të murrme (pothuajse e zezë). Në temperaturën —  $73^\circ\text{C}$  ngurtësohet në një masë me ngjyrë të verdhë në të gjelbër, me shkëlqim metalik (ka pamjen e jodit), e cila, në temperaturën —  $252^\circ\text{C}$ , bëhet pa ngjyrë. Bromi tretet mirë në alkool etilik, në eter dielitik, kloroform, benzen, sulfur karboni, kurse në ujë tretet pak ( $3,10\%$ , në  $20^\circ\text{C}$ ). Gjithashtu, tretet në acidin klorhidrik dhe në acidin bromhidrik, Tretësira ujore e ngopur e bromit (uji i bromit) nuk ngrin, madje, as në temperaturën —  $20^\circ\text{C}$ . Me ngrohje, bromi veçohet nga tretësira. Nga veprimi i dritës së diellit, uji i bromit shndërrohet në acid bromhidrik. Bromi është helm i fortë.

Për përfitimin e ujit të bromit të ngopur (tretësirë afro  $3\%$ ) në një shishe me tapë të smeriluar hidhen  $5 \text{ g}$  brom në  $100 \text{ ml}$  ujë dhe tunden fort duke hapur herë pas here tapën që të dalin avujt e bromit. Bromi merret me tepricë, kështu që një pjesë e tij qëndron në fund të shishes. Kur është harxhuar i gjithë uji i bromit, të shtojmë porcion të ri uji dhe e tundim mirë. Gjithë puna me ujin e bromit duhet të kryhet në kapë.

### 6.2. Përbërjet e bromit

#### 6.2.1. Acidi bromhidrik




Acidi bromhidrik është tretësirë ujore e bromurit të hidrogjenit. Bromuri hidrogjenit është gaz pa ngjyrë, me erë mbytëse që të kujton klorurin e hidrogjenit. Në kushte normale, 1 l peshon 3.6445. g. Në ujë tretet shumë mirë duke ciluar një sasi të madhe nxehësie.

Tretësira ujore (acidi bromhidrik) është lëng pa ngjyrë me shije të athët.

Acidi bromhidrik kur bie mbi lëkurë shkakton iritim të lëkurës. Ruhet në enë të myllura fort, në vend të errët (në drithë shpërbëhet).

#### 6.2.1.1. Gatitja e bromurit të hidrogjenit


a) Një nga metodat më të thjeshta për përfitimini<sup>1)</sup> e bromurit të hidrogjenit është veprimi i bromit me fosforin e kuq të lagësht:



Në një poç me fund të sheshtë (ose poç distilimi) të pajisur me një hinkë ndarëse dhe gyp zhvillimi (fig. 6.1) hidhen 10 g fosfor i kuq dhe 20 ml ujë. Me anë të hinkës ndarëse shtohen në të dalëngadalë 35 ml brom. Gazi që çlrohet, gurgullohet në një gyp në formën e shkronjës U të mbushur me një përzierje asbesti me fosfor të kuq të lagësht (por jo të qullët).

Përftohen rrëth 30 l bromur hidrogjeni.

b) Bromuri i hidrogjenit mund të përftohet edhe nga reduktimi i bromit me sulfur hidrogjeni:



Në një shishe larëse gazesh hidhet brom, shtohet<sup>1)</sup> pak ujë dhe gurgullohet sulfurihidrogjeni i gatzë. Gazi që çlrohet, gurgullohet pastaj në një shishe larëse me pezulli fosfori të kuq në ujë (për thithjen e  $Br_2$ ). Bromuri i hidrogjenit i përfthuar del mjaft i pastër, nuk përmban sulfur hidrogjeni.



Fig. 6.1. Aparat për përfitimini e HBr

1) Puna duhet të kryhet në kapë dhe me doreza gomë.

### 6.2.1.2. Gatitja e acidit bromhidrik

a) Bromuri i hidrogjenit i përfshuar sipas mënyrave (a) dhe (b) që thamë më sipër, gurgullohet në 200 ml ujë të vendosur në një përzierje ftohëse. Gypi i zhvillimit të gazit nuk duhet të futet në ujë, sepse si pasojë e tretshmërisë shumë të madhe të HBr së gaztë në ujë, ky i fundit mund të kalojë në aparatin e përfshimit të gazit.

b) Acidi bromhidrik teknik (madje edhe ai i pastër) shpesh përmban papastërti organike (ka mundësi të jenë të tipit të acideve naftenike) që nuk veçohen gjatë distilimit.

Ka një mënyrë të thjeshtë për pastrimin e acidit bromhidrik nga papastërtitë organike:

Në acidin bromhidrik që do të pastrohet, shtohet kloroform në raportin 1:3. Përzierja tundet 20-25 min dhe veçohet fazë e lëngët, e cila distilohet. Në temperaturën  $62^{\circ}\text{C}$  avullohet një sasi e vogël kloroformi, pastaj në  $125-126^{\circ}\text{C}$  avullon bromuri i hidrogjenit HBr. Mbetja përmban rrëth 10% të vëllimit fillestare të lëngut. Acidi i përfshuar ka  $d = 1437 \text{ kg/m}^3$ . Përbajtja e papastërtive (Fe, Cu, Pb, Zn, Ag, Mg, Al, Ti, Mn, Sb) është e rendit  $3 \cdot 10^{-5}$  deri  $1 \cdot 10^{-7}\%$ .

## 7. Fosfori dhe përbërjet e tij

### 7.1. Fosfori

$$M = 30,97 \text{ g/mol}$$

Fosfori formon disa forma alotropike.

#### Fosfori i bardhë

$$d = 1820 \text{ kg/m}^3$$

$$\begin{aligned} t. \text{ shk.} &= 44,1^\circ\text{C} \\ t. \text{ vl.} &= 275^\circ\text{C} \end{aligned}$$

Fosfori i bardhë është një substancë pa ngjyrë, e tejdukshme, me shkëlqim të dobët. Era e fosforit është e ngjashme me atë të hudhrës. Në ajër merr flakë (në temperaturën  $60^\circ\text{C}$ ). Gjatë ruajtjes (nën ujë) zverdhet lehtë, prandaj shpesht quhet fosfor i verdhë. Është pothuajse i patretshëm në ujë ( $0,0003\%$ , në  $15^\circ\text{C}$ ), pak më i tretshëm në eter dietilik, benzen e në lira të ngurta dhe fare pak i tretshëm në alkool etilik e në glicerinë. Tretet mjaft mirë në sulfur karboni ( $1$  pjesë  $\text{CS}_2$  tret  $18$  pjesë fosfor). Letra e lagur me tretësirë fosfori në  $\text{CS}_2$  pas tharjes, merr flakë.

Fosfori i bardhë është shumë helmues [doza vdekjeprurëse  $0,1 \text{ g}$ ] ka aftësi të vetëndizet në temperaturë të ulët. Shkakton plagë (fosfori që digjet) që dhembin shumë, shërohen me vështirësi dhe mund të janë të rrezikshme për jetën.

$$\text{Fosfori i kuq } d = 2200 \text{ kg/m}^3$$

Fosfori i kuq është pluhur kristalor me ngjyrë të kuqe të errët. Është i patretshëm në ujë, në alkool etilik, në sulfur karboni, dhe në tretës organikë. Nuk është helmues, nuk ka aftësi të vetëndizet. Fosfori i kuq thith lagështirën e ajrit, prandaj ruhet në shishe me tapë të parafinuar.

### a) Puna me fosfor të bardhë

Fosfori i bardhë ruhet nën ujë, në shishe të errët me tapë të smeriluar. Gjatë punës me fosfor të bardhë duhet kujdes dhe vëmendje e veçantë (syzë dhe doreza). Fosfori i bardhë asnjëherë nuk duhet kapur me dorë, ai copëtohet nën ujë (në një kristalizator të gjërë të mbushur me ujë), kapet me pincetë dhe pritet me thikë.

Në qoftë se duhet fosfor i thatë, copat e fosforit shtrëngohen shpejt midis letrave filtruuese. Fosfori që është duke u djegur, fiket nën ujë.

### b) Pastrimi i fosforit të bardhë

Gjatë punës me fosfor të bardhë duhet pasur gati një arkë me rërë që të hidhet mbi fosforin, në rast se ai merr flakë.

Fosfori teknik, i paketuar në kuti teneqeje, shpesh mbulohet me një cipë të hollë. Para përdorimit, ai mbahet 24 h në tretësirë 5% acidi nitrik, pastaj lahet me ujë.

Për të çngjyrosur fosforin e zverdhur (nga ruajtja për një kohë të gjatë), shkrihen nën ujë 100 pjesë në masë fosfor. Uji është ngrohur paraprakisht në temperaturën  $65^{\circ}\text{C}$  dhe përmban 3,5 pjesë në masë  $\text{K}_2\text{Cr}_2\text{O}_7$ , dhe 3,5 pjesë në masë  $\text{H}_2\text{SO}_4$ <sup>1)</sup>.

### c) Pastrimi i fosforit të kuq

Fosfori i kuq teknik për t'u pastruar valohet për një kohë të gjatë (mbi 8 h) me tretësirë 7% hidroksidi naftromi dhe pastaj me ujë (mbi 8 h). Uji derdhet, kurse precipitati i fosforit lahet me kujdes me ujë deri në reaksion asnjanes dhe thahet në eksikator mbi anhidrid fosforik.

## 7.2. Përbërjet e fosforit

### 7.2.1. Acidi fosforik



$$M = 98,00 \text{ g/mol}$$

$$d = 1834 \text{ kg/m}^3$$

$$\text{t.shk.} = 42,35^{\circ}\text{C}$$

Acidi fosforik formon kristale pa ngjyrë të sistemit rombik. Me nxehësi shkrin dhe kthehet në një lëng pa ngjyrë (në formë shurupi), pa erë me dendësi  $1880 \text{ kg/m}^3$ . Tretet mirë në ujë dhe në alkool etilik. Kristalizohet nga tretësirat ujore me  $d = 1750 - 1850 \text{ kg/m}^3$  (më lehtë po ti shtohen disa kristale). Me ngrohje mbi temperaturën  $150^{\circ}\text{C}$  acidi fosforik fillon të humbasë ujin e lidhur dhe shndërrohet në acid pirofosforik  $\text{H}_4\text{P}_2\text{O}_7$ , e më tej në acid metafosforik  $\text{HPO}_3$ .

1) Për 100 pjesë në masë ujë.

Acidi fosforik është acid me fortësi mesatare. Konstantet e shpërbashkimit të acidi fosforik (p), në temperaturën  $25^{\circ}\text{C}$ , përkatësisht janë:

$$K_1 = 7,6 \cdot 10^{-3}; \quad K_2 = 6,2 \cdot 10^{-8}; \quad K_3 = 4,4 \cdot 10^{-13}.$$


### 7.2.1.1. Pastrimi i acidit fosforik teknik

Acidi fosforik teknik mund të pastrohet (nga arseniku dhe metalet e tjera të rënda) me këtë metodë:

Acidi fosforik ( $d = 1650 \text{ kg/m}^3$ ) ngopet (në kapë) 30 min me klorur hidrogjeni. Pastaj, shtohet në të tretësirë sulfuri hidrogjeni (40-50 ml për 100 ml tretësirë), përsëri ngopet me klorur hidrogjeni 2 h dhe lihet në qetësi 24 h. Precipitati i përbërë nga sulfuri i arsenikut dhe sulfuret e metaleve të tjera të rënda, filtrohet. Filtrati, pasi shtohen në të disa pika acidi nitrik, avullohet në banjë rëre në temperaturë jo më të lartë se  $140^{\circ}\text{C}$  deri në dendësi të tretësirës  $1900 \text{ kg/m}^3$ .

### 7.2.1.2. Gatitja e acidit fosforik

Acidi fosforik mund të përfshohet nga veprimi i një kripe të tij me acid klorhidrik:



Në 460 ml ujë treten 73 g  $\text{Na}_2\text{HPO}_4 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$  (p.). Tretësira ngopet (në kapë) me klorur hidrogjeni të ftohtë. Kloruri i natriumit bie në trajtë precipitati, sepse është pothujse i patretshëm në tretësirën e ngopur të acidit klorhidrik. Lëngu filtrat; filtrati avullohet në banjë uji, derisa kthehet në një shurup të trashë. Pastaj ftohet dhe shtohet në të një vëllim i barabartë alkooli etilik absolut (për të precipituar kristalet e klorurit të natriumit, që ende nuk kanë rënë). Pas filtrimit, filtrati avullohet ngadalë për të larguar alkoolin.

Reaktivi, nganjëherë, përfshohet me ngjyrë të murrme për shkak të papastërvive inorganike.

## 8. Hekuri dhe përbërjet e tij

### 8.1. Hekuri

Fe

M = 55,85 g/mol  
t.shk. = 1539°C

d = 7860 kg/m<sup>3</sup>  
t.vl. = 2770°C

Hekuri është metal i butë ngjyrë hiri, që tretet në acide. Nga veprimi i acidit nitrik tymues, bëhet «pasiv», mbulohet me një cipë oksidesh dhe humb aftësinë për t'u tretur në acide.

Në laborator përdoret hekuri i reduktuar, i cili është pluhur me ngjyrë hiri.

#### 8.1.1. Gatitja e hekurit

Hekuri në formë pluhuri mund të përfshohet me anë të reduktimit të hidroksidit të hekurt me hidrogjen, sipas barazimit:



Hidroksidi i hekurt (shih gatitja e  $\text{Fe(OH)}_3$ ) i tharë në 100-120°C dhe i bluar në pluhur të hollë (në vend të  $\text{Fe(OH)}_3$ ) mund të merret  $\text{Fe}_2\text{O}_3$ , vendoset në shtresë të hollë në një gyp porcelani ose qelqi zjarrdurues. Gypi vishet me një tel rezistence në formë spiraleje, që lidhet me burimin e rrymës. Duke lëshuar hidrogjen të thatë e të pastë<sup>1)</sup>, në fillim nxirret nga gypi ajri e pastaj, pa ndërpërre rrymën e hidrogjenit, nxehet gypi gradualisht, derisa teli i rezistencës të kuqet. Reduktimi vazhdon për sa kohë vazhdon dalja e avujve të ujtit nga gypi.


1) Hidrogjeni i përdorur për reduktim pastrohet paraprakisht duke kaluar në fillim në tretësi<sup>ë</sup> 1N etanoati plumbi  $\text{Pb(CH}_3\text{COO)}_2$ , pastaj në tretësi<sup>ë</sup> 10% sulfati bakri dhe, së fundi, përharje në acid sulfurik të përqendruar.

(Për provë; gazet që dalin nga gypi, drejtohen në një gotë qelqi të ftohtë; në qoftë se nuk formohen bulëza uji, reduktimi ka mbaruar). Pasi mbaron reaksiuni, gypi ftohet me rrymë hidrogjeni dhe pluhuri i hekurit i përfshuar hidhet në një enë me tapë të smeriluar.

Shënim. Në përfstimin e hekurit ka rëndësi të gjendet temperatura e përshtatshme e reduktimit (kjo gjë arrihet duke e zgjatur ose shkurtuar gjatësinë e telit të rezistencës). Në qoftë se gypi është nxehur në temperaturë më të ulët, atëherë mund të përfshohet hekuri piroforik, i cili, duke rënë në kontakt me ajrin, ndizet menjëherë dhe oksidohet shpejt. Përkundrazi, gjatë nxehjes në një temperaturë relativisht të lartë, në vend të një pluhuri të imët, përfshohet një masë e pjekur.

## 8.2. Përbërjet e hekurit

### 8.2.1. Hidroksidi i hekurit (III)



Hidroksidi i hekurit (III) (i zakonshëm) formon copëza poroze që, kur thyhen, shndrisin.

Në ujë është pothuajse i patretshëm ( $4,8 \cdot 10^{-3}\%$ , në  $18^\circ\text{C}$ ;  $PT = 3,2 \cdot 10^{-3}$ ), por formon lehtë tretësira koloidale. Tretshmëria në acide varet nga «mosha e preparatit». Hidroksidi i porsagatitur tretet mirë në acide inorganike dhe organike; kurse ai që qëndron pak kohë, tretet me vështirësi. Hidroksidi i hekurit (III), po të ngrohet humbet dalëngadalë ujë dhe shndërrohet në  $\text{Fe}_2\text{O}_3$ .

#### 8.2.1.1. Gatitja e hidroksidit të hekurit III

Për të gatitur hidroksidin e hekurit (III), mund të veprohet sipas këtyre metodikave (a dhe b):

a) Në tretësirën e  $50 \text{ g Fe(NO}_3)_3 \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  në  $250 \text{ ml}$  ujë të ngrohur deri në  $70^\circ\text{C}$ , hidhet pika-pika, duke e përzier fort, tretësirë amoniakore  $5\%$ , derisa të ndihet era e lehtë e amoniakut (sipas provave  $125 \text{ ml}$ ).

Precipitati i  $\text{Fe(OH)}_3$  lahet me dekantim (2-3 herë) me ujë të ngrohtë; hidhet në filtri dhe lahet përsëri me ujë të ngrohtë. Hidroksidi i hekurit (III) i lagësht thahet në temperaturën  $110^\circ\text{C}$  dhe thërrmohet në pluhur. Me këtë metodikë përfshohen rrith  $30 \text{ g Fe(OH)}_3$ .

b) Në tretësirën  $1\%$  të  $\text{FeCl}_3 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$  hidhet (me curril të hollë dhe me përzierje të fortë) tretësirë  $15-20\% \text{ NH}_4\text{OH}$  (me tepricë fare të vogël) Përzierja trazohet 5 min dhe hidroksidi i hekurit i përfshuar lahet me dekantim me ujë, derisa në ujërat e larjes të mos ketë më jone klorur  $\text{Cl}^-$  (prova me tretësirë nitrati argjenti).


Precipitati i larë hidhet në hinkën përfiltrim në zbrazëti dhe thahet në  $30-50^\circ\text{C}$  (5-6 h) e pastaj në  $100-110^\circ$  (6-8 h).

## 8.2.2. Kloruri i hekurit (II)

### a) Kloruri i hekurit anhidër

$\text{FeCl}_2$	$M = 126,75 \text{ g/mol}$	$d = 2980 \text{ kg/m}^3$
	t.shk. = $672^\circ\text{C}$	t.vl. = $1012^\circ\text{C}$

### b) Kloruri i hekurit kristalhidrat



Kloruri i hekurit (II) anhidër formon kristale kubike të bardha dhe kokrriza ose kristale hekzagonale, në formë petash. Preparati i zakonshëm ka ngjyrë hiri në të bardhë. Gjatë qëndrimit në ajër bëhet krejtësisht i bardhë (hidratohet) dhe pastaj i verdhë (oksidohet). Kloruri i hekurit (II) tretet në ujë. Kripa e shkrirë e përcjell mirë rrymën elektrike. Me ngrohje (në  $450\text{-}480^\circ\text{C}$ ), në prani të oksigenit, shndërrohet në  $\text{Fe}_2\text{O}_3$  dhe çliron klor.

Kristalhydrati  $\text{FeCl}_2 \cdot 4\text{H}_2\text{O}$  formon kristale të tejdukshme të kaltra, që në ajër bëhen të gjelbra (si pasojë e oksidimit të pjesshëm). Me pak ngrohje ose po të ruhet në acid sukfurik të përqendruar, kalon në  $\text{FeCl}_2 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$ . Në ajër me lagëshitirë  $\text{FeCl}_2 \cdot 4\text{H}_2\text{O}$  qullet. Preparati tretet shumë mirë në ujë; tretet mirë në alkool etilik dhe në eter dietilik. Kripa duhet të ruhet në shishe të mbyllura, në mjesdi dioksidi karboni.

### 8.2.2.1. Pastrimi i klorurit të hekurit II

Kristalhydrati  $\text{FeCl}_2 \cdot 4\text{H}_2\text{O}$  (i çliruar nga ionet  $\text{Fe}^{3+}$ ) mund të përftohet nga produkti teknik në këtë mënyrë:

Në një poc qelqi treten me ngrohje 75 g  $\text{FeCl}_2 \cdot 4\text{H}_2\text{O}$  (teknik), në 25 ml ujë. Në tretësirën e përfthuar shtohet pak acid klorhidrik dhe pluhur hekuri. Poçi mbylljet me një tapë me gyp zhvillimi, i cili zhytet në ujë. Posa lëngu merr ngjyrë të kaltër të zbehtë, filtrohet shpejt në hinkën përfiltrim në zbrazëti. Në poçin konik përfiltrim në zbrazëti, përfthet larguar ajrin, hidhen paraprakisht 2-3 ml eter dietilik. (Kujdes! Rrezik zjarri!). Filtrati hidhet shpejt në një poc të rrumbullt me 2-3 ml eter. Poçi mbylljet mirë dhe stohet me një rrymë dioksidi karboni. Precipitati i  $\text{FeCl}_2 \cdot 4\text{H}_2\text{O}$  që bie, hidhet në hinkën përfiltrim në zbrazëti, thahet në eksikator me acid sulfurik të përqendruar dhe hidhet në një shishe të mbyllur me parafinë, në mjesdi dioksidi karboni.

### 8.2.2.2. Gatitja e klorurit të hekurit (II)

a) Përfthuar kristalhydratin  $\text{FeCl}_2 \cdot 4\text{H}_2\text{O}$ , tretet hekuri në acid klorhidrik.

Në një kupshore porcelani hidhen (në kapë) 45 ml ujë dhe 63 ml acid klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ). Shtohen në të pak e nga pak 25 g tallash hekuri. (Kujdes! Çlirim i hidrogenit paraqet rrezik zjarri). Pas stohjes, tretësira filtrohet dhe filtrati avullohet deri në shfaqjen në sipërfaqe të një cipe kristalore të hollë. Përfthet

parandaluar oksidimin, këshillohet që në tretësirën e përfstuar të vendoset një copë hekuri, me sipërfaqe të pastruar mirë. Pas disa orësh, kristalet e  $\text{FeCl}_2 \cdot 4\text{H}_2\text{O}$  që bien, kalohen në filter dhe thahen në dollapin tharës (termostat), në temperaturë jo më të lartë se  $50^\circ\text{C}$ . Preparati hidhet në shishe dhe mbylljet me parafinë, në mjeshtë dioksidi karboni.

b) Kloruri i hekurit (II) anhidër mund të përfshohet nga  $\text{FeCl}_3$  anhidër në këtë mënyrë:

Kloruri i hekurit  $\text{FeCl}_3$  futet në një gyp porcelani, që është i mbështjellë me një rezistencë nikel-kromi, në formë spiraleje. Gypi, pasi nxirret ajri me anë të hidrogenit, ngrohet shpejt deri në temperaturën  $300\text{-}350^\circ\text{C}$  (një temperaturë e tillë arrihet me një tel rezistence nikel-kromi në formë spiraleje, me gjatësi  $15\text{ m}$  dhe  $\varphi = 0,3\text{ mm}$ ). Ka rëndësi të arrihet ky interval temperature, sepse nën  $300^\circ\text{C}$   $\text{FeCl}_3$  sublimohet dhe nuk reduktohet nga hidrogeni; mbi  $350^\circ\text{C}$  mund të ndodhë rëndësi deri në hekur metalik.

### 8.2.3. Kloruri i hekurit (III)

#### a) Kloruri i hekurit [III] anhidër

$$\begin{array}{lll} \text{FeCl}_3 & M = 162,21 \text{ g/mol} & d = 2900 \text{ kg/m}^3 \\ & t.shk. = 309^\circ\text{C} & t.vl. = 319^\circ\text{C} \end{array}$$

#### b) Kloruri i hekurit [III] kristalhidrat



$$\text{FeCl}_3 \cdot 6\text{HO} \quad M = 270,30 \text{ g/mol}$$

Kloruri i hekurit anhidër formon kristale të mëdha në formë fletësh, të sistemit hekzagonal me ngjyrë të errët. Në ajër thith me etje lagështirë qullet; tretet mirë në ujë ( $47,9\%$ , në  $20^\circ\text{C}$ ) dhe çliron shumë nxehësi. Gjithashtu, tretet mirë në alkool etilik, glicerinë, eter dietilik dhe aceton, kurse në benzol tretet pak.

Kristalhidrati  $\text{FeCl}_3 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$  është një masë kristalore mjaft e butë, me ngjyrë të kuqe në kafe, i lagësht në prekje. Në ajër me lagështirë qullet shpejt. Shkrin në  $37^\circ\text{C}$ , avullon në  $100^\circ\text{C}$  dhe në temperaturë mbi  $250^\circ\text{C}$  shpërbëhet në  $\text{Fe}_2\text{O}_3$ ,  $\text{FeCl}_3$ ,  $\text{Cl}_2$  dhe  $\text{HCl}$ . Tretet shumë mirë në ujë; tretet mirë në alkool etilik, glicerinë dhe në eter dietilik.

#### 8.2.3.1. Gatitja e klorurit të hekurit [III]

Kristalhidrati  $\text{FeCl}_3 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$  përfshohet nga oksidimi i tretësirës së klorurit të hekurit (II) me klor<sup>1)</sup>.



1) Puna duhet të kryhet në kapë.

Në fillim gatitet tretësira e klorurit (II). Në një poç konik, me nxë nësi 500 ml, hidhen 370 ml tretësirë 25% acidi klorhidrik. Shtohen në të, me porcione të vogla 60 g tallash hekuri i pastër. (Kujdes! Rrezik zjarri!) Kur mbaron stadi i vrullshëm i reaksionit, tretësira ngrohet në 80-90°C, filtrohet dhe klorohet në një shtyllë përthithëse (absorbuese). Tretësira e  $\text{FeCl}_2$  bie nëpërmjet hinkës ndarëse, në përthithës (fig. 8.1) me shpejtësi 5 ml/min. Si përthithës përdoret një





Fig. 8.1.

shtyllë me lartësi 100 cm dhe diametër 4 cm, e mbushur me copëza të prera gypi qelqi, me diametër 6-8 mm dhe gjatësi 3 cm. Nga poshtë, në shtyllë futet klor (me shpejtësi), që paraprakisht lahet në një shishe me ujë. Teprica e klorit, pasi kalon shishen me dy gryka që ka tretësirë hidroksidi natriumi, thithet me anë të pompës për zbrazëti. Tretësira e kloruar, që rrjedh nga shtylla në gotë, hidhet në një kupshore porcelani, ku avullohet në temperaturë 90-95°C, derisa në sipërfaqen e lëngut shfaqet cipa kristolare. Pastaj ftohet deri në 4°C, duke e përzier rrallë. Kristalet që veçohen, filtrohen në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe hidhen në shishe me tapë të smeriluar.

Përstohen rreth 250 g kripë.

Shënim. Procesi i klorimit duhet të rregullohet në mënyrë të tillë që oksidimi të jetë sa më i plotë. Për këtë, prova e lëngut me tretësirë  $\text{K}_3[\text{Fe}(\text{CN})_6]$  nuk duhet të japë precipitat të kaltër.

#### 8.2.4. Oksidi i hekurit (III)



Oksidi i hekurit (III) formon kristale të sistemit triklin ose romboedrik me ngjyrë të hirtë, të verdhë ose të kuqe; i përgatitur artificialisht është pluhur amorf në ngjyrë të kuqe-tulle. Është fare pak i tretshëm në acide.

Në Kombinatin Kimiko-Metalurgjik në Laç, si mbeturinë e procesit teknologjik të prodhimit të acidit sulfurik (gjatë djegies së piritit) del edhe një sasi e mëdhe oksidi hekuri (III).


#### 8.2.4.1. Pastrimi i oksidit të hekurit (III)

Oksidi i hekurit  $\text{Fe}_2\text{O}_3$  i pastër mund të përfshohet në këtë mënyrë:

Treten me ngrohje 100 g oksid hekuri (III) teknik, në acid nitrik. Tretësira hollohet me ujë, filtrohet dhe avullohet në banjë uji deri në formimin e një cipe kristalore. Për kristalizimin e  $\text{Fe}(\text{NO}_3)_3$ , filtrati shfrohet. Kripa e përfshuar  $\text{Fe}(\text{NO}_3)_3 \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  tretet në ujë, filtrohet dhe ngopet me amoniak të gaztë  $\text{NH}_3$ . Precipitati i  $\text{Fe}(\text{OH})_3$  që fundërron pasi të filtrohet, lahet dhe thahet, pastaj gëllqerizohet në 500°C dhe thërrmohet në havan hekuri.

#### 8.2.4.2. Gatitja e oksidit të hekurit (III)

Për të përfshuar oksidin e hekurit (III), gëllqerizohet nitrati i hekurit (III). Gjatë këtij procesi  $\text{Fe}(\text{NO})_3$  shpërbëhet sipas barazimit:



Në një kupshore porcelani hidhen 50 g  $\text{Fe}(\text{NO}_3)_3 \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  dhe ngrohen në furnelë elektrike (në kapë). Kripa shkrin duke formuar një lëng të murrmë, i cili, në temperaturën 121°C, fillon të valojë dhe çliron avuj  $\text{HNO}_3$  dhe okside azoti. Për të shëmangur spërkatjet, lëngu duhet të përzihet shpesh me shpatull porcelani. Me nxehje ai dendësohet dhe formon një pastë. Në temperaturën 132°C pasta menjëherë fillon të thërrmohet në pluhur dhe vazhdon të çlirojë avuj  $\text{HNO}_3$  dhe okside azoti. Pa e ndërprerë përzierjen, masa reaguese ngrohet edhe 20-25 min, deri në tharjen e plotë. Masa e thatë hidhet në pote dhe gëllqerizohet 8-10 h, në temperaturën 600-700°C.

Përfshohen rreth 10 g oksid hekuri (III).

#### 8.2.5. Sulfati i hekurit (II)



Preparati i pastër ka ngjyrë të kaltë. Në ajër të thatë shndërrohet në një pluhur të bardhë, që në prani të lagështirës, e rimerr ngjyrën e kaltë. Në temperaturën 60°C,  $\text{FeSO}_4 \cdot 7\text{H}_2\text{O}$  zbardhet duke kaluar në  $\text{FeSO}_4 \cdot \text{H}_2\text{O}$ ; mbi 250° shpërbëhet dhe çliron  $\text{SO}_3$ . Tretet mirë në ujë (në 20°C, tretësira e ngopur përmban 21%  $\text{FeSO}_4$  pa ujë) dhe në glicerinë; nuk tretet në alkool etilik. Është substancë me veti helmuese; oksidohet në ajër dhe ruhet në vende pa lagështirë.

Sulfati i hekurit  $\text{FeSO}_4 \cdot 7\text{H}_2\text{O}$ , që prodhohet në fabrikën e gozhdë-bulonave, në Kavajë ka këto karakteristika fiziko-kimike: Pamja e përgjithshme . . . masë e ngurtë në formë kristalesh monokline.

Ngjyra	e gjelbër
Dendësia	1899 kg/m <sup>3</sup>
Tretshmëria (në 100 g)	në ujë të ftohtë treten 33 g, në ujë të ngrohtë (në 50°C) treten 149 g
Lagështira	maksimumi 32%
Pastërtia	minimumi 93%

Nuk përban papastërti të tjera, si kalcium, magnez etj.


### 8.2.5.1. Pastrimi i sulfatit të hekurit (II)

Preparati i pastër mund të përfshohet nga sulfati i hekurit (II) teknik. Produkti tretet në ujë. Tretësira e përfshuar acidohet me acid sulfurik deri në reaksi (mje-dis) acid; lihet disa ditë e mbyllur në shishe hermetike (për të shhangur kontaktin me ajrin), duke shtuar në tretësirë copa hekuri ose FeS (për precipitin e jojeve Cu<sup>2+</sup> dhe reduktimin e joneve Fe<sup>3+</sup> në Fe<sup>2+</sup>). Lëngu ngopet (në kapë) me sulfur hidrogjeni H<sub>2</sub>S, për ta pastruar nga As, Sn etj., dhe përsëri lihet disa ditë. Pastaj, tretësira nxehet dhe filtrohet; filtratit i shtohet pak hekur metalik dhe avullohet në banjë uji, derisa në sipërfaqen e lëngut të formohet një cipë kristalore (dendësia e tretësirës = 1340 kg/m<sup>3</sup>). Pasi filtrohet, lihet 24 h të kristalizojë, në temperaturë jo më të lartë se 18°C (ose mund të bëhet precipitimi me alkool si më poshtë).

Preparati pothuajse i lirë nga jonet Fe<sup>3+</sup> dhe mjaft i qëndrueshëm në ajër përfshohet me anë të kristalizimit me alkool etilik. Në tretësirën e përqendruar të FeSO<sub>4</sub> hidhet alkool etilik (në 1 vëllim të tretësirës së preparatit, 3 vëllime alkool). Pluhuri kristalor që precipiton, hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti, laget me alkool dhe thahet në letër filtruese, në temperaturën e mjedisit, deri në zhdukjen e erës së alkoolit (këshillohet që për largimin e alkoolit, pluhuri të laget me ujë të valuar paraprakisht).


### 8.2.5.2. Gatiqë e sulfatit të hekurit (II)

Sulfati i hekurit (II) mund të përfshohet nga tretja e hekurit metalik në acid硫urik:



Hekuri në trajtë tallashi ose téli tretet në tretësirë 15-20% acidi sulfurik dhe nxehet derisa mbetja e hekurit të mos tretet më. Tretësira filtrohet dhe acidohet me H<sub>2</sub>SO<sub>4</sub>, deri në reaksi (gaz), mbylljet shishja hermetikisht dhe lihet në qetësi 2-3 ditë. Pastaj, lëngu ngrohet në banjë uji dhe filtrohet nga precipitatet e sulfureve (SnS, CuS, As<sub>2</sub>S<sub>3</sub> etj.). Filtrati avullohet përgjysmë dhe lihet për kristalizim në një mjedis dioksid karboni; pas një dite kristalet veçohen dhe shpëlahen me ujë e më pas me alkool etilik. Preparati vendoset midis letrash filtruese dhe thahet deri në 30°C.

### 8.2.6. Sulfati i hekurit (III) (sulfati ferrik)



$$M = 562,01 \text{ g/mol}$$

$$d = 2100 \text{ kg/m}^3$$

Sulfati i hekurit (III) anhidër është pluhur me ngjyrë të bardhë në të verdhë, që në ajër shndërrohet në një lëng ngjyrë kafe.

Kristalhidrati është masë kristalore që qullet në ajër. Tretet shumë në ujë, por tretja bëhet shumë ngadalë; tretet në alkool etilik, kurse në acid sulfurik të përqendruar nuk tretet.

Tretësira ujore, për shkak të hidrolizës (formimit të  $\text{Fe(OH)}_3$ ), ngjyroset në ngjyrë të kuqe; me shtimin e  $\text{H}_2\text{SO}_4$  tretësira bëhet pothuaj pa ngjyrë.



Në Ndërmaqjen Kimike në Durrës prodhohet tretësirë e sulfatit të hekurit me këto karakteristika fiziko-kimike:

Pamja e përgjithshme ... tretësirë me ngjyrë kafe.

Përbajtja e sulfatit të hekurit (III) në tretësirë, jo më pak se 70%.

#### 8.2.6.1. Gatinja e sulfatit të hekurit (III)

Për të përfstuar sulfat hekuri (III), tretet hidroksidi i hekurit (III) në acid sulfurik sipas barazimeve:




Treten 50 g  $\text{Fe}(\text{NO}_3)_3 \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  në 50 ml ujë të ngrohtë. Shtohen në të 65-70 ml  $\text{NH}_4\text{OH}$  ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ). Mbetjen e  $\text{Fe}(\text{OH})_3$  e lajmë shpejt me dekantim me ujë të nxehët, për të larguar jonet nitrat  $\text{NO}_3^-$  (prova bëhet me difenilaminë). Hidroksidi i hekurit  $\text{Fe}(\text{OH})_3$  i lagësht hidhet në një kupshore porcelani.

Shtohen në të 9 ml  $\text{H}_2\text{SO}_4$  ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ) dhe nxehet 1-2h, duke e përzier deri në tretjen e plotë të mbetjes. Tretësira filtrohet, filtratit i shtohet një pikë acid sulfurik dhe avullohet, deri në formimin e një mase të trashë në formë shurupi (vëllimi i lëngut të mbetur duhet të jetë rrëth 50 ml). Në tretësirë hidhet një kristall  $\text{Fe}_2(\text{SO}_4)_3 \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  dhe lihet 24 h për kristalizim. Kristalet kalohen përmes filtrim dhe thahen në një xham sahati, në temperaturën 50-60°C.

Përfstohen rrëth 40 g kripë.

Preparati mund të përfstohet edhe me oksidim të sulfatit të hekurit (II) me acid nitrik<sup>1)</sup>, sipas barazimit:



Në tretësirën e ngrohur deri në 70°C të 43 g  $\text{FeSO}_4 \cdot 7\text{H}_2\text{O}$  në 55 ml ujë, hidhet pak e nga pak 4 ml  $\text{H}_2\text{SO}_4$  ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ) (Kujdes nga spërkatjet!) dhe pastaj 50 ml  $\text{HNO}_3$  ( $d = 1350 \text{ kg/m}^3$ ). Temperatura e tretësirës mbahet 95-100°C. Shkalla e oksidimit të joneve  $\text{Fe}^{2+}$  në  $\text{Fe}^{3+}$  kontrollohet me anë të provës me  $\text{K}_3[\text{Fe}(\text{CN})_6]$  (kur bëhet oksidimi i plotë, tretësira nuk duhet të marrë ngjyrë blu).

1) Puna duhet të kryhet në kapë.

Tretësira filtrohet, filtratit i hidhen 2 ml acid sulurik dhe avullohet, deri në formimin e një mase të trashë në formë shurupi (températura arrin në 120°C). Masa ftohet deri në 45-50°C. Kristalet që bien, kalohen për filtrim dhe thahen në temperaturë jo më të lartë se 60°C.

Përftohen rreth 35 g kripë.

### 8.2.7. Sulfuri i hekurit

$$\text{FeS} \quad M = 87,88 \text{ g/mol} \quad d = 4840 \text{ kg/m}^3 \\ \text{t.shk.} = 1193^\circ\text{C}$$

Sulfuri i hekurit FeS formon kristale të forta të sistemit monoklin, me ngjyrë hiri. Në ujë praktikisht nuk tretet; tretet lehtë në acide (duke çliruar sulfur hidro-gjeni  $\text{H}_2\text{S}$ ).

#### 8.2.7.1. Gatitja e sulfu rit të hekurit

Zakonisht, sulfuri i hekurit FeS (i përshtatshëm për gatitjen në laborator të  $\text{H}_2\text{S}$ ) përftohet me sintezë nga hekuri dhe squfuri<sup>1)</sup>.

Në një pote relativisht të madhe hidhen 50 g tallash hekuri i imtësuar. Potja fiksohet, me anë të një mbajtëseje (trekëndësh) porcelani, në një pote tjeter me përmasa më të mëdha (fig. 8.2). Largësia midis faqeve të poteve duhet të jetë 25-30 mm.




Fig. 8.2

Nga sipër potja e jashtme mbulohet me një kon prej asbesti, vrima e sipërme e të cilil ka diametër 45 mm dhe shërben për nxjerjen e flakës.

Potja nxehet me llambë me gaz (mund të përdoret pajisja nxehëse me benzinë për kallajisje); pasi hekuri nxehet deri në skuqje, pa ndërprerë gëlqerizimin, nëpër vrimën e konit futet squfur me copa me përmasa 15-25 mm (seksioni). Squfuri duhet të hidhet pak e nga pak, me intervale kohe të tilla, që të arrijë të veprojë me hekurin. Në rast të kundërt, hekuri ftohet në temperaturën ku nuk ndodh reaksiuni dhe squfuri avullon.

Pas hedhjes me afërsi të 25 g squfur, masa në pote bëhet e lëngët; lëngu hidhet në një fletë çeliku dhe lihet të ngurtësohet.

Përftohen rreth 70 g sulfur hekuri.

1) Puna duhet të kryhet në kapë.

## 9. Hidrogjeni dhe përbërjet e tij

### 9.1. Hidrogjeni

$$\begin{array}{lll} \text{H}_2 & M = 2,02 \text{ g/mol} & d = 70 \text{ kg/m}^3 \\ & & t.\text{vl.} = -252,79^\circ\text{C} \end{array}$$

Hidrogjeni është gaz pa ngjyrë, pa erë dhe pa shije. Digjet me flakë të kaltër të zbehtë. Në kushte normale, 1 l hidrogjen peshon 0,0898 g. Në lëngje treten fare pak; në 1 vëllim alkool etilik treten 0,0695 vëllime  $\text{H}_2$  (në temperaturë të zakonshme), në 1 vëllim ujë treten 0,0214 vëllime  $\text{H}_2$  (në temperaturën  $0^\circ\text{C}$ ).

Për hidrogenin është karakteristikë, plogëtia kimike në temperaturë të zakonshme (që shkaktohet nga energjia e madhe e lidhjes së molekulës  $\text{H}_2$ ) dhe afria e madhe kimike në temperaturë të lartë dhe në prani të katalizatorëve. Për shembull, me oksigenin (në temperaturë  $180^\circ\text{C}$ ) bashkëvepron ngadalë, kurse në temperaturë  $600^\circ\text{C}$  me plasje.

#### 9.1.1. Gatitja e hidrogenit

Në kushte laboratorike hidrogeni përftohet nga veprimi i metaleve relativisht aktivë me acid sulfurik ose acid klorhidrik.

Më shpesh përftohet nga veprimi i zinkut me acid klorhidrik ose acid sulfurik [1 vëllim  $\text{HCl}$  ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ) me 1 vëllim ujë ose 1 vëllim  $\text{H}_2\text{SO}_4$  ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ) me 8 vëllime ujë]. Reaksiioni mund të kryhet në aparatin e Kippit. Në qoftë se zinku është shumë i pastër, hidrogeni çlrohet ngadalë. Për shpejtimin e procesit në tretësirë shtohen disa pikë kloruri bakri (kur përdoret  $\text{HCl}$ ), ose sulfati bakri (kur përdoret  $\text{H}_2\text{SO}_4$ ). Bakri (duke u zhvendosur nga kripa e tij) vendoset mbi kokrrizat e zinkut dhe formon me të një çift galvanik; si pasojë zinku tretet më shpejt.

### 9.1.2. Pastrimi i hidrogjenit

a) Kur përdoret zink jo i pastër ose kur acidet së bashku me hidrogjenin cilrojnë si papastërti:  $\text{AsH}_3$ ,  $\text{SO}_3$ ,  $\text{NO}$ ,  $\text{NO}_2$ ,  $\text{CO}_2$ ,  $\text{N}_2$ ,  $\text{H}_2\text{S}$ ,  $\text{O}_2$  etj., hidrogjeni pastrohet duke e gurgulluar në tretësirën e përzierjes kromike [100 g  $\text{K}_2\text{Cr}_2\text{O}_7$  dhe 50 g  $\text{H}_2\text{SO}_4$  ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ) në 1 l ujë] ose në tretësirën bazike të  $\text{KMnO}_4$  (tretësirë 5%  $\text{KMnO}_4$  me tretësirë 10-12%  $\text{NaOH}$ ). Pastaj, thahet me  $\text{CaCl}_2$  ose  $\text{P}_2\text{O}_5$  të gëlqerizuar. Hidrogjeni i pastruar në këtë mënyrë përmban ende një sasi të parëndësishme ajri. Për largimin e oksigenit (që shpesh nuk është i dëshirueshëm), gazi kalohet në një gyp qelqi të nxehët, që përmban bakër të reduktuar (shih gatitja e  $\text{N}_2$ ). Në këtë rast hidrogjeni gjatë gjithë kohës i redukton oksidet e bakrit dhe gypi mund të punojë për një kohë të gjatë pa rigjenerim.

b) Për ta pastruar nga azoti, oksigeni dhe avujt e ujit, hidrogjeni futet në një gyp porcelani të mbushur me tallash magnezi dhe të nxehur deri në  $550-600^\circ\text{C}$ . Shënim. Hidrogjeni me ajrin formon përzierje plasëse; prandaj, gjithnjë, para ndezjes, duhet të provohet pastërtia e hidrogjenit të përfstuar.

Prova e djegies së gazit në provëz: gazi që përmban një sasi të madhe ajri, pëlcet; kur është më i pastër, flakeron duke u shoqëruar djegia me një tingull të imprehtë dhe i pastër digjet plotësisht.

Për të shmangur depërtimin e flakës së hidrogjenit brenda në aparatin gaz-sjellës, përdoret një gyp qelqi me gjatësi 10 cm dhe diametër 10 mm. Në këtë gyp vendosen 10 rrathë prej rrjete teli të imët, të puthitur fort në faqet e gypit dhe të ndarë nga njëri-tjetri me tampon pambuku. Gypi vendoset ndërmjet gypit përcjellës dhe burimit të flakës.

## 9.2. Përbërjet e hidrogjenit

### 9.2.1. Peroxidi i hidrogjenit

$\text{H}_2\text{O}_2$	$M = 34,01 \text{ g/mol}$	$d = 1464 \text{ kg/m}^3$ (në $0^\circ\text{C}$ )
t.shk. = $-0,9^\circ\text{C}$		t.vl. = $80,2^\circ\text{C}$ (në $6,266 \text{ kPa}$ )

Peroxidi i hidrogjenit është lëng pa ngjyrë, me erë si të acidit nitrik. Përzihet me ujin, me alkoolin etilik dhe eterin dietilik.

Peroxidi i hidrogjenit është acid shumë i dobët, por oksidues shumë i fortë. Në disa raste mund të veprojë edhe si reduktues. Për shembull, oksidan e argjendit e redukton sipas barazimit:



Reaktivi shumë i përqendruar, në prekje me substancat organike, merr flakë (veprimi me  $\text{MnO}_2$  shoqërohet me plasje).

Kur bie në lëkurë, shkakton djegie, lëkura zbardhet; pas larjes me ujë të pjesës së prekur, rreziku shmanget shpejt.


Gjatë ruajtjes peroksidit i hidrogjenit shpërbëhet në ujë dhe oksigjen (me hollimin e tij, qëndrueshmëria rritet). Shpërbërjen e shpejton prania e papastërtive bazike, e kripërave të metaleve të rënda dhe e substancave organike.

Nuk këshillohet ruajtja e peroksidit të hidrogjenit në shishe qelqi, të përshtatshme janë shishet prej polieteni. Për shkak të shpërbërjes, shishet nuk duhet të mbyllen fort. Gjithashtu, nuk duhet të përdoren tapa prej gome ose prej lëvoreje për shishet që përbajnë tretësirë peroksidit hidrogjeni me përqendrim mbi 10%.

Në laboratorin e kimisë reaktivi ruhet në një vend të veçantë.

### 9.2.1.1. Gatitja e peroksidit të hidrogjenit

a) Peroksidit i hidrogjenit mund të përftohet<sup>1)</sup> nga veprimi i peroksidit të bariumit me acid sulfurik:



Në 100 ml tretësirë 15-18% acidi sulfurik, të ftetur me akull, shtohet ngadalë peroksid bariumi, derisa tretësira të ruajë ende reaksion acid të dobët (rreth 40 g). Peroksidit i hidrogjenit (tretësirë) i përfshuar vëçohet nga precipitati i sulfatit të bariumit. Në qoftë se tretësira duhet të përqendrohet, shtohet në të eter dietilik (i pastër dhe i distiluar). Ekstraktohet 4-5 herë, duke përdorur çdo herë 20 ml eter. Nxjerrjet e eterit bashkohen dhe avullohen në banjë uji (në temperaturë jo më të lartë se 40°C) dhe mbetja mbahet në eksikator, mbi H<sub>2</sub>SO<sub>4</sub> të përqendruar.

Me këtë metodikë përftohet tretësirë 50% peroksidit hidrogjeni.

### 9.2.2. Uji

$$\text{H}_2\text{O} \quad M = 18,02 \text{ g/mol} \quad d = 1000 \text{ kg/m}^3 \text{ (në } 4^\circ\text{C)} \\ \text{t.shk.} = 0^\circ\text{C}$$

Uji është lëng i tejdukshëm, pa ngjyrë, pa erë, e pa shije. Temperatura e valimit të ujit varet shumë nga trysnia atmosferike.

#### 9.2.2.1. Pastrimi i ujit

a) Për të shkatërruar papastërtitë organike që janë të pranishme në ujë këshillohet që të shtohet në çdo litër ujë 0,025 g KMnO<sub>4</sub>. Pastaj, pas 30 min, shtohet tretësirë që përmban 0,5-1 g shap alumini dhe pas 1 h tretësirë që përbajnë 0,64 g NaH<sub>2</sub>PO<sub>4</sub>. Uji lihet 30 min dhe filtrohet. Filtrati valohet 10 min dhe distilohet me ftohës të zakonshëm duke derdhur thyesat e para dhe të fundit (10% të distilit).

b) Për të përfshuar ujë të distiluar, që të mos përbajë dioksid karboni, uj valohet 30 min deri në vëçimin e flluskave të mëdha, pastaj ftohet. Gjatë kësaj kohe poçi mbylljet me një tapë me gyp zhvillimi, i cili futet në një shishe larëse me tretësirë 20% hidroksidit natriumi ose hidroksidi kaliumi.

1) Puna duhet të kryhet në kapë, me syza e doreza mbrojtëse

## 10. Jodi

I<sub>2</sub>

M = 253,81 g/mol  
t.shk. = 113,7°C

d = 4940 kg/m<sup>3</sup>  
t.vl. = 184,35°C


Jodi formon kristale të sistemit rombik, me ngjyrë të murime të errët (në hiri dhe me shkëlqim metalik. Avujt e tij kanë ngjyrë vjollcë, me erë jo të këndshme (pak të ngjashme me klorin ose me bromin). Është përcjellës i keq i nxehësisë dhe i elektricitetit.

Jodi tretet pak në ujë (0,081 %, në temperaturën 10°C), tretet mirë në alkool etilik dhe më mirë në eter dietilik, në sulfur karboni, benzen, kloroform e në tretës të tjerë organikë.

Avujt e jodit janë helmues dhe ushtrojnë veprim ngacmues në membranat mukoze. Jodi ruhet në shishe të errëta me tapë të smeriluar.

### 10.1. G at it ja e jodit

Në një lëfytyje (stortë) të lidhur me një ftohës me ujë, ngrohet përzierja e 1 pjesë në masë pluhur joduri kaliumi (i thatë dhe i thërrmuar) me 1,5-2 pjesë në masë dikromat kaliumi, deri në ndërprerjen e çlirimit të avujve vjollcë të jodit:



Si rregull përfshohet jod i klasifikimit (p. p. a.).

### 10.2. P a strimi i jodit

a) Reaktivi i pastër (p.) mund të përfshohet me anë të sublimimit të jodit teknik. Thërrmohen dhe përzihen 6 pjesë në masë jod teknik, 2 pjesë në masë oksid kalciumi<sup>1)</sup> dhe 1 pjesë në masë jodur kaliumi<sup>2)</sup>. Përzierja e përfshuar hidhet në një

1) Oksidi i kalciumit shtohet për të thithur ujin.

2) Joduri i kaliumit shkëput jodin nga rëtërjet e tij me halogjenet  $ICl + KI = I_2 + KCl$ .

gotë kimike të vendosur në banjë rëre. Gota mbulohet me xham sahati, mbi të cilin hidhet pak ujë. Me ngrohje jodi sublimon dhe precipiton mbi xhamin e sahiatit në formën e kristaleve (në formë gjilpërash).

Për një pastrim më të mirë, sublimimi përsëritet në temperaturë sa më të ulët (që të jetë e mundur) dhe precipitati thahet në eksikator mbi klorur kalciumi të gëlqerizuar (buzët e kapakut të eksikatorit duhet të lyhen me talk dhe jo me vazelinë).

Sublimimi i jodit mund të kryhet, gjithashtu, edhe në kupshore (ose pjatë) porcelani, të mbuluar me hinkë. Më e përshtatshme është që në vend të xhamit të sahatit ose hinkës, të përdoret një poç qelqi me fund të rrumbullt, i cili nga brenda duhet të stohet me ujë të rrjedhshëm.

b) Një mënyrë shumë e thjeshtë për pastrimin e jodit është rikristalizimi i tij nga tetrakloruri i karbonit.

Treten 50 g jod në 500 ml tetraklorur karboni, në 65°C. Tretësira e ngrohtë filtrohet në letër filtruese të dendur dhe filtrati stohet në përzierjen e akullit me kripë (temperatura duhet të arrijë në  $-7^{\circ}\text{C}$  deri në  $-10^{\circ}\text{C}$ ). Kristalet e jodit të stohur hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe shtypen me kujdes.

## II. Kalciumi dhe përbërjet e tij

### 11.1. Kalciumi


Ca

M = 40,08 g/mol  
t.shk. = 845°C  
d = 1570 kg/m<sup>3</sup>  
t.vl. = 1480°C

Kalciumi është metal kahasimisht i butë, me ngjyrë të bardhë si argjendi. Pritet me thikë dhe është mjaft plastik. Ka afri të madhe kimike; në ajër oksidohet shpejt, që në temperaturë të zakonshme, prandaj ruhet në vajguri ose në vaj mineral. Bashkëvepron me vrull me ujin dhe me acidet, duke çliruar hidrogjen.


### 11.2. Përbërjet e kalciumit

#### 11.2.1. Etanoati i kalciumit




M = 176,19 g/mol

Etanoati i kalciumit (acetati i kalciumit) është pluhur i bardhë kristalor me erë të lehtë acidi etanoik. Tretet mirë në ujë (22,5% kripë anhidër, në 25°C). Me ngrohje shpërbëhet në karbonat kalciumi dhe propanon:



### 11.2.1.1. Gatinja e etanoatit të kalciumit


Etanoati i kalciumit mund të përftohet nga bashkëveprimi i karbonatit, të kalciumit me acid etanoik:



Në 105 ml tretësirë 20% acidi etanoik (p.) hidhet karbonat kalciumi (p.<sup>1)</sup>, derisa të ndërpritet çlirimi i dioksidit të karbonit. Pasi të shtohet në të edhe pak karbonat kalciumi, ngrohet deri në temperaturën 80°C. Përzierja reaguese lihet në qetësi 2-3 h, pastaj filtrohet dhe filtrati acidifikohet pak me tretësirë 80%  $\text{CH}_3\text{COOH}$  (p.), deri në reaksion acid të dobët ndaj laksnit (për të shmangur formimin e kripërave bazike). Përzierja e përfshuar, duke i shtuar herë pas here rreth 1 ml tretësirë 80%  $\text{CH}_3\text{COOH}$ , merr pamjen e një quilli të trashë. Pas ftohjes kristalet bien, hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti<sup>2)</sup> dhe thahen në temperaturën 60-70°C.

Përfshohen rreth 20 g reaktiv (p.).

### 11.2.2. Hidroksidi i kalciumit



Hidroksidi i kalciumit (gëlqerja e shuar) është pluhur i bardhë që qhidratohet vetëm në temperaturën 580°C. Bashkëvepron me dioksidin e karbonit të ajrit duke u shndërruar në karbonat kalciumi. Në ujë tretet pak (0,148% në 25°C; PT =  $= 3,1 \cdot 10^{-5}$ , në 25°C), pezullia (suspensioni) e hidroksidit të kalciumit në ujë quhet «qumësht gëlqereje». Hidroksidi i kalciumit është bazë e fortë.

Tretësira ujore e ngopur e hidroksidit të kalciumit «uji i gëlqeres» është lëng i tejdukshëm pa ngjyrë dhe pa erë; ka reaksion alkaljin të fortë, bashkëvepron shpejt me dioksidin e karbonit të ajrit, duke formuar një precipitat të bardhë ( $\text{CaCO}_3$ ).

Me ngrohje uji i gëlqeres turbullohet, sepse precipiton hidroksidi i kalciumit, i cili në ujë të ngrohtë tretet më pak se në ujë të stohë; me ftohje turbullira gradualisht zhdukjet.

#### 11.2.2.1. Gatinja e hidroksidit të kalciumit

a) Hidroksidi i kalciumit mjaft i pastër mund të përftohet nga veprimi i alkaleve me kripërat e kalciumit:



<sup>1)</sup> Në vend të  $\text{CaCO}_3$  mund të përdoret  $\text{Ca}(\text{OH})_2$  i klasifikimit (p.).


<sup>2)</sup> Provat tregojnë se ky veprim mund të kryhet edhe me hinkë të zakonshme.

Në 125 ml ujë treten 125 g  $\text{CaCl}_2 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$  (p.). Tretësira ngrohet në temperaturën  $80^\circ\text{C}$  dhe përpunohet me tretësirën e filtruar të 60 g hidroksid natriumi në 125 ml ujë. Qulli i ngrohtë, që përftohet, hidhet shpejt në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe lahet, deri në largimin e plotë të joneve klorur  $\text{Cl}^-$ . Në ujërat larëse (në provën e filtratit pak të acidifikuar me acid nitrik) nuk duhet të shfaqet turbullirë, kur i shtohet tretësira e nitrati argjenti. Precipitati në fillim lahet me ujë që përmban 0,4% hidroksid natriumi e pastaj me ujë të pastër. Precipitati i larë thahet në temperaturën  $80-100^\circ\text{C}$ .

Përftohen rrëth 30 g hidroksid kalciumi.

b) Për të përfstuar precipitat të dendur, është mirë të përdoret kjo metodikë: Në një gotë me nxënësi 1 l të pajisur me një përzierës mekanik, hidhet nga 53 g  $\text{Ca}(\text{NO}_3)_2 \cdot 4\text{H}_2\text{O}$  në 22 ml ujë dhe tretësira e 18 g NaOH në 75 ml ujë. Shpejtësia e rrjedhjes së tretësirave duhet të jetë e njëjtë dhe hedhja e tyre duhet të zgjatë 10-20 min. Pasta e përfstuar hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti si në rastin e parë (a).

c) Preparati i pastër dhe i thatë mund të përftohet duke vepruar oksidi i kalciumit me ujë:




Në një pote porcelani, me nxënësi të mjaftueshme, hidhen 10 g oksid kalciumi. Duke e lënë kapakun gjysmë të hapur, shtohen në pote me anë të buretës 7 ml ujë. Uji, në fillim, hidhet me pika e pastaj (pas zhvillimit të reaksionit të vrullshëm) më shpejt (gjithsej 15 min). Potja me hidroksid kalciumi mbahet 1 h në dollapin tharës në temperaturën  $105^\circ\text{C}$  e pastaj thahet në eksikator me hidroksid natriumi të ngurtë. Hidhet në shishe dhe tapa e shishes mbulohet me parafinë. Përftohen rrëth 13 g hidroksid kalciumi.

### 11.2.2.2. Gatitja e ujit të gëlqeres

Në 10 g oksid kalciumi të gëlqerizuar hidhen 40 ml ujë dhe përzihen, deri në formimin e një mase homogjene.

Pas precipitimit, lëngu i tejdukshëm mund të ndahet nga precipitati. Precipitati përzihet përsëri me 500 ml ujë, deri në formimin e një mase homogjene; hidhet në shishe, mbyllët dhe lihet në qetësi që të precipitojnë plotësisht mbeturinat. Tretësira e kthjellët derdhet me kujdes në një shishe, që mbyllët fort me tapë gome.

### 11.2.3. Karbonati i kalciumit



$$d = 2710 - 2930 \text{ kg/m}^3$$

Karbonati i kalciumit (guri gëlqeror) është pluhur kristalor i bardhë. Tretet në acide; është fare pak i tretshëm në ujë (0,0014%, në  $25^\circ\text{C}$ ;  $PT = 0,87 \cdot 10^{-8}$ , në  $25^\circ\text{C}$ ). Me ngrohje, deri në temperaturën  $420^\circ\text{C}$ , fillon të shpërbëhet në oksid kalciumi dhe dioksid karboni.

Guri gëlqeror i bluar që përdoret si mbushës në industrinë e gomës, si ushqim

në blegtori dhe në degë të tjera të ekonomisë ka karakteristikat fiziko-kimike që jepen në tabelën 11.1.

Tabela 11.1


Treguesit	Përbajtja	në përqindje
	Për industri	Për blegtori
karbonat kalciumi përbajtja e fluorit	më shumë se 92	më shumë se 90
përbajtja e karbonatit të maganit dhe dioksidit të silicit lagështira	më pak se 8 më pak se 1,0	më pak se 0,2 — 2

Kurse guri gëlqeror që përdoret si lëndë e parë në Uzinën e Sodë-PVC-së në Vlorë, ka këto veçori:

CaCO <sub>3</sub>	97%
MgCO <sub>3</sub>	2%
SiO <sub>2</sub>	0,2-0,3%
R <sub>2</sub> O <sub>3</sub> (Al <sub>2</sub> O <sub>3</sub> , Fe <sub>2</sub> O <sub>3</sub> etj.)	0,2-0,3%

### 11.2.3.1. Gatitja e karbonatit të kalciumit

a) Karbonati i kalciumit mund të përfshohet nga bashkëveprimi i karbonatit të amonit me nitrat kalciumi:



Përgatitet tretësira e 50 g Ca(NO<sub>3</sub>)<sub>2</sub> · 4H<sub>2</sub>O në 100 ml ujë dhe tretësira e 24g (NH<sub>4</sub>)<sub>2</sub>CO<sub>3</sub> në 100 ml ujë. Në secilën prej tretësirave hidhen 10 ml të tretësirës tjetër. Të dy tretësirat, që të ndahen nga precipitati i cili ka tërhequr me vete pa pastërtitë filtrohen. Filtratet hidhen ngadalë, duke i përzier me të njëjtën shpejtësi, në një gotë që përbën 100 ml ujë. Pas precipitimit të plotë (provohet nëse precipitimi është i plotë, duke shtuar në rast nevoje edhe pak (NH<sub>4</sub>)<sub>2</sub>CO<sub>3</sub>), precipitati i karbonatit të kalciumit hidhet në hinkën përfiltrim në zbrazëti<sup>1)</sup>, lahet me një rrymë të ngadalshme uji deri në largimin e joneve nitrat NO<sub>3</sub><sup>-</sup> (prova me disenilaminë), (shpenzohen rreth 750 ml ujë).

Precipitati i larë i karbonatit të kalciumit thahet në temperaturën 110°C.

Përfshohen rreth 20 g karbonat kalciumi.

b) Për të përfshuar karbonat kalciumi të klasifikimit (k.p.) dhe pa praninë e përzierjeve të metaleve të rënda, në tretësirën e karbonatit të amonit dhe në tretësirën e nitratit të kalciumit (shih rastin a) hidhen disa pika tretësirë sulfuri amoni dhe përzierjet lihen 1-2 ditë, deri në precipitin e plotë të sulfureve. Precipitati filtrohet dhe ecuria e punës më tej është si në rastin (a.).

1) Mund të përdoret hinkë e zakonshme.

## 11.2.4. Karburi i kalciumit



$M = 74 \text{ g/mol}$

$d = 2300 \text{ kg/m}^3$

Karburi i kalciumit (karbiti) është substancë pa ngjyrë, e tejdukshme. Pluhuri ka veprim djegës mbi lëkurën dhe ngacmon rrugët e frymëmarrjes. Vepron me ujin dhe qilron etin (acetilen), që është gaz i djegshëm.

Në temperaturën  $0^\circ\text{C}$  dhe në trysninë atmosferike, 1 kg karbur kalciumi i pastër duhet të japë 349,4 l etin (acetilen).

Karburi i kalciumit ruhet në enë hermetike dhe në vende të thata.

Në Uzinën e Sodë-PVC-së në Vlorë prodhohet karbur kalciumi me këto vëçori fiziko-kimike:

Ngjyrë vjollcë në kafe

Erën karakteristike të etinit

Dendësinë  $2240-2500 \text{ kg/m}^3$

Litrazhi (acetilen)  $220-270 \text{ l/kg}$ .

Përbajtja e  $\text{H}_2\text{S}$  (në vëllim) më e vogël se  $0,15\%$

Përbajtja e  $\text{PH}_3$  (në vëllim) më e vogël se  $0,08\%$

## 11.2.5. Kloruri i kalciumit

### a) Kloruri i kalciumit anhidër




$M = 129,84 \text{ g/mol}$

$d = 2512 \text{ kg/m}^3$ , në  $25^\circ\text{C}$

t.shk. =  $772^\circ\text{C}$

### b) Kloruri i kalciumit kristalhidrat



$M = 237,93 \text{ g/mol}$

$d = 1680 \text{ kg/m}^3$  (në  $17^\circ\text{C}$ )

t.shk. =  $21,92^\circ\text{C}$

Kloruri i kalciumit anhidër është substancë kristalore hidroskopike, me ngjyrë të bardhë. Si pasojë e shpërbërjes së pjesshme, kloruri i kalciumit i shkrirë (gjithmonë) përmban një sasi oksidi kalciumi, prandaj jep reaksion bazik. Tretet shumë mirë në ujë ( $42,7\%$ , në  $20^\circ\text{C}$ ) duke qiruar nxehësi; tretet keq në alkool etilik dhe aceton. Kloruri i kalciumit i gëlqerizuar është tharës i mirë i gazeve. Lagështira e mbetur në ajrin mbi klorur kalciumi anhidër, në temperaturën  $25^\circ\text{C}$ ; nuk i kalon  $0,36 \text{ mg/l H}_2\text{O}$  (g).

Kloruri i kalciumit i hidratuar formon kristale pa ngjyrë në formë prizmash rombikë me shije të kripur në të hidhur. Me ngrohje reaktivi shndërrohet në hidratin  $\text{CaCl}_2 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$ , që formon një masë të bardhë poroze.

Në Uzinën e Sodë-PVC-së, në Vlorë kloruri i kalciumit del në formë mbeturine me këto karakteristika:

Ngjyrë kafe të zbehtë, pa erë, me shije të kripur

Përbajtja e  $\text{CaCl}_2$

$32\%$

Përbajtja e  $\text{NaCl}$

$2-3\%$

Dendësia e tretësirës

$1335-1350 \text{ kg/m}^3$

pH-i

7-8

#### 11.2.5.1. Pastrimi i klorurit të kalciumit teknik

a) Një preparat i klasifikimit (p.) përfshohet duke pastruar klorurin e kalciumit teknik.

Paraprakisht duhet të provohet mungesa e klorateve në klorurin e kalciumit teknik. Për këtë 5 g kripë hidhen në 20 ml acid klorhidrik ( $d = 1100 \text{ kg/m}^3$ ) dhe në përzierjen e përfshuar, vendoset një letër indikatore jod-amidoni. Në mungesë të klorateve letra indikatore nuk duhet të ngjyrosjet në ngjyrë të kaltër.

Në 450-500 ml ujë treten 300 g klorur kalciumi teknik. Hidhen në të 3 ml acid klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ) dhe 1-1,5 ml tretësirë 30% kloruri bariumi dhe përzihen.

Pas precipitimit, tretësira provohet për praninë e joneve  $\text{SO}_4^{2-}$  dhe  $\text{Ba}^{2+}$ .

Për zbulimin e joneve  $\text{SO}_4^{2-}$  dhe  $\text{Ba}^{2+}$ , në 5 ml tretësirë hidhen 20 ml ujë, 1 ml acid klorhidrik ( $d = 1120 \text{ kg/m}^3$ ) dhe 0,5 ml tretësirë 1N kloruri bariumi. Në qoftë se gjatë 15 min nuk shfaqet turbullirë, kjo provon mungesën e joneve  $\text{SO}_4^{2-}$ . Në qoftë se zbulohen jone  $\text{SO}_4^{2-}$ , në tretësirën fillohet pak tretësirë kloruri bariumi.

Për zbulimin e joneve  $\text{Ba}^{2+}$ , në 5 ml tretësirë shtohen 20 ml ujë dhe 5 ml tretësirë e ngopur sulfati kalciumi. Në mungesë të joneve  $\text{Ba}^{2+}$ , gjatë 15 min, nuk duhet të ketë turbullirë. Në qoftë se shfaqet turbullirë, për precipitimin e joneve  $\text{Ba}^{2+}$  në tretësirën fillohet me pikë acidi sulfurik i holluar.

Më pas, në tretësirën që do t'i nënshistrohet pastrimit hidhen 5 ml qumësht gëlqereje, deri në shfaqjen e reaksionit të dukshëm bazik ndaj fenolftaleinës dhe rrëth 0,5 g qymyr aktiv. Përzjeja trazohet mirë dhe lihet në qetësi 2 h. Provohet përsëri menjësi i tretësirës, në rast nevoje shtohet edhe pak hidroksid kalciumi. Përzjeja lihet në qetësi 24 h, pastaj filtrohet. Filtrati asnjani shtohet me acid klorhidrik (p.); derisa të mos e ngjyrosë më metilin e kuq në ngjyrë trëndafili dhe metiloranzhin në të verdhë. Pastaj, shtohet në të ujë deri në dendësi  $1526 \text{ kg/m}^3$ . Me këtë mënyrë përfshohet tretësirë 50% kloruri kalciumi, e cila mund të përdoret pë eksperimentet laboratorike.

Për përfshimin e klorurit të kalciumit kristalhidrat, në 200 ml tretësirë 50% kloruri kalciumi hidhen 0,5 g qymyr aktiv; tretësira ngrohet në temperaturën  $90-100^\circ\text{C}$  dhe avullohet deri në dendësinë  $1370 \text{ kg/m}^3$ <sup>1)</sup>. Pastaj, filtrohet dhe lihet në qetësi dy ditë. Kristalet hidhen në hinkën përfshimtësuese shtohet 1-2 h, derisa gjatë copëtimit të copave të mëdha në copëza më të vogla të mos dallohen kristale të shndërtshme.


Preparati është me byllët në shishe me tapë hermetike, të parafinuar.

L.P.


<sup>1)</sup> Provat tregojnë se në pamundësi të matjes së dendësisë, mund të kufizohemi në avullimin e  $1\frac{1}{3}$  së vëllimit.

## 11.2.6. Nitrati i kalciumit


### a) nitrati i kalciumit anhidër



### b) nitrati i kalciumit kristalhidrat




Nitrati i kalciumit anhidër është substancë në ngjyrë të bardhë. Në temperaturë të lartë shpërbëhet, sipas barazimit:



Nitrati i kalciumit kristalhidrat formon kristale të tejdukshme, në formë prizmash që qullen në ajër. Reaktivi tretet shumë në ujë (54,8% kripë anhidër, në 18°C).

### 11.2.6.1. Gatitja e nitratit të kalciumit

Nitrati i kalciumit kristalhidrat mund të përftohet nga bashkëveprimi i nitratit të amonit me hidroksid kalciumi:




Në një kupshore porcelani hidhet tretësira e 110 g nitrat amoni (p.) në 200 ml ujë. Shtohen në të (në kapë) me porcione 40 g pluhur hidroksid kalciumi i përfshuar nga shuarja e 32 g oksidi kalciumi (teknik) në 35 ml ujë të nxehjtë.

Përzierja ngrohet në banjë uji, duke e trazuar (rrallë) dhe uji që avullon plotësohet, derisa të mos ndihet më era e dobët e amoniakut. Pasi imbaron reaksiuni, përzierja filtrohet dhe precipitati lahet me ujë. Filtrati, pasi të shtohet në të me pikë acid nitrik (p.) (me dendësi 1400 kg/m<sup>3</sup>), deri në reaksiun acid të dobët me lakmuesin, ngrohet në temperaturën 40-50°C dhe filtrohet. Filtrati avullohet (deri në vëllimin 200 ml) dhe pasi i shtohen disa kristale  $\text{Ca}(\text{NO}_3)_2 \cdot 4\text{H}_2\text{O}$  fitohet deri në temperaturën e mijedisit. Kristalet që bien, hidhen në hinkën përfiltrim në zbrazëti dhe pa i tharë futen në shishe me tapë të smeriluar.

Përftohen rreth 70 g kripë.

b) Nitrati i kalciumit kristalhidrat mund të përftohet, gjithashtu nga bashkëveprimi i karbonatit të kalciumit me acid nitrik:



Në tretësirën e 100 ml acid nitrik (p.), me dendësi 1400 kg/m<sup>3</sup>, në 30 ml ujë, hidhet me porcione të vogla karbonat kalciumi (që përmban sasi të vogla jonesh  $\text{SO}_4^{2-}$ ), deri në ndërprerjen e çlirimt të dioksudit të karbonit. Pastaj, shtohet hidroksid kalciumi (p.) derisa tretësira të ketë reaksiun bazik të fortë; përfprecipi-

## 13. Kallaji dhe përbërjet e tij

### 13.1. Kallaji

Sn	M = 118,69 g/mol t. shk. = 231,91°C	d = 7280 kg/m <sup>3</sup> t. vl. = 2720°C
----	--	---

Kallaji është metal shumë i butë, me ngjyrë të bardhë si argjendi. Formon kristale të sistemit tetragonal. Mbi temperaturën 160°C bëhet i ashpër, sepse shndërrrohet në kallajin rombik (formë altropike). Në temperaturë më të ulët se 13,5°C shndërrrohet në formën tjetër altropike në kallajin e hirtë. Po të lihet për një kohë të gjatë në të stohtë, metali e irit vëllimin dhe shndërrrohet në një pluhur të shkrifët me ngjyrë hiri («murtaja e kallajit») që përbëhet nga kristale të sistemit kubik. Kallaji, në kushte të zakonshme, është i qëndrueshëm ndaj veprimeve kimike. Në ajet humbet ngadalë shkëlqimin, por cipa e oksidit, që formohet në sipërsaqe, e mbron metalin nga oksidimi i mëtejshëm. Në ujë është i qëndrueshëm; tretet ngadalë në acide të holluara dhe shpejt në acide të përqendruara. Në tretësirat e nxehta të alkaleve tretet, duke çliruar hidrogjen.

### 13.2. Përbërjet e kallajit

#### 13.2.1. Kloruri i kallajit (II)

##### a] Kloruri i kallajit [II] anhidër

SnCl <sub>2</sub>	M = 189,60- g/mol t. shk. = 247°C	d = 3950 kg/m <sup>3</sup> t. vl. = 623°C
-------------------	--------------------------------------	--

##### b] Kloruri i kallajit [II] kristalhidrat


SnCl <sub>2</sub> · 2H <sub>2</sub> O	M = 225,63 g/mol	d = 2710 kg/m <sup>3</sup>
---------------------------------------	------------------	----------------------------

Kloruri i kallajit (II) anhidër formon kristale të sistemit rombik, pa ngjyrë, të tejdukshme, mjafë të qëndrueshme në ajër. Tretet në ujë, në alkool etilik, në eter dietilik dhe në propanon.

Kristalhidrati i klorurit të kallajit (II) formon kristale pa ngjyrë, në formë plakash ose gjilpërash. Tretet shumë mirë në ujë; tretet në alkool etilik. Në temperaturën  $37,7^{\circ}\text{C}$  reaktivi tretet në ujin e kristalizimit, kurse me ngrohje në temperaturë më të lartë çhidratohet.

### 13.2.1.1. Gatitja e klorurit të kallajit [II]

a) Kristalhidrati  $\text{SnCl}_2 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$  mund të përfshohet nga veprimi i kallajit me acidin klorhidrik:



Në një kupshtore porcelani<sup>1)</sup> hidhen 35 g kallaj i kokërruar; shtohen në 100 ml acid klorhidrik ( $d = 1140 \text{ kg/m}^3$ ) dhe përbajtja e kupshtores valohet deri në tretjen e plotë të metalit. Tretësira e përfshuar filtrohet dhe filtrati avullohet derisa prova e marrë nga lëngu, të kristalizojë me ftohje. Pastaj, tretësira ftohet me akull, hidhet në hnkë dhe kistalet ruhen në shishe me tapë të smeriluar.


Tretësia mëmë, me avullim dhe me kristalizim, jep një sasi tjetër kripe. Përfshohen rreth 50 g klorur kallaji (II) kristalhidrati.

b) Kloruri i kallajit (II) anhidër murd të gatitet nga kristalhidrati. Në një pjatë (ose kupshore) porcelani ngrohen 100 g  $\text{SnCl}_2 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$ . Kripa shkrihet në temperaturën rreth  $40^{\circ}\text{C}$ ; duke e përzier temperatura ngadalë rritet në  $120-125^{\circ}\text{C}$ . Gjatë ngrohjes lëngu dendësohet dhe shndërrohet në një masë në formë brumi dhe pastaj në kektrizë, të cilat duhet të thërrimohen periodikisht. Pastaj, temperatura ngrihet në  $130^{\circ}\text{C}$  dhe kripa ngrohet në këtë temperaturë deri në përfshimin produktit krejt të thatë. Kripa e përfshuar thërrimohet me shtypës dhe thatet në çollapin thatës në temperaturën  $130-135^{\circ}\text{C}$ , deri në një masë të qëndrueshme hidhet në shishe me tapë të smeriluar.

Përfshohen rreth 80 g klorur kallaji anhidër.

Sipas kësaj metodike, në qoftë se substanca nistore është e klasifikimit (p. p. a.), reaktivi i përfshuar përmban afro 99,6%  $\text{SnCl}_2$  dhe i përgjigjet klasifikimit (p. p. a.).

### 13.2.2. Oksidi i kallajit (II)




Oksidi i kallajit (II) është pluhur me ngjyrë të zezë, që nuk tretet në ujë dhe në tretësirat e alkaleve. Në acide tretet dhe formon kripëra të kallajit  $\text{Sn}^{2+}$ . Me ngrohje në ajër digjet duke formuar dioksidin e kallajit  $\text{SnO}_2$ .

---

Këshillohet që në kupshoren e porcelanit të vendoset një copë platini për të formuar çiftin galvanik, i cili shpejton shumë reaktionin.


### 13.2.2.1. Gatitja e oksidit të kallajit [II]

Oksidi i kallajit (II) mund të përftohet nga bashkëveprimi i kripërave të kallajit  $\text{Sn}^{2+}$  me karbonat natriumi:



Përzierja e 30 g  $\text{SnCl}_2 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$  dhe 37 g  $\text{Na}_2\text{CO}_3 \cdot 10\text{H}_2\text{O}$  shkrihet në një pote porcelani. Masa e shkrirë, pas ftohjes, lahet me ujë për të larguar klorurin e natriumit (përmë tretësirë nitrati argjendi), hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe lahet me alkool etilik dhe eter dietilik.




### 13.2.3. Oksidi i kallajit (IV)



Oksidi i kallajit (IV) është pluhur i bardhë, i patretshëm në ujë, në acide dhe në tretësirat e bazave. Në qoftë se shkrihet me bazat, formon kripëra të acidit staniq (stanate).

### 13.2.3.1. Gatitja e oksidit të kallajit (IV)

Oksidi i kallajit (IV)  $\text{SnO}_2$  mund të përftohet nga gëlqerizimi në ajër i oksidit të kallajit (II), sipas barazimeve të reaksioneve:



Në përzierjen e 80 ml ujë me 15 ml acid klorhidrijik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ) treten 50 g  $\text{SnCl}_2 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$  dhe filtrohen. Në filtrat hidhet me porcione të vogla hidroksid amoni  $\text{NH}_4\text{OH}$  ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ), deri në reaksiuni të dobët bazik ndaj laksosit (rreth 75 ml).

Precipitati i hidroksidit të kallajit (II) hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti; lahet 3 herë me ujë (me porcione nga 50 ml), kalohet në kupshore (ose pjatë) porcelani dhe thahet 5 h në temperaturën 50-60°C duke e përzier rriallë. Pastaj, masa e thatë gëlqerizohet 5-6 h në temperaturën 800-900°C.

Përftohen rreth 60 g oksid kallaji (IV).

### 13.2.4. Sulfati i kallajit (II)

$\text{SnSO}_4$        $M = 214,75 \text{ g/mol}$

Sulfati, i kallajit (II) formon gjilpëra pa ngjyrë ose fletë me shkëlqim. Ngrohje, mbi temperaturën  $360^\circ\text{C}$ , shpërbëhet duke çiruar anhidrid sulfurik. Tretet mirë në ujë ( $16,0\%$ , në  $20^\circ\text{C}$ ). Nga tretësira ujoje, dalëngadalë, veçohet precipitati i kripës bazike.

#### 13.2.4.1. Gatitja e sulfatit të kallajit (II)

Në  $120 \text{ g}$  kallaj të kokërrzuar shtohen  $65 \text{ ml}$  ujë dhe  $65 \text{ ml}$  acid sulfurik ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ). Përzierja e përstuar valohet disa orë, derisa të ndërpitet tretja e metalit (tretja e kallajit në acid sulfurik zgjat disa dhjetëra orë). Tretësira veçohet, kurse masa që mbetet, ngrohet me  $250 \text{ ml}$  ujë (për të tjerhequr  $\text{SnSO}_4$  që ka mbetur). Të dy porcionet e tretësirës filtrohen. Filtratet bashkohen dhe avullohen (më mirë hinkën në zbrazëti) deri në formimin e një mase të dendur. Pas ftohjes, kripa hidhet në përfiltrim në zbrazëti, lahet dy herë me alkool etilik (nga  $20-25 \text{ ml}$ ) dhe thahet.

Përftohet rreth  $130 \text{ g}$  sulfat kallaji (II).

# 14. Karboni dhe përbërjet e tij

## 14.1. Karboni

C

M = 12,01 g/mol

d = 1475 kg/m<sup>3</sup>

t. shk. = 4200°C

Qomyri i drurit i një cilësie të mirë ka në përbërjen e tij 87,5 – 91% C, 1,3 – 2% hi, 5 – 7% H<sub>2</sub>O, 1,8 – 2,5% H<sub>2</sub>, 1,5 – 6% O<sub>2</sub> (digjet pa tym dhe pa flakë). Temperatura e distilimit të tij është rreth 3600°C. Rëndësi të veçantë ka qomyri aktiv.

Qomyri aktiv është në formë kokrrizash të zeza dhe të imëta ose në formë pluhuri dhe dallohet për porozitet të madh. Sipërfaqja e 1 g qomyri aktiv është 400 – 1000 m<sup>2</sup>, prandaj ka aftësi të madhe ndajthihëse.

### 14.1.1. Gatitja e qomyrit aktiv

Qomyri i zakonshëm thërrmohet, sitet dhe gëlqerizohet me kujdes 1 h, në një pote bakri ose hekuri (për heqjen e substancave dyllore). Pastaj në 30 g qomyr shtohen 500 ml tretësirë acidi nitrik 4 N dhe lihet 1 h. Pas 1 dite, përzierja valohet 1 h dhe hidhet e nxehëtë në hinkën për filtrim në zbrazëti. Lahet me ujë, valohet përsëri 1 h në temperaturën 110°C dhe gëlqerizohet 30 min në një pote porcelani në 500-600°C.


Përpunimi me tretësirë acidi nitrik përsëritet si u tha më sipër dhe qomyri lahet me ujë. Pastaj, thahet në temperaturën 110°C dhe gëlqerizohet 1 h në një gyp porcelani, të ngrohur me rezistencë (në trajtë spiraleje) në temperaturën 600-800°C, duke i thithur gazet që çlironen në një pompë vaji<sup>1)</sup>. Pas ftohjes, në gyp futet ajër i thatë.

Qomyri aktiv i përfstuar ruhet në një shishe me tapë të smeriluar ose në eksikator me klorur kalciumi (ose me anhidrid fosforik).

) Në mungesë të pompës së vajit mund të përdoret pompa e ujit për zbrazëti.

## 14.2. Përbërjet e karbonit

### 14.2.1. Acidi etanoik (acidi acetik)



Acidi etanoik është lëng pa ngjyrë, më erë të fortë karakteristike. Me uljen e temperaturës shndërrohet në një masë kristalore me temperaturë shkrirjeje  $16,6^\circ\text{C}$  dhe me temperaturë valimi  $118^\circ\text{C}$ .

Përzihet me ujin, me alkoolin etilik dhe eterin dietilik.

Acidi etanoik është acid i dobët (konstantja e shpërbashkimit  $1,74 \cdot 10^{-5}$ , në  $25^\circ\text{C}$ ). Kur është i përqendruar, ngacmon mukozat dhe shkakton djegie të rënda në lëkurë; gjatë ngrohjes formon avuj që ndizen.

Në NPN në Elbasan nga distilimi i thatë i drurit prodhohet «acidi etanoik i drurit» (acid pirolignor). Ky produkt përmban acid etanoik (50%), propanon, metanol, katrane të ndryshme etj. Acidi pirolignor është lëng me ngjyrë të murre, me  $d = 1018 - 1030 \text{ kg/m}^3$ ; përzihet me ujin dhe alkoolin etilik.

#### 14.2.1.1. Pastrimi i acidit etanoik teknik

a) Acidi etanoik i klasifikimit (p.) mund të përftohet duke pastruar produkthin teknik.

Në një poç me fund të rrumbullt, me nxënësi  $1,5-2 \text{ l}$ , hidhet  $1 \text{ kg}$  acid etanoik (teknik),  $75 \text{ g}$  anhidrid etanoik ( $\text{CH}_3\text{COO})_2\text{O}$  (teknik) dhe  $0,5 \text{ g}$  karbonat natriumi anhidër.

Përzierja ngrohet deri në temperaturën  $40-50^\circ\text{C}$  dhe hidhen në të, me curril të hollë,  $5 \text{ ml}$  acid sulfurik (k.p.) me  $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ . Pas 15 min shtohen  $5 \text{ g}$  permanganat kaliumi i shtypur dhe përzierja trazohet me kujdes. Pastaj, poçi bashkohet me një shtyllë të lartë distilimi të mbushur me copa gypash qelqi dhe një ftohës. Acidi distilohet duke mbledhur thyesat me temperaturë të ngrirjes më të ulët se  $15,8^\circ\text{C}$  dhe me temperaturë të ngrirjes nga  $15,8-16,5^\circ\text{C}$  (temperaturat e ngrirjes përcaktohen nga provat e distilatit, të mbledhura herë pas here).

Për përcaktimin e temperaturës së ngrirjes një provëz me  $4-5 \text{ ml}$  acid etanoik vendoset në ujë me temperaturë  $0^\circ\text{C}$  dhe përzihet me termometër. Kur fillojnë të dalin kristalet, provëza liqet, sfera e termometrit vendoset në qendër të lëngut dhe përcaktohet temperatura.

b) Për pastrimin e acidit teknik nga përzierja se acidit klorhidrik, ai distilohet duke i shtuar një sasi të vogël etanoati natriumi  $\text{CH}_3\text{COONa}$  anhidër.

Në qoftë se acidi teknik përmban dioksid squfuri, atëherë në të hidhet pak dioksid plumbi, mbahet disa ditë duke e tundur rrallë dhe distilohet.

#### 14.2.1.2. Gatitja e acidit etanoik

Acidi etanoik mund të gatitet me këtë mënyrë:

Distilohet përzierja e  $100 \text{ g}$  etanoat natriumi anhidër me  $435 \text{ ml}$  acid sulfurik

$d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ). Në distilat hidhet 1 g  $\text{K}_2\text{Cr}_2\text{O}_7$  dhe 5 g  $\text{CH}_3\text{COONa}$  anhidër; tunden dhe lëngu që mbetet, distilohet përsëri.

Përftohen rrëth 60 g acid etanoik.

### 14.2.2. Amidoni i tretshëm

Amidoni i tretshëm është pluhur i bardhë, i tretshëm në ujë të ngrohtë.

#### a. Gatitja e amidonit të tretshëm

Në një gotë me nxënësi 1 l, hidhen 350 ml acid klorhidrik (p. p. a.) me dendësi  $1060 \text{ kg/m}^3$ . Duke e përzier me anë të përzierësit mekanik, hidhen në të më ngadalë 450-500 g amidon tregu. Temperatura e përzierjes nuk duhet të jetë më e lartë se  $25^\circ\text{C}$ . Në këto kushte prishet membrana e kokrrizave të amidonit. Amidoni tanë përpunohet me acid klorhidrik 10-12 h dhe provohet tretshmëria e tij (1 g amidon tretet në 100 ml ujë të distiluar, duhet të formohet tretësirë e tejdukshme). Pastaj amidoni lahet me dekantim me ujë të ftohtë, deri në reaksion asnjanës ndaj kongos së kuqe dhe thahet në temperaturë jo më të lartë se  $25^\circ\text{C}$  (në të kundërtën amidoni humbet aftësinë për t'u tretur).

Përftohen rrëth 400-500g amidon (në varësi të përbajtjes së lagështirës).

### 14.2.3. Oksidi i karbonit (II)

$\text{CO} \quad M = 28,01 \text{ g/mol}$


t. shk. =  $-205^\circ\text{C}$   
t. vl. =  $-192^\circ\text{C}$

Oksidi i karbonit (II) është gaz pa ngjyrë, pa erë dhe pa shije. Në kushte normale, 1 l peshon 1,2504 g. Tretet fare pak në ujë (në 1 vëllim ujë, në temperaturën  $0^\circ\text{C}$ , treten 0,03537 vëllime CO, kurse në  $25^\circ\text{C}$  0,02142 vëllime); tretet më mirë në alkool etilik e në alkool metilik, në acid etanoik, kloroform etj. Nuk e ndihmon djegien, digjet në ajër me flakë të kaltër dhe formon dioksid karboni.

Oksidi i karbonit (II) është substancë shumë helmuese.

#### 14.2.3.1. Gatitja e oksidit të karbonit [II]

Për të përfstuar oksidin e karbonit (II), ngrohet<sup>1)</sup> acidi metanoik (acidi formik) me acid sulfurik të përqendruar (ky i fundit vepron si çhidratues):




Në një poç të pajisur me një hinkë ndarëse dhe një gyp zhvillimi hidhen 100 ml acid sulfurik ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ).

1) Puna duhet të kryhet në kapë.

Përbajtja e poçit ngrohet deri në temperaturën  $100^{\circ}\text{C}$ ; pastaj, ndërpritet ngrohja dhe nga hinka ndarëse shtohen me pika 25-30 ml acid metanoik 85% (teknik). Shpejtësia e çlirimit të gazit rregullohet në varësi të shpejtësisë së hedhjes së acidit. Kur të ngadalësohet çliri i gazit, poçi ngrohet lehtë. Reaksiioni zhvillohet mjaft qetë, deri në fund.

b) Oksidi i karbonit (II) mund të përfshohet, gjithashtu, nga acidi etanoik (acid oksalik), por në këtë rast përmban si papastërti dioksid karboni:



Në një poç me fund të rrumbullt hidhen 270 ml acid sulfurik ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ) dhe 100 g acid oksalik  $\text{H}_2\text{C}_2\text{O}_4 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$ . Poçi ngrohet, derisa të fillojë çlirim i gazit. Pastaj ngrohja ndërpritet (reaksioni zhvillohet me vrull). Oksidi i karbonit (II) që çlirohet, përmban dioksid karboni, ajër dhe lagështirë. Për ta pastruar nga  $\text{CO}_2$  gurgullohet në dy shishe larëse me tretësirë hidroksidi kaliumi 30% dhe kaliumi të ngurtë.

Oksigjeni i ajrit mund të largohet duke e gurgulluar gazin në tretësirën e  $\text{Na}_2\text{S}_2\text{O}_4$ . Kurse, për t'u tharë gurgullohet në klorur kalciumi të gëlqerizuar ose në acid sulfurik të përqendruar e pastaj në anhidrid fosforik.


#### 14.2.4. Oksidi i karbonit (IV) (dioksidi i karbonit)

$\text{CO}_2$	$M = 44,01 \text{ g/mol}$	$d = 1560 \text{ kg/m}^3$
t. shk. = $-56,6^{\circ}\text{C}$		t. vl. = $-78^{\circ}\text{C}$

Oksidi i karbonit (IV) është gaz pa ngjyrë, pa eë, me shije pak të thartë. Në kushte normale; 1 l peshon 1,976 g. Oksidi i karbonit (IV) tretet mjaft mirë në ujë ( $0,878 / \text{CO}_2$ , në 1 l ujë në  $20^{\circ}\text{C}$ ) duke formuar acidin karbonik  $\text{H}_2\text{CO}_3$ , (3 vëllime  $\text{CO}_2$  në 1 vëllim alkool, në  $20^{\circ}\text{C}$ ).

##### 14.2.4.1. Gatitja e oksidit të karbonit [IV]

Metoda më e njobur e përfshimit të  $\text{CO}_2$  bazohet në veprimin e acidit klorhidrik me karbonatin e kalciumit:



Reaksiioni është mirë të kryhet në aparatin e Kippit. Në sferën e mesme të aparatit vendosen copa mermeri me përimasa 2-3 cm dhe me anë të sferës së sipërme hidhet acid klorhidrik i holluar (1:1). Gazi që çlirohet, gurgullohet në një shishe me ujë dhe në një shishe me acid sulfurik të përqendruar (për ta pastruar nga gjurmët e klorurit të hidrogjenit dhe për tharje).

Në qoftë se duhet të përfshohet dioksid karboni krejtësisht i çliruar nga ari, atëherë copat e mermerit valohen disa orë me ujë dhe ashtu ende të lagështa hidhen në aparatin e Kippit. Gjurmët e fundit të oksigjenit largohen duke e kaluar gazin në një gyp për djegie që ka në brendësi të tij një spirale bakri të skuqur (shih gatitja e azotit).

### I5. Klori dhe përbërjet e tij

### 15.1. Klori

Klori është gaz me ngjyrë të gjelbër në të verdhë, me erë mbytëse; në kushtet normale, 1 l klor peshon 3,214 g. Tretet në ujë (në 100 ml ujë, në temperaturën 20°C, treten 0,7291 g klor), prandaj duhet të mblidhet në tretësirë të ngopur kloruri natriumi, në ujë të ngrohtë ose në acid sulfurik të përqendruar. Uji që tret klor, ngjyroset në ngjyrë të gjelbër dhe ka erën e klorit (quhet ujë klori). Klori është i tretshëm në tetraklorur karboni dhe në acid klorhidrik të përqendruar (në 1 l acid klorhidrik, me  $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ , treten 7,3 g klor).

Klori është substance helmuese. Frymëmarrja në mjeshtë me klor shkakton një kollë mytëse dhe në sasi të mëdha kollë me gjak.

### 15.1.1. Gatitja e klorit


a) Një nga mënyrat më të vjetra të përfshimit të klorit është oksidimi i acidit klorhidrik me oksid mangani (IV):



Në një poc, me nxënësi 500 ml, hidhen 50 g dioksid mangani  $MnO_2$  (teknik), në copa me diametër 10-15 mm. Poçi mbylljet me një tapë me hinkë ndarëse. Me anë të hinkës ndarëse hidhen në të 250 ml acid klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ) dhe ngrohet, në fillim me kujdes e pastaj më fort. Klori i gaztë që përftohet, për tu pastruar nga piklat e acidit, gurgullohet në një shishe me ujë.


1) Puna duhet të kryhet në kapë.

b) Klori mund tē pērftohet edhe nga oksidimi me dioksid mangani i pērzierjes sē klorurit tē natrīumit me acid sulfurik (kjo pērzierje zēvendëson acidin klorhidrik):




Në një poç, me nxënësi 500 ml, hidhen 6 pjesë nē masë dioksid mangani dhe 3 pjesë nē masë klorur natriumi. Shtohen në tē 20 pjesë nē masë acid sulfurik i holluar (1:1) dhe i ngrohtë. Në fund tē reaksionit, pērzierja eshtë mirë tē ngrohet, klori që çlirohet, eshtë pothaujse pa ujë, por pērmban një farë sasie kloruri hidrogjeni.

c) Metoda më e pērshtatshme laboratorike pēr pērstimin e klorit eshtë oksidimi i acidit klorhidrik me permanganat kaliumi:



Në një poç me dy gryka hidhen 10 g permanganat kaliumi. Me anë tē hinkës ndarëse shtohen në tē me pika 60-65 ml acid klorhidrik ( $d = 1170 \text{ kg/m}^3$ ); çlirohet një rrymë e njëtrajtshme klori.

d) Klori mund tē pērftohet edhe nga oksidimi i acidit klorhidrik me dikromat kaliumi:



Në një banjë uji ngrohen 90-100 g dikromat kaliumi i thërmuar imët me 500 ml acid klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ). Klori i gaztë që çlirohet, mund tē pērbajë; klorur hidrogjeni, sasi tē vogla oksidi klori, ajër dhe avuj uji. Pēr t'u pasruar nga kloruri i hidrogjenit, klori gurgullohet nē dy shishe me ujë, pastaj nē një shishe me acid klorhidrik tē pērqendruar; kurse pēr shpërbërjen e oksidit tē klorit, kalohet nē një gyp tē skuqur (me gjatësi 30 cm) tē mbushur me asbest. Klori i pastruar gurgullohet nē një gyp nē formë U-je, që ftohet nē një pērzierje akulli me kripë, dhe sē fundi, thahet nē klorur kalciumi tē gëlqerizuar ose nē anhidrid fosforik.

## 15.2. Pērbërjet e klorit

### 15.2.1. Kloruri i hidrogjenit

HCl	$M = 36,46 \text{ g/mol}$	$d = 1276 \text{ kg/m}^3$ (në $113^\circ\text{C}$ )
t. shk. = -114,2°C	t. vl. = -85,1°C	

Kloruri i hidrogjenit eshtë gaz pa ngjyrë, me erë tē fortë mbytëse. Në kushte normale, 11 klorur hidrogjeni peshon 1,639 g. Në ajër me lagështirë, formon pikla tē imëta acidi klorhidrik, nē formë mjegulle. Tretet shumë mirë nē ujë (45%, nē 0°C) dhe çliron nxehësi; tretet nē alkool etilik, nē benzen dhe nē eter dietilik (35%, nē 0°C). Tretësira ujore e klorurit tē hidrogjenit ka veti acide dhe quhet acid klorhidrik.

Acidi klorhidrik i pastër është pa ngjyrë dhe, kur është i përqendruar, tymon në ajër (çliron klorur hidrogjeni të gaztë). Në qoftë se acidi është shumë i holluar, çliron avuj uji dhe përqendrimi i tij rritet. Në të dy rastet, kur përbajtja e klorurit të hidrogjenit në acid arrin 20,3% (në 101 kPa), distilon tretësira me përbërje konstante.

Acidi klorhidrik i përqendruar, zakonisht e ka dendësinë  $1190 \text{ kg/m}^3$ ; kjo dendësi i përgjigjet përbajtjes 37% të klorurit të hidrogjenit<sup>1)</sup>. Acidi klorhidrik shkakton djegie të lëkurës, kurse avujt e tij ngacmojnë rrugët e frysma marrjes.

Ruhet në shishe me tapë të smeriluar (nuk duhet të përdoren tapa gome), ose në enë polieteni.


Acidi klorhidrik që prodhohet në Uzinën e Sodë-PVC-së në Vlorë është lëng me ngjyrë të verdhë, me erë ngacmuese dhe me veçoritë fiziko-kimike që jepen në tabelën 15.1.

Tabela 15.1

Treguesit	Norma në përqindje
acid klorhidrik (HCl)	jo më pak se 39
hekur (Fe)	jo më shumë se 0,01
sulfate ( $\text{SO}_4^{2-}$ )	jo më shumë se 0,07
arsenik (As)	jo më shumë se 0,00002
klor ( $\text{Cl}_2$ )	mungon

### 15.2.1.1. Gatitja e klorurit të hidrogjenit

a) Kloruri i hidrogjenit mund të gatitet nga veprimi i acidit sulfurik me klorurin e natriumit:



Në një poç distiliimi hidhen 25 pjesë në masë klorur natriumi dhe përzierja e 45 pjesëve në masë acid sulfurik ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ) me 10 pjesë në masë ujë. Gazi që çlirohet, gurgullohet (lahet) në acid sulfurik të përqendruar.

b) Një shishe e madhe grykëgjerë mbushet deri në  $1/3$  e vëllimit me klorur natriumi. Shtohet në të acid klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ), në mënyrë të tillë që nivel i tij të arrijë 5 cm mbi shtresën e kripës (kur përdoret acid klorhidrik teknik, për të shmangur çlirimin e mundshëm të klokit, këshillohet të shtohet në të pak  $\text{FeSO}_4$ ). Në përzierjen e përfstuar hidhet, me porcione të vogla, me anë të hindës ndarëse acid sulfurik ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ). Kloruri i hidrogjenit që çlirohet, përtu tharë, gurgullohet në acid sulfurik të përqendruar.

1) Ka një mënyrë empirike për të përcaktuar me afersi përbajtjen në përqindje të klorurit të hidrogjenit në acid, sipas dendësisë: numri i dytë dho i tretë në vlerat e dendësisë, po të shumëzohet me 2, jep përqendrimin në përqindje të acidit. Për shembull, në acidin me dendësi  $1190 \text{ kg/m}^3$  përbajtja e klorurit të hidrogjenit është  $19 \cdot 2 = 38\%$ .

### 15.2.1.2. Pastrimi i acidit klorhidrik teknik

a) Acidi klorhidrik teknik mund të pastrohet nga të gjitha papastërtitë (përveç arsenikut) duke e distiluar në aparatin e paraqitur në figurën 15.1 (storta (lëfytja) mund të zëvendësohet me një poç distilimi). Në shishen e ftohur (pritesin) hidhet pak ujë i distiluar. Kur ngrohet acidi në banjë rërë, në fillim çlirohet klorur hid.




Fig. 15.1. Distilimi i acidit klorhidrik teknik

rogjeni, i cili tretet në ujë; pastaj fillon të distilojë përzierja azeotropike, që përmban 20% klorur hidrogjeni. Distilimi mbaron kur në stortë mbetet 10% e vëllimit fillestari të acidit të marrë.

b) Sasi të vogla acidi klorhidrik më të pastër mund të përfshohen me metodën e distilimit izotermik. Në fundin e një eksikatori hidhen 500 ml acid klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ), kurse në pjatën e porcelanit me vrima vendoset një pjatë polieteni me 50 ml ujë të distiluar. Eksikatori myllitet me kapak dhe lihet 3-4 ditë, përfshohet acid klorhidrik me  $C \approx 10 \text{ N}$ , i papastërtisë më të lartë.

# 16. Kromi dhe përbërjet e tij

## 16.1. K r o m i

Cr	M = 52,00 g/mol t. shk. = 1875°C	d = 716 kg/m <sup>3</sup> t. vl. = 2570°C
----	-------------------------------------	--

Kromi është metal me ngjyrë të bardhë në hiri (i shndritshëm); ka strukturë kristalore, përbëhet nga romboedra mikroskopikë. Në ajet oksidohet shumë ngadalë. Me ngrohje vpron me acidin klorhidrik dhe me acidin sulfurik, kurse me acidin nitrik nuk vpron edhe kur ky është i nxeh të dëri i përqendruar; aciditit kromit është i «pasivizon» kromin.

### 16.1.1. Gatitja e kromit

Kromi mund të përfshohet me reduktim aluminotermik të oksideve të tij:




Përzierja e 60 g Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>, 12 g CrO<sub>3</sub> (të thatë e të thërrmuar) dhe 27 g pluhur alumini hidhet në një pote, që i ka muri e brendshme të lyera me oksid magnezi. Potja futet në një arkë me rërë dhe përzierja ndizet me anë të një ndezësi të përgatitur nga 20 koka shkrepse dhe një shirit magnezi. (Kujdes! Përdoren syze mbrojtëse.)

Pasi mbaron reaksiuni i vrullshëm, potja shtohet, thyhet dhe korja e kromit pastrohet nga mbeturinat (skorjet).

## 16.2. Përbërjet e kromit

### 16.2.1. Hidroksidi i kromit (III)




Hidroksidi i kromit (III) është pluhur amorf me ngjyrë të gjelbër ose hiri në të kaltër. Zakonisht, produkti i përfshuar është i hidratuar dhe i përgjigjet formulës  $\text{Cr(OH)}_3 \cdot n\text{H}_2\text{O}$  me  $n = 2-4$ . Po të mbahet në acid sulfurik të përqendruar, kalon në dihidrat  $\text{Cr(OH)}_3 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$  dhe, pas tharjes në  $100^\circ\text{C}$ , në  $\text{Cr(OH)}_3$  anhidër. Mbi  $100^\circ\text{C}$  shpërbëhet në  $\text{Cr}_2\text{O}_3$  dhe  $\text{H}_2\text{O}$ , më pas kalitet, merr ngjyrë të gjelbër dhe humbet aftësinë për t'u tretur në acide. Është i patretshëm në ujë (PT =  $6,3 \cdot 10^{-31}$ ); tretet në tretësirat e alkaleve dhe formon kromate. Pra, ka veti amfotere, sillet si bazë dhe si acid shumë i dobët ( $\text{HCrO}_2$ ).

#### 16.2.1.1. Gatitja e hidroksidit të kromit [III]

Hidroksidi i kromit (III) mund të gatitet me një nga mënyrat e mëposhtme:


a) Nga bashkëveprimi i një kripe të kromit (III) me ujë amoniakor:



Në tretësirën e  $6,7 \text{ g Cr(NO}_3)_3 \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  në  $500 \text{ ml ujë}$ , hidhen duke e trazuar fort (me përzierës mekanik)  $250 \text{ ml}$  tretësirë  $0,1 \text{ N NH}_4\text{OH}$ . Substanca bashkëvepruese përzihen edhe  $2 \text{ h}$ , derisa precipitati i  $\text{Cr(OH)}_3$ , tretet. Pastaj, shtohen në të, ngadalë edhe  $250 \text{ ml NH}_4\text{OH}$   $0,1 \text{ N}$ . Precipitati i  $\text{Cr(OH)}_3$  që bie, lahet me pak ujë, përlargimin e joneve nitrat  $\text{NO}_3^-$  (prova me difen laçinë) dhe thahet në temperaturën deri  $100^\circ\text{C}$ .

Përfshohen rrëth  $2 \text{ g hidroksid kromi (III)}$ .

b) Nga reduktimi i dikromatit të natriumit me metanal (aldehid formike) dhe precipitimi<sup>1)</sup> i klorurit të kromit (III):



Në  $270-300 \text{ ml ujë}$  treten  $100 \text{ g Na}_2\text{Cr}_2\text{O}_7$ <sup>2)</sup> dhe tretësira filtrohet. Filtrati ngrohet në kupshore porcelani (në kapë) deri në  $60^\circ\text{C}$  dhe hidhen në të  $100 \text{ ml}$  acid klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ). Pasi të përzihet, shtohet me porcione të vogla

1) Precipitimi bëhet me ujë amoniakor.

2) Dikromati i natriumit duhet të përbajë jo më pak se  $90\% \text{ Na}_2\text{Cr}_2\text{O}_7$ , dhe jo më shumë se  $1\% \text{ Na}_2\text{SO}_4$ . Në qoftë se nuk i përgjigjet këtyre kërkesave, gatitet tretësira e  $\text{Na}_2\text{Cr}_2\text{O}_7$ , e ngrohet në temperaturën  $15-20^\circ\text{C}$ . Në tretësirën e ngrohtë, mbetet një pjesë e kripës e patretur, kështu që pothuaj e gjithë  $\text{Na}_2\text{SO}_4$  kalon në precipitat. Në  $160 \text{ g}$  të kësaj tretësira shtohen  $240 \text{ ml ujë}$ .

përzierja e 50 ml tretësirë 32-35% metanali me 60 ml acid klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ).

Reaksioni i eduktimit zhvillohet me virull dhe, po të shtohet metanali shpejt, lëngu mund të spërkatë. Gjatë zhvillimit të reaksionit, ngjyra kafe e tretësirës bëhet e kaltërt në të gjelbër të errët.

Shënim. Për të përcaktuar nëse reduktimi është i plotë, merren disa mililitra tretësirë dhe ngrohen. Shtohet në të  $\text{NH}_4\text{OH}$  deri në erë të dobët amoniaku<sup>1)</sup>, ngrohet deri në valim dhe lihet që të precipitojë  $\text{Cr(OH)}_3$ . Në qoftë se tretësira mbi precipitat nuk ka ngjyri të veidhë, reduktimi ka mbaruar.

Tretësira reaguese hollohet me 200 ml ujë, ngrohet deri në valim dhe shtohet në të me porcione të vogla  $\text{NH}_4\text{OH}$  ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ), deri në erë të dobët amoniaku (rreth 190 ml). Kur kemi precipitim të plotë, tretësira mbi  $\text{Cr(OH)}_3$  e fundërruar, duhet të ketë ngjyrë vjollcë të zbehtë. Në qoftë se tretësira përfshohet në formë paste, duhet që t'i shtohet edhe një sasi tjetër  $\text{NH}_4\text{OH}$ .


Precipitati lahet mbi letrën filtruese (ose në filter bezëje) disa herë me ujë të ngrohtë. Pastaj hidhet në një shishe me nxënësi 2-3 l, lahet shumë herë me ujë (duke e tundur dhe përzier) dhe sifonohet. Gjatë larjeve të paia, rekomandohet që të shtohen në ujë 10-15 ml  $\text{NH}_4\text{OH}$  për secilën larje.

Precipitati, pasi të jetë larë 10-15 herë, hidhet në një kupshore porcelani dhe lahet disa herë me dekantim (duke e ngrohur deri në valim). Mbaitimi i larjes provohet në këtë mënyrë: në provën e precipitatit hidhet acid nitrik dhe tretësirë nitrati argjendi. Në qoftë se nuk shfaqet turbullirë ( $\text{AgCl} \downarrow$ ), produkti ka pastërti të mjaftueshme. Precipitati i larë filtrohet në letër filtruese dhe lihet që të rrjedhin ujërat e larjes. Pastaj (precipitati i lagësht) thahet në kupshore porcelani (më mirë qelqi) në 40-60°C, duke e përzier shpesh. Produkti i thatë therrmohet në havan dhe sitet (hidroksidi i kromit i thatë piuhuroset mirë).


Hidrati i përfshuar i përgjigjet formulës  $\text{Cr(OH)}_3 \cdot n\text{H}_2\text{O}$  ( $n = 2-4$ ). Përfshohen rreth 100 g hidroksid kromi (III).

### 16.2.2. Kloruri i kromit (II)

#### a) Kloruri i kromit (II) anhidër



#### b) Kloruri i kromit (II) kristalhidrat




Kloruri i kromit (II) anhidër formon gjilpëra të shndritshme. Tretet në ujë dhe tretësira ka ngjyrë të kaltër (kur ujti paraprakisht i largohet oksigjeni i tretur). Në ajër, tretësira ngjyroset në ngjyrë të gjelbër (veçori për përbërjet e  $\text{Cr}^{3+}$ );

1) Në qoftë se  $\text{NH}_4\text{OH}$  merr me tepricë,  $\text{Cr(OH)}_3$  tretet pjesërisht dhe jep tretësirë ngjyrë vjollcë.

Kloruri i kromit (II) oksidohet nga oksigjeni i ajrit, në klorur kromi (III). Hidrati  $\text{CrCl}_2 \cdot 4\text{H}_2\text{O}$  formon kristale të tejdukshme me ngjyrë të kaltër, që oksidohen lehtë në tepricë oksigjeni.

### 16.2.2.1. Gatitja e klorurit të kromit [II]


Kloruri i kromit (II) kristalhidrat mund të përfshihet nga bashkëveprimi i etanoatisë të kromit (II) me acid klorhidrik:



Etanoati i kromit (II) tretet në një sasi të njëjtë acidi klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ); tretësira ftohet në temperaturën  $0^\circ\text{C}$  dhe shtohen në të 1,5 vëllime acid klorhidrik (ose tretësira ngopet me klorur hidrogjeni të pastër, pa oksigjen).

Kristalet e  $\text{CrCl}_2 \cdot 4\text{H}_2\text{O}$  që bien, filtrohen dhe thahen në mjeshtë azoti të pastër.


Tretësira e klorurit të kromit (II) mund të gatitet duke reduktuar klorurin e kromit (III) me zink të kokërrzuar;




Në një enë me tretësirë kloruri kromi (III) të acidifikuar shumë me acid klorhidrik, hidhen disa kokërrza zinku. Ena, pasi të mbylljet, tundet (jo fort), deri në shfaqjen e ngjyrës së kaltër të pastër. Meqë tretësira oksidohet shpejt, duhet ruajtur nën një shtresë të hollë benzine. (Megjithatë, edhe kështu tretësira nuk mund të ruhet për një kohë të gjatë).

### 16.2.3. Kloruri i kromit (III)

#### a) Kloruri i kromit (III) anhidër



#### b) Kloruri i kromit (III) kristalhidrat



Kloruri i kromit (III) anhidër formon fletë shumë të shndritshme të sistemit hekzagonal, me ngjyrë vjollcë. Është pothuajse i patretshëm në ujë. Me valim formon tretësirë të gjelbër. Po të gëlqerizohet në ajër, shndërrrohet në  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ . Me një rrymë  $\text{H}_2$ , në temperaturën  $415^\circ\text{C}$ , reduktohet në  $\text{CrCl}_2$ .

Kloruri i kromit kristalhidrat njihet në katër forma alotropike:

Forma e gjelbër e errët formon kristale me ngjyrë të gjelbër smeraldi, të sistemit rombik ( $d = 1585 \text{ kg/m}^3$ , t. shk. =  $83^\circ\text{C}$ ). Hidrati është i tretshëm në ujë (tretësira ka ngjyrë të kaltër në të gjelbër) dhe në propanon, kurse në acid klorhidrik të përqendruar është i patretshëm.

Forma e gjelbër e zbehtë formon kristale higroskopikë me  $d = 1760 \text{ kg/m}^3$  (në  $25^\circ\text{C}$ ). Reaktivi tretet mirë në ujë; tretet pak në alkool etilik dhe eshtë i patretshëm në propanon, në eter dietilik dhe në acid klorhidrik të përqendruar.

Forma vjollcë, ose vjollcë në hirë, eshtë pluhur kristalor mjaft higroskopik, i sistemit monoklin ( $d = 2760 \text{ kg/m}^3$ , t.shk.  $95^\circ\text{C}$ ). Eshtë i patretshëm në propanon; tretet mirë në ujë (28,1 % kripë anhidër, në  $25^\circ\text{C}$ ), formon një tretësirë me ngjyrë të zbehtë (vjollcë në të gjelbër).

#### 16.2.3.1. Gatitja e klorurit të kromit (III) të hidratuar

Forma e gjelbër e errët mund të përfshohet në këtë mënyrë:

Në acid klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ) tretet hidroksidi i kromit<sup>1)</sup> (III); për 100 g  $\text{Cr}_2\text{O}_3$  që ndodhen në të (në pastë), merren 350 ml acid. Tretësira lihet disa orë dhe pastaj thithet nëpër një beze, në hinkën përfiltrim në zbrazëti. Filtrati avullohet në banjë uji, deri në  $1/3$  e vëllimit (lëngu duhet të bëhet si shurup) dhe hidhet në një enë qelqi të ftohur me akull. Gurgullohet në të (në kapë) klorur hidrogjeni, i tharë paraprakisht në  $\text{H}_2\text{SO}_4$  të përqendruar dhe  $\text{CaCl}_2$  të gëlqerizuar.

Gypi i nxjerrjes së gazit duhet të mbaroje me një zgjerim në formë hinke, përfthyer nga kistalet e  $\text{CrCl}_3$  që dalin. Ngopja vazhdon, derisa tretësira të bëhet mjaft e përqendruar nga kistalet që bien.

Përzierja lihet 24 h (duke e ftohur me akull) që të mbaroje kristalizimi. Kistalet hidhen me kujdes në hinkën përfiltrim në zbrazëti dhe, pasi thahen në  $30-40^\circ\text{C}^2)$ , ruhen në shishe me tapë të smeriluar. Përfshohen rreth 350 g klorur kromi (III) (nga 100 g  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ).


#### 16.2.4. Nitrati i kromit (III)



Nitrati i kromit (III) kristalhidrat formon kristale me ngjyrë vjollcë. Tretet shumë mirë në ujë dhe në alkool etilik. Në temperaturë rreth  $125,5^\circ\text{C}$  shpërbëhet.

#### 16.2.4.1. Gatitja e nitratit të kromit (III)

Nitrati i kromit (III) mund të përfshohet me një nga mënyrat e mëposhtme:  
a) Nga vepriimi i hidroksidit të kromit (III) me acid nitrik:



Në një kupshore porcelani përzihen 100 g  $\text{Cr}(\text{OH})_3$ <sup>3)</sup> më 280 ml  $\text{HNO}_3$  ( $d = 1400 \text{ kg/m}^3$ ). Tretësira e përfshohet; filtrati avullohet në banjë uji në  $50-60^\circ\text{C}$  deri në  $d = 1400 \text{ kg/m}^3$ <sup>4)</sup>. Shtohen në të 50 ml  $\text{HNO}_3$  ( $d = 1400 \text{ kg/m}^3$ )

1) Shih paragrafin 16.2.1.1.

2) Provat tregojnë se në një temperaturë më të lartë kistalet qullen.

3) Shih paragrafin 16.2.1.1.

4) Në pamundësi përmes matjenës dendësisë mund të mjaftohemi edhe me shfaqjen e cipës kristalore.

dhe lihet 24 h të kristalizojë, në temperaturë nën 0°C. Në qoftë se nuk kristalizon, shtohen edhe 20-30 ml HNO<sub>3</sub> dhe një kristal Cr(NO<sub>3</sub>)<sub>3</sub> · 9H<sub>2</sub>O.

Lëngu derdhet, kistalet hidhen në hinkën përfiltrim në zbrazëti, thahen në ajër deri në zhdukjen e erës së HNO<sub>3</sub> dhe hidhen në shishe me tapë smerile.

Tretësira mëmë avullohet përsëri, shtohen në të 10-20 ml HNO<sub>3</sub> (d = 1400 kg/m<sup>3</sup>) dhe ftohet.


Përfstohen 370-400 g nitrat kromi (III).

b) Nga veprimi i oksidit të kromit (III) me acid nitrik.

Në 100 g CrO<sub>3</sub> hidhen 200 ml HNO<sub>3</sub> (d = 1300-1400 kg/m<sup>3</sup>). Shtohet në të me kujdes sheqer ose niseshte, derisa të marrë ngjyrë të verdhë të qëndrueshme të oksideve të azotit.

Tretësira ftohet; i shtohet acid nitrik (120-140 ml, në 1 l tretësirë) dhe lihet 24 h të kristalizojë. Kistalet e Cr(NO<sub>3</sub>)<sub>3</sub> · 9H<sub>2</sub>O që bien, hidhen në hinkën përfiltrim në zbrazëti<sup>1)</sup> dhe thahen me rrymë ajri të thatë, në temperaturë jo më të lartë se 36°C.

### 16.2.5. Oksidi i kromit (III)




Oksidi i kromit (III) është pluhur amorf kristalor, me ngjyrë të gjelbër të errët. Është i patretshëm në acide dhe në tretësirat e alkaleve. Nuk ka veti magnetike.

#### 16.2.5.1. Gatinja e oksidit të kromit (III)


Oksidi i kromit (III) mund të përfstohet me një nga mënyrat e mëposhtme:

a) Nga shpërbërja e dikromatit të amonit:



Në një kupshore të madhe porcelani hidhet (NH<sub>4</sub>)<sub>2</sub>Cr<sub>2</sub>O<sub>7</sub> (rreth 50 g) i thërrmuar imët. Shtohen në të disa pika alkool etilik dhe ndizet; ndodh një reaksiون i vrullshëm (që të jep përshtypjen e shpërthimit të një vullkani).

b) Nga reduktimi i dikromatit të kaliumit me një karbohidrat (për shembull me sheqer):



Përzihen me kujdes 100 g K<sub>2</sub>Cr<sub>2</sub>O<sub>7</sub>, i thërrmuar imët me 16 g sheqer pudër. Përzierja vendoset në një fletë hekuri (në kapë); shtohen në të disa pika alkool metilik dhe ndizet me kujdes. Ndodh një reaksiون i vrullshëm reduktimi. Me imbarimin e reaksiонit, masa qullet me ujë (duke i shtuar edhe pak CH<sub>3</sub>COOH) dhe lahet, derisa ujërat larëse të marrin një ngjyrë të verdhë të zbehtë.

Pas larjes thahet në temperaturën 120°C dhe thërrmohet.

Përfstohen rreth 50 g oksid kromi (III).

1) Provat tregojnë se ky veprim mund të bëhet edhe me hinkë të zakonshme.

## 16.2.6. Oksidi i kromit (VI)

$$\text{CrO}_3 \quad M = 99,99 \text{ g/mol} \quad d = 2700 \text{ kg/m}^3 \\ t. \text{ shk.} = 196^\circ\text{C}$$

Oksidi i kromit (VI) formon kristale me ngjyrë të kuqe të errët, të sistemit rombik, që qullen në ajër. Reaktivi tretet shumë mirë në ujë (62,8%, në 20°C) dhe formon tretësirën e acidit kromik  $\text{H}_2\text{CrO}_4$ . Me ngrohje nxihet, në 196°C shkrin (leng i kuq i murrmë) dhe në 350°C shpërbëhet në oksigjen dhe oksid kromi (III).

Oksidi i kromit (VI) është oksidues shumë i fortë, mund të shkaktojë flakërimin e letrës e të alkoolit.

### 16.2.6.1. Gatitja e oksidit të kromit (VI)

Oksidi i kromit (VI) mund të përfshohet nga bashkëveprimi i tretësirës së dikromatit të kaliumit me acid sulfurik të përqendruar.

Në tretësirën e 150 g  $\text{K}_2\text{Cr}_2\text{O}_7$ , në 250 ml ujë të ngrohur deri në 75°C, shtohen duke e përzier (me kujdes) 210 ml  $\text{H}_2\text{SO}_4$  ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ). Gjatë reaksionit përzierja nxehet shumë dhe me ftohjen e saj bien kristalet e  $\text{KHSO}_4$ . Pas 6-8 h tretësira veçohet nga kristalet, ngrohet në banjë uji deri në 60-90°C dhe duke e përzier shtohen në të edhe 75 ml  $\text{H}_2\text{SO}_4$  ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ). Kristalet e imëta që bien të  $\text{CrO}_3$ , treten në një sasi shumë të vogël uji. Tretësira avullohet deri në formimin e një cipe të trashë kristaloje dhe pastaj ftohet ngadalë. Kristalet e mëdha të  $\text{CrO}_3$  që formohen, hidhen në hinkë porcelani (pa letër filtruese), kurse tretësira e turbullt avullohet përsëri deri në formimin e cipës kristalore dhe kristalizohet.<sup>1)</sup>


Pë largimin e papastërtive të  $\text{H}_2\text{SO}_4$ , kristalet e  $\text{CrO}_3$  (pa i larë) hidhen në shishe me tapë të smeriluar dhe në të hidhet acid nitrik i klasifikimit (p. p. a.) me  $d = 1400 \text{ kg/m}^3$ , në mënyrë që lëngu të mbulojë plotësisht kristalet. Përzierja tundet herë pas here. Pas 10-12 h acidi derdhet; hidhet një sasi e freskët acidi nitrik dhe përsëritet larja, si më lart. Bëhen gjithsej 3 larje. Pastaj kristalet kaloheu në hinkën për filtrim në zbrazëti (pa përdorur letër filtruese), lahen 3 herë dhe thanhen (në kapë) në kupshore të vendosur në banjë rëre në temperaturën 60-100°C, duke i përzier shpesh dhe veçanërisht në fund të tharjes. Kur ndërpitet veçimi i avujve të  $\text{HNO}_3$ , masa e  $\text{CrO}_3$  bëhet pluhur (i thatë). Tharja vazhdohet në termostat në 100°C dhe pas tharjes reaktivi ftohet në eksikator (mbi acid sulfurik të përendruar).

Përfshohen rrëth 55 g oksid kromi (VI).

Sipas kësaj metode përfshohet reaktiv i klasifikimit (p. p. a.).

1) Tretësira mëmë pas kr istalizimit të dytë është e përshtatshme të përdoret si përzierje kromike.


## 16.2.7. Sulfati i kromit (III)



Sulfati i kromit (III) formon kristale të imëta të sistemit kubik, me ngjyrë vjollcë. Është i tretshëm në ujë; me ngrohje deri në temperaturën  $70^\circ\text{C}$  ngjyra vjollcë e tretësirës kthehet në të gjelbër. Është i patretshëm në alkool etilik. Preparati i tharë në  $100^\circ\text{C}$  përmban 5-6 molekula ujë.

### 16.2.7.1. Gatitja e sulfatit të kromit (III)

Sulfati i kromit (III) mund të përftohet nga bashkëveplimi i hidroksidit të kromit (III) me acid sulfurik:



Në një kupshore porcelani me nxënësi 1 l (ose 500 ml) hidhet hidroksidi i kromit (III) dhe shtohen në të ngadalë 210 ml acid sulfurik ( $d = 1610 \text{ kg/m}^3$ ), duke pastaj filtrohet e ngrohtë në një letër filtruese dy herë të palosur.

Filtrati avullohet deri në gjendjen e një shurupi të trashë. Me shurupin e përtuar lyhet sipërsaqja e një xhami, në formë shtrese të hollë 3 mm dhe mbahet në temperaturën  $80^\circ\text{C}$ , deri në tharjen e plotë. Fletët me ngjyrë të shndritshme të preparatit, sipas shkallës së tharjes, hiqen nga sipërsaqja e xhamit.

Përftohen rreth 400 g sulfat kromi (III).

## 17. Magnezi dhe përbërjet e tij

### 17.1. Magnezi

Mg	M = 24,305 g/mol	d = 1740 kg/m <sup>3</sup>
t. shk. = 650°C		t. vl. = 1107°C

Magnezi është metal me ngjyrë të bardhë, me fortësi mesatare. Në ajër oksidohet dhe humbet shkëlqimin. Në temperaturën 600-650°C, ndizet (në ajër) me një dritë verbuese, duke formuar oksid magnezi dhe pak nitrur magnezi Mg<sub>3</sub>N<sub>2</sub>. Magnezi tretet në acide dhe është reduktues i fuqishëm.

Në eksperimentet laboratorike përdoret magnezi në formë shiriti. Në mungesë të shiritit të magnezit, për të demonstruar djegien e magnezit në oksigjen, mund të përdoret shirit letra magnezi. Letra e magnezit mund të përgatitet duke lyer një letër të zakonshme me një përzierje të përgatitur nga pluhur magnezi me pak ujë dhe gomë arabike. Pas tharjes letra pritet në formë shiritash.

### 17.2. Përbërjet e magnezit


#### 17.2.1. Etanoati i magnezit (acetati i magnezit)

Mg(CH <sub>3</sub> COO) <sub>2</sub> · 4H <sub>2</sub> O	M = 214,66 g/mol	d = 1454 kg/m <sup>3</sup>
		t. shk. = 80°C

Etanoati i magnezit Mg(CH<sub>3</sub>COO)<sub>2</sub> · 4H<sub>2</sub>O formon kristale pa ngjyrë të sistemit monoklin. Në ajër me lagështirë reaktivi qullet; po të mbahet në eksikator me acid sulfurik të përqendruar thahet. Tretet shumë mirë në ujë (39,6% kripë anhidër, në 25°C). Në temperaturën 100°C kripa çhidratohet. kurse në 323°C shpërbëhet.

### 17.2.1.1. Gatitja e etanoatit të magnezit


Reaktivi mund të përftohet duke tretur karbonatin e magnezit në acid etanoik:



Në 180 ml ujë treten 90 ml  $\text{CH}_3\text{COOH}$  80%. Tretësira ngrohet deri në temperaturën 60°-80°C. Hidhet dalëngadalë në të  $\text{MgCO}_3 \cdot 3\text{H}_2\text{O}$ , derisa të ndërpritet dalja e dioksidit të karbonit (rreth 60 g). Përzierja ngrohet 15-20 min në banjë uji dhe filtrohet e nxehjtë. Në filtrat shtohen 3 ml acid etanoik dhe filtrati avullohet, derisa dendësia e tretësirës së nxehjtë të arrijë në 1250-1260 kg/m³. Pas ftohjes kristalet që bien, hidhen në hinkën përfiltrim në zbrazëti dhe pastaj në shishe; tapa e shishes duhet të lyhet me parafinë.

Përftohen rreth 100 g kripë.

### 17.2.2. Karbonati bazik i magnezit




Karbonati bazik i magnezit është pluhur me ngjyrë të bardhë, pothuajse i patretshëm në ujë (0,02%, në 15°C). Tretet në tretësirat e kripërave të amonit.

### 17.2.2.1. Gatitja e karbonatit bazik të magnezit

Karbonati bazik i magnezit gatitet nga veprimi i karbonatit të natriumit me klorurin e magnezit. Në 500 ml ujë të ngrohtë treten rreth 150 g  $\text{MgCl}_2 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$ . Shtohen në të 2 ml  $\text{NH}_4\text{OH}$  ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ). Përzierja ngrohet deri në temperaturën 60°C dhe dekantohet; precipitati, që përmban papastërti mekanike, si dhe  $\text{Fe(OH)}_3$ , filtrohet.

Në një enë tjetër, treten 75 g  $\text{Na}_2\text{CO}_3$  (teknik) në 440 ml ujë të ngrohtë. Shtohen në të 2-3 ml tretësirë  $\text{NaOH}$  40%. Përzierja valohet, dekantohet dhe filtrati i përfshuar ngrohet deri në 60°C dhe hidhet, në formë currili të hollë, në tretësirën e ngrohtë të klorurit të magnezit, deri në precipitatimin e plotë të karbonatit bazik të magnezit (mostra e lëngut të filtruar nuk duhet të japë precipitat me tretësirë kloruri bariumi dhe karbonati natriti (natriti), që është filtruar, lahet me ujë deri në largimin e joneve klorur  $\text{Cl}^-$  (prova me tretësirë nitratje argjendi) dhe thahet në temperaturën 70°C.

### 17.2.3. Karbonati i magnezit



$$M = 138,37 \text{ g/mol} \quad d = 1850 \text{ kg/m}^3$$


Karbonati i magnezit  $\text{MgCO}_3 \cdot 3\text{H}_2\text{O}$  formon kristale në formë gjilpërash të shndritshme, të sistemit monoklin, që në ajër, zakonisht, gjerryhen. Kripa kur ngrohet humbet ujin dhe dioksidin e karbonit (dioksid karboni çlirohet edhe gjatë valimit të kripës në ujë).

Reaktivi është pak i tretshëm në ujë ( $1,1 \cdot 10^{-2}\%$ ,  $PT = 4 \cdot 10^{-5}$ , në 25°C).

### 17.2.3.1. Gatitja e karbonatit të magnezit

Karbonati i magnezit mund të përfstohet në këtë mënyrë:

Në një gyp qelqi të mbushur me karbonat bazik magnezi<sup>1)</sup> dhe të ngrohur në temperaturën 150–220°C, futet dioksid karboni i pastër dhe i thatë. Reaksiioni që ndodh, jepet me barazimin:



dhe vazhdon, derisa masa e pluhurit të mos ndryshojë pamjen.

### 17.2.4. Kloruri i magnezit

#### a) Kloruri i magnezit anhidër

$$\text{MgCl}_2 \quad M = 95,22 \text{ g/mol} \quad d = 2320 \text{ kg/m}^3$$

$$t. \text{ shk.} = 714^\circ\text{C} \quad t. \text{ vl.} = 1417^\circ\text{C}$$

#### b) Kloruri i magnezit kristalhidrat

$$\text{MgCl}_2 \cdot 6\text{H}_2\text{O} \quad M = 203,31 \text{ g/mol} \quad d = 1560 \text{ kg/m}^3$$

$$t. \text{ shk.} = 117,5^\circ\text{C}$$

Kripa anhidër formon kristale në formë pllakash me shkëlqim. Tretet në ujë (me ngrohje) dhe në alkool etilik. Në ajër me lagështirë tymon dhe qullet.

Kristalhidrati  $\text{MgCl}_2 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$  është shumë hidroskopik, ka formë gjilpërash ose shkopinjsh me shije të kripur të hidhur; është shumë i tretshëm në ujë (33,3% kripë anhidër, në 20°C) dhe në alkool etilik. Në 151°C hum bet ujin dhe klorurin e hidrogenit, duke u shndërruar në oksid magnezi.

#### 17.2.4.1. Gatitja e klorurit të magnezit kristalhidrat

Kloruri i magnezit  $\text{MgCl}_2 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$  mund të përfstohet nga veprimi i karbonatit të magnezit me acid klorhidrik:



Përgatitet përzierja e 50 g magnezit<sup>1)</sup> teknik me 50 ml ujë dhe në të hidhet pak e nga pak 210 ml acid klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ). Reaksiioni i tretësirës së përfshuar duhet të jetë bazik i dobët (prova me fenolftaleinë), në rast të kundërt, shtohet pak magnezit. Në tretësirë hidhen 2-3 pilka  $\text{H}_2\text{SO}_4$ , 10 ml tretësirë sulfuri hidrogeni dhe tretësira lihet një natë (12 h). Pastaj filtrohet dhe filtrati provohet për praninë e joneve  $\text{Fe}^{3+}$  (prova me tretësirë  $\text{NH}_4\text{SCN}$ ). Në qoftë se tretësira nuk përbën jone  $\text{Fe}^{3+}$ , shtohet rreth 1 g magnezit dhe mbas përzierjes lihet disa

1) Magneziti mund të zëvendësohet me  $\text{MgO}$  ose  $\text{MgCO}_3$ .


orë. Tretësira e çliruar nga jonet  $\text{Fe}^{3+}$ , ngrohet deri në valim. Shtohen në të 4-6 ml tretësirë 10% kloruri bariumi (për precipitimin e joneve sulfat  $\text{SO}_4^{2-}$ ) dhe valohet 30 min. Filtrati provohet për praninë e joneve  $\text{Ba}^{2+}$  dhe  $\text{SO}_4^{2-}$ . Në rast se këto jone zbulohen, në tretësirë shtohet magnezit ose klorur bariumi  $\text{BaCl}_2$ . Përzierja lihet të dekantojë dhe filtrohet. Filtrati asnjanësitet me acid klorhidrik (prova me lakmus) dhe avullohet, derisa në sipërfaqen e tij të shfaqet një cipë kri stalore.

Pas ftoshjes, kristalet e  $\text{MgCl}_2 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$  që bien, filtrohen me letër filtruese dhe hidhen në një shishe me tapë të smeriluar.

- Përftohen rrëth 70 g kripe.

Me avullimin e mëtejshëm të tretësirës mëmë mund të përftohet edhe një sasi tjetër kripe, por më pak e pastër.


### 17.2.5. Nitrati i magnezit



Nitrati i magnezit  $\text{Mg}(\text{NO}_3)_2 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$  formon kristale pa ngjyrë, të sistemit monoklin. Tretet mirë në ujë (42,1% kripë anhidër, në 25°C) dhe në alkool etilik.

#### 17.2.5.1. Gatitja e nitratit të magnezit


Nitrati i magnezit mund të gatitet duke tretur oksid magnezi (ose  $\text{MgCO}_3$ ) në acid nitrik:



Në 70 ml acidi nitrik ( $d = 1400 \text{ kg/m}^3$ ) hidhet pak e nga pak 20 g oksid magnezi teknik<sup>1)</sup>. Pastaj, shtohen në të 2 ml tretësirë sulfuri hidrogjeni (për precipitin e sulfureve të metaleve të rënda) dhe tretësira ngrohet pak sa të vaket. Tretësira e ngrohtë filtrohet.

Filtrati acidifikohet pak me acid nitrik dhe avullohet deri në formimin e cipës kristalore. Pas ftoshjes kristalet e  $\text{Mg}(\text{NO}_3)_2 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$  filtrohen dhe thahen në mjeshtë zakonshëm me anë të letrës filtruese. Sipas kësaj metodike përftohen rrëth 60 g kripë.

### 17.2.6. Oksidi i magnezit



Oksidi i magnezit  $\text{MgO}$  është pluhur i bardhë, i shkrifët.

Në ujë është pothuajse i patretshëm ( $8,4 \cdot 10^{-14}\%$ , në 18°C); thith ngadalë



1) Një pjesë e oksidit të magnezit duhet të mbetet e patretur.

lagështirën e ajrit dhe dioksidin e karbonit (ajri i tharë mbi oksid magnezi përmban  $0,008 \text{ mg/l H}_2\text{O}$ , në  $25^\circ\text{C}$ ). Oksidi i magnezit tretet mirë në acide, madje edhe në acid etanoik dhe në tretjet e kripërave amoniakore.

Në qoftë se përzihet me 12 pjesë në masë ujë, formon një masë në trajtë qulli, hidroksidin e magnezit  $\text{Mg}(\text{OH})_2$ .

#### 17.2.6.1. Gatitja e oksidit të magnezit

Metoda e përfitimit të oksidit të magnezit bazohet në gatitjen e karbonatit bazik të magnezit, i cili pastaj gëlqerizohet në temperaturë të lartë:



Tretësira e  $75 \text{ g MgCl}_2 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$  në  $150 \text{ ml ujë}$ , pasi të hidhen në të  $0,5 \text{ g MgO}$ , ngrohet 1-2 h, në temperaturën  $70-75^\circ\text{C}$ , duke e përzier shpesh.


Përzierja lihet të dekantojë dhe pastaj filtrohet. Filtrati ngrohet në temperaturën  $80-85^\circ\text{C}$  dhe hidhet në të në formën e një currili të hollë tretësira e ftohtë dhe e filtruar e  $125 \text{ g Na}_2\text{CO}_3 \cdot 10\text{H}_2\text{O}$  në  $350 \text{ ml ujë}$ , derisa reaksiioni i filtratit të bëhet bazik i dobët (prova me fenolftaleinë). Pastaj tretësira ngrohet 30 min dhe dekantohet. Preparati i karbonatit bazik të magnezit, pasi përzihet me  $200 \text{ ml ujë}$  të nxeh të 10 min, dekantohet.

Precipitatit i shtohen  $100 \text{ ml ujë}$  të nxeh të pasi përzihet, dëkantohet. Larja me dekantim (për largimin e joneve sulfat  $\text{SO}_4^{2-}$ ) përsëritet rreth 8 herë. Precipitati filtrohet në letër filtruese dhe, mbas larjes me ujë të nxeh të (rreth  $100 \text{ ml}$ ), thahet në temperaturën  $110-120^\circ\text{C}$ , duke përzier rrallë. Kripa e përfshuar ( $50-55 \text{ g}$ ) gëlqerizohet në pote në  $660-750^\circ\text{C}$ , 4-5 h. Mbas ftohjes, preparati thërrmohet në pluhur dhe lahet me dekantim me ujë 2-3 herë (nga  $150 \text{ ml}$ ). Grimcat e pluhurit të oksidit të magnezit kthehen në gjendje pezullie. Preparati filtrohet në letër filtruese, lahet me  $50 \text{ ml ujë}$  dhe thahet 4 h, në  $120-150^\circ\text{C}$ .

Përfshohen  $13 \text{ g oksid magnezi}$ .

Sipas literaturës, në rast se substancat që përdoren përfshinin e oksidit të magnezit janë të klasifikimit (p. p. a.), edhe produkti i përfshuar i përgjigjet klasifikimit (p. p. a.).

#### 17.2.7. Sulfati i magnezit



Sulfati i magnezit  $\text{MgSO}_4 \cdot 7\text{H}_2\text{O}$  ka shije të kripur në të hidhur dhe formon kristale prizmatike të tejdukshme, që gjerryhen (shprishen) lehtë në ajër. Me shigratim përfshohen kështjellat me  $6,2,5,1$  dhe  $0,5$  molekula ujë.

Tretet mirë në ujë (26,2% kripë anhidër, në  $20^\circ\text{C}$ ), kurse në alkool etilik nuk tretet. Me ngrohje të kujdeshshme (deri në  $238^\circ\text{C}$ ), shndërrohet në kripë anhidër ( $\text{MgSO}_4$ ). Sulfati i magnezit anhidër është pluhur kështjella me dendësi  $2666 \text{ kg/m}^3$ ; në temperaturën  $1127^\circ\text{C}$  shpërbëhet dhe çliron  $\text{SO}_3$ .

Sulfati i magnezit teknik, që prodhohet në Ndërmarrjen Kimike Durrës formon kristale me ngjyrë të bardhë në të verdhë me karakteristikat fiziko-kimike që jepen në tabelën 17.1.

Tabela 17.1

Treguesit	Norma në përqindje
$MgSO_4 \cdot 7H_2O$	jo më pak se 98
$Fe_2O_3$	jo më shumë se 0,2
lëndë të patretshme acide të lira lagështirë	jo më shumë se 0,3
	—
	jo më shumë se 1,5

Sulfati i magnezit, reaktiv kimik që prodhohet në Ndërmarrjen Kimike në Durrës (nga pastrimi i sulfatit të magnezit teknik), ka karakteristikat fiziko-kimike që jepen në tabelën 17.2.

Tabela 17.2

Treguesit	Norma në përqindje
pamja e jashtme, ngjyra përbajtja e sulfatit të magnezit ( $MgSO_4 \cdot 7H_2O$ ) mbetja e patretshme përbajtja e klorureve ( $Cl^-$ ) përbajtja e fosfatave ( $PO_4^{3-}$ ) përbajtja e acidit të lirë përbajtja e $Na^+$	substancë kristalore, pa ngjyrë jo më pak se 99% jo më shumë se 0,004% jo më se 0,0006% jo më shumë se 0,001% jo më shumë se 0,008% jo më shumë se 0,02%

Reaktiv i kimik ambalazhohet në shishë qelqi ose plastmase, me nxënësi 500-1000 g, të mbyllura mirë (është substancë hidroskopike); ruhet në vende të thata.

### 17.2.7.1. Gatitja e sulfatit të magnezit

Sulfati i magnezit mund të gatitet në këtë mënyrë:

Në një enë me tretësirë të nxehë të acidit sulfurik 30% hidhet, duke e përzier energjisht, karbonat magnezi (teknik) ose oksid magnezi deri në ndërprerjen e shkumëzimit<sup>1)</sup>.

Tretësira filtrohet dhe filtrati lihet të kristalizojë në mjeshtë ftohtë; një natë (12 h). Ditën tjeter, kristalet që bien, filtrohen në letër filtruese, lahen me një sasi të vogël uji të ftohtë dhe rikristalizohen (për 100 g kripë merren 40 ml ujë).

1) Mostra e filtruar e lëngut nuk duhet të japë ngjyrë të kuqe me  $NH_4SCN$  (papastërti të jo-neve  $Fe^{3+}$ ), në rast të kundërt shtohet edhe një sasi  $MgO$ .

Sipas literaturës përftohet një preparat i pastër për analizë (p. p. a.).

Një pastrim më i mirë i tretësirës së  $MgSO_4$  nga përbërjet e  $Ni^{2+}$ ,  $Co^{2+}$ ,  $Fe^{3+}$ ,  $Zn^{2+}$  dhe  $Cu^{2+}$  (papastërtitë) mund të arrihet duke i precipituar me hidroksid magnezi, të porsaprecipituar.

Hidroksidi i magnezit i precipituar gatitet nga veprimi i tretësirës së hidroksidit të natriumit me tretësirën e  $1\text{ g }MgSO_4 \cdot 7H_2O$ . Precipitimi bëhet në një gotë polieni; precipitati i njomur i  $Mg(OH)_2$  hidhet në një tretësirë të valuar të 100-120 g  $MgSO_4 \cdot 7H_2O$  (i pastër). Përzierja tundet fort rrëth 30 min dhe lihet 24 h. Pastaj, tretësira e kthjellët sifonohet (ose dekantohet me shumë kujdes). Përbajtja e papastërtive të  $Ni^{2+}$ ,  $Co^{2+}$ ,  $Fe^{3+}$ ,  $Zn^{2+}$  dhe  $Cu^{2+}$  në tretësirën e përfstuar të  $MgSO_4$  është më e vogël se  $10^{-6} - 10^{-7}\%$ .

## 18. Mangani dhe përbërjet e tij

### 18.1. Mangani

Mn	$M = 54,938 \text{ g/mol}$	$d = 7440 \text{ kg/m}^3$
t. shk. = $1245^\circ\text{C}$		t. vt. = $2097^\circ\text{C}$

Mangani është metal me ngjyrë të bardhë të argjendtë. Në temperaturë të zakonshme është i qëndrueshëm në ajër, sepse në sipërfaqe të tij formohet një cipë e hollë okside, e cila e mbron nga oksidimi i mëtejshëm (në gjendje pluhuri oksidohet me lehtësi). Me oksigjenin formon disa okside që mund të janë okside bazike, amfotere ose acide. Me nxehje bashkohet me të gjitha jometalet; tretet në të gjitha acidet minerale të holluara.

### 18.2. Përbërjet e manganit

#### 18.2.1. Karbonati i manganit

$\text{MnCO}_3$	$M = 114,95 \text{ g/mol}$	$d = 3125 \text{ kg/m}^3$
-----------------	----------------------------	---------------------------

Karbonati i manganit është pluhur i bardhë, pothuajse i patretshëm në ujë ( $1,33 \cdot 10^{-4}\%$ ;  $PT = 1,8 \cdot 10^{-11}$ ). Reaktivi i thatë është i qëndrueshëm në ajër, kurse i lagësht oksidohet lehtë dhe errësitet si pasojë e formimit të oksidit të manganit (III)  $\text{Mn}_2\text{O}_3$ . Duke e valuar me ujë, hidrolizohet.

##### 18.2.1.1. Gatitja e karbonatit të manganit

a) Karbonati i manganit i klasifikimit (p.) që i përgjigjet me saktësi formules  $\text{MnCO}_3$  (pa papastërti të kripës bazike) mund të përfshihet nga veprimi i hidro-gjenkarbonatit të natriumit me tretësirën e një kripe të  $\text{Mn}^{2+}$ :



Tretësira 10% e nitratit të manganit (II) e ngrohur deri në 50°C hidhet në formë currili të hollë në tretësirën 10% të një sasie njëvlerëse të hidrogjenkarbonatit të natriumit. Përzierja trazohet, ngopet me dioksid karboni dhe ena ku kryhet reaksiioni mbyllë fort. Pas precipitimit, lëngu dekantohet; precipitati lahet me ujë të ftohtë të ngopur me dioksid karboni deri në largimin e plotë të nitratit të natriumit, hidhet në letër filtruese dhe thahet në një rrymë dioksidi karboni në temperaturën 70-80°C.

Sipas kësaj metodike, në rast se substancat nistore janë të klasifikimit (p. p. a.), edhe reaktivi i përfshuar i përgjigjet po këtij klasifikimi.


b) Karbonati i manganit (II) mund të përfshohet edhe nga veprimi i klorurit të manganit (II) me hidrogjenkarbonat natriumi.

Tretësira e filtruar e 25 g  $MnCl_2 \cdot 4H_2O$  në 50 ml ujë hidhet në tretësirën e filtruar të 20 g  $NaHCO_3$  në 200 ml ujë. Precipitati i bardhë i  $Mn(HCO_3)_2$ , pas 10-12 min, shpërbëhet duke çliruar dioksid karboni. Pasi ndërpritet çlirimini i  $CO_2$ , precipitati filtrohet, lahet me kujdes me ujë, pastaj lahet 3-4 herë me alkool etilik dhe hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti.

Reaktivi i përfshuar ka përbërjen  $MnCO_3 \cdot 2H_2O$ .

## 18.2.2. Kloruri i manganit

### a) Kloruri i manganit anhidër



### b) Kloruri i manganit kristalhidrat



Kloruri i manganit anhidër formon fletë të kuqërrreme. Mbi temperaturën 650°C  $MnCl_2$  avullon; me ngrohje, në ajër të lagësht, shpërbëhet duke çliruar klorur hidrogjeni dhe precipiton  $Mn_3O_4$ . Tretet në alkool etilik absolut (66%, në 20°C), kurse në eter dietilik nuk tretet.

Kristalhidrati  $MnCl_2 \cdot 4H_2O$  formon kristale të kuqërrreme hidroskopike, të sistemit monoklin. Është i tretshëm në ujë (42,3% kripë anhidër, në 20°C) dhe në alkool etilik. Në temperaturën 58°C humbet një pjesë të ujit dhe kthehet në  $MnCl_2 \cdot 2H_2O$ . Në temperaturën 200-230°C shpërbëhet pjesërisht duke çliruar klorur hidrogjeni.


### 18.2.2.1. Gatitja e klorurit të manganit të hidratuar

Reaktivi mund të përfshohet në këtë mënyrë: Ferro-mangani<sup>1)</sup> tretet në acid klorhidrik dhe papastërtitë e hekurit precipitoohen me pastë  $MnCO_3$ . Në një kupshore porcelani hidhen 175 ml acid klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ )

1) Lidhje e hekurit që përbën afro 75% Mn.

dhe shtohen në të me porcione të vogla (në kapë) 60 g pluhur ferromangani. Pasi mbaron reaksioni i vrullshëm, shtohen 210 ml ujë dhe përzierja ngrohet në banjë uji 4–5 h. Pas një dite, përzierja filtrohet. Në filtrat shtohen 7,5 g dioksid mangani pluhur dhe përzihet deri në oksidimin e plotë të  $\text{Fe}^{2+}$ ; prova e filtratit nuk duhet të japë precipitat të kaltër me  $\text{K}_3[\text{Fe}(\text{CN})_6]$ . Pas precipitimit, mbetja hidhet në hinkën përfiltrim në zbrazëti. Nga 1/5 pjesë e filtratit përftohet pasta e  $\text{MnCO}_3$ , kurse  $\text{Fe}^{3+}$  precipitohet<sup>1)</sup> në 4/5 pjesë të tretësirës. Pastaj, tretësira avullohet deri në formimin e cipës së dendur kristalore dhe kristalizohet në temperaturën e mijedisit. Kristalet hidhen në hinkën përfiltrim në zbrazëti, dhe pasi thahen në temperaturë më të ulët se  $40^\circ\text{C}$ , hidhen në shishe, me tapë të smeriluar.

### 18.2.3. Nitrati i manganit





Nitrati i manganit formon prizma në formë gjilpërash të gjata, me ngjyrë trëndafili të hapët. Në temperaturën  $160\text{--}200^\circ\text{C}$  reaktivi shpërbëhet dhe formon dioksid mangani. Tretet mirë në ujë (62,4% e kripës anhidër, në  $25^\circ\text{C}$ ) dhe në alkool etilik.

#### 18.2.3.1. Gatitja e nitratit të manganit

a) Nitrati i manganit mund të përftohet nga bashkëveprimi i karbonatit të manganit  $\text{MnCO}_3$  me acid nitrik. Në 200 g acid nitrik ( $d = 1200 \text{ kg/m}^3$ ), hidhen dalëngadalë 100 g  $\text{MnCO}_3$ ; një pjesë e kripës duhet të mbetet e patretur. Precipitati i formuar filtrohet dhe tretësira, pasi acidifikohet pak me acid nitrik, avullohet në temperaturën  $60\text{--}70^\circ\text{C}$ , derisa prova e lëngut me ftohje të kristalizojë. Pastaj, lihet 12 h në të ftohtë; kristalet që bien hidhen në hinkën përfiltrim në zbrazëti dhe ruhen në shishe me tapë të smeriluar.

Sipas kësaj metodike, në qoftë se substancat nistore janë të klasifikimit (p. p. a.), edhe reaktivi i përfuar i përgjigjet klasifikimit (p. p. a.).

b) Reaktivi i pastër mund të përftohet sipas metodikës që bazohet në tretjen me acid nitrik të ferromanganit (lidhje hekuri që përmban deri në 75% Mn);



Në 250 ml acid nitrik ( $d = 1200 \text{ kg/m}^3$ ), hidhen ngadalë (në kapë) 50 g ferromangan i thërrmuar. Kur ndërpritet çlirim i oksideve të azotit, përzierja ngrohet në banjë rëre dhe filtrohet. Në 50 ml filtrat shtohen  $(\text{NH}_4)_2\text{CO}_3$ , deri në reaksiون të dobët bazik; përzierja e  $\text{Fe}(\text{OH})_3$  dhe  $\text{MnCO}_3$  që bie, filtrohet dhe lahet me kuqdes me ujë. Pasta e përfuar hidhet në 200 ml filtrat që ka mbetur, dhe ngrohet 30


1) Shih gatitja e sulfatit të manganit.

min në temperaturën 90-95°C; jonet e  $\text{Fe}^{3+}$  precipitojnë plotësisht në formën e hidroksidit të hekurit  $\text{Fe(OH)}_3$ .

Përzierja e ngrohtë filtrohet. Filtrati ecidifikohet pak me acid nitrik dhe avullohet, në temperaturë jo më të lartë se 70°C, derisa dendësia e tretësirës<sup>1)</sup> të arrinjë 1630-1650 kg/m<sup>3</sup> (në 40°C) dhe ftohet. Këshillohet që në tretësirë të futet një kristalth  $\text{Mn(NO}_3)_2 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$  për t'i dhënë shkas fillimit të kristalizimit. Kristalet që bien, hidhen në hinkën përfiltrim në zbrazëti dhe mbahen 24 h në eksikator mbi hidroksid natriumi, për t'u larguar acidi nitrik i lirë.

Përftohen rrëth 150 g nitrat magnezi.


#### 18.2.4. Oksidi i manganit (II)



Oksidi i manganit (II) është pluhur me ngjyrë të gjelbër në të hirtë. Po të skuqet (me nxehësi) në ajër, shndërrrohet në  $\text{Mn}_3\text{O}_4$ . Nuk tretet në ujë; kurse në aoxide tretet mirë.

##### 18.2.4.1. Gatitja e oksidit të manganit (II)


Oksidi i manganit (II) mund të përftohet nga gëlqerizimi i karbonatit të manganit në atmosferë reduktuese:



Në një gyp porcelani hidhen 100 g  $\text{MnCO}_3$ , pasi nxirret ajri me anë të rrymës me hidrogen, gypi ngrohet disa orë (më shumë se 4 h) në temperaturën 300°C, në prani të hidrogenit. Pastaj, ftohet në rrymë hidrogeni dhe masa kryesore me ngjyrë të gjelbër në të hirtë hidhet në një shoshë (produkti i errët që ndodhet në anët e gypit nuk duhet).

Përftohet rrëth 50 g oksid mangani (II).

#### 18.2.5. Oksidi i manganit (IV) (dioksidi i manganit)



Oksidi i manganit (IV) anhidër formon kristale me ngjyrë të zezë ose pluhur amorf. Nuk tretet në ujë; me gëlqerizim mbi temperaturën 535°C shndërrrohet në  $\text{Mn}_3\text{O}_4$ . Në mjesës acid ose me ngrohje është oksidues i foitë.

**Oksidi ujor i manganit** (acidi manganor)  $\text{MnO(OH)}_2$  ose  $\text{H}_2\text{MnO}_3$  është pluhur i shkrifët me ngjyrë të zezë në kafe.

1) Në pamundësi për matjen e dendësisë mund të kufizohemi në shfaqjen e cipës kristalore.

### 18.2.5.1. Gatitja e oksidit tē manganit (IV)

Reaktivi mund tē përfstohet me anë tē gëlqerizimit tē nitratit tē manganit:




Në një kupshore porcelani ngrohet (në kapë)  $\text{Mn}(\text{NO}_3)_2 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$  në temperaturën  $100^\circ\text{C}$ ; pastaj temperatura ngrihet ngadalë deri në  $160^\circ\text{C}$ . Përfstohet një masë e zezë në formë pluhuri. Produkti ftohet, laget me acid nitrik ( $d = 1340 \text{ kg/m}^3$ ), përzihet deri në një masë qulli tē lëngshëm dhe përsëri ngrohet në  $160^\circ\text{C}$ . Pas ftohjes, masa hidhet në një hinkë me qelq poroz, lahet dy herë me acid nitrik, ( $d = 1620 \text{ tg/m}^3$ ) dhe ngrohet me acid nitrik, deri në  $160^\circ\text{C}$ . Pastaj, hidhet në hinkën për fil-krim në zbrazëti dhe thahet në  $150^\circ\text{C}$ .

Për përfstimin e 100 g dioksidi mangani shpenzohen 400 ml acid nitrik ( $d = 1340 \text{ kg/m}^3$ ).

Sipas kësaj metodike, në rast se substancat nistore janë tē klasifikimit (p. p. a.), edhe produkti i përfstuar i përgjigjet po këtij klasifikimi.

### 18.2.5.2. Gatitja e oksidit ujor tē manganit

Dioksidi ujor i manganit  $\text{MnO(OH)}_2$  «i precipituar pa squfur» mund tē pëftohet nga reduktimi i permanganatit tē kaliumit me alkool étilik:




Në tretësirën e 100 g permanganat kaliumi në 2 l ujë hidhet 125 ml alkool étilik. Pasi mbaron reaksiuni dhe zhduket ngjyra vjollcë e tretësirës, shtohen në të 12,5 ml acid nitrik ( $d = 1400 \text{ kg/m}^3$ ) dhe ngrohet. Precipitati lahet me dekantim me ujë, deri në largimin e joneve nitrat  $\text{NO}_3^-$  dhe thahet në temperaturën  $20^\circ\text{C}$ . Në qoftë se përban ende squfur, precipitati thërrmohet, përzihet me ujë, shtohen në të 25-35 g karbonat natriumi, ngrohet deri në valim dhe mbahet në këtë temperaturë 30 min, duke e përzier pa ndërprerje. Pastaj lëngu dekantohet, shtohet edhe pak acid nitrik dhe precipitati lahet me dekantim me ujë, derisa në ujërat e larjes të mos ketë më jone  $\text{SO}_4^{2-}$  (prova me tretësirë kloruri bariumi) dhe jone nitrat  $\text{NO}_3^-$  (prova me difenilaminë). Precipitati hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe thahet në temperaturën e mjedisit.

Përfstohen rrëth 50 g oksid ujor mangani.

### 18.2.5.3. Gatitja e dioksidit tē manganit aktiv

Dioksidi i manganit aktiv përfstohet nga veprimi i permanganatit tē kaliumit me një kripë tē tjetshme tē  $\text{Mn}^{2+}$ :



Në një poç me dy gryka, tē paqisur me hinkë ndarëse dhe me përzierës mekanik hidhen 250 ml tretësirë 5% sulfati mangani e ngrohur në temperaturën  $50-60^\circ\text{C}$ . Shtohen në të, duke e përzier 2h, 200 ml tretësirë 5%  $\text{KMnO}_4$ . Përzierja ngrohet

edhe për 2h në temperaturën  $60^{\circ}\text{C}$ . Pastaj lihet në qetësi 24 h, në temperaturën  $30\text{--}35^{\circ}\text{C}$ . Precipitati që bie, filtrohet, lahet me ujë deri në largimin e joneve sulfat  $\text{SO}_4^{2-}$  dhe thahet 8-10 h në temperaturën  $110\text{--}120^{\circ}\text{C}$ .

Përftohen rrëth 17 g dioksid mangani aktiv.

### 18.2.6. Sulfati i manganit

Sulfatit i manganit kristalhidrat formon kristale të sistemit triklin, me ngjyrë -të kuqërmëme. Tretet mirë në ujë ( $38.6\%$ , kripë anhidër, në  $20^{\circ}\text{C}$ ), kurse në alkool të etilik nuk tretet. Në temperaturën  $54^{\circ}\text{C}$  shkrin në ujin e kristalizimit.

Sulfatit i manganit anhidër është substance e bardhë, në formë pudre të ashpër ( $\text{të brishtë}$ ) me  $d = 3250 \text{ kg/m}^3$ . Gjatë një gëllqerizimi të dobët sulfatit i manganit është i qëndrueshëm.

#### 18.2.6.1. Gatija e sulfatit të manganit

a) Sulfatit i manganit i klasifikimit (p.) mund të përfshohet nga dioksidit i manganit teknik (piroluziti). Për të larguar metalet alkaline, piroluziti përpunohet para-prakisht me acid nitrik dhe pastaj lihet të vaprojë më dioksidin e squfurit:



Në një kupshore porcelani hidhen 250 g piroluzit teknik (p.), me një pak se  $80\% \text{ MnO}_2$ . Shtohen në të 400 ml ujë dhe 350 ml acid nitrik ( $d = 1350 - 1400 \text{ kg/m}^3$ ) dhe përzierja trazohet me përzierës mekanik 6-8 h. Precipitimit lëngu derdhet; precipitati lahet me dekantim me ujë dhe pastaj hidhet në hinkën përfiltrim në zbrazëti, ku lahet me ujë të ngrohtë, derisa në ujërat elarjes, të mos ketë më jone  $\text{Mn}^{2+}$ . Precipitati i larë i dioksidit të manganit thahet në  $100\text{--}120^{\circ}\text{C}$ .

Përftohen rrëth 230 g dioksid mangani.

Në një gotë porcelani të pajisur me përzierës mekanik hidhen 120 g dioksid mangani dhe 300 ml ujë. Në përzierjen e përfshuar gurgullohet, duke e trazuar (në kapë), dioksid squfuri, derisa ngjyra e zezë e precipitatit të kthehet në hiri të hapët. Duke e trazuar shtohen edhe 9-10 g dioksid mangani deri në shfaqjen e ngjyrës së zezë të qëndrueshme. Përzierja duhet të trazohet rrëth 2 h, derisa të mos ndihet era e dioksidit të squfurit. Pastaj filtrohet; filtrati acidifikohet më 5 ml tretësirë  $10\%$  acidi sulfurik dhe avullohet në banjë uji që të thahet.

Mbetja e thatë gëllqerizohet 5 h në temperaturën  $450^{\circ}\text{C}$ , derisa të ndërpritet çlirim i dioksidit të squfurit.

Përftohen rrëth 80 g sulfat mangani anhidër  $\text{MnSO}_4$  me ngjyrë të bardhë në vjollcë.

Kripa e përfshuar tretet në 150 ml ujë, acidifikohet pak me disa pika tretësirë  $10\%$  acidi sulfurik, ngrohet deri në temperaturën  $60^{\circ}\text{C}$  dhe ngopet (në kapë) me sulfur hidrogjeni, derisa lëngu të ketë erë të qëndrueshme  $\text{H}_2\text{S}$ . Tretësira filtrohet (që të ndahet nga precipitati i sulfureve) në një letër filtruese dy herë të palosur. Filtrati (rrëth 150 ml) avullohet në banjë uji, derisa të precipitojë një sasi e madh

Kristalesh dhe shfobet ne temperaturen e mjesdit. Kristalesh hidhen ne hinken per përfshirë ne zbijazeti dhe lëhen 3 herë me uje te shfoste. Duke avulluar tretësirat mëmë ne përfshohen edhe një sasi tjeter kristalesh.

b) Reaktivi mund te përfshohet edhe nga ferromangani. Ferromangani tretet ne acid sulfurik dhe hekuri largohet me pastë  $MnCO_3$ .

Ne një kupshore (ose pjatë) porcelani përzihen 75 g pluhur ferromangani (lidhje hekuri me 70% Mn) me 120 ml uje. Shfohen ne flë, me përcione te vogla (ne kapë), 65 ml acid sulfurik ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ). Si pasojë e një reaksiuni te vrullshëm uji avullon, prandaj duhen shfuar (falle) nga 10 ml uje. Pasë mbaron reaksiuni, shfohen 210 ml uje; përzierja lloght 12 h ne qetësi dhe shfrohet. Ne filtrat shfohen 6 g dioksid mangani, ngrohet deri ne temperaturen 50°C dhe tretësira mbahet ne kete temperaturë, duke e trazuar me përziesh mekanik, deri ne eksidimin te kalter me  $R_s[Fe(CN)_6]$ . Nje pjesë (1/5) e tretësires se reaksiunit hidhet ne tretësire e ligrohëte te 60 g karbonat natriumi ne 300 ml uje per precipitimin e  $MnCO_3$  qe bie, lahet me dekantim me uje, deri ne largimin e joneve  $SO_4^{2-}$ .

Pasta e përfshuat e  $MnCO_3$  përdoret per te pastruar nga hekuri porcionin kryesor te tretësires se reaksiunit. Per kete, ne pastë shfohen 60 ml uje, ngrohet deri ne tretësires te  $MnSO_4$ . Pas precipitimit te plotë te hekurtit (prova e filtruar e tretësires, nuk duhet te jape ngjyre te kuqe me  $NH_4SCN$ ), përzierja filtohet. Filtrati avullohet pak, perseri filtohet dhe filtrati acidiifikohet me pak acid sulfurik 5 ml  $H_2SO_4$  ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ) ne 1 l tretësire. Pastaj, ayullohet ne banjë uji me temperaturë jo me të lartë se 60°C, deri ne shfaqjen e cipës kristalore te hollë. Kristallet hidhen ne hinken perfiltrim ne zbjazeti, lahlen me uje ne temperaturën 0°C, theme tanje te smerilluar.

Perfshohen frejtë 125 g sulfat mangani. Ne një pjate porcelani hidhen 180 ml uje dhe me curfil te hollë e duke e përzier, 40 ml acid sulfurik ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ). Shfohen ne te delengadalë frejtë 105 g  $MnCO_3$ , deri ne ndërprerjen e qirimt te dioksidit te karbonit. Pastaj, tretësira avullohet dhe kristalizohet si ne rastin e dyte (b).

Perfshohen frejtë 50 g sulfat mangani. Ne një pjate porcelani hidhen 180 ml uje, me curfil te hollë e duke e përzier, 40 ml acid sulfurik ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ). Shfohen ne te delengadalë frejtë 105 g  $MnCO_3$ , deri ne ndërprerjen e qirimt te dioksidit te karbonit. Pastaj, tretësira avullohet dhe kristalizohet si ne rastin e dyte (b).

Shtohen 100 g sulfat mangani ne 100 ml uje, me curfil te hollë e duke e përzier, 40 ml acid sulfurik ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ). Shfohen ne te delengadalë frejtë 105 g  $MnCO_3$ , deri ne ndërprerjen e qirimt te dioksidit te karbonit. Pastaj, tretësira avullohet dhe kristalizohet si ne rastin e dyte (b).

merkuri i cinkit është një lëngjë e gjatë, me ngjyrë të bardhë në binë, gjatë shtohjes formon kristale (oktaedra që shndërrohen në gjilpëra) dhe bëhet i farkët tueshmë si plumbi. Në ajet të temperaturës zakonshme, merkuri nuk oksidohet; oksidohet vetëm me nxehje afér temperaturës së valimit. Merkuri i pastër, kur derdhet, formon pikë sferike të shndritshme, i mjaftë të këvizshme.

## 19. Merkuri dhe përbërjet e tij

### 19.1. Mérkuri

$$\text{Hg} \quad M = 200,59 \text{ g/mol} \quad d = 1354 \text{ kg/m}^3$$

$$\text{Melt. shk. } = 38,87^\circ\text{C} \text{ fundoja e } \text{Hg} \quad \text{Boiling point } = 338,8^\circ\text{C}$$

(II) Merkuri është metal i nxeq gjendje tashmë, me ngjyrë të bardhë në binë. Gjatë shtohjes formon kristale (oktaedra që shndërrohen në gjilpëra) dhe bëhet i farkët tueshmë si plumbi. Në ajet të temperaturës zakonshme, merkuri nuk oksidohet; oksidohet vetëm me nxehje afér temperaturës së valimit. Merkuri i pastër, kur derdhet, formon pikë sferike të shndritshme, i mjaftë të këvizshme.

#### 19.1.1. Pastrimi i merkurtit

a) Pastrimi i merkurtit mund të bëhet sipas kesaj me-

todike:

Një gyp qelqi i gjerë më gjatësi rreth 1 m, dhe me përkulje kapilate në fund (fig. 19.1), mbushet më 1/4 e sa me 0,5% acidi nitrik. Mbi gyp vendoset një hinkë me letër filtruese. Një hinkë tjeter vendoset në mbajtëse, si në figurën 19.1. Të dy letrat filtruese kanë vrima, më letrën filtruese të sipërme vrimat janë bëre më njerëzish të zakonshme, kurse më letrën nuk janë të poshtme më njerëzish. Gjilpëra është më e gjilpëre sa më te gjithë, me teknikë e cila filtruese e sipërme mban papastërtitë mëkë mëte medha. Në hinken e sipërme lidhet atëkurri papastërt. Pasikalohet përbërjet dy letrave filtruese më kuri ne formen e pikave të cilimetë bëjnë gypin pas trohet nga papastërtitë. Përkthës gypit, mbledhet merkuri.




Fig. 19.1 Pastrimi i merkurtit

pastërt. Pastaj, merkuri hidhet në një pjatë porcelani dhe lahet me dekantim me ujë, derisa të largohet plotësisht acidi nitrik. Piklat e ujit që mbeten në sipërfaqen e merkurit, mblidhen me anë rripash letre filtruese. Pastaj, merkuri filtrohet edhe një herë me një letër filtruese të thatë, të shpuar me gjilpërë.

b) Merkuri mund të pastrohet edhe me këtë metodë të thjeshtë: Në një havan shtypet merkuri teknik me dy vëllime pudër (pluhur) sheqeri, derisa sheqeri të bëhet gjyrë hiri. Pastaj, lahet me ujë të n grohtë dhe thahet në temperaturën  $100\text{--}110^{\circ}\text{C}$

## 19. 2. Përbërjet e mërkurit

### 19.2.1. Etanoati i merkurit (II) (acetati i merkurit)



Etanoati i merkurit formon kristale të bardha, në formë plakash. Tretet mirë në ujë (20%, në  $10^{\circ}\text{C}$ ) dhe në alkool etilik.

#### 19.2.1.1. Gatija e etanoatit të merkurit (II)


Etanoati i merkurit mund të përfshihet nga veprimi i oksidit të merkurit (II) me acid etanoikë. Reaktioni është i përcaktuar me reagjimin e oksidit me etanoat e hidrogenit:

$$\text{HgO} + 2\text{CH}_3\text{COOH} \rightleftharpoons \text{Hg}[\text{CH}_3\text{COO}]_2 + \text{H}_2\text{O}$$

Në 150 ml acid etanoik  $30\%$  shtohet dalëngadale dhe me ngrohje, 55 g oksid merkuri (II). Tretetira filtrohet dhe vëçohet kristalet e bardha të kripës pâk të tretshme të  $\text{Hg}_2(\text{CH}_3\text{COO})_2$  (mund të jetë formuar në një sasi të vogël; nga reaksiimi i joneve  $\text{Hg}^{2+}$ ). Filtrati avullohet, deri në formimin e cipës kristalore (duke mbrojtur nga dritha), dhe ftohet. Kristalet që bien, hidhen në hinkën për filtrim në zbrazetë dhe ruhen në shishe të errët.

Përfshohen rrëth 50 g etanoat merkuri (II). Sipas kësaj metodike, në qoftë se substancat nistore janë të klasifikimit (p. p. a.) ose (p.), edhe reaktivi i përfshuar i përgjigjet po këtij klasifikimi.


### 19.2.2. Kloruri i merkurit (I)



Kloruri i merkurit formon kristale mikroskopike, pa ngjyre, të sistemit tetragonal. Nën veprimin e vazhdueshmës drithës, reaktivi errësohet; vëçohet merkuri metalik. Kurse me ngrohje të vazhdueshme sublimon, temperatura e sublitimit është  $383,2^{\circ}\text{C}$ . Avujt e  $\text{Hg}_2\text{Cl}_2$  përbëhen nga molekula  $\text{HgCl}_2$ . Kripa, praktikisht, nuk tretet në ujë ( $\rho_T = 1,3 \cdot 10^{-18}$ , në  $25^{\circ}\text{C}$ ), në alkookstilik dhe në acidet e holluara. Tretet në acid nitrik dhe në acid sulfurik të nxëhtë, duke formuar kripëra të merkurt  $\text{Hg}^{2+}$ . Ngjithashtu, tretet në benzen, dhe në piridinë.

### 19.2.2.1. Gati<sup>ja</sup> e klorurit t<sup>e</sup> merkurit [I]

### 20.2.13.1. Pastrimi i nitratit të natriumit teknik

Produkti teknik mund të pastrohet nëpërmjet kësaj metodike:

Në një kupshore porcelani hidhen 500 g nitrat natriumi  $\text{NaNO}_3$  (teknik). Shtohen në të 100-150 ml ujë, sa të mbulohen kistalet. Përzierja e përfshuar përzihet me përzierës mekanik, 3-4 h. Pastaj, kistalet hidhen në filter, ku lahen 2-3 herë me ujë (me sasi të vogla nga 15 ml) dhe thahen në temperaturën e mjedisit.

Nëpërmjet kësaj metodike përfshohen rreth 350 g nitrat natriumi i pastër.

### 20.2.14. Nitriti i natriumit

$$\text{NaNO}_2 \quad M = 69,00 \text{ g/mol} \quad d = 2168 \text{ kg/m}^3 \\ t.shk. = 271^\circ\text{C}$$

Nitriti i natriumit  $\text{NaNO}_2$  formon kristale të imëta të sistemit rombik, pa ngjyrë ose me ngjyrë të verdhë. Tretet shumë mirë në ujë (44,9%, në  $19^\circ\text{C}$ ), kurse në eter etilik absolut tretet pak. Acidet e shpërbëjnë, duke qiruar oksid azoti NO dhe dioksid azoti  $\text{NO}_2$ . Nitriti i natriumit shfaq veti oksiduese dhe reduktuese. Tretësira ujore e tij ka reaksiون bazik. Duke u bashkuar me oksigenin e ajrit, nitriti i natriumit në tretësirë shndërrohet gradualisht në nitrat natriumi  $\text{NaNO}_3$ . Kripa e thatë është e qëndrueshme në ajër.

Nitriti i natriumit, në prekje me lëndë të djegshme, mund të shkaktoj zjarr; është substancë helmuese.


#### 20.2.14.1. Pastrimi i nitritit të natriumit teknik

Nitriti i natriumit i pastër mund të përfshohet duke pastruar produktin teknik sipas kësaj metodike:

Në 100 ml ujë, në temperaturën  $70-80^\circ\text{C}$ , treten 100 g nitrat natriumi  $\text{NaNO}_2$  (teknik). Për precipitin e hekurit, shtohen në të 1-2g  $\text{NaOH}^1$  dhe përzierja filtrohet. Filtrati avullohet, derisa të formohet cipa kristalore (dendësia 1450  $\text{kg/m}^3$ ). Pastaj, filtrohet përsëri dhe ftohet deri në temperaturën e mjedisit. Kristalet e nitritit të natriumit, që precipitojnë, çohen në filter dhe lahen me pak ujë tè stohë. Pasi thahen me anë të letrave filtruese, mbyllen në shishe me tapë smenësile. Tretësira mëmë me anë të avullimit dhe kristalizimit jep sasi të tjera nitriti natriumi. Me këtë metodikë përfshohen rreth 70 g kripë.

#### 20.2.14.2. Gatitja e nitritit të natriumit

Nitriti i natriumit mund të gatitet me anë të reduktimit me plumb metalik, të nitratit të natriumit  $\text{NaNO}_3$  të shkrirë:



1) Sipas literaturës, në rast se përdoret  $\text{NaOH}$  i pastër, nitriti i natriumit i përfshuar i përgjigjet klasifikimit reaktiv i pastër për analizë (p.p.a.).


Në një pote porcelani shkrihen 25 g nitrat natriumi me 30 g plumb. Shkrirja përpunohet me një sasi shumë të vogël uji të ngrohtë dhe gurgullohet në të dioksid karboni. Dioksidi i karbonit precipiton oksidin e plumbit (të shkrirë), në formën e karbonatit  $PbCO_3$ . Për të veçuar precipitatin që përmban  $PbCO_3$ ,  $Na_2CO_3$  dhe  $NaNO_3$ , përzierja ftohet dhe filtrohet.

Filtrati avullohet deri në të thatë dhe mbetjet i shtohen 100 ml alkool etilik. Tretësira e përfshuar filtrohet për të veçuar nitratin e natriumit të patretur dhe nga filtrati avullohet alkooli.


Nitriti i natriumit  $NaNO_2$  mbetet në formën e një pluhuri të bardhë.

### 20.2.15. Peroksidi i natriumit

#### a) Peroksidi i natriumit anhidër



#### b) Peroksidi i natriumit kristalhidrat



Peroksidi i natriumit  $Na_2O_2$  (krejtës isht i pastër) është pluhur i bardhë me ngrohje zverdhët. Është i patretshëm në alkool etilik. Në ujë tretet duke çliruar nxehësi dhe oksigen.

Hidrati  $Na_2O_2 \cdot 8H_2O$  është substancë kristalore me ngjyri të bardhë, në formë petash. Në temperaturën  $30^\circ\text{C}$  shkrin në ujin e kristalizimit. Po të ruhet për një kohë të gjatë, hidrati shpërbëhet në hidroksid natriumi, ujë dhe oksigen. Peroksidi i natriumit kristalhidrat thih me etje dioksidin e karbonit të ajrit, duke u shndërruar në karbonat natriumi  $Na_2CO_3$ .


Peroksidi i natriumit anhidër ( $Na_2O_2$  teknik) ka ngjyrë të verdhë.

#### 20.2.15.1. Pastrimi i peroksidit të natriumit teknik

Peroksidi i natriumit (teknik) pastrohet në këtë mënyrë:

Tretet 1 pjesë në masë peroksid natriumi teknik në 4 pjesë në masë ujë shumë të ftohtë (ujë në  $0^\circ\text{C}$ ). Gjatë procesit të tretjes temperatura nuk duhet të ngrihet mbi  $40^\circ\text{C}$ . Me ftohjen e tretësirës deri në  $0^\circ\text{C}$ , rikristalizon hidrati  $Na_2O_2 \cdot 8H_2O$  që, pasi filtrohet, thahet në mjedis pa dioksid karboni.

### 20.2.16. Pirosulfati i natriumit



Pirosulfati i natriumit është një masë e bardhë kompakte. Në temperaturën  $460^\circ\text{C}$  çliron  $SO_3$  dhe kripa shndërrrohet në  $Na_2SO_4$ . Reaktivi tretet mirë në ujë.

Pirosulfati i natriumit  $Na_2S_2O_7$  (reaktiv) që prodhohet në Ndërmarrjen Kimike Durrës ka veçoritë fiziko-kimike që jepen në tabelën 20.5.

Treguesit	Norma në përqindje
pirosulfat natriumi	jo më shumë se 99
lëndë të patretshme	më pak se 0,007
sulfure	më pak se 0,0005
sulfate dhe sulfite	më pak se 0,1
kalcium	më pak se 0,005
hekur	më pak se 0,001
metale të rënda	më pak se 0,001
arsenik	gjurmë
azot	më pak se 0,007

Kurse pirosulfati i natriumit (fiksanal) tretësirë 0,1000 N ka këto veçori fiziko-kimike:

tretësirë pa ngjyrë

përbajtja e pirosulfatit të natriumit në 1 l


ujë të distiluar . . . . . 24,818 g

kufiri i shmangieve të normalitetit në 20°C ± 0,002

ambalazhohet në ampula qelqi 100 ml.

#### 20.2.16.1. Gafitja e pirosulfatit të natriumit

Pirosulfati i natriumit përfshohet nga ngrohja e hidrogjen-sulfatit të natriumit:



Në një kupshore porcelani ngrohet në temperaturë 200-250°C, 100 g NaHSO<sub>4</sub> · H<sub>2</sub>O. Kripa, duke u tretur në ujin e kristalizimit, valon. Pas 30 min temperaturës ngrihet deri në 320°C dhe ngrohja vazhdon deri në ndërprerjen e daljes së SO<sub>3</sub> në formë tymi të bardhë.

Përfshohen rreth 80 g.


#### 20.2.17. Pirosulfiti i natriumit



Pirosulfiti i natriumit është një pluhur i bardhë, me erë të fortë dioksid i squfurit. Në prani të ajrit, çliron dioksidit i squfurit dhe bashkohet me oksigjenin duke u shndërruar në sulfat natriumi. Tretet mirë në ujë (39,5 %, në 20°C); reaksiioni i tretësirës është acid. Gjatë ngrohjes së tretësirës mbi temperaturën 65°C shpërbëhet në sulfit natriumi dhe dioksidit i squfurit. Tretësira e Na<sub>2</sub>S<sub>2</sub>O<sub>5</sub> tretësqufurin duke dhënë Na<sub>2</sub>S<sub>2</sub>O<sub>3</sub>.

### 20.2.17.1. Gatinja e pirosalfitit tē natriumit

Gatinja e pirosalfitit tē natriumit tē klasifikimit (p.p.a.) bazohet nē reaksionet e mëposhtme:




Në një poc hidhen 80 g  $\text{NaHCO}_3$ <sup>1)</sup> dhe 400 - 600 ml ujë. Gurgullohet nē tē (nē kapë) një rrymë dioksidi squfuri (e larë paraprakisht nē ujë), deri nē ndërprerjen e plotë tē qelqit tē dioksidit tē karbonit. Në tretësirën e përfuar tē  $\text{NaHSO}_3$  hidhet një vëllim i barabartë alkooli etilik dhe pluhuri kristalor që bie, hidhet nē hinkën përfurtrim nē zbrazëti.


Përfstohen rreth 70 g pirosalfit natriumi.

### 20.2.18. Silikati i natriumit

#### a) Silikati i natriumit anhidër



#### b) Silikati i natriumit kristalhidrat



Silikati i natriumit  $\text{Na}_2\text{SiO}_3 \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  formon kristale pa ngjyrë tē sistemit rombik. Kripa anhidër është një masë amorfë gëlqerore. Silikati i natriumit tretet mirë nē ujë (15,8% e kripës anhidër, nē 20°C), kurse nē alkool etilik është i patretshëm.

Tretësira ujore e silikatit tē natriumit (qelqi i lëngët ose ujë qelqi) është e tejdukshme, e dendur, pa ngjyrë ose pak e verdhë nē tē gjelbër (gjurmë tē hekurit). Ka reaksiون bazik tē fortë; vepron me acidet (madje edhe me dioksidin e karbonit tē ajrit) dhe shndërrrohet nē një precipitat tē qullët, nē acid silicik. Tretësira e silikatit tē natriumit duhet tē ruhet nē enë me tapë gome. Uji i qelqit<sup>2)</sup> i zakonshtëm që prodhohet nē fabrikën e qelqit nē Tiranë, ka karakteristikat fizikokimike që jepen nē tabelën 20-6.

1)  $\text{NaHCO}_3$  mund tē zëvendësohet me 140 g  $\text{Na}_2\text{CO}_3 \cdot 10\text{H}_2\text{O}$  ose 40 g  $\text{NaOH}$ .  
2) Sipas literaturës nē përbërjen e ujit tē qelqit duhet tē ketë 30,58%  $\text{SiO}_2$  dhe 14,34%  $\text{Na}_2\text{O}$ . Përujë qelqi me përbërje tjeter, duhen bërë përllogaritjet përkatëse.

Nr.	Karakteristikat	
1.	Dendësia në 20°C në Be° (Bomé)	40-41
2.	Raporti (moduli) $\text{Na}_2\text{O} : \text{SiO}_2$	1:2,6-2,8
3.	Mbetje e patretshme, në përqindje	gjurmë
4.	Përberja kimike: $\text{SiO}_2$ , në përqindje $\text{Na}_2\text{O}$ , në përqindje $\text{K}_2\text{O}$ $\text{H}_2\text{O}$ , në përqindje Ngjyra	25-26 10,11 — 63-65 ngjyrë qumështi e turbullt


### 20.2.18.1. Gatiqë e silikatit të natriumit kristalhidrat

Preparati kristalor i  $\text{Na}_2\text{SiO}_3 \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  mund të përfshohet duke përzier «ujë qelqi» me tretësirë hidroksidi natriumi.


Në tretësirën e përfshuar nga tretja e 31,8 g NaOH në 200 ml ujë hidhen 100 g ujë qelqi. Përzierja trazohet dhe filtrohet nëpërmjet një filtri të dyfishtë, në mënyrë që të arrihet një tejdukshmëri e plotë. Në filtrat hidhen disa kristale të gatshme  $\text{Na}_2\text{SiO}_3 \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  dhe lihen 12 h. Kristalet që precipitojnë, ndahen dhe thahen me letra filtruese<sup>1)</sup>. Preparati hidhet në shishe dhe tapa vuloset me parafinë, përfshohen rreth 100 g kripë.

### 20.2.19. Sulfati i natriumit

#### a) Sulfati i natriumit anhidër



#### b) Sulfati i natriumit kristalhidrat




Sulfati i natriumit anhidër  $\text{Na}_2\text{SO}_4$  është pluhur i bardhë, kurse hidrati  $\text{Na}_2\text{SO}_4 \cdot 10\text{H}_2\text{O}$  formon kristale prizmatike të sistemit monoklin, pa ngjyrë, me shije të kripur të hidhur. Në ajërt reaktivi shndërrohet në pluhur të bardhë anhidër; në temperaturën  $32,4^\circ\text{C}$  shkrin në ujin e kristalizimit.

1) Literatura këshillon që tharja e kristaleve të bëhet në zbrazëti, në temperaturë jo më të lartë se  $30^\circ\text{C}$ .

### 20.2.19.1. Gatitja e sulfatit të natriumit

Sulfati i natriumit  $\text{Na}_2\text{SO}_4$  mund të përftohet duke asnjanësuar me acid sulfurik  $\text{H}_2\text{SO}_4$  karbonatin e natriumit  $\text{Na}_2\text{CO}_3$ , sipas barazimit:




Në tretësirën e acidit sulfurik me përqendrim 20% hidhet pak e nga pak karbonat natriumi  $\text{Na}_2\text{CO}_3$ , i pastër dhe i thatë, derisa të ndërpitet çlirimi i dioksidit të karbonit dhe të përftohet një tretësirë me reaksion të dobët bazik.<sup>1)</sup> Pastaj tretësira ngrohet deri në valim dhe filtrohet. Filtrati avullohet sa të fillojë kristalizimi. Gjatë ftohjes bien kristalet e  $\text{Na}_2\text{SO}_4 \cdot 10\text{H}_2\text{O}$ .


Për përfitimin e preparatit anhidër, hidrati  $\text{Na}_2\text{SO}_4 \cdot 10\text{H}_2\text{O}$  ngrohet në kupshore porcelani në temperaturë rrëth  $100^\circ\text{C}$ , derisa të shndërrrohet në një pluhur të bardhë të shkrifët.

### 20.2.20. Sulfiti i natriumit

#### a) Sulfiti i natriumit anhidër




#### b) Sulfiti i natriumit kristalhidrat




Sulfiti i natriumit anhidër  $\text{Na}_2\text{SO}_3$  është pluhur kristalor. Në ajër të thatë është i qëndrueshëm dhe oksidohet shumë më ngadalë se kristalhidrati.

Kristalhidrati  $\text{Na}_2\text{SO}_3 \cdot 7\text{H}_2\text{O}$  formon kristale të mëdha pa ngjyrë, të sistemit monoklin. Tretet mirë në ujë (20,7% të kripës anhidër, në  $20^\circ\text{C}$ ). Reaksioni i tretësirës ujore është alkalin. Në ajër pluhuroset dhe oksidohet, duke kaluar në sulfat natriumi  $\text{Na}_2\text{SO}_4$ . Gjatë ruajtjes në shishe, shtresa e sipërme e reaktivitet mbron nga oksidimi shtresën tjetër. Në temperaturën  $150^\circ\text{C}$  humbet ujin e kristalizimit; me nxehje më të fortë shkrin dhe jep përzierjen e sulfurit të natriumit  $\text{Na}_2\text{S}$  me sulfat natriumi  $\text{Na}_2\text{SO}_4$  sipas barazimit:



### 20.2.20.1. Gatitja e sulfitit të natriumit

Sulfiti i natriumit  $\text{Na}_2\text{SO}_3$  mund të përftohet nga bashkëveprimi i karbonatit të natriumit  $\text{Na}_2\text{CO}_3$  me dioksid squfuri  $\text{SO}_2$  sipas barazimeve:



1) Provat tregojnë se i duhet kushtuar kujdes kthimit të mjedisit acid në mjedis bazik.


Tretësira e përfshuar nga 80 g  $\text{Na}_2\text{CO}_3 \cdot 10\text{H}_2\text{O}$  në 160 ml ujë dhe e filtruar rdahet në dy pjesë. Një pjesë ngrohet në banjë uji deri në temperaturën 40°C dhe ngopet (në kripë) me dioksid sulfuri  $\text{SO}_2$ . Në tretësirën e përfshuar që përmban hidrogjensulfit natriumi  $\text{NaHSO}_3$ , hidhet pjesa tjetër e tretësirës së karbonatit të natriumit  $\text{Na}_2\text{CO}_3$ . Tretësira lihet për t'u kristalizuar, mundësishët duke e ruajtur nga kontakti me ajrin.

### 20.2.20.2. Pastrimi i sulfitit të natriumit


Sulfiti i natriumit  $\text{Na}_2\text{SO}_3 \cdot 7\text{H}_2\text{O}$  mund të pastrohet në këtë mënyrë: Përgatitet tretësirë e ngopur e sulfitit të natriumit (teknik) në temperaturën 33°C. Shtohet në të pak tretësirë e përqendruar hidroksidi natriumi (pëi precipitimin e joneve kalcium  $\text{Ca}^{2+}$ , magnez  $\text{Mg}^{2+}$  dhe të metaleve të tjera) dhe filtrohet. Filtrati ngrohet ngadalë deri në temperaturën 100-105°C; precipiton sulfiti i natriumit anhidër. Tretësira, e nxehëtë filtrohet shpejt në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe precipitati thahet në temperaturën e mjedisit.

### 20.2.21. Sulfuri i natriumit

#### a) Sulfuri i natriumit anhidër



#### b) Sulfuri i natriumit kristalhidrat



Sulfuri i natriumit anhidër  $\text{Na}_2\text{S}$  është pluhur me ngjyrë të bardhë ose të verdhë në të kuqe. Kristalhidrati  $\text{Na}_2\text{S} \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  formon kristale të mëdha, pa ngjyrë, të tejdukshme ose të ngjyrosur lehtë. Në ajër kripa thith lagështirë, por nuk qullet; oksidohet ngadalë.

Tretet në ujë; tretësira ujore ka reaksiون alkalin. Tretësira e sulfurit të natriumit oksidohet shpejt, prandaj duhet ruajtur në një shtresë vajguri.

### 20.2.21.1. Pastrimi i sulfurit të natriumit

Reaktivi  $\text{Na}_2\text{S} \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  mund të përfshohet nga pastrimi i produktit teknik. Treten (në kapë) 200 g sulfur natriumi  $\text{Na}_2\text{S}$  (teknik) në 200 ml ujë të nxehëtë dhe tretësira filtrohet me letër filtruese të valëzuar (pala-pala). Filtrati flohet me akull, duke e përzier me viull. Kristalet e vogla të verdha që precipitojnë (300-350 g) ndahen me filtrim në zbrazëti dhe hidhen në një kupshore porcelani, ku shtohet përzierja e 8 ml ujë me 0,1 g hidroksid bariumi  $\text{Ba}(\text{OH})_2$ . Pastaj nxehen, filtrohen dhe stohen. Kristalet hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti. Për pastrimin përfundimtar treten në 5 ml ujë, ku shtohen 1-2 g oksid zinku  $\text{ZnO}$ , përzihen me k ujdes dhe pas lëndies në qetësi filtrohen. Filtrati flohet me akull, duke e përzier

vazhdimisht, Kristalet<sup>1)</sup> e bardha që precipitojnë, hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti.

Në qoftë se duhet të gatitet kripe anhidër, atëherë preparati thahet 24 h në eksikator (me zbrazëti), me klorur kalciumi  $\text{CaCl}_2$  anhidër.

Në qoftë se kristalet përfshohen me ngjyrë të verdhë, atëherë përsëritet kristalizimi duke i shtuar pak oksid zinku.


#### 20.2.21.2. Gatitja e sulfurit të natriumit kristalhidrat

Sulfuri i natriumit  $\text{Na}_2\text{S} \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  mund të përfshohet nga hidroksidi i natriumit dhe sulfuri i hidrogjenit  $\text{H}_2\text{S}$ .

Treten 25 g hidroksid natriumi  $\text{NaOH}$  (i pastër) në 100 ml ujë. Pas filtrimit tretësira ndahet në dy pjesë. Në njëren pjesë (në kapë) gurgullohet  $\text{H}_2\text{S}$  deri në ngopjen e plotë. Hidhet në të pjesa tjeter e tretësirës dhe filtrohet (me hinkë për filtrim në zbrazëti) shpejt, duke e mbyllur hinkën me xham sahati, për të penguar futjen e ajrit. Filtrati avullohet në temperaturën 50-55°C në zbrazëti<sup>2)</sup>, në banjë uji deri në gjysmën e vëllimit. Përzierja me kristale të  $\text{Na}_2\text{S} \cdot 9\text{H}_2\text{O}$  tretet në një sasi të vogël uji. Tretësira e përfshuar futet në një shishe me grykë të gjerë dhe shohet me akull, duke e përzier shpejt (këshillohet që në tretësirë të hidhet një kristalth i  $\text{Na}_2\text{S} \cdot 9\text{H}_2\text{O}$ ). Kripa e precipituar hidhet shpejt në hinkën për filtrim në zbrazëti, lahet 2-3' herë me alkool etilik (nga 3 ml) dhe hidhet në një shishe me tapë gome.

Përfshohen rrëth 40 g kripë.


#### 20.2.22. Tartrati i natriumit dhe i kaliumit (kripë Senjeti)



Tartrati i natriumit dhe i kaliumit formon kristale të mëdha pa ngjyrë, të sistemit rombik. Në temperaturën 70-80°C, shkrin në ujin e kristalizimit, kurse në 100°C shndërrohet në monohidrat  $\text{KNaC}_4\text{H}_4\text{O}_6 \cdot \text{H}_2\text{O}$ ; dhe në 130°C humbet molekulën e fundit të ujit. Me ngrohje të mëtejshme shpërböhët, duke çliruar oksid karboni dhe ujë. Masa e shkrumbosur, që mbetet pas gëlqerizimit, formon  $\text{eKNaCO}_3$ . Kripa e Senjetit tretet mirë në ujë, (35,4%, në 20°C), kurse në alkool etilik nuk tretet.

#### 20.2.22.1. Gatitja e tartratit të natriumit e të kaliumit

Preparati përfshohet duke vepruar sasi të njëjta të karbonatit të kaliumit, dhe të karbonatit të natriumit me acidin tartrik.



1) Nga 200 g tretësirë sulfuri natriumi (teknik) që prodhohet në Uzinën e Përpunimit të Thellës të Naftës në Ballsh, përfshohen rrëth 35 g  $\text{Na}_2\text{S}$ .

2) Provat tregojnë se ky proces mund të kryhet edhe pa zbrazëti, por temperatura e tretësirës nuk duhet të kalojë 45°C.

Në tretësirën e ngrohtë të 36 g  $K_2CO_3$  në 90 ml ujë, hidhet dalngadalë acid tartrik deri në reaksion të dobët bazik (sipas provave duhen rreth 45 g acid). Shtohen në të 36 g  $Na_2CO_3$  dhe acid tartrik deri në reaksion të dobët bazik, ndaj fenolftaleinës. Për të precipituar sulfuret e metaleve, në tretësirë gurgullohet sulfur hidrogjeni<sup>1)</sup>. Pastaj, tretësira valohet deri në largimin e sulfurit të hidrogenit, filtrohet dhe stohet.


Kristalet që bien, hidhen në hinkën përfiltrim në zbrazëti (ose në hinkë të zakonshme) dhe thahen me letra filtruese.

Përftohen rreth 70 g kripë.


Sipas literaturës, në rast se substancat nistore janë të klasifikimit i pastër (p), preparati i përfkuar pas dy kristalizimesh i përgjigjet klasifikimit i pastër për analizë (p.p.a.).

### 20.2.23. Tetraborati i sodiumit (boraksi)

#### a) Tetraborati i sodiumit anhidër



#### b) Tetraborati i sodiumit kristalhidrat



Tetraborati i sodiumit anhidër  $Na_2B_4O_7$  formon copa qelqore pa ngjyrë që, po të lihen në ajër, thithin lagështirën dhe humbasin tejdukshmérinë (turbullohen).

Në temperaturën  $1575^\circ C$  kripa shpërbëhet.

Hidrati  $Na_2B_4O_7 \cdot 10H_2O$  formon kristale prizmatike, të bardha dhe të forta. Me ngrohje në temperaturën  $75^\circ C$  shkrin, shkumëzon, humbet ujin e kristalizimit dhe shndërrohet në një masë qelqore. Deri në temperaturën  $200^\circ C$  monohidrati  $Na_2B_4O_7 \cdot H_2O$  («boraksi i pashuar») është i qëndrueshëm. Çhidratimi i plotë arrihet në temperaturën  $400-450^\circ C$ . Tetraborati i sodiumit tretet pak në ujë (2,58 %, në  $20^\circ C$ ) dhe shumë mirë në glicerinë, kurse në alkool etilik pothuajse nuk tretet. Tretësira ujore e tetraborati ka reaksion bazik (ndaj laksosit).

#### 20.2.23.1. Pastrimi i tetraboratit të sodiumit (teknik)

Preparati kristalor përftohet me anë të rikristalizimit të boraksit teknik.


Në 150 ml ujë, me temperaturë jo më lartë se  $60^\circ C$ , treten 70-75 g boraks teknik. Tretësira filtrohet në filter të rrudhosur (pala-pala) dhe hidhet në një kupshore porcelani. Duke e përzier (pa ndërpërje) filtratin me shufër qelqi, përftohet preparati në formën e një mielli kristalor.

1) Punohet në kapë.

Kristalet ndahen me filtrim në zbrazëti, lahen me pak ujë të ftohtë dhe thohen në ajër 2-3 h.


**Shënim.** Sipas literaturës, preparati i përfshuar në këtë mënyrë i përgjigjet me përpikëri formulës  $\text{Na}_2\text{B}_4\text{O}_7 \cdot 10\text{H}_2\text{O}$ .

Tetraborati i natriumit kristalor mund të përfshohet edhe nga asnjanësimi i karbonatit të natriumit me acid borik:




Në tretësirën e përfshuar nga 60 g  $\text{Na}_2\text{CO}_3$ , në 540 ml ujë, treten 50 g  $\text{H}_3\text{BO}_3$ . Lëngu filtrohet. Filtrati avullohet deri në dendësi  $1600 \text{ kg/m}^3$  dhe ftohet. Kristalet që bien, ndahen me filtrim, lahen me pak ujë të ftohtë dhe thahen në temperaturën e mjedisit.

#### 20.2.24. Tiosulfati i natriumit (hiposulfiti i natriumit)



Tiosulfati i natriumit formon kristale të mëdha të tejdukshme (në formë prizmi), të sistemit monoklin. Në ajër reaktivë është i qëndrueshëm; në temperaturën  $56^\circ\text{C}$  shkrin në ujin e kristalizimit, në  $100^\circ\text{C}$  çhidratohet dhe me gëlqerizim shpërbëhet:



Në acide të forta shpërbëhet duke qiruar squfur dhe dioksid squfuri. Tretet mirë në ujë (41,2% e kripës anhidër, në  $20^\circ\text{C}$ ), dhe reaksiioni i tretësirës është bazik i dobët, kurse në alkool etilik është i patretshëm.

Ka veprim helmues në aparatin tretës.

Tiosulfati i natriumit (teknik) që prodhohet në Ndërmarrjen Kimike Durrës është në formë pluhuri kristalor, me ngjyrë të bardhë, shkëlqim karakteristik dhe me veçoritë fiziko-kimike që jepen në tabelën 20.7.

Tabela 20.7

Treguesit	norma në përqindje
tiosulfat natriumi	më shumë se 98,7
sulfat dhe sulfit natriumi	më pak se 1,0
oksid hekuri (III)	më pak se 0,004
kripëra të kalciumit	më pak se 0,005
lagështirë	më pak se 0,8

##### 20.2.24.1. Pastrimi i tiosulfatit të natriumit teknik

a) Reaktivë i pastër mund të përfshohet me kristalizimin e produktit teknik. Në 150 ml ujë të nxeh të treten 350 g kripë dhe tretësira filtrohet. Pastaj, ftohet në  $0^\circ\text{C}$ , me përzierje të pandërrerë, që të përfshohen kristale sa më të imëta,

Kripa që vëçohet (225 g), hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe rikristalizohet edhe një herë, po në këto kushte.

Sipas kësaj metodike reaktivi i përfstuar, zakonisht, i përgjigjet klasifikimit (p.p.a.).

Nga tretësira mëmë mund të vëçohet një preparat më pak i pastër.

b) Fër të përfstuar reaktiv të pastër, të përshtatshëm për qëllime analitike, kripa e pastruar me rikristalizim shtypet (thërrmohet) në alkool etilik. Masa e përfstuar hidhet në letër filtruese, duke e lënë të rrjedhë alkooli. Pastaj, kripa laget me alkool etilik absolut dhe eter dietilik. Preparati lihet 48 h duke e mbuluar me letër filtruese dhe hidhet në një kuti të thatë.

Reaktiv i pastruar në këtë mënyrë duhet të përbajë 99,93%  $\text{Na}_2\text{S}_2\text{O}_3 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$ .

## 21. Nikeli dhe përbërjet e tij

### 21.1. Nikeli

Ni    M = 58,71 g/mol  
t.shk. = 1455°C

d = 8909 kg/m<sup>3</sup>  
t.vl. = 2900°C

Nikeli është metal me ngjyrë të bardhë, të argjendtë. Në temperaturë të zakonshme nuk oksidohet dhe është shumë i qëndrueshëm ndaj brejtjes. Me oksigjenin bashkëvepron në temperaturë 500°C. Nikeli, në formë pluhuri të imët dhe me nxehësi, vepron lehtë me squfurin, fosforin, arsenikun, antimonin etj. Në acid sulfurik e klorhidrik tretet pak, kurse në acid nitrik të holluar tretet mirë. Është shumë i qëndrueshëm ndaj alkaleve; kurse në tretësirat amoniakore në prani të karbonatit të amonit, tretet duke formuar kripëra komplekse (amoniakate) të tretshme në ujë. Amoniakatet e nikelite kanë ngjyrë blu të theksuar.,

### 21.2. Përbërjet e nikelite

#### 21.2.1. Kloruri i nikelite (II)

##### a) Kloruri i nikelite (II) anhidër

$\text{NiCl}_2$                     M = 129,62 g/mol                    d = 3350 kg/m<sup>3</sup>

##### b) Kloruri i nikelite (II) kristalhidrat


$\text{NiCl}_2 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$                     M = 237,72 g/mol

Kloruri i nikelite anhidër formon plu hur të verdhë ose kristale (fletë) të shndritshme me ngjyrë të verdhë në kafe. Është hidroskopik; në ajër të lagësht qullet dhe shndërrohet në kristalhidrat me ngjyrë të gjelbër. Tretet mirë në ujë (39%, në 20°C) dhe në alkool etilik.

Kristalhidrati  $\text{NiCl}_2 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$  formon kristale të sistemit monoklin me ngjyrë të gjelbër, që thërrmohen në ajër të thatë dhe që qullen në ajër me lagështirë. Është i tretshëm në ujë dhe në alkool etilik.

### 21.2.1.1. Gatitja e klorurit të nikelite (II)

a) Kloruri i nikelite (II) anhidër ose i hidratuar «pa kobalt», që shërben si lëndë nistore për gatitjen e kripërave të tjera të nikelite mund të përftohet nga sulfati i nikelite (II) kristalhidrat sipas barazimeve të reaksioneve<sup>1)</sup>:



Në 200 ml hidroksid amoni ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ) hidhen 100 g  $\text{NiSO}_4 \cdot 7\text{H}_2\text{O}$  (teknik). Përzierja tundet dhe lihet 12 h (për të oksiduar papastërtitë e  $\text{Fe}^{2+}$ ). Pastaj lëngu filtrohet. Gjatë filtrimit në sipërfaqen e filtratit nuk duhet të formohet cipë e murrme (në rast të kundërt përzierja mbahet edhe 24 h). Në filtrat shtohen 50 g  $\text{NH}_4\text{Cl}$  (p.). Kristalet që bien, hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti, lahen me tretësirën e 20 g  $\text{NH}_4\text{Cl}$  (p.p.a.) në 100 ml  $\text{NH}_4\text{OH}$  ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ), thahen dhe gëlqerizohen (në kapë) në kupshore nikeli në temperaturën  $450^{\circ}\text{C}$  (duke e përzier shpesh).

Përftohen rrëth 35 g klorur nikeli (anhidër).

Kristalhidrati  $\text{NiCl}_2 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$  gatitet në këtë mënyrë:

Kloruri i nikelite i përfstuar tretet në 90 ml ujë dhe filtrohet. Filtrati acidifikohet pak me 2 ml tretësirë 10% acidi klorhidrik (p.p.a.) dhe ngrohet deri në valim. Për të precipituar jonet  $\text{SO}_4^{2-}$  shtohet me pika 1-2 ml tretësirë 3% e  $\text{BaCl}_2$  dhe filtrohet. Pastaj, avullohet në  $75-80^{\circ}\text{C}$  deri në formimin e cipës kristalore. Kristalet që formohen gjatë ftohjes (rrëth 30 g), hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe ruhen në shishe me tapë të smeriluar.

Me avullimin e tretësirës mëmë mund të përftohen rrëth 20 g preparat; gjithsej përftohen rrëth 50 g klorur nikeli (II) kristalhidrat.


b) një metodë e thjeshtë për të përfstuar preparat «pa kobalt», bazohet në precipitimin e  $\text{NiCl}_2$  nga tretësira ujë-propanon (aceton) me klorur hidrogjeni.

Në tretësirën pothuajse të ngopur të klorurit të nikelite (II) shtohen 4 vëllime propanon, përzierja ngrohet në temperaturën rrëth  $50^{\circ}\text{C}$  dhe në të gurgullohet (në kapë) një rrymë e fortë kloruri hidrogjeni, deri në fundërrimin e precipitatit kristalogjor. Tretësira dekantohet, kristalet hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe lahen me propanon.

Rendimenti është rrëth 80%.

1) Papastërtitë e kobaltit mbeten në tretësirë.

### 21.2.2. Nitrati i nikelit




$$\begin{aligned}M &= 290,81 \text{ g/mol} \\d &= 2050 \text{ kg/m}^3\end{aligned}$$

Nitrati i nikelite (II) formon kristale të sistemit monoklin me ngjyrë të gjelber smeraldi. Në ajër të thatë gërryhet lehtë, kurse në ajër me lagështirë qullet. Në 56,7°C reaktiv i tretet në ujin e kristalizimit; me ngrohje të mëtejshme humbet tri molekula ujë dhe acidin nitrik, kurse me gëlqerizim shpërbëhet dhe mbetet  $\text{Ni}_2\text{O}_3$ .

Eshtë i tretshëm në ujë dhe në alkool etilik.

#### 21.2.2.1. Gatitja e nitratit të nikelite (II)

Për të përfstuar nitratin e nikelite (II), veprohet me acid nitrik mbi karbonatin e nikelite (II):






Përzihen duke i tundur 46 g karbonat nikeli (II) me 140 ml ujë. Në përzierjen e përfstuar shtohen dalëngadalë 84 ml acid nitrik ( $d = 1400 \text{ kg/m}^3$ ). Tretësira avullohet deri në vëllimin 140 ml dhe ftohet. Kristalet që bien, hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe ruhen në një shishe të mbyllur mirë.

Përftohen rrëth 35-38 g nitrat nikeli (II).

Sipas kësaj metodike, në rast se substancat nistore janë të klasifikimit të pastër (p.), reaktivi i përstuar i përgjigjet klasifikimit i pastër (p.).

Tretësira mëmë me avullim jep edhe një sasi të vogël reaktivi.

Nitrati i nikelit (II) (p.p.a.) «pa kobalt» mund tē përftohet duke u nisur nga kloruri i nikelit (II) (p.p.a.) «pa kobalt» (shih gatitja e  $\text{NiCl}_2$ ), sipas metodikës së bazuar në këto reaksione:



Në një kupshore porcelani hidhen 57,5 g klorur nikeli (II) anhidër, 50 ml uje dhe 90 ml acid nitrik (p.p.a.) me dendësi  $1400 \text{ kg/m}^3$ . Përzierja avullohet (në kapë) në banjë uji deri në gjendje qulli dhe pastaj gëlqerizohet në banjë rrëre me pote nikeli ose porcelani, në temperaturën  $500^\circ\text{C}$ .

Oksidi i nikelite (II) i përfstuar (rrreh 33 g) provohet për praninë e joneve klorur  $\text{Cl}^-$  (prova me tretësirë nitrati argjendi). Në qoftë se zbulohen jone klorur  $\text{Cl}^-$ , oksidi i nikelite (II) lahet me ujë të ngrohtë. Pasi të tretet në 58 ml acid nitrik (p.p.a.) me dendësi  $1400 \text{ kg/m}^3$ , ngrohet dhe filtrohet. Filtrati avullohet deri në formimin e cipës kristalore dhe stohet. Kristalet hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe ruhen në shishe me tapë të smeriluar.

Përfstohen rrreth 100-120 g nitrat nikeli (II).

### 21.2.3. Oksidi i nikelit (III)



M = 165,42 g/mol


d = 4830 kg/m<sup>3</sup>

Oksidi i nikelit (III) formon kokrriza të zeza të shndritshme që thërmohen, pluhurosen lehtë. Është i patretshëm në ujë. Me acidin sulfurik dhe acidin nitrik vepron duke çliruar oksigjen, kurse me acidin klorhidrik çliron klor.

Oksidi i nikelit (III) është oksidues i fortë.

#### 21.2.3.1. Gatitja e oksidit të nikelit (III)

Oksidi i nikelit (III) mund të përftohet nga oksidimi i kripërave të Ni<sup>2+</sup> me hipoklorit natriumi:



Në 500 ml ujë treten 250 g NaOH dhe tretësira e përfstuar lihet 10-12 ditë në një shishe të myllur me tapë gome. Pastaj, hollohet me ujë deri në dendësi 1332 kg/m<sup>3</sup> (tretësirë 30%).

Në tretësirën e filtruar të 165 g NiCl<sub>2</sub> · 6H<sub>2</sub>O «pa kobalt» (shih gatitja e NiCl<sub>2</sub> · 6H<sub>2</sub>O) hidhen 100 ml nga tretësira e gatitur e NaOH dhe duke e përzier shtohen dalëngadalë 250-300 ml tretësirë NaClO. Përzierja lihet 12 h, precipitati i përfstuar hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe lahet me ujë të ngrohtë, derisa në ujérat e larjes të mos ketë më jone klorur Cl<sup>-</sup> ( prova me tretësirë nitratit argjendi). Pastaj, precipitati hidhet përsëri në hiakën për filtrim në zbrazëti, thahet në 100°C; lahet me ujë të ngrohtë (rreth 3 l) dhe thahet përfundimisht në 130°C.

Përftohen rreth 50 g preparat i pastër.

### 21.2.4. Sulfati i nikelit (II)

#### a) Sulfati i nikelit (II) anhidër



M = 154,78 g/mol

d = 3680 kg/m<sup>3</sup>

#### b) Sulfati i nikelit (II) kristalhidrat



M = 289,89 g/mol

d = 1948 kg/m<sup>3</sup>

Sulfati i nikelit anhidër i përfstuar nga gëlqerizimi i NiSO<sub>4</sub> · 7H<sub>2</sub>O është një masë e verdhë e shndritshme, që në ajër merr ngjyrë të gjelbër (si pasojë e bashkimit me ujin). Tretet mirë në ujë (25,5%, në 15°C); është i patretshëm në alkool etilik dhe në eter dietilik.

Nga tretësirat ujore, në varësi të kushteve, kristalizojnë hidrate të ndryshme:

NiSO<sub>4</sub> · 7H<sub>2</sub>O kristalizon në temperaturën 15-20°C dhe formon kristale, si smeraldi, të sistemit rombik.

NiSO<sub>4</sub> · 6H<sub>2</sub>O kristalizon në temperaturën 30-40°C dhe formon kristale me ngjyrë blu në të gjelbër, të sistemit tetragonal.


Sulfati i nikelit  $\text{NiSO}_4 \cdot 7\text{H}_2\text{O}$  që prodhohet në Kombinatin Kimiko-Metalurgjik në Laç ka veçoritë fiziko-kimike që jepen në tabelën 21.1.

Tabela 21.1

Treguesit	Përbajtja në përqindje
Ni	20,65
Cu	0,002
Pb	0,0005
Co	0,43
Fe	0,00026
Zn	0,002
Mbetje	0,03

#### 21.2.4.1. Gatitja e sulfatit të nikelit anhidër

Një preparat i pastër «pa kobalt» mund të përftohet duke u nisur nga kloruri i nikelit anhidër «pa kobalt» (shih gatitjen e  $\text{NiCl}_2$ ), sipas reakzionit:



Në tretësirën e 35 g klorur nikeli në 80 ml ujë hidhen (në kapë) 18 ml acid sulfurik ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ). Reaksiuni shoqërohet me çlirim të një sasicë të madhe nxehësie dhe kloruri hidrogjeni. Pasi mbaron reaksiuni, tretësira avullohet deri në tharje; mbetja gëlqerizohet në banjë rrere. Pastaj shtohen në të 150-200 ml ujë, valohet deri në tretjen e plotë dhe filtrohet. Filtrati avullohet në 70-75°C deri në formimin e cipës kristalore dhe ftohet. Kristalet që bien, hidhen në hindkën përfiltrim në zbrazëti dhe thahen në temperaturën e mijedisit, midis letash filtruase.

Përftohen rreth 70 g sulfat nikeli anhidër.

## 22. Oksigjeni dhe ozoni

### 22.1. Oksigjeni

$O_2$

$M = 31,999 \text{ g/mol}$

$t.\text{shk.} = -218,8^\circ\text{C}$

$t.\text{vl.} = -182,97^\circ\text{C}$

$d_{(15^\circ\text{C})} = 1156 \text{ kg/m}^3$

(në  $-186^\circ\text{C}$ )

Oksigjeni është gaz pa ngjyrë, pa erë dhe pa shije. Në kushte normale, 1 l oksigjen peshon 1,4289 g; dendësia e oksigjenit sipas ajrit është 1,1053. Është fare pak i tretshëm në ujë ( $0,031 \text{ vëllim oksigjen në 1 vëllim ujë, në } 20^\circ\text{C}$ ). Oksigjeni ndil mën shumë djegien, prandaj në mëdës oksigjeni të pastër digjen substanca të tilla, si për shembull hekuri, të cilat nuk digjen në ajër.

#### 22.1.1. Gatitja e oksigjenit

a) Sasi të vogla oksigjeni mund të përfshohen me anë të shpërbërjes termike të kloratit të kaliumit, në prani të një katalizatori; si katalizator mund të përfloret dioksidi i manganiit ose oksidi i hekurit (III):



Kujdes! Klorati i kaliumit dhe katalizatori nuk duhet të përmbajnë si papastërti lëndë organike (p.sh. qymyi, letër, etj.), sepse mund të ndodhë shpërthim i fortë.

Në fillim, për tu bindur që oksigjeni do të çirohet qetësisht, në një lugë metalike gëlçerizhet një sasi e vogël e përzierjes vepruese<sup>1)</sup>. Fastaj, në një provë të madhe hidhet pëzierja e 1 pjese në masë klorat kalumi me 0,5 pjese në masë katalizator ( $Mr.O_2$ ). Përmbajtja e provëzës ngrohet me flakë të fortë (më e përshtatshme është llambë me gaz). Oksigjeni që çlirchet, mund të përmbajë si pa-

1) Disa shkëndija që mund të duken në përzierje nuk paraqesin irrezik.


astërti sasi të vogla klori, prandaj, për t'u pastruar gurgullohet në tretësirë hidroksidi kaliumi.

b) Nga shpërberja termike e permanganatit të kaliumit oksigjeni përfshohet sipas barazimit:



Ngrohja kryhet si dhe te klorati i kaliumit dhe nga 32 g permanganat kaliumi përfshohen 1,7 l oksigjen.

c) Oksigjeni mund të përfshohet edhe nga shpërberja katalitike e peroksidit të hidrogenit:



Dioksid i manganit (p.) i thërrmuar trashë, pasi të sitet për të hequr pluhurin, vihet në sferën e mesme të aparatit të Kippit (në të cilën janë vendosur fije asbesti). Aparati mbushet me tretësirën, e cila gatitet duke hedhur me stohje 150 ml acid sulfurik ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ) në 1 l  $\text{H}_2\text{O}_2$  3%. Oksigjeni që çlrohet (në aparatin e Kippit), është mjaf i pastër. Kur punohet me sasi të vogla, në vend të aparatit të Kippit, mund të përdoret një poç konik.

Shënim. Oksigjeni që prodhohet në Ndërmarrjen Kimike në Durrës përpërdorim në industri dhe në mjekësi, i trysuar në bombola çeliku, ka këta tregues:

Përbajtja e oksigenit-jo më pak se 98,5%.

Përbajtja e lagështires - jo më shumë se 0,07 %.

Për qëllime laboratorike mund të përdoren kameradare të posaçme të mbushura me oksigjen.

## 22.2. Ozoni

$$\begin{array}{lll} \text{O}_3 & M = 48,00 \text{ g/mol} & d = 1710 \text{ kg/m}^3 \\ & t.shk. = -197,2^\circ\text{C} & t.vl. = -111,9^\circ\text{C} \end{array}$$

Ozoni është gaz me ngjyrë të kaltër të hapët (sipas disa të dhënavës është parëngjyri), me erë karakteristike (me përqendrime të mëdha ka erën e klorit), që ndihet madje edhe me një hollim 1 : 100 000.

Ozoni i lëngët ka ngjyrë vjollcë të errët, kurse ozoni i ngurtë ka ngjyrë të zezë në vjollcë.

Në ujë tretet më mirë se oksigjeni (në 1 vëllim ujë, në temperaturën  $0^\circ\text{C}$  dhe trysni 101,3 kPa, treten 0,49 vëllime ozon). Ajri i tretur në ujë është 20 herë më i pasur me ozon sesa ajri atmosferik. Ozoni tretet mirë në acid etanoik të akullt (glacial) dhe në tetraklorur karboni dhe foimon tretësira me ngjyrë hiri të errët. Ozoni i përqendruar, me ngrohje të shpejtë, pëlcet me fuqi të madhe, kurse i lëngët dhe i ngurtë pëlcet me goditje. Në përqendrime të mëdha ozoni shkakton dhembje koke.

## 22.2.1. Gafitja e ozonit

Ozoni mund tē gatitet nga oksigjeni, nân veprimin e shkarkesave elektrike, sipas barazimit:



në aparate që quhen ozonatorë<sup>1)</sup>.

Puna duhet tē kryhet në kapë dhe tē zbatohen masat e mbrojtjes gjatë përdorimit tē rrymës me tension tē lartë.

Ozoni për disa minuta e shkatërron gomën, prandaj gypat e qelqit te ozonatorët (nëpër tē cilët kalon gazë) duhet tē bashkohen buzë më buzë ose tē ngjiten me njëri-tjetrin.

---

1) Për përdorimin e ozonatorit shih librin e misuesit «Kimia 1».

## 23. Plumbi dhe përbërjet e tij

### 23.1 Plumbi

Pb

M = 207,19 g/mol  
t.shk. = 327,3°C

d = 11.34 kg/m<sup>3</sup>  
t.vl. = 1751°C

Plumbi i pastër është metal i shndritshëm, me ngjyrë të kaltër në të hirtë. Në ajër me lagështirë humbet shkëlgimin dhe mbulohet me një cipë okside, e cila e mbron nga oksidimi i mëtejshëm. Me ngrohje oksidohet plotësisht deri në PbO. Në ujë, me tepricë ajri dhe dioksid karboni, plumbi dalëngadalë shndërrohet në karbonat bazik plumbi (në formën e kristaleve të shndritshme).

Plumbi «i sfungjertë» është masë poroze me ngjyrë të hirtë të errët, që oksidohet lehtë në ajër:

Avujt e plumbit d'he përbërjet e tij janë shumë helmuese.

#### 23.1.1. Gatitja e plumbit

##### a) Gatitja e plumbit të kokërruar

Për gatitjen e plumbit të kokërruar (gra nuluar) metali i shkrirë hidhet me pika në ujë, nga një lartësi 5 m. Në këto kushte përfshohen kokrriza të përshtatshme për qëllim e laboratorike.

##### b) Gatitja e plumbit të «sfungjertë»

Për gatitjen e plumbit të «sfungjertë» në një fletë zinku vendoset një shtresë brumi e përgatitur nga  $\text{PbSO}_4$  dhe uji më trashësi 25 mm. Kjo shtresë mbulohet me një fletë tjeter zinku dhe futet në tretësirë k'loruri natriumi. Pas 9-10 ditësh sulfati i plumbit  $\text{PbSO}_4$  shndërrohet në plumb sfungjeror metalik.

## 23.2. Përbërjet e plumbit

### 23.2.1. Etanoati i plumbit (acetati i plumbit)



M = 379,33 g/mol

d = 2550 kg/m<sup>3</sup>

Etanoati i plumbit (II) for mon kristale të mëdha të tejdukshme të sistemi<sup>t</sup> monoklin, që gjerryhen shpejt në ajër dhe mbulohen me një shtresë karbonat plumbi  $\text{PbCO}_3$ . Në ajër të thatë (mbi acid sulfurik të përqendruar) humbet ujin e kristalizimit që në temperaturën 40°C. Në 75°C shkrin në ujin e kristalizimit, kurse me ngrohje të mëtejshme shndërrohet në një pluhur të bardhë, në kripë anhidër  $\text{Pb}(\text{CH}_3\text{COO})_2$ , me temperaturë shkrirjeje 280°C.

Tretet mirë në ujë (60% kripë anhidër, në 20°C) dhe në glicerinë (17%, në 20°C), kurse në eter dietilik është i patretshëm.

Etanoati i plumbit është su bsthancë helmuese.

#### 23.2.1.1. Pastrimi i etanoatit të plumbit

Preparati i pastër mund të përfshohet duke pastruar produktin teknik:

Në 100 ml tretësirë 1% acidi etanoik treten me ngrohje 100 g kripë. Tretësira e ngrohtë filtrohet dhe kristalet që bien gjatë ftohjes, veçohen me dekantim dhe thahen me letra filtruese.

Tretësira mëmë avullohet deri në gjysmën e vëllimit dhe kristalizohet.


Në qoftë se lënda e parë përmban si papastërti përbërje të hekurit, tretësira valohet me një sasi të vogël  $\text{PbO}_2$ ; shtohet në të  $\text{PbO}$  dhe valohet përsëri. Precipitati që përmban  $\text{Fe(OH)}_3$ , filtrohet; tretësira acidifikohet me acid etanoik dhe avullohet deri në kristalizim.

Sipas literaturës me këtë metodikë përfshohet reaktiv i klasifikimit: i pastër për analizë (p.p.a.).

#### 23.2.1.2. Gatitja e etanoatit të plumbit


Etanoati i plumbit gatitet në këtë mënyrë:

Në tretësirën e ngrohtë të acidit etanoik me përqendrim 50% tretet oksid plumbi (II), deri në përfitimin e tretësirës së ngopur;



Pas filtrimit, në tretësirë shtohet pak  $\text{CH}_3\text{COOH}$  dhe avullohet deri në kristalizim (dendësia e tretësirës të arrijë 1400 kg/m<sup>3</sup>). Kripa që kristalizon gjatë ftohjes, veçohet nga tretësira mëmë dhe thahet me letra filtruese.

### 23.2.2. Hidroksidi i plumbit




$M = 241,20 \text{ g/mol}$

Hidroksidi i plumbit (II) është pluhur i bardhë mikrokristalor; në ajër thith dalëngadalë dioksidin e karbonit dhe shndërrrohet në karbonat plumbi. Është praktikisht i patretshëm në ujë, tretësira ujore e tij ka reaksion të dobët bazik (ka veti amfotere). Me ngrohje, në temperaturën  $130\text{-}145^\circ\text{C}$ , çhidratohet.

#### 23.2.2.1. Gatitja e hidroksidit të plumbit

Për të gatitur reaktivin e pastër, vihet të veprojë një kripë e  $\text{Pb}^{2+}$  me ujin amoniakor:



Në tretësirën e ngrohtë të  $100 \text{ g Pb}(\text{NO}_3)_2$  (teknik) në  $300 \text{ ml ujë}$ , shtohen  $2\text{-}2,5 \text{ ml NH}_4\text{OH}$  ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ). Përzierja, së bashku me precipitin e  $\text{Pb}(\text{OH})_2$  (që bie), valohet disa minuta. Gjatë valimit, papastërtitë e  $\text{Fe}^{3+}$  precipitojnë në formë  $\text{Fe}(\text{OH})_3$ . Tretësira ngrohet deri në temperaturën  $65\text{-}70^\circ\text{C}$ ; shtohen në të, duke e përzier me vrull,  $40 \text{ ml tretësirë amoniakore}$  ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ) deri në precipitin e plotë të  $\text{Pb}(\text{OH})_2$  (mund të teprojnë  $1,5\text{-}2 \text{ ml tretësirë amoniakore}$ ).

Precipitati lahet me dekantim, me ujë të ngrohtë, që përmban  $1\%$  në vëllim  $\text{NH}_4\text{OH}$  ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ); larja bëhet deri në largimin e joneve nitrat  $\text{NO}_3^-$  (në ujërat e larjes me shtimin e  $1 \text{ ml tretësirë difenilamine}$  në acid sulfurik mund të shfaqet një ngjyrë e kaltër shumë e hapët). Hidroksidi i plumbit (precipitati) filtrohet në hinkën përfiltrim në zbrazëti, thahet në temperaturën  $105^\circ\text{C}$  dhe thërritet në havan. Përftohen rrëth  $65 \text{ g}$  reaktiv i pastër.

### 23.2.3. Joduri i plumbit



$M = 461,00 \text{ g/mol}$   
t.shk. =  $412^\circ\text{C}$

$d = 6160 \text{ kg/m}^3$   
t.vl. =  $872^\circ\text{C}$


Joduri i plumbit (II) në formë pluhuri ka ngjyrë të verdhë, kurse në krishtale të mëdha formon fletë të arta të shndritshme të sistemit hekzagonal. Me ngrohje ngjyroset në fillim në të verdhë të kuqe, pastaj të kuqe tulle dhe në fund, kafe të errët. Po të ftohen, fiton përsëri ngjyrën e mëparshme (të verdhë). Tretet pak në ujë ( $0,076\%$ , në  $25^\circ\text{C}$ ), kurse në tretësira të përqendruara të jodurit të kaliumit dhe të jodurit të natriumit tretet mirë, duke formuar përbërje komplekse. Me hollimin e këtyre tretësirave me ujë, bie përsëri  $\text{PbI}_2$ .

#### 23.2.3.1. Gatitja e jodurit të plumbit

Në tretësirën e ngrohtë të  $52 \text{ g jodur kaliumi}$  në  $120 \text{ ml ujë}$  hidhet me curril të hollë (duke e përzier) tretësira e  $60 \text{ g Pb}(\text{CH}_3\text{COO})_2 \cdot 3\text{H}_2\text{O}$  në  $120 \text{ ml ujë}$ .

Precipitati lahet me dekantim me ujë 8-10 herë, hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti; thahet në 80-90°C dhe thërrmohet (në kapë) në pluhur të imët. Përtohen rrëth 75 g jodur plumbi.

### 23.2.4. Karbonati i plumbit (II)




Karbonati i plumbit (II) është pluhur i bardhë. Në temperaturën 300°C shpërbëhet plotësisht në PbO dhe CO<sub>2</sub>. Po të valohet ngadalë në ujë, çliron CO<sub>2</sub> dhe shndërrohet në karbonat bazik plumbi. Tretet në acid nitrik (të holluar), në acid etanoik, si dhe në tretësirë të hidroksidit të kaliumit dhe të hidroksidit të natriumit; në ujë tretet fare pak.

#### 23.2.4.1. Gatitja e karbonatit të plumbit (II)

Karbonati i plumbit (II) mund të gatitet në këtë mënyrë:

Në tretësirën e ftohur deri në 10-12°C të 12 g Na<sub>2</sub>CO<sub>3</sub> në 100 ml ujë, hidhet tretësira e 33 g Pb(NO<sub>3</sub>)<sub>2</sub> ose e 38 g Pb(CH<sub>3</sub>COO)<sub>2</sub> · 3H<sub>2</sub>O në 150 ml ujë. Precipitati i PbCO<sub>3</sub> (që bie) hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti, lahet me kujdes me ujë dhe thahet në 30-40°C. Përftohen rrëth 26 g kripe.

### 23.2.5. Karbonati bazik i plumbit



Karbonati bazik i plumbit është pluhur i dendur amorf me ngjyrë të bardhë. Me ngrohje n.bë 100°C shndërrohet në PbO. Është i patretshëm në ujë dhe në alkool etilik, tretet në acid nitrik, acid etanoik të holluar si dhe në tretësirë hidroksidi kaliumi dhe hidroksidi natriumi.

#### 23.2.5.1. Gatitja e karbonatit bazik të plumbit

Në tretësirën e 50 g Pb(CH<sub>3</sub>COO)<sub>2</sub> · 3H<sub>2</sub>O ose 43,5 g Pb(NO<sub>3</sub>)<sub>2</sub> në 250 ml ujë hidhet dalëngadalë 28 g NaHCO<sub>3</sub> i ngurtë (ose tretësirë e 8 g Na<sub>2</sub>CO<sub>3</sub> në 8 ml ujë dhe 9-10 g NaHCO<sub>3</sub>).

Precipitati i PbCO<sub>3</sub> që bie, lahet me ujë dhe shtohet në të tretësirë karbonati bazik plumbi<sup>1)</sup>. Përzgjaja trazohet mirë. Pas precipitimit precipitati filtrohet, lahet me kujdes me ujë dhe preschet mes letrash filtruese.

1) Për të gatitur këtë tretësirë në 125-150 ml ujë, tretet 25 g Pb(CH<sub>3</sub>COO)<sub>2</sub> · 3H<sub>2</sub>O dhe shtohen në të 15 g PbO i thërrmuar imët.

### 23.2.6. Kloruri i plumbit (II)



$M = 278,10 \text{ g/mol}$   
t.shk. =  $501^\circ\text{C}$

$d = 5850 \text{ kg/m}^3$   
t.vl. =  $956^\circ\text{C}$

Kloruri i plumbit (II) formon kristale të imëta, të sistemit rombik në formë gjilpërash ose fletësh me shkëlqim. Në gjendje të shkrirë, me stohje, ngurtësohen në një masë të bardhë (në formë brirësh).

Kloruri i plumbit (II) është pak i tretshëm në ujë (1,05%, në  $25^\circ\text{C}$ ); po të hichtet në tretësirën ujore të  $\text{PbCl}_2$ , acid klorhidrik 10%, tretshmëria zvogëlohet.

#### 23.2.6.1. Gatitja e klorurit të plumbit (II)

Gatitja e  $\text{PbCl}_2$ , sipas metodikës së mëposhtme, bazohet në veprimin e acidit klorhidrik me kripërat e  $\text{Pb}^{2+}$ .

a) Në 1800 ml ujë hidhen 15 ml acid klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ). Tretësira e acidit ngrohet deri në valim dhe treten në të 15 g  $\text{PbCO}_3$ . Pastaj, stohet deri në temperaturën  $0^\circ\text{C}$  dhe lëngu derdhet. Kristalet e  $\text{PbCl}_2$  hidhen në hinkë për filtrim në zbrazëti, lahen me 5-10 ml ujë në temperaturë  $0^\circ\text{C}$  dhe thahen nën temperaturën  $40^\circ\text{C}$  (në të kundërtën, ka mundësi të ndodhë hidroliza e pjesshme).

Përfshken rreth 13 g klorur plumbi (II).

b) Në 80 ml ujë treten 40 g  $\text{Pb}(\text{CH}_3\text{COO})_2 \cdot 3\text{H}_2\text{O}$ . Shtohen në të 15 g  $\text{PbO}$  (teknik); valchet deri në tretjen e  $\text{PbO}$  dhe filtrohet. Në filtrat hidhen 34 ml acid klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ) dhe pas precipitimit, lëngu derdhet në një enë tjetër.<sup>1)</sup> Kristalet e  $\text{PbCl}_2$  hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe lahen me 15 ml ujë të stohtë.

Në lëngun e mbledhur hidhen 25 g oksid plumbi (II), ngrohen deri në tretje dhe filtrohen. Në filtrat shtohen 25 ml acid klorhidrik  $\text{HCl}$  ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ); kristalet që bien, hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe lahen me 10-15 ml një të stohtë.

Kristalet e përfshura nga precipitimi i parë dhe precipitimi i dytë thahen në temperaturën rreth  $25-35^\circ\text{C}$ .

Përfshken rreth 75 g kripë<sup>2)</sup>.

### 23.2.7. Kromati i plumbit (II)



$M = 323,18 \text{ g/mol}$

$d = 6120 \text{ kg/m}^3$   
t.shk. =  $844^\circ\text{C}$

Kromati i plumbit (II) amorf, i përfshuar me anë të precipitimit, është pluhur me ngjyrë të verdhë. Kurse kromati i plumbit kristalor formon kristale të kuqe, të tejdukshme ose kristale me ngjyrë kafe të errët të sistemit monoklin. Me ngrohje kripë e verdhë bëhet e kuqe (me stohje merr ngjyrën fillestare). Kripë e shkrirë,


1) Lëngu duhet për të vepruar me oksidin e plumbit  $\text{PbO}$ .

2) Sipas literaturës reaktivi i përfshuar i përgjigjet klasifikimit: i pastër për analizë (p.p.a.).

po tē ftohet, ngurtësohet nē një masë me ngjyrë kafe tē errët, më ngrohje tē fortë çliron oksigjen. Kromati i plumbit është i patretshëm nē ujë; tretet nē acid nitrik dhe nē tretësirat e alkaleve.

### 23.2.7.1. Gatiqë e kromatit tē plumbit (II)

Për tē përfshuar kromatin e plumbit (II) precipitohet dikromati i natriumit me tretësirë tē etanoatit tē plumbit:



Në 450 ml ujë tē ngrohtë treten 75-80 g  $\text{Pb}(\text{CH}_3\text{COO})_2 \cdot 3\text{H}_2\text{O}$ . Në qoftë se shfaqet turbullirë, shtohen 1-2 ml acid etanoik, i cili filtrohet. Në tretësirën përfshuar, nē temperaturën 35-40°C, shtohet tretësirë e ngrohtë e filtruar e 35g  $\text{Na}_2\text{Cr}_2\text{O}_7 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$  (teknik) nē 450 ml ujë; përzihet mirë dhe pas precipitimit, filtrohet. Precipitati hidhet nē hinkën për filtrim nē zbrazëti, lahet me ujë dhe thahet nē 100-110°C. Preparati i thatë thërrmohet nē havan.

Përfshohen rrëth 65 g kromat plumbi (II).

Sipas kësaj metodike, reaktivi i përfshuar i përgjigjet klasifikimit: i pastër (p.).

Reaktivi i pastër për analizë (p.p.a.) mund tē përfshuhet nē këtë mënyrë: Kromati i plumbit (i thatë) i përfshuar sipas metodikës që thamë vendoset nē një pote, mbulohet me kapak dhe ngrohet ngadalë deri nē temperaturën 850°C. Në këtë temperaturë  $\text{PbCrO}_4$  shkrin duke valuar; masa e shkrirë valohet 6-7 min dhe hidhet nē një tas gize ose fletë çeliku. Pas ftohjes, kripa e ngurtësuar thërrmohet.

Rendimenti është 97%.

### 23.2.8. Nitratit i plumbit

$$\text{Pb}(\text{NO}_3)_2 \quad M = 331,20 \text{ g/mol} \quad d = 4530 \text{ kg/m}^3$$

Nitratit i plumbit (II) formon kristale më ngjyrë tē bërdhë tē sistemit këzik. Tretet mirë nē ujë (33,7 %, nē 20°C), pak nē alkool metilik dhe nuk tretet nē alkool etilik. Me ngrohje nē temperaturën mbi 200°C, shpërbëhet nē  $\text{PbO}$ ,  $\text{NO}_2$  dhe  $\text{O}_2$ .


### 23.2.8.1. Pastrimi i nitratit tē plumbit (II)

Për tē larguar papastërtitë e  $\text{Cu}^{2+}$  dhe tē  $\text{Fe}^{3+}$ , nitratit i plumbit precipitohet nē tretësirë me anë tē acidit nitrik, sipas kësaj metodike:

Në tretësirën e 37,5 g  $\text{Pb}(\text{NO}_3)_2$  nē 95 ml ujë hidhen duke e përzier fort, 100 ml  $\text{HNO}_3$  ( $d = 1240 \text{ kg/m}^3$ ) dhe tretësira lihet 1 h. Kristalet me përmasa të mëdha që bien, filtrohen nē hinkën për filtrim nē zbrazëti (në hinkë qelqi dhe pa letër filtruuese), lahen me porcione uji tē ftohtë dhe thahen nē temperaturën 30-40°C.

### 23.2.8.2. Gatitja e nitratit të plumbit (II)

Preparati mund të përfshohet duke tretur plumb metalik në acid nitrik:



Në 63 ml acid nitrik ( $d = 1400 \text{ kg/m}^3$ ) treten (në kapë) 50 g plumb i koktrizuar. Përzierja ngrohet në fillim dhe pastaj lihet të ftohet. Pas ftohjes pluhuri mikrokristalor që bie i  $\text{Pb}(\text{NO}_3)_2$ , lahet me dekantim 2-3 herë më acid nitrik, thithet me filter qelqi dhe rikristalizohet. Rikristalizimi bëhet në këtë mënyrë:

Në 55 ml ujë treten me ngrohje 75 g  $\text{Pb}(\text{NO}_3)_2$ . Shtohet në të tretësirë amoniakore ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ), deri në shfaqjen e një turbullire të qëndrueshme. Duke e pakësuar ngrohjen, futet në tretësirë një pllakë plumbi, 10-15 min; tretësira filtrohet shpejt dhe ftohet.

Kristalet që bien, hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti, lahen më 15-20 ml ujë dhe thahejn në  $80^\circ\text{C}$ .

Përfshohen rrëth 70 g reaktiv.


Sipas kësaj metodike, në rast se acidi nitrik i përdorur është i klasifikimit: i pastër për analizë (p.p.a.), edhe reaktivi i përfstuar i përgjigjet po këtij klasifikimi.

Preparati kimikisht i pastër (k.p.) mund të gatitet në këtë mënyrë:

Në 75 ml ujë treten me ngrohje 75 g  $\text{Pb}(\text{NO}_3)_2$  i klasifikimit (p.p.a.) dhe tretësira e ngrohtë filtrohet. Në filtrat shtohet 1 ml  $\text{HNO}_3$  (k.p.) ( $d = 1400 \text{ kg/m}^3$ ) dhe lihet të ftohet. Kristalet që bien, hidhen në hinkën (hinkë qelqi) për filtrim në zbrazëti dhe thahen.

Përfshohen rrëth 32 g reaktiv kimikisht i pastër (k.p.)

### 23.2.9. Oksidi i plumbit (II)



Oksidi i plumbit (II) formon kristale me ngjyrë të verdhë, të sistemit rombik ( $d = 8000 \text{ kg/m}^3$ ) ose kristale me ngjyrë të kuqe të sistemit tetragonal ( $d = 9530 \text{ kg/m}^3$ ). Mbi temperaturën  $587^\circ\text{C}$ , forma (modifikimi) e kuqe kalon në të verdhë (t.shk. =  $890^\circ\text{C}$ ; t.vl. =  $1473^\circ\text{C}$ ). Në ajër thith ngadalë dioksidin e karbonit. Është substancë fare pak e tretshme në ujë ( $1,7 \cdot 10^{-3}\%$ ) dhe ka reaksion bazik të dobët. Me tretësirat e ngrohta të  $\text{KOH}$  dhe  $\text{NaOH}$  formon plumbate. Oksidi i plumbit tretet në acid nitrik, në acid etanoik dhe në acid klorhidrik (shndërrohet në  $\text{PbCl}_2$ ).

#### 23.2.9.1. Gatitja e oksidit të plumbit [III]

Në një kupshore nikeli, në temperaturën  $750-900^\circ\text{C}^1$ , gjëqerizohen 100 g  $\text{Pb}(\text{OH})_2$  ose  $\text{PbCO}_3$  duke e përzier masën me shpatull nikeli. Gjëqerizimi zgjat 2-3 h, derisa përfshohet preparati më ngjyrë të njëjtë kafe - portokall. (Kujdes


1) Një temperaturë e tillë e afërt mund të arrihet kur nikeli skuqet lehtë.

Oksidimi i mëtejshëm i jep shkas formimit të  $Pb_3O_4$ .)

Përftohen rrëth 90 g.

Sipas kësaj metodike, në rast se substancat nistore janë të klasifikimit; i pastër për analizë (p.p.a.) edhe reaktivë i përfshuar i përgjigjet klasifikimit (p.p.a.).



Oksidi i plumbit (II) mund të përfshohet edhe duke u nisur nga etanoati i plumbit:



Në 600 ml ujë tretën 200 g  $Pb(CH_3COO)_2$ . Shthen në të 10 pika acid klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ) dhe filtohet në një kupshore të madhe porcelani. Tretësira e përfshuar ngrohet deri në temperaturën  $60^\circ\text{C}$ , hidhet në të (me curril të hollë, duke e përzier lehtë), tretësira tejdushme e 60 g KOH (ose e 45 g NaOH) në 550 ml ujë dhe valohet deri në kalimin e  $Pb(OH)_2$  me ngjyrë të bardhë në  $PbO$  me ngjyrë të verdhë të precipituar mirë (rrëth 1 h). Precipitati lahet me dekantim me ujë deri në largimin e joneve klorur  $Cl^-$  (pova me tretësirë nitriti argjjerdi), pastaj gëlcérizohet në kupshore porcelani në temperaturën  $600-650^\circ\text{C}$  dhe sfohet në ajër.

Përftohen rrëth 100 g oksid plumbi (II).


### 23.2.10. Oksidi i plumbit (IV)



Oksidi i plumbit (IV) është pluhur amorf kristalor me ngjyrë kafe të errët. Është pothuaje i patretshëm në ujë dhe në acidet e holluara, me përvashim të acidit oksalik. Me ngrohje, në temperaturë mbi  $290^\circ\text{C}$ , fillon të shpërbëhet dhe çliron oksigjen; në  $420^\circ\text{C}$  formohet  $Pb_3O_4$ . Është oksidues i fortë, thith  $SO_2$  duke u shndërruar në  $PbSO_4$  të bardhë. Me acid sulfurik të përqendruar të nxeh të çliron  $O_2$ , kurse me acid klorhidrik çliron  $Cl_2$ . Gjatë veprimit të  $H_2S$  me  $PbO_2$  të lagur, ky i fundit nxehet deri në skuqje.

#### 23.2.10.1. Gatitja e dioksudit të plumbit

Dioksid i plumbit mund të përfshohet nga kripërat e plumbit  $Pb^{2+}$ , duke i oksiduar ato me klor, në mëndis bazik:



Në tretësirën e 50 g  $Pb(CH_3COO)_2$  + 3 $H_2O$  në 150 ml ujë, hidhet tretësira përqendruar e 15 g  $Na_2CO_3$  dhe gurgullohet në të (në kapë) një rrymë e fortë klori, derisa masa të fitojë ngjyrë kafe të errët. Gypi nëpër të cilin kalon klori, duhet të futet pothuaj deri në fundin e enës së reaksionit. Pasi mbaron reaksiuni, përzierja ngrohet 1,5 h në tanjë uji. Lihet në qetësi dhe lëngu dekantohet. Përtë larguar papastërtitë e  $PbCO_3$  në precipitat shtohen disa pika acidi nitrik ( $d = 1150 \text{ kg/m}^3$ ). Pastaj, precipitati lahet me dekantim disa herë me ujë,

hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe lahet me ujë deri në largimin e plotë të joneve klorure  $\text{Cl}^-$ .<sup>1)</sup> Precipitati i përfshuar thahet në  $100^\circ\text{C}$ .

Përfshohen rrëth 25-30 g oksid plumbi (IV).

Sipas kësaj metodike, në rast se substancat nistore janë të klasifikimit; i pastër për analizë (p.p.a.), edhe reaktivi i përfshuar i përgjigjet po këtij klasifikimi.

Për të përfshuar sasi të vogla oksidi plumbi (IV), është mirë të përdoret për oksidimin e  $\text{Pb}^{2+}$  gëllqerja klorike:




Në fillim gatitet tretësira oksiduese. Për këtë, përzihen 75 g gëllqere klorike me 225 ml ujë (me kujdes duke i shtypur kokrrizat e gëllqeres). Pas precipitimit përzierja filtrohet nëpër një filter të dendur, duke e larë precipitatin me 50 ml ujë. Është mirë që, pas disa orësh, tretësira të filtrohet edhe një herë.

Tretësira e tejdukshme e gëllqeres klorike hidhet në një kupshore të madhe porcelani dhe, duke e përzier, shtohet në të tretësirë e ngrohtë ( $50^\circ\text{C}$ ) dhe e tejdukshme e 32,5 g  $\text{Pb}(\text{CH}_3\text{COO})_2 \cdot 3\text{H}_2\text{O}$  në 50 ml ujë. Precipitati i verdhë që bie, merr shpejt ngjyrë kafe. Përzierja ngrohet në temperaturën  $100-110^\circ\text{C}$  dhe pas 20-30 min provohet nëse precipitimi i  $\text{Pb}^{2+}$  është i plotë (në provën e përzierjes shtohet pak tretësirë  $\text{CaCl}_2$ ). Në qoftë se ka kripë të  $\text{Pb}^{2+}$ , që nuk ka vepruar, atëherë në përzierjen e reaksiionit hidhen 25-50 ml tretësirë e gëllqeres klorike dhe valohet 2 h. Precipitati i  $\text{PbO}_2$  lahet me dekantim me ujë të ngrohtë (duke e përzier fort) deri në largimin e joneve klorur (prova me tretësirë nitrati argjendi). Pas larjes, hidhen në të 50-70 ml  $\text{HNO}_3$  15% dhe lihet 2 h. Pastaj, lahet me dekantim (2-3 herë me ujë), hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe thahet në  $100^\circ\text{C}$ .

Përfshohen rrëth 100 g oksid plumbi (IV).

### 23.2.11. Oksidi i plumbit (II, IV)


(Ortoplumbat i plumbit)



Oksidi i plumbit (II,IV) (miniumi) është pluhur i kuq kristalor (me ngrohje ngjyra bëhet më e qartë). Në temperaturën mbi  $500^\circ\text{C}$  shpërbëhet duke çliruar oksigen atomik. Është i patretshëm në ujë. Tretet në acid etanoik të akullt (glacial). Acidi nitrik e shpërbën duke e shndërruar në  $\text{PbO}_2$  dhe  $\text{Pb}(\text{NO}_3)_2$ ; acidi klorhidrik e oksidon duke çliruar klor.

#### 23.2.11.1. Gatiqë e oksidit të plumbit (II dhe IV)

Preparati mund të përfshohet duke gëllqerizuar karbonatin e plumbit (II) në tepricë ajri:




<sup>1)</sup> Në provën e ujërave larëse, të acidifikuara pak me  $\text{HNO}_3$ , shtimi i tretësirës së  $\text{AgNO}_3$  nuk duhet të japë turbullirë.

Në një kupshore të sheshtë platin<sup>1)</sup>, të nxehur deri në një skuqje të dobët, hidhet  $\text{PbCO}_3$ , duke e përzier me shpatull nikeli. Pas shpërbërjes së  $\text{PbCO}_3$ , fillon procesi i oksidimit, zhvillimi i të cilit kontrollohet me analizë në përbajtje  $\text{Pb}_3\text{O}_4$ . Reaksioni quhet i përfunduar kur përbajtja e  $\text{Pb}_3\text{O}_4$  mbetet konstante.

Për të përcaktuar sasinë e  $\text{Pb}_3\text{O}_4$  në masën (mostrën) e dhënë, veprohet në këtë mënyrë: peshohen me përpikëri 0,3 g mostër dhe hidhen në një poç konik të vogël. Shtohet në të 1 ml  $\text{CH}_3\text{COOH}$  i akullt (glacial), 10 ml ujë dhe me pikë 4 ml tretësirë 20% joduri kaliumi. Përbajtja e poçit tundet fort; jodi që çlrohet, titullohet me tretësirë 1N  $\text{Na}_2\text{S}_2\text{O}_3$  (1 ml e tretësirës 1N  $\text{Na}_2\text{S}_2\text{O}_3$  i përgjigjet 0,03428 g  $\text{Pb}_3\text{O}_4$ ).

Pasi mbaron reaksioni (reaksioni zgjat disa orë), masa valohet disa herë me tretësirë 10% etanoati plumbi. Lëngu ende i ngrohtë dekantohet; precipitati filtrohet, lahet me ujë të ngrohtë dhe thahet.


### 23.2.12. Sulfati i plumbit



Sulfati i plumbit (II) është pluhur i bardhë, fare pak i tretshëm në ujë (0,0046%, në 18°C). Me tretësirat e alkaleve formon plumbite, kurse me tretësirat amoniakore të etanoatit dhe të tartratit të amonit formon kripëra dyfishe.

#### 23.2.12.1. Gatitja e sulfatit të plumbit (II)

Sulfati i plumbit (II) mund të përftohet duke precipitar kripërat e  $\text{Pb}^{2+}$  me acid sulfurik:




Në tretësirën e 83 g  $\text{Pb}(\text{NO}_3)_2$  në 250 ml ujë hidhet  $\text{H}_2\text{SO}_4$  (me përqendrim 15%), deri në precipitim e plotë të  $\text{PbSO}_4$ . Pas precipitimit, precipitati lahet 3-4 herë me dekantim me  $\text{H}_2\text{SO}_4$  2% (për largimin e joneve nitrat  $\text{NO}_3^-$ ), pastaj hidhet në hinkën përfiltrim në zbrazëti, lahet me ujë dhe thahet në temperaturën 200°C.

Rendimenti është 93%.

Sipas kësaj metodike, në rast se substancat nistore janë të klasifikimit i pastër për analizë (p.p.a.), edhe preparati i përfuar i përgjigjet këtij klasifikimi.

### 23.2.13. Sulfuri i plumbit (II)




Sulfuri i plumbit (II) është pluhur amorf me ngjyrë të zezë në kafe ose pluhur kristalor (i sistemit kubik) në ngjyrë të hirtë plumbi, që në temperaturën 800°C

1) Provat tregojnë se kupshorja e platinit mund të zëvendësohet me një kupshore të sheshtë nikeli ose inoksi.

fillon të avullojë pjesërisht. Reaktivi me ngrohje është i tretshëm në acid nitrik të holluar, kurse në ujë është pothuajse i patretshëm ( $8,67 \cdot 10^{-10}\%$ , në  $25^\circ\text{C}$ ).

### 23.2.13.1. Gatitja e sulfurit të plumbit

Preparati mund të përftohet nga veprimi i karbonatit të plumbit me squfurin.



Përzierja e  $25\text{ g PbCO}_3$  dhe  $6,12\text{ g}$  squfur pluhur ngrohet me kujdes në një pote të myllur mirë (por jo hermetikisht), në temperaturën  $300^\circ\text{C}$ . Me ftohje produkti thërrmohet dhe pluhu roset.

Përftohen rreth  $26\text{ g}$  sulfur plumbi amorf.

Për të gatitur  $\text{PbS}$  kristalor, gëlqerizohet me kujdes përzierja e 1 pjese në masë  $\text{PbS}$  amorf i thatë me 6 pjesë në masë  $\text{CaCO}_3$  dhe 6 pjesë në masë squfur, derisa masa të skuqet. Pas ftohjes, masa qullet me ujë. Precipitati i  $\text{PbS}$  hidhet në hinkën për filtrim në zbrazëti dhe lahet me acid klorhidrik të holluar.

## 24. Squfuri dhe përbërjet e tij

### 24.1. Squfuri

$$S \quad M = 32,06 \text{ g/mol} \quad t.vl = 444,6^\circ\text{C}$$

Squfuri i pastër është substancë kristalore, me ngjyrë të verdhë, pa erë e pa shije. Njihen disa forma alotropike: nga të cilat në kryesoret janë: squfuri rombik, squfuri monoklin dhe squfuri plastik.

Squfuri rombik formon kristale të mëdha, të thyeshme me  $d = 2070 \text{ kg/m}^3$  dhe  $t.shk = 112,8^\circ\text{C}$ . Tretet në sulfur karboni, në hidrokarbure, vajra eterike dhe në dioksid squfuri të lëngët. Në ujë është i patretshëm, kurse në alkool etilik dhe në eter dietilik është pothuajse i patretshëm.

Squfuri monoklin formon kristale me ngjyrë të verdhë në të kaltër, me  $d = 1960 \text{ kg/m}^3$ . Kalon shumë shpejt (brenda disa ditësh) në squfur rombik dhe çliron nxehësi. Temperatura (ose pikë) e kalimit është  $95,6^\circ\text{C}$  dhe  $t.shk. = 119,25^\circ\text{C}$ . Është i tretshëm në sulfur karboni dhe në toluol.

Squfuri plastik formon një masë me ngjyrë të verdhë në hiri (e ngjashme me rrëshirën). Tretet pjesërisht në sulfur karboni. Gjatë ruajtjes kalon dalëngadalë në squfur rombik.

Squfuri i përfstuar me ftohje të shpejtë të avujve është një pluhur me ngjyrë të verdhë të zbehtë që njihet me emrin «lule squfuri».

Në vendin tonë prodhohet squfur i rikuperuar nga gazet e përpunimit të naftës në Ballsh dhe nga gazet e kokut në Elbasan.

Squfuri i prodhuar në kombinatin metalurgjik «Çeliku i Partisë» në Elbasan ka jo më pak se 95% squfur dhe 1% lagështirë.

#### 24.1.1. Pastrimi i squfurit

- a) Squfuri teknik copëtohet dhe piuhuroset. Përzihen duke i tundur shpesht 10 pjesë në masë squfur i pluhurosur me 7 pjesë në masë ujë dhe 1 pjesë në masë hidroksid amoni. Pastaj, squfuri lahet me kujdes me ujë, thahet në temperaturë jo më të lartë se  $30^\circ\text{C}$ , dhe thërrmohet në pluhur.

b) Treten 100 g sfuqur në 250 ml sulfur karboni (Kujdes! Rrezik, zjarr!). Tretësira filtrohet, futet në një poç për distilim dhe avullohet në një banjë uji të ngrohur paraprakisht, deri në vëllimin 150-160 ml. Tretësira që mbetet, stohet sa më ngadalë dha lëngu dërdhet (ai mund të përdoret për të tretur sasi të tjera squfurit). Kristalet e squfurit thahen në letor filtruese, në temperaturën e mjedisit, 1-2 ditë, derisa të mos ndihet më era e sulfurit të karbonit.

Përftohen rreth 40 g squfur i pastër kristalor.

### 24.1.2. Gatiqja e formave alotropike të squfurit

Për të përfstuar squfurin rombik kristalizohet squfuri nga sulfuri i karbonit, në temperaturë të ulët (shih pastrimin e squfurit, pika/b).

Squfuri monoklin mund të përftohet me mënyrat e mëposhtme:

s) Squfuri shkrihet në pote dhe lihet të stohet pak. Pasi të formohet mbi sipërfaqe një kore mjaft e trashë, thyhet ajo dhe squfuri i lëngët që mbetet, derdhet. Në faqet e potes mbeten gjilpëra tërthore të squfurit monoklin.

b) Për të përfstuar squfur plastik, squfuri i ngrohar deri në valim hidhet në ujë të ftoh. ë.

## 24.2. Përbërjet e squfurit

### 24.2.1. Acidi sulfurik



$$M = 98,03 \text{ g/mol}$$

$$d = 1834 \text{ kg/m}^3$$

$$\text{t.vl.} = 290^\circ\text{C}$$

Acidi sulfurik është lëng pa ngjyrë, i trashë si vaj. Me ftuhej formon krisale, të cilat shkrijnë në temperaturën  $10,37^\circ\text{C}$ . Në  $30-40^\circ\text{C}$  acidi fillon të tymojë dhe me ngrohje të mëtejshme çliron avuj anhidridi sulfurik  $\text{SO}_3$ . Valimi fillon në  $290^\circ\text{C}$  dhe pastaj temperatura rritet shpejt, derisa të ndërpitet çlirimini i  $\text{SO}_3$ . Hidrati që mbetet, me përmbytje  $98,3\% \text{ H}_2\text{SO}_4$  valon në  $330^\circ\text{C}$ . Acidi sulfurik i përqendruar thith me etje të madhe lagështirën, karbonizon letrën, drurin dhe substancat e tjera organike. Gjatë përzierjes me ujin çliron një sasi të madhe nxehësie dhe shkakton spërkatje (kujdes!). Në lëkurë shkakton djegie të forta, plagë, që shërohen me vështirësi; rënia e tij në sy është shumë e rrezikshme.

Acidi sulfurik ruhet në shishe me tapë të smeriluar, të mbyllura mirë ose në bidonë prej plastmase. Për mbylljen e shishevë nuk duhet të përdoren tapa gome.

Në Kombinatin Kimiko-Metalurgjik në Laç prodhohet acid sulfurik i zakonshëm dhe acid sulfurik për bateri me veçoritë fiziko-kimike që jepen përkatësisht në tabelat 24.1 dhe 24.2.

Tabela 24.1

## Acidi sulfurik i zakonshëm

Treguesit	Norma në përqindje
përbajtja e $H_2SO_4$	jo më pak se 92
përbajtja e Fe	jo më pak se 0,03
përbajtja e mbeturinës së thatë	jo më pak se 0,2
përbajtja e $H_2O$	7

Tabela 24.2

## Acidi sulfurik për bateri

Treguesit	Norma në përqindje
përbajtja e $H_2SO_4$	92-94
dendësia	1,820-1,830
substanca të patretshme	jo më shumë se 0,003
përbajtja e Mn	jo më shumë se 0,0001
përbajtja e Fe	jo më shumë se 0,012
përbajtja e As	jo më shumë se 0,0001
përbajtja e Cl <sup>-</sup>	jo më shumë se 0,0001
përbajtja e NO <sub>3</sub> <sup>-</sup>	jo më shumë se 0,0001
përbajtja e SO <sub>3</sub>	jo më shumë se 0,001

## 24.2.1.1. Pastrimi i acidit sulfurik

a) Acidi sulfurik i klasifikimit (k.p.) mund të përfshohet me anë të distilimit të acidit sulfurik teknik.

Kujdes! Distilimi duhet bërë në kapë, duke zbatuar masat e teknikës së sigurimit (syzë, doreza gume, ekran mbrojtës dhe kundërgaz).

Në acid sulfurik teknik hidhet 1% në masë anhidrid kromik  $C_1O_3$  dhe lihet të precipitojë. Fasat, hidhet në një aparat distilimi (të gjitha pjesët e të cilit janë të laftkuara me lëdhje të smerilluara) prej qelqi zjarrdurues, me nxënësi rreth 2 l. Foci i distilimit mështilët me asbest dhe futet në një enë hekuri, që shëiten si kanjë ajri. Distilohet rreth 80-85% nga e gjithë sasia e acidit fillestar (mbeturinat, pas ftohjes së plotë, merren dhe përdoren për përzierje kromike).

Në acidin e distiluar gurgullohet 16 h një riyemë e ngadalte sulfuri hidrogjen. Fasat, përzierja lihet dy ditë dhe përsëri distilohet, duke derdhur 10% të pjesës së parë dhe të fundit të distilimit.

Në qoftë se acidi sulfurik pësrohet «për akumulatorë», atëherë përpunimi me sulfuri hidrogjeni dhe distilimi i dytë nuk duhet të bëhen.

b) Acidi sulfurik i ngjyrosur prej substancave organike (në ngjyrë kafe ose të zezë) murd të ngjyrosjet me anë të peroksidit të hidrogjenit. Për këtë, hidhet rë të 0,01-0,03% tretësirë 20% perokside hidrogjeni dhe përzihet.

Acidi fiton një ngjyrë të verdhë të zbehtë. Për pastrimin e acidit sulfurik, me ngjyrë krejtësisht të zezë, hidhet në të 1% tretësirë 30% peroksidi hidrogjeni.

### 24.2.2. Dioksidi i squfurit



$$M = 64,06 \text{ g/mol}$$

$$d = 1491 \text{ kg/m}^3 \quad (\text{në } -20^\circ\text{C})$$

$$t.\text{vl} = -10^\circ\text{C}$$

Dioksidi i squfurit është gaz pa ngjyrë me erë karakteristike mbytëse. Në kushte normale, 1 l peshon 2,9266 g. Tretet mirë në ujë dhe formon acidin sulfuror. Gjithashtu, tretet mirë në tretës organikë, si në alkool etilik, eter dietilik, e sulfur karboni. Dioksidi i squfurit nuk digjet dhe nuk ndihmon djegien. Ka veti të forta zbardhëse.


#### 24.2.2.1. Gatitja e dioksidit të squfurit

a) Dioksidi i squfurit mund të gatitet duke vepruar acidi sulfurik i përqendruar me bakrin (me ngrohje):



Në një poc me fund të rrumbullt, të pajisur me gyp zhvillimi dhe hinkë ndarëse me acid sulfurik ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ) hidhen 50 g tallash bakri<sup>1)</sup> dhe 28 ml acid sulfurik ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ). Përzierja ngrohet, derisa fillon reaksiuni i vrullshthon me pikë, me anë të hinkës ndarëse edhe 30-35 ml acid sulfurik. Gazi që çlirohet, lahet me ujë dhe thahet duke e gurgulluar në një shtyllë me klorur kalciumi të gëlqerizuar.

b) Më e përshtatshme është që dioksidi i squfurit të përftohet nga veprimi i acidit sulfurik me një kripë të acidit sulfuror, për shembull me sulfit natriumi:



Në një poc që përmban tretësirë të ngopur  $\text{Na}_2\text{SO}_3$ , hidhet me pikë  $\text{H}_2\text{SO}_4$  ( $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ ). Gazi që çlirohet, thahet duke e gurgulluar në një gyp me klorur kalciumi të gëlqerizuar dhe në një shishe me acid sulfurik.

### 24.2.3. Acidi sulfuror



$$M = 82,07 \text{ g/mol}$$

Acidi sulfuior njihet vetëm në tretësirë ujore dhe është shumë i paqëndrueshëm, ruhet në të ftohtë dhe vetëm për një kohë të shkurtër. Përgatitet para përdorimit. Tretësira e tij ka erë karakteristike. Në ajër oksidohet ngadalë dhe shndërrohet në acid sulfurik.

1) Puna duhet të kryhet në kapë.

### 24.2.3.1. Gatitja e acidit sulfuror

Për të gatitur acidin sulfuror, dioksidi i squfurit i përstuar (shih gatitja e  $\text{SO}_2$ ) gurgullohet në një poç konik me 50-100 ml ujë.

Gurgullimi në ujë duhet të vazhdojë deri në ngopjen e plotë të ujit me  $\text{SO}_2$ . Tretësira e përgatitur e acidit sulfuror përdoret ashtu e përqendruar dhe hollohet me ujë të ftohtë në raportin 1:1.

Tretësira ujore e ngopur në temperaturën  $0^\circ\text{C}$  përmban 18,60%  $\text{SO}_2$ , kurse në temperaturën  $20^\circ\text{C}$  përmban 10,14%  $\text{SO}_2$ .

### 24.2.4. Sulfuri i hidrogjenit



$$M = 34,08 \text{ g/mol}$$

$$t.\text{shk.} = -82,9^\circ\text{C}$$

$$t.\text{vl.} = -60,8^\circ\text{C}$$


Sulfuri i hidrogjenit është gaz pa ngjyrë me erën e vezëve të prishura. Në kushte normale, 1 l peshon 1,5392 g. Është i tretshëm në ujë (në 1 l ujë, në temperaturën  $20^\circ\text{C}$ , treten 2,91 l) dhe në alkool etilik. Përzierja e  $\text{H}_2\text{S}$  me ajrin, po të ndizet, shpërthen.

Tretësira ujore e  $\text{H}_2\text{S}$  (acidi sulfhidrik) është një acid shumë i dobët, dybazik. Në prekje me ajrin tretësira ujore e  $\text{H}_2\text{S}$  dalengadalë turbullohet duke qiruar squfur. Për të shmangur shpërbërjen, këshillohet që në tretësirën ujore të  $\text{H}_2\text{S}$  të shtohet 2% sheqer ose 1% acid salicilik.

Sulfuri i hidrogjenit ka veti të forta helmuese. Përqendrimë të papërfillshme shkaktojnë veprim irritues në rrugët e frysma marrjes, në sy dhe dhembje. Përqendrimi në më shumë se 1 mg/l është i rrezikshëm për jetën.

#### 24.2.4.1. Gatitja e sulfurit të hidrogjenit

a) Në laborator, zakonisht, sulfuri i hidrogjenit përstohet nga veprimi i tretësirës 20% të acidit klorhidrik ose tretësirës 25% të acidit sulfurik me sulfürin e hekurit:



Reaksiioni është mirë të kryhet në aparatin e Kippit, në kapë.

Për t'u pastruar nga  $\text{AsH}_3$ , gazi, që del, gurgullohet në katër shishe larëse (1,2,3,4) që përmbajnë përkatësish:

shishja (1) tretësirë 8% acidi klorhidrik

shishja (2) tretësirë 5% acidi klorhidrik

shishja (3) tretësirë 2,5% acidi klorhidrik

shishja (4) ujë të distiluar.

Shisjet bashkohen me gypa qelqi duke përdorur tapa lëvoreje (jo tapa gome) dhe vihen në banjë uji në  $60-70^\circ\text{C}$ .

Pastrimi nga  $\text{AsH}_3$  mund të bëhet edhe me mënyrën e mëposhtme:


Sulfuri i hidrogjenit (g) i tharë mbi  $\text{CaCl}_2$  ose  $\text{P}_2\text{O}_5$  gurgullohet në një gyp në formën e shkronjës U të mbushur me përzierjen e jodit të thatë me lesh qelqi

(jodi bashkohet me  $\text{AsH}_3$ , dhe formon  $\text{AsI}_3$ ). Pastaj, gazi gurgullohet në një shishe me ujë dhe më pas (në qoftë se duhet) thahet mbi  $\text{P}_2\text{O}_5$ . Në asnjë mënyrë nuk duhet të përdoret për tharje acid sulfurik, sepse e oksidon sulfurin e hidrogjenit.

Për t'u pastruar nga oksigjeni, këshillohet të gurgullohet në një tretësirë kloruri kromi (II), kurse për t'u pastruar nga  $\text{CO}_2$  në ujë gëlqereje.

Sulfuri i hidrogjenit mblidhet në gazometër të mbushur me ujë të ngrohtë (për të pakësuar tretshmërinë e gazit). Më e përshtatshme është që të mblidhet në gazometër të mbushur me ujë të mbuluar me një shtresë 5-10 mm vaji parafine.

b) Sulfuri i hidrogjenit mund të përfshohet edhe nga sulfuri i natriumit:



Në një shishe me dy gryka hidhet  $\text{Na}_2\text{S}$  (teknik) dhe shtohet me anë të hinkës ndarëse tretësirë 5-10% acidi i klorhidrik. Tretësira e acidit hidhet me pika, ngadalë dhe duke e lëkundur e rrötulluar shishen (për një njomje të njëtrajtshme). Shtesa e tepërt e acidit klorhidrik mund të jep shpërthim të tapës dhe, madje thyerje të shishes. Pastimi i gazit mund të kryhet si më sipër (rasti a).

c) Për të përfshuar sasi të vogla sulfuri hidrogjeni, mund të përdoret kjo metodikë:

Përzihen 25 g parafinë e shkrirë me 15 g «ule squfuri», derisa të përfshohet një masë e njëtrajtshme. Pastaj shtohen në të edhe 7 g Kiselgur<sup>1)</sup> dhe përzierja ftohet: Kur arrin temperaturia 30-40°C, formohet një pastë me trashësi rrëth 20 mm. Nga kjo pastë pa u ftohur, priten me anë të një gypi ose me anë të një shpuseseje tapash «crotulla» të përshtatshme, me diametër rrëth 6 mm. Një copëz (me masë rrëth 0,5 g) e tillë vihet në një provëz (të kapur në një shtrënguese pravëzash) të pajisur me një gyp zhvillimi dhe ngrohet deri në 170°C. Veçohen rrëth 120 mg  $\text{H}_2\text{S}$  (mbi 300 cm<sup>3</sup>) me pastërti 97-98%.

#### 24.2.4.2. Gatiqë e tretësirës së sulfurit të hidrogjenit

Sulfuri hidrogjenit i gaztë gurgullohet (në kapë) në një sasi të vogël uji, pastaj në një poç konik me ujë të ftohtë (poçi nga jashtë ftohet me një përzierje të akullit me kripë gjelle). Shpejtësia e daljes së gazit duhet të jetë: një flusku gazi në 2 s. Ngopja kryhet për 15-25 min.

Gjatë eksperimenteve laboratorike duhet gjithnjë të përdoret tretësirë ujore e porsapërgatitur sulfuri hidrogjeni. Për ta ruajtur për një kohë sa më të gjatë, tretësira, hidhet në një shishe të mbushur sa më plot, që mbyllët me tapë të lye, me parafinë dhe vendoset në vend të errët.

1) Kiselgur (diatomit, tokë silicore, tokë infuzorësh), shkëmb fundërror i shkrifët ose pak gjimetuar, që përbëhet kryesisht prej skeleteve silicore të disa bimëve të vogla ujore të quajtura diatome. Tregohet në trajtë bloqesh, pluhuri ose kokrrash. Përdoret për filtrim kullim dhe çangjyroje lëngjesh (në prodhimin e sheqerit, të birrës, të verës, të vajrave etj.) në prodhimat qeramike etj.

## 25. Zinku dhe përbërjet e tij

### 25.1. Zinku

Zn       $M = 65,37 \text{ g/mol}$   
tshk. =  $419,5^\circ\text{C}$

$d = 7140 \text{ kg/m}^3$   
t.vl. =  $913^\circ\text{C}$

Zinku është metal i shndritshëm, me ngjyrë të bardhë, me shkëlqim të hirtë të kaltër (formon kristale të sistemit hekzagonal). Është i qëndrueshëm në ajër dhe në prani të dioksidit të karbonit, me një cipë të hollë hidroksidi ruan metalin nga oksidimi i mëtejshëm. Tretet mirë në acide dhe në tretësirën e ngrrohtë të hidroksidit të kaliumit.

Zinku i pastër është shumë plastik dhe mund të petëzohet në fletë të holla; metali i pastër teknikisht nuk është plastik (në të ftohtë), por, kur nxehet në temperaturën  $100-150^\circ\text{C}$ , bëhet plastik dhe farkëtohet.

#### 25.1.1. Gatitja e zinkut

Për të gatitur zinkun e kokërrzuar (granular), metali i shkrirë derdhet në ujë të ftohtë në formë currili të hollë. (Kujdes! Të përdoren syze mbrojtëse e dorezal!)

Zinku i pastër tretet shumë ngadalë në acide. Për ta bërë të tretshëm në acide (për qëllime laboratorike), zinku i kokërrzuar vëndoset në shtresë të hollë, në një furrë në temperaturë  $400^\circ\text{C}$ ; mbahet 3-4 h dhe pastaj lihet të ftohet ngadalë. Zinku humbet shklqimin, por vepron shumë shpejt me acidet.

Për të përfthuar zink pluhur, metali i shkrirë hidhet në një havan hekuri të ngrorur deri në temperaturën  $200^\circ\text{C}$  dhe, porsa të nguroset, goditet me rrahës dorezë havani. Zinku thërrmohet në pluhur. (Kujdes! duart mbrohen me doreza të trasha.)


Pluhuri i zinkut zakonisht përmban 80-90% Zn, 5-15%  $\text{ZnO}$ , sasi të ndryshme Cd, Pb, Fe dhe ndonjëherë sasi të vogla As, Sb, Cu e  $\text{SiO}_2$ .

Për të pastruar pluhurin e zinkut, veprohet në këtë mënyrë: 15 g pluhur zinku përpunoohen gjatë 1 h, në temperaturën  $30^\circ\text{C}$ , me tretësirë dikromati kaliumi (treten 2-4 g  $\text{K}_2\text{Cr}_2\text{O}_7$  në 50 ml ujë). Pastaj, lahen 15 min me përzierjen

e ngrohtë (në 40-50°C) të gatitur nga 2 ml tretësirë hidroksidi amoni ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ) dhe tretësira e 3 g kloruri amoni në 50 ml ujë.  
Pluhuri i zinkut i përfshuar përmban afro 95-97% zink.

## 25.2. Përbërjet e zinkut


### 25.2.1. Etanoati i zinkut (acetati i zinkut)



Etanoati i zinkut formon kristale të shndritshme, në formë kokrrizash gjashtë-këndëshe. Në temperaturën 100°C hidrati humbet ujin dhe shndërrohet në  $\text{Zn}(\text{CH}_3\text{COO})_2$  me  $d = 1840 \text{ kg/m}^3$ , t.shk. = 235-237°C. Në temperaturë të lartë shpërbëhet dhe çliron proponon. Tretet mirë në ujë (28,5%, në 20°C).

#### 25.2.1.1. Gatitja e etanoatit të zinkut


Etanoati i zinkut gatitet nga veprimi i oksidit të zinkut me acid etanoik.



Në 300 ml tretësirë 20% acidi etanoik, të ngrohur në temperaturën 75-80°C, hidhen 50 g oksid zinku teknik dhe tretësira filtrohet. Filtrati, pasi t'i shtohen 8-10 ml  $\text{H}_2\text{O}_2$  3%, ngrohet deri në valim dhe hidhet në të me pikë tretësirë 2% etanoati bariumi  $\text{Ba}(\text{CH}_3\text{COO})_2$ , derisa në tretësirë të mbetet një sasi e papërfillshme jonesh sulfat  $\text{SO}_4^{2-}$ . Përkëtë bëhet prova (me pak filtrat) me  $\text{Ba}(\text{CH}_3\text{COO})_2$  (mungesa e turbullirës tregon për precipitimin e plotë të joneve sulfat  $\text{SO}_4^{2-}$ ).

Pastaj, në tretësirë hidhen 5 g  $\text{ZnCO}_3$  i porsaprecipituar; përzierja valohet 5 min, ngrohet 40-50 min në banjë uji (për ngjizjen e precipitatit) dhe filtrohet. Në filtrat hidhet acid etanoik  $\text{CH}_3\text{COOH}$ , derisa të ndihet era e dobët e tij. Krishtalitet që bien, hidhen në hinkën për filtrim në zbrazëti. Kurse tretësira mëmë avullohet deri në formimin e cipës kristalore dhe kristalizohet. Kripa thahet në temperaturën e mjedisit.

### 25.2.2. Hidroksidi i zinkut




Hidroksidi i zinkut amorf është pluhur i bardhë, i shkrifët, me përbajtje të ndryshme uji. Në ujë është pothuajse i patretshëm ( $PT = 7,1 \cdot 10^{-13}$ ); me ngrohje shndërrohet në  $\text{ZnO}$ .

Hidroksidi i zinkut kristalor formon kristale të gjata të sistemit rombik. Preparati që thahet në temperaturën  $40\text{--}50^\circ\text{C}$ , i përgjigjet formulës  $\text{Zn(OH)}_2$ ; në  $100^\circ\text{C}$  fillon të humbasë ujin. Hidroksidi i zinkut është bazë e dobët (në  $25^\circ\text{C}$   $K_1 = 4,4 \cdot 10^{-5}$ ;  $K_2 = 1,5 \cdot 10^{-9}$ ), pothuajse e patretshme në ujë.

### 25.2.2.1. Gatitja e hidroksidit të zinkut

Për të përfshir hidroksidin e zinkut amorf, tretësira e nitratit të zinkut  $\text{Zn(NO}_3)_2$  precipitohet me një sasi hidroksidi kaliumi<sup>1)</sup>:



Precipitati që përfshihet, lahet me kujdes.

Hidroksidi i zinkut kristalor mund të përfshihet nga karbonati i zinkut  $\text{ZnCO}_3$  në këtë mënyrë: hidhen 1,25 g karbonat zinku, i thërrmuar imët, në tretësirën e 2,25 g hidroksidi kaliumi, në 400 ml ujë dhe përzierja tundet. Pas disa minutash bien kristale të imëta të hidroksidit të zinkut, kristalizimi përfundon pas 20 min.

Kurse nga sulfati i zinkut përfshihet si më poshtë:

Në tretësirën e 2,8 g hidroksidi kaliumi KOH në 50 ml ujë, hidhet me buretë ngadalë dhe me pika tretësirë sulfati zinku 2N. Precipitati që bie, në fillim, tretet, pastaj lëngu turbullohet dhe po të hidhen disa kristalthe  $\text{Zn(OH)}_2$ , precipiton pluhuri i kokërruar i rëndë i hidroksidit kristalor.

### 25.2.3. Karbonati i zinkut

$$\text{ZnCO}_3 \quad M = 125,38 \text{ g/mol} \quad d = 4440 \text{ kg/m}^3$$

Karbonati i zinkut  $\text{ZnCO}_3$  është pluhur amoif, pothuaj i patretshëm në ujë. Kur hidhet në ujë shndërrrohet pjesërisht në kripë bazike, kurse gjatë valimit shndërrrohet plotësisht. Karbonati bazik i zinkut ka përbërje të ndryshme nga karbonati i zinkut. Ky është një pluhur i bardhë me dendësi  $4440 \text{ kg/m}^3$ , që tretet fare pak në ujë. Në temperaturën  $140^\circ\text{C}$  shpërbëhet në  $\text{ZnO}$ ,  $\text{CO}_2$  dhe  $\text{H}_2\text{O}$ .

### 25.2.3.1. Gatitja e karbonatit të zinkut

Për përfshimin e karbonatit të zinkut veprohet në këtë mënyrë: Në tretësirën e ftohtë të 15 g  $\text{ZnSO}_4 \cdot 7\text{H}_2\text{O}$  në 700 ml ujë hidhen, duke e përzier, 300 ml tretësirë e ngopur hidrogjenkarbonati kaliumi  $\text{KHCO}_3$ . Përzierja lihet 3-4 ditë në mjeshtë ftohtë, deisa precipitati i shkrifët të shndërrohet në pluhur kristalor. Pastaj lahet me dekantim me ujë të ftohtë (ujë në temperaturën  $0^\circ\text{C}$  deri në largimin e joneve sulfat  $\text{SO}_4^{2-}$  (prova me tretësirë kloruri bariumi) dhe thahet në  $20\text{--}30^\circ\text{C}$ .

1) Provat tregojnë se sasia e hidroksidit të kalumit duhet të jetë pak më e vogël se sasia që llogaritet mbi bazën e taazimit të reaksionit, në të kundërtën, riqarati ruk përfshihet i pastër.

Përfshken rreth 6,3 g kripë.

Karbonati i zinkut mund të përfshohet edhe nga sulfati i zinkut. Për këtë, në tretësirën që valon, të 9 pjesëve në masë  $\text{Na}_2\text{CO}_3 \cdot 10\text{H}_2\text{O}$  hidhet në formë curili, duke e trazuar vazhdimisht, tretësira që përmban 2 pjesë në masë  $\text{ZnSO}_4 \cdot 7\text{H}_2\text{O}$ . Përzierja valohet 5-10 min dhe pas precipitimit, filtrohet. Precipitati lahet me dekantim me ujë të ngrohtë, deri në largimin e joneve sulfat  $\text{SO}_4^{2-}$  (prova me tretësirë kloruri bariumi) dhe filtrohet. Thahet me anë të letrave filtruese e pastaj në  $100^\circ\text{C}$ .

## 25.2.4. Kloruri i zinkut


### a) Kloruri i zinkut anhidër



$$M = 136,28 \text{ g/mol}$$

$$d = 2910 \text{ kg/m}^3$$

### b) Kloruri i zinkut kristalhidrat




$$M = 163,28 \text{ g/mol}$$

Kripa arhidër është puhui i bardhë. Preparati i shkrirë formon një masë të tejtë këm me pamje si porcelani. Në temperaturën  $650-700^\circ\text{C}$  formon tym të bardhë të derdur ( $\text{ZnCl}_2$  i sublimuar). Reaktivi është shumë higroskopik; tretet shumë mië i ë ujë, ( $78,6\%$ , në  $20^\circ\text{C}$ ) rë alkool etilik, eter dietilik dhe glicerinë.

Hidrati  $\text{ZnCl}_2 \cdot 1 \frac{1}{2} \text{H}_2\text{O}$  formon kristale pizmatike, pa ngjyrë, që quilen në ajër. Është i qëndrueshkëm vetëm në temperaturën  $12,5-26^\circ\text{C}$ ; tretet shumë mië në ujë, në alkool etilik e glicerinë.

### 25.2.4.1. Gatiqë e klorurit të zinkut

Kloruri i zinkut në gjendje të shkrirë mund të përfshohet sipas metodikës së bazuar në tretjen e zinkut në acid klorhidrik:



Zinku (fletë) pritet në copa, lahet me tretësirë 5% acidi klorhidrik (teknik), pastaj me ujë dhe thahet.


Në një gotë kimike hidhet 40 g zink dhe 100 ml ujë. Shtohen në të, dalëngadalë (në kapë), 100 ml acid klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ), duke e përzier trallë. Kur do të shitet çlirim i hidrogjenit, tretësira ngrohet në banjë uji, derisa ndalon çlirim i fluskuave të gazit që lihet në qetësi një natë (12 h). Pasi të ndahet tretësira nga metali që ka mbetur, gurgullohet në të (në kapë) klor 10-15 min; hidhen 20-25 g karbonat zirku  $\text{ZnCO}_3$  dhe ngrohet në banjë uji 1 h, duke e përzier trallë. Pas precipitimit, përzierja filtrohet.

Filtrati avullhet në banjë uji deri në  $1/3$  e vëllimit dhe ngrohet deri në formë min e një mase të thatë. Në masën e thatë shtohet 1 ml acid klorhidrik ( $d = 1190 \text{ kg/m}^3$ ) dhe nxehet derisa të ndërpitet çlirim i fluskuave. Kripa e shkrirë

hidhet në një kupshore porcelani dhe ftohet në eksikator me acid sulfurik të përendruar. Reaktivi hidhet në shishe, mbyllt me tapë prej lëvoreje dhe vuloset me parafinë.

Përftohen rrerh 65 g kripë.

### 25.2.5. Nitrati i zinkut




$$M = 297,47 \text{ g/mol}$$

$$d = 2065 \text{ kg/m}^3$$

Nitrati i zinkut formon kristale pa ngjyrë të sistemit hekzagonal. Me ngrohje në temperaturën rrerh  $36,4^\circ\text{C}$ , kripa tretet në ujin e kristalizimit. Nitrati i zinkut tretet mirë në ujë ( $53,7\%$  e kripës anhidër, në  $18^\circ\text{C}$ ).

#### 25.2.5.1. Gatitja e nitratit të zinkut

Nitrati i zinkut i pastër mund të gatitet nga veprimi i zinkut me acid nitrik:



Në një kupshore porcelani (në kapë) hidhen 45 ml ujë dhe 32 ml acid nitrik  $\text{HNO}_3$  ( $d = 1400 \text{ kg/m}^3$ ). Në tretësirën e ngrohur deri në  $50^\circ\text{C}$ , hidhen, me porcione të vogla, 12,5 g zink i kokërrzuar ose 16 g oksid zinku (i pastër). Me mbarimin e reaksionit, tretësira lihet të precipitojë dhe filtrohet. Filtrati avullohet<sup>1)</sup>, derisa në sipërfaqen e tij të formohet një shtresë kristalore, pastaj ftohet duke e përzier shpesh. Kristalet që bien, hidhen në letër filtruese dhe mbyllen në shishe me tapë të smeriluar.

Përftohen 30-40 g kripë.

Tretësira mëmë me avullim dhe rikristalizim jep edhe një sasi tjetër kripe.

Nitrati i zinkut i pastër mund të përftohet edhe me anë të kësaj metodike: Në një kupshore porcelani (në kapë) hidhen 60 ml ujë dhe 20 g zink i kokërrzuar; shtohen në të dalëngadalë 40 ml acid nitrik ( $d = 1400 \text{ kg/m}^3$ ). Kur reaksiuni dobësohet, tretësira me zinkun që mbetet, ngrohet në banjë uji 2-2,5 h<sub>1</sub> çlirohet kripa bazike së bashku me  $\text{Fe(OH)}_3$ . Zinku i patretur largohet nga tretësira dhe tretësira ngrohet edhe 40-45 min (për të bërë precipitimin e plotë të joneve  $\text{Fe}^{3+}$ ). Në qoftë se precipitimi i joneve  $\text{Fe}^{3+}$  nuk ka mbaruar, atëherë tretësira hidhen rrerh 0,5 g  $\text{ZnO}$  dhe tretësira ngrohet 10-15 min. Pastaj tretësira filtrohet; filtrati acidifikohet pak dhe avullohet në  $80-90^\circ\text{C}$ . Kristalet (që bien) hidhen në letër filtruese dhe lahen me 10-15 ml ujë.

**Shënim.** Në qoftë se tretësira mëmë avullohet dhe ftohet, veçohen edhe 20

g kripë, e cila, po të lahet dhe të kristalizohet, jep 10-12,5 g reaktiv të pastër. Rendimenti i përgjithshëm është rrerh 40 g.

1) Në qoftë se si lëndë e parë përdoret oksid zinku, atëherë përpara avullimit tretësira duhet acidifikuar me pak acid nitrik, deri në reaksiun të dobët acid.

## 25.2.6. Oksidi i zinkut

ZnO

M = 81,37 g/mol

d = 5600 kg/m<sup>3</sup>

Oksidi i zinkut është pluhur amorf me ngjyrë të bardhë në të verdhë. Ka qëndrueshmëri termike, me ngrohje zverdhet (me ftohje rifiton ngjyrën e mëparshme), në 1800° sublimon. Oksidi i zinkut është i patretshëm në ujë ( $2,6 \cdot 10^{-4}\%$  në 25°C).

Vepron si me acidet, ashtu edhe me alkalet (ka veti amfotere), nuk reduktohet nga hidrogjeni.

### 25.2.6.1. Pastrimi i oksidit të zinkut

Preparati «pa squfur» mund të përfshohet nga produkti teknik (e bardha e zinkut) në këtë mënyrë:

Në një gotë porcelani, me nxënësi 1 l, hidhen (në kapë) 140 g karbonat amoni ( $\text{NH}_4\text{CO}_3$ ), 200-250 ml ujë dhe 50 ml hidroksid amoni  $\text{NH}_4\text{OH}$  ( $d = 910 \text{ kg/m}^3$ ). Në përzierje shtohen dalengadalë 50 g oksid zinku (teknik) dhe (pas 20-40 min) 20 g tallash zinku (për të precipituar papastërtitë e plumbit). Për t'u bindur për veçimin e plotë të plumbit, bëhet prova me tretësirë të sulfurit të hidrogjenit (nuk duhet të vërehet ngjyrosje e errët). Tretësira filtrohet me letër filtruese dy herë të palosur dhe të lagur paraprakisht me tretësirë amoniakore 10%. Filtrati hidhet në kupshore porcelani dhe avullohet (në kapë) në banjë uji deri në 1/3 e vëllimit. Gjatë avullimit çlirohet amoniak  $\text{NH}_3$ , dioksid karboni  $\text{CO}_2$  dhe kristalet e karbonatit bazik të zinkut që precipitojnë. Lëngu i ngrohtë filtrohet, kristalet lahen 3-4 herë me ujë, vendosen në një kupshore porcelani dhe thahen në temperaturën 100-125°C; pastaj gëlqerizohen në 400°C, derisa mostra e preparatit të tretet në acid, pa çliruar flluska dioksidi karboni  $\text{CO}_2$ . Përfshohen 30-34 g oksid zinku; rendimenti është 60-70%.

### 25.2.6.2. Gatitja e oksidit të zinkut

Për të përfshuar preparat të pastër oksidi zinku, si lëndë e parë merret nitrati i zinkut  $\text{Zn}(\text{NO}_3)_2$  (shih paragrafin 26.2.5).


Treten 100 g  $\text{Zn}(\text{NO}_3)_2 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$  në 300 ml ujë, shtohen 5 ml  $(\text{NH}_4)_2\text{S}$  dhe përzierja lihet 24 h, duke e trazuar rrallë. Pastaj filtrohet (në qofte se dñejet), hollohet me një vëllim të njëjtë uji dhe, duke e përzier, shtohet në të hidroksid amoni  $\text{NH}_3 \cdot \text{H}_2\text{O}$  ( $d = 992 \text{ kg/m}^3$ ) deri në precipitim e plotë të  $\text{Zn}(\text{OH})_2$  (rreth 55 ml). Precipitati hidhet në letër filtruese<sup>1)</sup> dhe lahet 8-10 herë me ujë të nxehëtë (me porcione nga 50-60 ml). Hidroksidi i zinkut  $\text{Zn}(\text{OH})_2$  i lagësht vendoset në shtresë të hollë në një kupshore porcelani dhe thahet në 100-120°C, duke e përzier shpesh. Pastaj gëlqerizohet 3-4 h në temperaturën 500-550°C.

Përfshohen rreth 20 g oksid zinku.


1) Filtrimi duhet bërë me filter bezeje.

## 25.2.7. Sulfati i zinkut

### a) Sulfati i zinkut anhidër



### b) Sulfati i zinkut kristalhidrat



Sulfati i zinkut formon kristale pa ngjyrë të sistemit rombik. Tretet shume mirë në ujë (33,4% e kripës anhidër, në 15°C). Është e patretshme në alkool etilik.

Në ajër të thatë kripa dalengadalë shkrifërohet. Në temperaturën 39°C shkrin në ujin e kristalizimit duke u shndërruar në  $\text{ZnSO}_4 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$ , në 230-250°C çbidirohet dhe në temperaturë më të lartë shpërbëhet në  $\text{ZnO}$  dhe  $\text{SO}_3$ .

### 25.2.7.1. Gatitja e sulfatit të zinkut

Në 115 g acid sulfurik  $\text{H}_2\text{SO}_4$  20% (të pastër) hidhen (në kapë) 17 g zink kokërrzor. Në fund të reaksionit përzierja ngrohet; një sasi e vogël zinku duhet të mbetet e patretur<sup>1)</sup>. Në tretësirë hidhen 2-3 pika ujë të oksigjenuar  $\text{H}_2\text{O}_2$  30% dhe një qull i përgatitur nga disa kristale  $\text{ZnCO}_3$  ose  $\text{ZnO}$  me disa pika ujë. Përzihen me kujdes dhe lihen të precipitojnë. Pasi të bindemi për precipitimin e plotë të hekurit (prova me tretësirë të sulfocianurit të amonit  $\text{NH}_4\text{SCN}$ ), përzierja filtrohet. Filtrati avullohet deri në formimin e një cipe kristalore të dendur, pas taj ftohet (me ujë), duke e përzier shpesh. Kristalet hidhen në letër filtruese (ose në hinkën për filtrim në zbrazëti) dhe thahen në temperaturën e mjedisit.

Përfshohen rreth 50 g kripë.

1) Për gatitjen e sulfatit të zinkut mund të përdoret edhe tretësira e mbetur nga aparati i Kippit (gjatë gatitjes së hidrogenit nga  $\text{H}_2\text{SO}_4$  dhe Zn).

# Sh tojce

## 1. Përzierjet ftohëse

Gjatë tretjes shumë kripëra thithin një sasi të madhe nxehësie. Duke përdorur për tretjen e tyre akull ose borë (jo ujë) arrihen temperatura edhe më të ulëta.

Akulli e kripa përzihen në formën e grimcave të imëta, në mënyrë që të i riitet sipërfaqja e takimit.

### 1.1. Përzierjet ftohëse nga akulli ose bora me kripëra

Në tabelën 1 jepet ulja e temperaturës, kur përzihet kripa me 100 g boë ose akull të grimcuar.

Tabela 1

Kripa	Sasia në gramë	Temperatura në °C
klorur natriumi $\text{NaCl}$	33	-21,2
sulfat amoni anhidër $(\text{NH}_4)_2\text{SO}_4$	62	-19
sulfat amoni i hidratuar $(\text{NH}_4)_2\text{SO}_4 \cdot 10\text{H}_2\text{O}$	96	-1,2
sulfat magnezi i hidratuar $\text{MgSO}_4 \cdot 7\text{H}_2\text{O}$	51,5	-3,9
karbonat natriumi i hidratuar $\text{Na}_2\text{CO}_3 \cdot 10\text{H}_2\text{O}$	20	-2,1
klorur kaliumi $\text{KCl}$	30	-11,1
klorur amoni $\text{NH}_4\text{Cl}$	25	-15,8
nitrat natriumi $\text{NaNO}_3$	59	-18,5
tiosulfat natriumi i hidratuar $\text{Na}_2\text{S}_2\text{O}_3 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$	67,5	-11,0
klorur kalciumi i hidratuar $\text{CaCl}_2 \cdot 6\text{H}_2\text{O}$	14,3	-55
nitrat amoni $\text{NH}_4\text{NO}_3$	45	-17,3

## 1.2. Pérzierje ftohëse nga acidet dhe bora (ose akulli)

Duke pérzier acid me borë (ose akull), pérftohet një ulje temperaturë që tregohet në tabelën 2.

Tabela 2

Pérzierja	Temperatura °C
1 pjesë acid klorhidrik i përqendruar me 1 pjesë borë (ose akull)	-37,5
1 pjesë acid nitrik i përqendruar me 2 pjesë bore (ose akull)	-56
